Sabir Krasniqi

PARAPSIKOLOGJIA

SHKENCË QË TROKET NË DYERT E TË SOTMES

Natyra nuk i thyen liqjet e veta,
jemi ne ata që nuk arrijmë t'i kuptojmë ato.

www.sa-kra.ch

„SA-KRA"

Sabir Krasniqi - PARAPSIKOLOGJIA

Sabir Krasniqi

PARAPSIKOLOGJIA

Shkencë që troket në dyert e të sotmes

Biblioteka: „SA-KRA”
www.sa-kra.ch

Redaktor / Lektor:
Hasan HAMËZBALA

Recensent:
Salih BASHA
Dr. Xhevat HASANI

Kopertina:
Sabir KRASNIQI

Botimi i dytë i plotësuar
(Botimi i parë, Prizren 1996, Biblioteka „Astra”)

© 2019 autori

Sabir Krasniqi

PARAPSIKOLOGJIA

Shkencë që troket në dyert e të sotmes

Kreuzlingen 2019

PARATHËNIA

Më vjen mirë që shoku Sabir Krasniqi e ka ndërmarrë një hap të tillë për ta shkruar këtë libër mbi parapsikologjinë. Edhe pse parapsikologjia është lëmë shumë e gjerë për të cilën janë shkruar, e shkruhen edhe sot, numër i madh librash në mbarë rruzullin tokësor si dhe bëhet numër i madh eksperimentesh, edhe libri i shoku Sabir e zë një vend në mesin e tyre. Libri është shkruar me kujdes e vëmendje dhe autori sadopak është munduar që ta shuaj etjen për të panjohurën dhe të fshehtën.

Vetë, si shkrues i këtyre rreshtave, që edhe merrem personalisht me parapsikologji dhe drejtime të ndryshme të zhvillimit të lartë spiritual, e kryesisht „Mistik", jam pjesëmarrës okular kur autori i këtij libri ka bërë eksperimente me hipnozë, autohipnozë, sugjestione, ndërtim eksperimental të piramidave, radistezi (gjetjen e rrezatimeve negative në dhomë nga rrjetet e ujërave nëntokësore, rrezatimet e të cilave u sjellin shumë sëmundje dhe fatkeqësi njerëzve), hulumtime për shërim, si të shpirtit ashtu edhe të trupit fizik etj.

Autori i këtij libri është munduar që juve, lexues të nderuar, t'jua tregoj të mirat dhe të këqijat e parapsikologjisë, si p.sh.: aftësitë shëruese të saj dhe zhvillimin mental në nivel të lartë, forcën e madhe të veprimit psikik, si dhe shumë e shumë dukuri të tjera që nuk i pranon logjika, por që ekzistojnë dhe veprojnë. Gjithashtu edhe anët negative të saj, si: keqpërdorimet në kriminalistikë, politikë, organizata të fshehta ku bëhet pastrimi (shpëlarja) e trurit e ku njerëzit i shndërrojnë në armë të forta për qëllime të errëta etj.

I uroj suksese të mëtejme shokut, Sabir Krasniqi, dhe i dëshiroj që të punojë në këtë lëmi edhe më tutje.

Salih BASHA (Mistik)

FJALA E RECENSENTIT

Libri „Parapsikologjia” i autorit Sabir Krasniqi më është dhënë për vlerësim, ndonëse me profesion jam mjek dhe posedoj vetëm dije elementare nga lëmi i psikologjisë dhe parapsikologjisë. Do të thosha se libri në fjalë është libër pionier, sidomos në lëmin e parapsikologjisë, meqë gjer më tani nuk ka ende diç të shkruar në gjuhën shqipe. I bërë nga autori me kureshtje të madhe pozitive, ky libër do të mund t’u shërbente, jo vetëm individëve të ndryshëm, por edhe atyre të cilët merren tani ose edhe do të merren në të ardhmen me psikologji e parapsikologji, kurse autorit do t’ia shtojë kurajën për hapa të tjerë në këtë drejtim.

Ky libër, ndër të tjera, paraqet edhe një dritare për shkencën shqiptare në fushën e parapsikologjisë, meqë është i pari i këtij lloji në gjuhën tonë. Ai, sado që është libër i karakterit alternativ-shkencor, me punën e mëtutjeshme të autorit në fjalë ose edhe të autorëve të tjerë, është udhërrëfyes që në të ardhmen të marr formën e një libri shkencor. Me rëndësi është se autori i cili e ka hartuar këtë libër, nuk është ndalë vetëm tek literatura të cilën e ka shfrytëzuar, por në të njëjtën kohë ai nuk ka ngelur duarkryq. Në fakt ai edhe vet ka eksperimentuar në këtë lëmi dhe përvojën e vetë e ka cekur në këtë libër.

Duke pasur parasysh se tani afro një milion shqiptarë nga Kosova dhe viset tjera shqiptare janë vendosur nëpër vende të ndryshme të Evropës Perëndimore, e cila aktualisht paraqet djepin e kulturës, artit dhe shkencës, do të ishte mirë që secili prej nesh, duke u bazuar në shembullin e Sabir Krasniqit, të bëjë diç brenda mundësive që ka, në kuadrin e profesionit dhe prirjeve që posedon. Vetëm kështu do ta zbusim sadopak dëmin dhe tragjedinë e madhe, e cila e ka kapluar popullin tonë në këto kohët e fundit.

Sa i përket fenomeneve parapsikologjike, ato ajanë prezentë në mbarë njerëzimin, tek të gjithë popujt, duke mos e përjashtuar edhe popullin tonë, por puna është që brenda këtyre fenomeneve, duke i studiuar mirë ato, të ndahet çfarë është në bazë psikomateriale, çfarë është e pasaktë, çfarë është gënjeshtër ose edhe fantazi e sëmur e individit ose grupit, i cili pretendon se merret me parapsikologji. Për të mos ndodhur shkarje të tilla, duhet që idetë e ndryshme mbi këto fenomene të vërtetohen me eksperimente, siç ka bërë përpjekje edhe autori i këtij libri.

E përfundoj vlerësimin tim për këtë libër duke i dëshiruar autorit (S.K.) suksese të reja dhe punë të mbarë në këtë lëmi.

Me respekt
Dr. Xhevat HASANI


Sabin
Krasniqi

TEORITË EKZISTUESE MBI PREJARDHJEN E JETËS NË TOKË

Njëra prej pyetjeve më të diskutueshme, por edhe njëra ndër më të vështirat për t'i dhënë përgjigje shkencore, është ajo mbi prejardhjen e jetës në tokë. Me gjithë përparimet e shumta, falë teknologjisë moderne, shkenca akoma nuk ka arritur që të japë një definicion përfundimtar për këtë çështje.

Teoritë, tezat e hipotezat mbi prejardhjen e jetës në tokë janë të shumta dhe ekzistojnë që nga antika e lashtë.

Sipas Talesit të Miletit (filozof, astronom, gjeometër dhe matematikan grek, autor i veprave filozofike të cilat më vonë, nga shumë shkencëtarë, merren si pikënisje e punës së tyre) jeta në tokë ka filluar nga uji. Sipas Talesit, pasi që uji ka mundësi transformimi dhe si lëndë është shumë i përhapur, është substanca dhe principi i lidhjes së çdo ndodhie: shkaku, prejardhja, materia, elementi.

Herakliti e sheh zjarrin si krijues të jetës. Një thënie e tij për zjarrin është : „Gjithçka shndërrohet në zjarr dhe zjarri shndërrohet në gjithçka, siç këmbehet ari me një mall dhe një mall me arin".

Aristoteli mendonte se jeta ka filluar në ujë, në mënyrë spontane, përkatësisht nga vetëlindja.

Një teori tjetër supozon se jeta ka origjinë nga kozmosi dhe se ajo mund të shtrihet në gjithësi, nga njëri planet në tjetrin.

Engelsi shtron teorinë e prejardhjes së jetës në tokë nga materiet jo të gjalla. Më vonë teorinë e pranoi dhe e përpunoi A. J. Oparin, hulumtues sovjetik, i cili thotë se jeta në tokë nuk ka prejardhje spontane as të rastësishme, por të ligjshme.

Me arritjen e njeriut në hënë, si dhe me fluturimin e fluturakeve të ndryshme në planetët tjerë, viteve të fundit, gjithnjë e më shumë përhapet mendimi se mundësia e bartjes së

organizmave të gjalla në gjithësi është e realizueshme. Gjithashtu, ekziston mendimi se njeriu ka ardhur ose është dërguar nga planetët tjerë, ku ekzistojnë qenie të gjalla me intelekt.

Teoria e Panspermias niset nga ajo se jeta nuk ka filluar spontanisht në Tokë, por u soll këtu nga hapësirat tjera. Kometat mund të kenë qenë transportues ideal të baktereve të para. Këtë teori e sugjerojnë edhe shumë shkencëtarë; pasi që kometat përbëhen edhe nga një pjesë e konsiderueshme akulli, ato edhe kanë veti rezistuese duke i konservuar dhe mbrojtur bakteret nga rrezatimet kozmike, të cilat edhe e kanë arritur Tokën, duke i dhënë jetë asaj.



Eksperimenti i famshëm i kimistëve Stanley Miller dhe Harold Urey, që u raportua në vitin 1953, ngrit një hipotezë të re se jeta në Tokë mund të jetë krijuar me ndihmën e shkëndijave elektrike, gjegjësisht, rrufesë. Elektriciteti i krijuar nga rrufeja

mund të gjenerojë aminoacide dhe sheqerna nga një atmosferë e ngarkuar me ujë, metan, amoniak dhe hidrogjen. Ka mendime nga shkencëtarët se retë vullkanike, në atmosferën primitive, mund të kenë mbajtur metan, amoniak e hidrogjen. Vullkanet aktive, të para disa miliarda vitesh, kanë lëshuar gazra dhe minerale në atmosferë (që ishte larg dendësisë së kësaj të sotmes) përmes së cilave është krijuar një përzierje kimike (aminoacide, tullat e proteinave, molekula të domosdoshme për jetën) nga e cila, me kohë, janë krijuar organizma të thjeshtë, pastaj më kompleksë, dhe kështu ka filluar gjallërimi i jetës në Tokë.

James Cleaves dhe Jeffrey Bada, duke u nisur nga eksperimenti i S. Millerit dhe H. Ureyt, erdhën te një ide e re. Ata shtuan në përzierjen e gazrave disa tamponë për të neutralizuar përbërjet azotike, përpara se këto të arrinin të dëmtonin aminoacidet, e cila edhe funksionoi. Nga kjo del se origjina e jetës varet nga një proces ngjarjesh fizike, kimike e biologjike, të cilët u përshtaten kushteve të evolucionit. Mirëpo, për ta kuptuar më thellësisht se si prej gazrave të atmosferës së hershme arrihet në përbërje organike, shkencëtarët u nisën nga ARN-ja (acidi ribonukleik). ARN-ja përbëhet nga molekula më të vogla, të quajtura nukleotide dhe të lidhura mes tyre. Është një version njëfillësh i ADN dhe kryen shumë funksione të rëndësishme në të gjithë qelizat e gjalla.

Së fundmi, është arritur të dëshmohet se disa nukleotide ARN-je mund të rrisin shkallën e zhvillimit të disa reaksioneve kimike specifik edhe të krijojnë spontanisht një molekulë vetë-riprodhuese.

Nëse një molekulë ARN-je mund të riprodhonte vetveten, ajo mund të krijonte bazat për jetën e një organizmi të thjeshtë.

Se fragmentet e ARN-së dinë të shfrytëzojnë nukleotidet e lira për të formuar një molekulë të ARN-së, të ngjashme me molekulën që është tashmë e pranishme në solucion, arritën ta demonstrojnë në laborator Tracely Lincoln dhe Gerald Joyce.

Pas procesit të kopjimit, molekulat e ARN-së (të vjetrat dhe të rejat) ndahen, duke mundësuar kështu vazhdimin e një kopjimi tjetër, pra vetë-prodhimin. Mirëpo, që të arrihet deri te një përbërje organike me të cilën fillon dhe procesi i jetës, ARN-ja duhej të gjente kushte të përshtatshme, p.sh. një qelizë në Tokën e para disa miliarda vjetësh.



Jack Szostak, i cili u laureua me Çmimin Nobel pikërisht për këto kërkime, bashkë me kolegët e tij arritën të demonstrojnë „lojën” që bën ARN-aj për të arritur qëndrueshmëri më të madhe duke rënë në „kurthin” e acideve yndyrore dhe molekulave të tjera, falë variacioneve ciklore të temperaturës. Megjithatë, mbetet akoma e paqartë se si këto „protoqeliza” (versionet e para të qelizave të thjeshta), me ARN-në brenda, kanë arritur të evoluojnë drejt qelizave më të përsosura.

Në bazë të disa zbulimeve paleontologjike në gjendje fosilesh, supozohet se jeta në tok ka filluar para 500 milionë vjetësh. Megjithatë, këto gjurmime nuk japin kurrfarë të dhënash me të cilat do të sqarohej përfundimisht prejardhja e jetës të tokë. Disa mendojnë se jeta në tokë filluar para dy miliardë vjetësh mirëpo, sipas kërkimeve më të reja, supozohet se formimi kozmik i tokës ka filluar para 3.5 miliardë vjetësh e jo si mendohej më herët para 5 - 7 miliardë vjetësh. Këtë e dëshmon zbulimi i fosileve në një shkëmb sedimentar 3.4 miliardë vite të lashtë, në Streley Pool, në bregun perëndimor të Australisë. „Kemi zbuluar njësi të konservuara në mënyrë fantastike dhe të përfshira në dritare të vogla mes kokërrzave të rërës, që duket se e kanë shmangur shtypjen. Janë struktura të ngjashme me qelizat, morfologjia e tyre është e llojit biologjik

dhe kimia e tyre e pajtueshme me rrugët metabolike biologjike”, shpjegon Martin Brasier, paleobiolog në Universitetin e Oksfordit. Shkëmbi përmban struktura mikroskopike të ngjashme me qelizat, të rrethuara nga gjurmë kimike, tregues ky i një aktiviteti biologjik. Bëhet fjalë për izotope të karbonit të pranishme në përmasa që tregojnë konvertimin nga CO2 – anhidriti karbonik – inorganik, në molekulat organike që prodhohen prej qelizave të gjalla.

Në kohët e fundit rëndësi e posaçme u kushtohet rrezeve kozmike, rrezeve të diellit dhe rrezeve radioaktive. Supozohet se në periudhat gjeologjike më të hershme (para dy miliardë vjetësh) intensiteti i këtyre rrezeve ka mundur të jetë relativisht më i fortë në momente të caktuara e kjo ka mundur të ndikojë në formimin e jetës, gjithashtu edhe në ndryshimin e formës te qeniet e gjalla.

Duhet të pranojmë se njeriu është larg njohjes përfundimtare mbi krijimin e jetës në tokë. Për këtë duhet të pranohen teoritë e mësipërme, kuptohet me rezervë të caktuar, deri në atë moment kur shkenca do të krijojë në mënyrë artificiale materien e gjallë.

TEORITË MBI PREJARDHJEN E NJERIUT NË TOKË

Prejardhja e njeriut në tokë është çështje e cili i ka munduar edhe popujt e lashtë, duke filluar nga sumerët, akadët, babilonasit, fiset maja e deri në ditët tona. Dhe me të drejtë pasi njeriu, si qenie humane, ndryshon dukshëm nga qeniet e tjera që e popullojë planetin tonë. Njeriu ka strukturë të ndryshme fizike nga krijesat tjera, e në veçanti dallon me intelektin që posedon. Ai ka logjikën - parimin e të menduarit drejtë, si substancë bazike me aftësi për t'i arsyetuar veprimet, për të gjykuar, por njëkohësisht edhe për të hulumtuar, shtruar pyetje e kërkuar përgjigje. E një ndër pyetjet më bazikë është edhe kjo: „Kush jemi ne, kush është krijuese ynë, kur na ka krijuar dhe pse?". Mendime e teori ka shumë, por përgjigjja përfundimtare mungon edhe sot e kësaj dite!

Në lashtësi, duke pasur parasysh nivelin e ultë të njohurive në atë kohë, njerëzit krijuan një lloj kulti për të panjohurën. Ky kult mund të ishte krijuar edhe si shkak i frikës që ata kishin për objektet qiellore, për fuqinë e tyre të mbinatyrshme, të cilat filluan edhe t'i hyjnizojnë, veçanërisht Diellin dhe Hënën. Dielli ishte sundues i ditës, ndërsa Hëna, sunduese natës. Këto objekte ata i konsideronin si krijues të tyre andaj edhe i adhuronin dhe, si nderim për to, ndërtonin tempuj, statuja e obeliskë si dhe praktikonin rituale mistike me simbolika



Bernard Picart - Gravurë

të llojllojshme, duke shkuar aq larg saqë flijonin bimë, shtazë e edhe njerëz për ta. Dielli, duke qenë se kishte ndikim jetësor në florën dhe faunën ekzistuese, adhurohej më së shumti nga të gjitha qytetërimet e lashta. Ilirët e quanin Dieu, egjiptianët Horus, grekët Helios, romakët Sole etj.

Paganët, përveç që e konsideronin Diellin si krijues të jetës, ata besonin se ai iu ndihmonte edhe në riprodhim, andaj martesat i bënin pikërisht në ditën e diel (ditë e emërtuar sipas Diellit), madje edhe kufomën e vendosnin me fytyrë nga Dielli.

Simboli i DEA-s dardane

Si te shumë popuj paganë, edhe tek ilirët, banorët e lashtë të Gadishullit Ballkanik, adhurohej Kulti i Diellit, ku dita e diel ishte ditë e shenjtë dhe quhej -Dita e Diellit. Dielli përdorej në ornamentet e tyre dhe simbolizohej në formën e rrethit, lules, spirales etj. Kultin e Diellit e ruajtën edhe banorët e Apolonisë, që dëshmojnë edhe gravurat e gjetura në këtë qytet antik. Besohet se këto simbole i kanë trashëguar shqiptarët e sotëm pasi, edhe në ditët e sotme, Dielli dhe Hëna janë simbole dhe motive të zakonshme me përdorim të gjerë në artin popullor shqiptar.

Në vitin 247 (para erës sonë) perandori Aurel e grabiti këtë simbol hyjnor dhe e bëri si perëndi supreme të Perandorisë Romake, duke e quajtur Sol-Invictus (Dielli i Pamposhtur).

Me krijimin e religjioneve monoteiste, adhurimi i kulteve të mëhershme (Dielli, Hëna, yjet...) si krijues të njeriut dhe jetës në Tokë, mori një kuptim tjetër. Prejardhja e jetës dhe njeriut filloi t'iu atribuohej forcave mbinatyrore, gjegjësisht Zotit. Zanafilla e gjithë kësaj fillon me Abrahamin, 2000 vjet para erës sonë. Ai mohoi kultin e idhujve dhe filloi të besojë në një Zot, i cili edhe u bë Zot i Izraelit. 500 vjet më vonë, në malin e Sinait, Zoti i flet popullit të Izraelit përmes dhjetë urdhëresave të

shkruara në dy rrasa guri (ligje të dhëne nga Perëndia) që ia jep Moisiut, ku ndër të tjera thuhet: „Unë jam Zoti, Perëndia jote. Mos adhuro perëndi të tjera përveç meje. Mos bëj idhuj...”

Ky adhurim ndaj një Perëndie ishte i kufizuar, pasi praktikohej në tokën e Izraelit vetëm nga populli hebre, ndërsa në vendet dhe popujt tjerë vazhdonte tradita Politeiste (besimi në shumë hyjni).

Me përhapjen e krishterimit (në fillim të shekullit të parë) edhe islamit (gjashtë shekuj më vonë) tradita politeiste filloi ta humb pushtetin dhe të dominohej nga religjionet monoteiste. Zoti konsiderohej qenia më e lartësuar, më i ndrituri, më i madhi. Ai është i gjithëfuqishmi dhe krijues i njeriut, i të gjitha gjallesave, i gjithë jetës. Ai është zotërues dhe drejtues i çdo gjëje. Zoti e krijoi njeriu me detyrë që ta përfaqësojë kreativitetin e tij në tokë, pasi njeriu është i përkushtuari, i besuari dhe mëkëmbësi i Zotit, që të përmbushë përsosmërisht rolin e tij si qenie e përsosur e Perëndisë.

Në vitet e fundit të shekullit XVIII filloi të zhvillohej shkenca e kërkimeve për kohët e vjetra si dhe për prejardhjen dhe zhvillimin e qenieve të gjalla në tokë (pra edhe njeriut) - Paleontologjia, që kishte koncept krejt të ndryshëm nga religjionet.

Janë gjetur mbeturina të shtazëve të ndryshme, shpezëve dhe të disa organizmave që kanë jetuar para 100 ose 500 milionë vjetësh. Me zhvillimin e paleontologjisë u formua ideja se njeriu e ka prejardhjen nga speciet antropoide që i njohim sot si majmun. Në këtë përfundim sjell ngjashmëria shumë e madhe e njeriut të dikurshëm primitiv dhe majmunit, veçanërisht shimpanzesë. Sipas studimeve shkencore më të reja thuhet se aq

i ngjashëm është njeriu me shimpanzenë saqë dallimi është vetëm 1.3 %, pra 98.7 % kanë ngjashmëri - gati identikë!

Zhvillimi i mëtejshëm, jo vetëm i paleontologjisë, por edhe i fushave tjera shkencore që merren drejtpërdrejt me origjinën e njeriut si paleoantropologjia dhe arkeologjia, arrijnë në një përfundim se origjina e njeriut nuk rrjedh nga ndonjë lloj i veçantë majmuni, por prej ndonjë paraardhësi të tyre. Majmuni dhe njeriut mund të kenë një trung të përbashkët!



Në shekullin e XIX shkencëtari britanik Çarles Darvin (një natyralist britanik dhe themelues i Teorisë së Evolucionet) u paraqit me një teori të re që ishte në kundërshtim të plotë me çdo doktrinë fetare monoteiste. Në librin „Mbi origjinën e llojeve” që e publikoi në vitin1859, Darvini shtjellon teorinë e vet për evolucionin e qenieve të gjalla dhe prejardhjen e njeriut nga majmuni.

Sipas Teorisë së Evolucionit zhvillimi i krijesave të gjalla ishte si rrjedhojë e një procesi të quajtur - përzgjedhje natyrore. Gjatë periudhave tejet të gjata, një numër i vogël gjallesash të para, duk filluar nga njëqelizorët, evoluuan dalëngadalë (mikroevolucion), nëpërmjet modifikimeve fare të vogla duke sjellë, me kohë, miliona lloje të gjallesave në tokë. Këto ndryshime të vogla, nga ky proces evolutiv, u grumbulluan dhe sollën ndryshimet e mëdha (makroevolucion) që u deshën për t’i shndërruar peshqit në amfibë dhe majmunët në njerëz. Për Darvinin edhe njeriu ishte pjesë e këtij procesi të gjatë evolutiv të përzgjedhjes natyrore që lind, rritet dhe vdes sipas fatit të gjallesës, e jo produkt i Perëndisë.

Teoria e Evolucionit, pavarësisht polemikave dhe të metave, u bë një teori dominuese që u përhap shpejt në të gjithë globin e që, edhe sot e kësaj dite, ka mbështetjen e botës shkencore.

Më vonë janë publikuar edhe hipoteza të tjera mbi prejardhjen e njeriut në tokë, njëra prej të cilave është edhe ajo e B. Kurten-it, i cili e kundërshton teorinë e Darvinit dhe thotë se paranjeriu - hominoidi është krijuar para 10 ose 15 milionë vjetësh. Ai në fillim ka jetuar nëpër drunj e më vonë ka zbritur në tokë dhe, duke zhvilluar aktivitet për mbijetesë, ka filluar të marrë pozicion të drejtë. Kurteni thotë se hominoidi ka qenë i racës së vogël në krahasim me njeriun e sotëm.

Sipas teorisë, që e pranon edhe shkenca e që e përkrahin shumica e ekspertëve, Homo sapiens (nga i cili evoluoi njeriu modern) ka origjinë nga Afrika (rreth 200,000 vjet më parë), bazuar kjo në prova fosilesh të gjetura në pjesën jugore dhe juglindore të këtij kontinenti. Shumë vjet më vonë, Homo sapiensët, migruan nga Afrika në të gjithë kontinentet e tjera. Mirëpo zbulimet e reja duket se e kontestojnë teorinë e origjinës monogjene të njeriut, se ai është paraqitur në të njëjtën kohë vetëm në një vend të caktuar. Një kafkë 260,000 - vjeçare e zbuluar në vitin 1978 në Dali County të Kinës mund të jetë dëshmi e origjinës poligjene të njeriut, që nënkupton se ai është paraqitur në kohë të ndryshme dhe në kontinente të ndryshme. Sipas ekipit hulumtues kafka është shumë e ngjashme me kafkat Homo sapiens të gjetura në vitin 1961 në shpellën Jabel Irhoud në Marok.

Kafka e zbuluar në Kinë

Se njerëzit nuk e kanë origjinën vetëm nga Afrika dëshmojnë edhe provat e gjetura në vitin 2006 në Izrael, në një shpellë, në pjesën lindore të Tel Avivit. Një grup arkeologësh nga Universiteti i Tel Avivit zbuluan dhëmbë të njerëzve të lashtë pothuajse 400.000 vjet, të cilët kishin një pamje gati identike me njeriun e sotëm. Këto janë gjurmët më të vjetra të

llojit Homo sapiens të zbuluara deri më sot pasi datojnë 200.000 vjet para mbetjeve të gjetura në Afrikë. Dhe, nëse këto gjetje do të rezultojnë të sakta, atëherë gjithë teoritë ekzistuese për origjinën e njeriut, që njohim deri më sot, do të bien poshtë.

„Erdhën nga planeti Nibiru, 300,000 vjet më parë, manipuluan ADN-në e të parëve për të krijuar Homo Sapiensët" - thotë studiuesi dhe arkeologu i njohur Zecharia Sitchin në teorinë e tij ku pretendon se njeriu u krijua nga alienët, teori e cila mbështetet edhe nga shumë studiues të tjerë. Sitchin njihet si babai i historiografisë heretike i cili ka shkruar rreth 14 libra, të përkthyera në më shumë se 20 gjuhë, në të cilat sqaron origjinën e njerëzimit.

Sipas Sitchinit origjina e njeriut fillon falë një procesi gjenetik 300,000 vjet më parë, kur alienët zbarkuan në Tokë. Ata manipuluan gjenomët (seri kromozomike e një organizmi që përmban numrin e përgjithshëm të kromozomeve) e disa ekzemplarëve të Homos Erectus duke i shtuar ADN-së afro 200 prej gjeneve të tyre. Homo Erectusët u zhvilluan aq shumë saqë mësuan të përdorin vegla pune dhe të komunikojnë mes vete duke u transformuar në Homo Sapiens.

Kjo teori ka zanafillën e vet diku në shekullin XVIII, kur arkeologët zbuluan për herë të parë mbetjet e civilizimit të lashtë Sumer, një civilizim i hershëm që ka ekzistuar në zonën e Gjirit Persik e cila dikur njihej si Mesopotamia (sot Iraku jugor). Dhjetëra mijëra tabela argjile që u zbuluan nga arkeologët mahnitën jo vetëm shkencëtarët, por edhe teologët. Shënimet sumere, që konsiderohen si dokumentet më të hershmet të një civilizimi, të shkruara me shkrim piktopografik e kunjor në pllaka argjile, përmes

Pllaka argjile

tabelave, vulave cilindrike e kolonave, na japin një version shumë të pasur grafik të civilizimit të lashtë njerëzore. Janë shënime me përmbajte historike, kulturore, mitologjike, astronomike, të luftërave të mëdha, përfshirë këtu edhe historinë e krijimit të tokës dhe të njeriut.

Alienët, këto qenie inteligjente që vinin nga planeti Nibiru, sumerët i quanin Anunnaki (bijtë e zotit Anu - „ata që erdhën nga qielli në tokë"). Nibiru do të thotë „planeti i kalimit" që shfaqet në të gjithë vëzhgimet e tyre qiellore, me orbitë eliptike të njëjtë si të një komete, dhe kalon ndërmjet Marsit e Jupiterit çdo 3600 vjet. Astronomët mendonin se bëhej fjalë për Jupiterin apo Marsin por, bazuar në shënimet sumere, del se Nibiru është një planet më shumë në sistemin tonë diellor. Dhe kjo duket të jetë e saktë, pasi që më 21 tetor të vitit 2003, me anë të teleskopit 1.22 Oschin, nga pika e vëzhgimit në Malin Palomar në Kaliforni, për herë të parë u vrojtua ky planet i cili u quajt 2003 - UB - 313 ose Planeti Eris. Është zbuluar nga Michael E. Brown, Chad Trujillo dhe David L. Rabinovitz, më 5 janar të vitit 2005, bazuar në hulumtimin e fotove të bëra në datën e sipërpërmendur. 2003 - UB - 313 ose Planeti Eris është i njohur në Antikitet me emra të ndryshëm si: Nibiru, Marduk Hercolubus, Planeti i Zotit etj.



Vëzhgime të tjera, të publikuara në tetor të vitit 2005, treguan se Planeti Eris / Nibiru, i cili i afrohet tokës periodikisht një herë në 3600 vjet, mund të sjell ndryshime klimatike me pasoja të rënda natyrore si: shkrirjen e akujve, zhdukjen e gjelbërimit, tharjen e kores së tokës, pakësimin e oksigjenit, me fjalë të tjera mund të jetë fundi i jetës në Tokë, fenomene këto që përmenden edhe në profecitë e lashta.

Sitchin mendon se sumerët janë produkt i çiftëzimit me një racë alienësh që kanë pamje të ngjashme me tonën. Historia e krijimit të njeriut duhet të ketë ndodhur kështu: Anunnakët filluan ta vizitojnë Tokën dhe bëmat e tyre janë ato që lexojmë edhe në Besëlidhjen e Vjetër ose tek Epi i Gilgameshit. Në vazhdim ata e kolonizuan Tokën në një moment të favorshëm për ta. Duke pasur nevojë për njerëz, që do të punonin në minierë për të mbledhur ar që u nevojitej për mbylljen e ozonit në planetin e tyre, ata krijuar njeriun që korrespondon me Homo Sapiensin.

Në shkrimet sumere, ku është ruajtur kultura dhe historia e këtij civilizimi të lashtë, thuhet se „njeriu u krijua për të adhuruar” por, në një përkthim të më vonshëm, fjala „adhuruar” dilte të ishte „punuar” - „njeriu u krijua për të punuar”.

Se njeriu është dizajnuar nga alienët e pohojnë edhe dy shkencëtarë nga Kazakistani të cilët kaluan mbi 13 vjet duke punuar në Projektin e Gjenomit Njerëzor (Human Genome Project). Maxim A. Makukov, nga Instituti Astrofizikal i Fesenkov dhe Vladimir I. shCherbak, nga Universiteti Kombëtar i Kazakistanit, mendojnë se njeriu është dizajnuar nga një civilizim alienësh të cilët kanë dashur të ruajnë një mesazh në ADN-n e njeriut ose të krijojnë jetë në ndonjë planet tjetër.

Konstatimin për teorinë e tyre ata e kanë nxjerr nga vendosja e modeleve aritmetike dhe simboleve gjuhësore ideografike të koduara nga alienët dhe besojnë se 87% e ADN-së njerëzore janë kode gjenetike nga format jetësore të alienëve.

Teorinë e prejardhjes së njeriut nga alienët e mbështet

fuqishëm edhe studiuesi dhe autori i shumë librave, zvicerani Erich von Deniken. Ai supozon se njeriu e ka prejardhjen nga gjithësia - nga planetë të tjerë që, në disa periudha dhe në marrëdhënie seksuale me krijesat e tokës, kanë krijuar racën e re të njerëzimit, pjesë e së cilës jemi ne sot. Të njëjtët alien nga gjithësia u kanë dhënë njerëzve në tokë njohuritë e para nga shkenca dhe teknika. Sipas tij edhe piramidat egjiptiane janë ndërtuar sipas udhëzimeve të alienëve për të zgjuar vetëdije e shoqërisë së atëhershme njerëzore.

Një teori e re për prejardhjen e njeriut vjen nga profesori i ekologjisë, Dr. Ellis Silver. Ai thotë se ka shumë shenja që tregojnë se njerëzit nuk evoluuan bashkë me format e tjera të jetës në Tokë. Në librin e tij „Njerëzit nuk janë nga Toka: Një evoluim shkencor i dëshmisë” ai paraqet një përmbledhje teorish si dëshmi se njerëzit nuk janë nga Toka ku ndër të tjera thotë:

-Njeriu ka dhimbje shpine, gjë që kafshët tjera në Tokë nuk e kanë. Kjo ndodh shkaku se anatomia e specieve tona ka evoluuar në një planet me gravitet të ulët.

-Njeriu nuk u pajisë gjatë procesit evolutiv, që në ambientin natyror t’i rezistojë të ftohtit ose të ngrohtit.

-Njeriu është qenia e vetme në Tokë që ka më së shumti komplikime gjatë lindjes natyrale e cila nganjëherë mund të rezultojë me fatalitet për nënën ose foshnjën e porsalindur. Kjo ndodh pasi koka e të porsalindurit është mbiproporcionale.

-Njeriu ka frikë jashtëzakonisht të madhe nga fatkeqësitë natyrore, edhe pse katastrofa të tilla e kanë përcjell gjatë gjithë evolucionit.

-Njeriu nuk mund t’i ekspozohet gjatë Diellit pa iu djegur lëkura. Kjo dëshmon se planeti i origjinës sonë ka qenë në largësi të madhe nga dielli ose ka qenë rezistent ndaj

rrezatimeve etj.

Dr. Ellis mendon se njerëzimi nuk evoluoi nga një formë e veçantë e jetës, por evoluoi diku tjetër dhe u transportua në Tokë (si homo sapien shumë të evoluar) rreth 60,000 - 200,000 vjet më parë.

Mendohet, gjithashtu, se edhe Atlantët, ndoshta dhe Lemurët, për të cilët flet edhe Platoni, janë produkt i çiftëzimit të grave të Tokës me alienët.



Një teori tjetër rreth prejardhjes së njeriut është edhe Teoria e Ujit. Qysh në vitin 1923 patologu nga Berlini, Max Westenfofer, shkruan për këtë teori. Një përmbledhje rreth kësaj ideje ai e publikon në librin e tij „Rrugëtimi unik i njeriut" të botuar në vitin 1942. Ai besonte se përgjatë historinë së evoluimit, njeriu ka kaluar nëpër një fazë të një procesi hidro-ekologjik. Westenfofer nuk e sheh njeriun si pasardhës nga ndonjë lloj majmuni, por si pasardhës i drejtpërdrejtë i amfibeve (ujë-tokësoreve, gjegjësisht bretkosës) dhe salamandrës (hardhucë me pika të verdha në trup). Ky proces i gjatë transformues ka imponuar ndryshime shumë të rëndësishme në organizimin trupor, të jashtëm dhe të brendshme, të gjallesave për përshtatje me kushtet ambientale.

Teoria e Ujit avancohet nga Alister Hardy pas viteve 1930, një biolog që studionte zhvillimin e jetës përgjithësisht në dete. Hardy, procesin hidro-ekologjik të transformimit e bazonte në krahasimet që bëri me balena. Balenat janë gjitar deti dhe, si të gjithë gjitarët tjerë, thithin ajër me mushkri, ushqejnë të vegjlit

me qumësht gjiri dhe kanë pak flokë. Gjithashtu, shumë studiues pranojnë faktin e ngjashmërisë së theksuar anatomike ndërmjet veshit të balenës dhe atij të njeriut. Të dhënat krahasuese balenë-njeri, që i kishte mbledhur si biolog, i publikoi si artikull shkencor në gazetën prestigjioze „New Scientist" në mars të vitit 1960. Hipotezat e Hardyt, 10 vjet më vonë, u zhvilluan dhe popullarizuan nga gazetari britanik Eliane Morgan. Sipas Hardyt dhe Morganit, njeriu erdhi drejtpërdrejt nga uji - ne ishim dikur një lloj primati i detit, apo peshqit humanoid. Paraardhësi ynë ishte një lloj majmuni nga familja e prokonsulëve, i cili, para se të kalonte në tokë, jetoi miliona vjet në ujë.

Në favor të kësaj shkon edhe aftësia e një të porsalinduri të cilin po ta vendosim në ujë, menjëherë pas largimit nga barku i nënës, ai do të ndihet i madh. Ai tanimë di se si të notoj!

Për fund mund të thuhet se të gjitha supozimet, teoritë e hipotezat rreth prejardhjes së njeriut nuk duhet të jenë pengesë për gjurmime të mëtejme shkencore përkundrazi, ato duhet të jenë një ndihmesë - bazament për hapat pasues. Megjithatë, e drejta shkencore është që t'u besojë dëshmive të bazuara në fakte bindëse dhe të shpresojë, falë teknologjisë moderne, se kërkimet e reja, në Tokë dhe Kozmos, do të na japin rezultate më faktike për zgjidhjen përfundimtare të këtij misteri. Deri atëherë, çështja e prejardhjes së njeriut në tokë si dhe shumë çështje të tjera, do mbesin akoma të hapura.


Sabin
Erasniqi

TRURI

Për t'i kuptuar më mirë sjelljet e njerëzve duhet të dimë më shumë mbi ndikimet biologjike tek ata. Pra, cili është ai gjenerator aq i fuqishëm (po aq edhe kompleks) që i futë në funksion gjithë këto procese psiko-fizike? Kush tjetër, pos trurit.

Truri ka tërhequr gjithmonë vëmendjen, jo vetëm të psikologëve të sotëm, por edhe të dijetarëve që nga kohët më të lashta, sepse aktiviteti i tij psiko-fizik, ndikon dhe drejton pothuajse shumicën e sjelljeve. I përbërë nga miliona neurone, truri (sidomos ai i qenies njerëzore) është organi më i ndërlikuar i çdo gjallese. Shprehur figurativisht ai është më i ndërlikuar se cilido kompjuter i sotëm modern, pra një superkompjuter biologjik. Sa për ilustrim, sërish figurativ, po e cek se i tërë rrjeti telefonik botëror, në krahasim vëllimor me trurin, paraqet vetëm një kokërr fasuleje.

Truri është edhe pjesa më e rëndësishme dhe më e ndërlikuar e sistemit nervorë. Ai veçanërisht luan rol shumë të rëndësishëm për zhvillimin e jetës psikike të njeriut: rregullon funksionimin e organeve; harmonizon organizmin në përgjithësi; bën të mundur lidhjen e organizmit me realitetin objektiv (nëpërmjet transmetimit të impulseve nervore) dhe paraqet bazën fiziologjike për tërë jetën psikike: pra, është bartës i të gjitha proceseve psikike.



Pjesët kryesore të trurit janë tri: truri i madh, truri i mesëm dhe truri i vogël, kurse pjesa më e rëndësishme dhe

më e zhvilluar e tij është korja e trurit ose, siç quhet ndryshe, korteksi. Në zhvillimin e sistemit nervor, korja e trurit zhvillohet më së voni dhe ajo paraqet rezultatet më të larta të evolucionit. Sipërfaqja e saj është rreth $2m^2$ dhe përmban rreth 14 miliardë elemente qelizore.

Truri i të porsalindurit është katër herë më i lehtë se ai i njerit të rritur. Deri në vitin e gjashtë truri arrin përafërsisht 90% të peshës dhe të proporcioneve të tij përfundimtare. Kështu, ndërmjet moshës 9 dhe 10 vjeçare, truri i fëmijës arrin të ketë proporcion gati të njëjtë me atë të trurit të të rriturit. Gjithashtu, është vërtetuar shkencërisht se pesha dhe mosha e trurit nuk është e lidhur drejtpërsëdrejti me zhvillimin e inteligjencë. Truri peshon rreth 1.5 kg.

FORCA E TRURIT

Siç u tha edhe më lart, inteligjenca nuk varet as nga pesha e as nga vjetërsia e trurit. Mundet që njeriu, në moshë shumë të re ose shumë të vjetër, të arrijë rezultate fenomenale. P.sh. Gogeni filloi të merret me art pas moshës 30 vjeçare. Mikelangjelo, veprat më madhështore i krijoi në moshën 80 vjeçare. Edhe Pikaso veprat më të mëdha i krijoi në vitet e 90 të jetës.

Aleksandri i Madh i Maqedonisë i ka njohur me emër të gjithë ushtarët e vet. Mitroditi ka sunduar mbi 22 popuj dhe ka biseduar me të gjithë pa përkthyes. Kinej Cynes, delegat i mbretit Pirro, për një ditë i mësoi të gjithë emrat e anëtarëve të senatit dhe të shumë njerëzve tjerë të Romës, me të cilët u taku. Filozofi dhe mjeku arab, Ibun Sina, shekulli X, qysh në moshën 10 vjeçare e recitonte Kur’anin përmendësh, ndërsa në moshën 14 vjeçare edhe të gjitha veprat e Aristotelit. Shkrimtari spanjoll, Alfonso Tostado, shekulli XV, kishte memorie fantastike: secilin libër që e lexonte dy herë, mund ta përsëriste fjalë për fjalë. Mocarti si 14 vjeçar, në kishën e Shënë Pjetrit në Romë,

mbajti në mendje gjatë kohës së interpretimit gjithë muzikën e një muzikantit të madh, notat e së cilës mbaheshin në fshehtësi. Indiania, Shakuntala Devi ishte për gjashtë sekonda më e shpejtë se kompjuteri në zgjidhjen e një problemi të ndërlikuar matematikor (është fjala për vitet e 80-ta) etj.

Gjithashtu, truri i madh ndahet edhe në dy gjysmëpjesë: e majta dhe e djathta, kështu që secila anë e trurit kontrollon pjesën e kundërt të trupit: pra, në qoftë se dëmtohet ana e majtë e trurit, pëson paralizë pjesa e djathtë e trupit dhe anasjelltas.

Kërkimet më të reja nga profesoresha Roberta Ornshtajn japin dritë më tepër në aktivitetin e këtyre dy pjesëve të trurit. Pjesa e majtë e trurit drejton aktivitetet shkencore: matematikën, logjikën, analizën etj., ndërsa pjesa e djathtë drejton aktivitetet artistike: ngjyrat, muzikën, ritmin, fantazinë etj.

Sipas Ornshtajn-it, njerëzit që janë mësuar ta shfrytëzojnë njërën anë të trurit, e kanë vështirë ta shfrytëzojnë edhe pjesën tjetër. Është interesant se kur njëra anë e trurit dëmtohet, atëherë

e gjithë forca kalon në anën tjetër. Por në qoftë se shfrytëzohen të dy pjesët e trurit, shumëfishohet aftësia deri në gjenialitet.

Hulumtimet tek njerëzit, të cilët zakonisht konsiderohen artistë ose shkencëtarë të mëdhenj dhe supozohet se kanë shfrytëzuar te dy pjesët e trurit, japin këto rezultate: Ajnshtajni konsiderohet si shkencëtari më i madh i kohës së vet. Ai nuk ishte vetëm matematikan apo fizikan, por edhe ëndërrues i madh, i cili për ëndërrimet gati që përjashtohet nga kolegji. Sipas fjalëve të tij, Teorinë e relativitetit nuk e zbuloi duke punuar në tavolinë por i shtrirë në një rrafsh, duke shikuar diellin me sy gjysmë të mbyllur. Rrezet e diellit, duke kaluar nëpër qepalla, oscilonin duke u shpërndarë në mijëra rrezatime të imëta. Ajnshtajni pyeti veten se si do të dukej udhëtimi në një nga ato rreze të diellit. Kështu, fantazia e solli atë deri në atë vend, ku njohuria shkollore nuk e lejonte të shkonte, por imagjinata (ana e djathtë e trurit) dhe njohuritë shkencore (ana e majatë e trurit) e sollën atë deri te zbulimi më i rëndësishëm i të gjitha kohërave - Teoria e Relativitetit.

Pikaso, një ndër piktorët më të njohur të kohës së sonë, tregon se në mënyrë matematikore dhe gjeometrike e ka përshkruar atë që ka dashur ta punojë, duke paraqitur detajisht marrëdhëniet specifike të cilat ka pretenduar t'i krijojë me ngjyrë, formë dhe vijë.



Ndoshta rasti më i mirë për ilustrimin e forcës së përbashkët të dy pjesëve të trurit do të ishte Leonardo da Vinçi, një ndër kokat më kreative të të gjitha kohërave, i cili ishte: matematikan, linguist, artist, anatomist, arkitekt etj. Supozohet se Leonardo me njërën dorë ka vizatuar, ndërsa me tjetrën ka shënuar njëkohësisht. Ekspertët, që janë

marrë me punimet e Leonardos, thonë se për t'i përmbledhur të gjitha punimet e tij, një njeriu i duhet 40 vite punë të pandërprere, nga tetë orë në ditë dhe atë, me njërën dorë të shkruajë, ndërsa me tjetrën të vizatojë.

Siç pamë edhe më lart, kapaciteti i trurit është i pakufishëm. Sa është i pakufishëm aq është edhe i pazbuluar dhe misterik ose me fjalët të tjera, truri është i vetmi organ që e studion vetveten.

Konsiderohet se truri është një ndër krijesat më të ndërlikuara dhe më të çuditshme të natyrës në tokë dhe se është fare pak i shfrytëzuar. Sipas prof. Toni Bizen, trurin e kemi në funksion vetëm 1%, ndërsa Karl Shishar jep mendimin se vetëm 10% e trurit shfrytëzohet, kurse pjesa tjetër (90%) është një gjigant i vjetur. Ndërsa sipas njohurive më të reja supozohet se ne shfrytëzojmë vetëm 4% nga numri i përgjithshëm i qelizave nervore.

Nga gjithë kjo që u tha, del se truri posedon kapacitet të pamatur, të cilin asnjë tru elektronik, së paku deri më sot, nuk mund ta arrijë. Ai mund të pranojë (teorikisht) deri në 10^{15} të mendimeve. Se sa është mundësia e pamatur e pranimit të informacioneve mund ta kuptojmë vetëm përmes rrugës së krahasimit figurativ. Për t'u numëruar kjo madhësi e informacioneve, një njeriu i duhen 30 milion vjet punë të pandërprerë, ditë e natë, me shpejtësi: një informacion për një sekondë; ose nëse e paramendojmë se secila pjesë e mendimeve ose çdo informacion është në madhësinë e një kokrre gruri, atëherë kjo masë stërmadhe e grurit do të mund të vendosej në një depo, e cila do të kishte lartësinë 3 metra, gjerësinë 5 metra dhe gjatësinë 4500 km.

Në koren e trurit, mendohet se ekzistojnë rreth 15 miliardë qeliza, të cilat po të vendosën në një varg të pandërprerë, do të formonin gjatësinë rreth 100.000 km.

Prof. D. Semjev (instit. Izrael) erdhi në përfundim se në çdo moment në tru ndodhin rreth 100.000 milion reaksione kimike.

Se si funksionojnë ato qeliza në tru, me bilionë lidhje mes

veti, me gjasë, deri në fund, kurrë nuk do të zbulohen.

HISTORIA E ZHVILLIMIT TË TRURIT

Truri ka tërhequr vëmendjen e njeriut që nga lashtësia. Sipas shënimeve historike truri për herë të parë përmendet në një papirus, të cilin historianetë e mjekësisë e konsiderojnë si librin më të vjetër mjekësor në botë.

Ky papirus edhe u emërtua si „Papyrus Edwin Smith", sipas emrit të personit i cili e gjeti në Ksar (Egjipt) më 1862. Supozohet se është shkruar rreth vitit 1700 p.e.r. (1200 vjet para Hipokratit, babait të mjekësisë, në formulën e të cilit edhe sot e kësaj dite betohen mjekët e rinj para se ta fillojnë këtë profesion).

Papyrus Edwin Smith

Truri përmendet edhe tek grekët e vjetër si tek Hipokrati, Aristoteli, Platoni etj., por tek më vonë, në shkollën e Aleksandrisë, 335 - 285 p.e.r., Herofili dhe kolegu i tij Erazistrati, filluan të merren në mënyrë sistematike me trurin dhe prej atëherë zbulimet për trurin përparojnë ngadalë nëpër shekuj deri në ditët tona.

Përsosja e pjesëve të posaçme të trurit tek organizmat shtazorë gjatë evolucionit, vështirë mund të shpjegohet, edhe pse evolucioni i shqisave organike ka filluar mjaft herët.

Evolucioni i shqisave organike ka filluar qysh në kohën kur janë formuar organizmat njëqelizor, prej ku, disa pjesë të posaçme të qelizave kanë pasur funksione të specializuara. P.sh. Euglena, si organizëm njëqelizor, posedon shqisën e

ashtuquajtur „njolla e syrit”, e cila reagon ndaj dritës, kurse kloroplasti, organi për fotosintezë, reagon ndaj dritës ashtu që fillon të kryej fotosintezë të drejtpërdrejtë.

Është e qartë se te organizmat mikroskopikë nuk mund të bëhet fjalë për kooperim në nivel intelektual, i cili dirigjon sjelljet e shkathta të Euglenës, që zakonisht u përshkruhen llojeve të kafshëve më të larta. Ajo sjellje e shkathët e organizmave njëqelizorë është ekskluzivisht rezultat i proceseve biokimike, të provokuara nga rrezet e dritës. Mund të thuhet se tek shqisat organike ekziston një substancë, e cila ka rolin e baterisë për shndërrimin e rrezeve të marra në energji elektrike me forcë të ulët. Të gjitha kërkimet për sistemin e komunikimit nëpërmjet sinjaleve biologjike (impulseve) te organizmat shtazorë, vërtetojnë se komunikimi kryhet posaçërisht nëpërmjet impulseve bioelektrike. Pra, gjatë gjithë komunikimit është vërejtur rritja e metabolizmit të qelizave nervore 20-30%.

Euglena

Metabolizmi qelizor i qendrave nervore në tru është i dirigjuar nga ana e impulseve të marra nëpërmjet shqisave organike. Kjo do të thotë se evolucioni i trurit të madh te shtazët, rrjedh nën veprimin e impulseve biologjike ose rrezatimeve biologjike. Disa qendra të posaçme të pranimit të ngacmimeve, fiziologjia ka arritur t’i zbulojë, ashtu që janë identifikuar: qendra e të pamurit, e të dëgjuarit, e të shijuarit etj. Qendrat janë të vendosura nëpër pjesë të ndryshme të trurit, varësisht nga karakteri i ngacmimeve.

Përshtypjet e jashtme barten nëpërmjet shqisave (në formë fotografish) në qendrat përkatëse, ku një pjesë e tyre mbeten përgjithmonë lidhje biokimike. Po të ishin këto paraqitje të vizatuara në mënyrë materiale, do të tregonin se edhe njeriu

mundet, pas një kohe të gjatë, të rikonstruktohet. Cilësitë e rikonstruktimit për kujtesën i posedojnë të gjitha shtazët, në masë më të madhe apo më të vogël. Pra, kujtesa nuk është gjendje metafizike, andaj, edhe shqisat, jo vetëm të njeriut, por edhe të shumë gjallesave tjera, janë procese biokimike. P.sh. pa kujtesën (mbamendjen) organizmat shtazorë nuk do bënin shumë dallime. Ato nuk do e dinin kë e kanë mik e kë armik; nuk do mund të kryenin zgjedhjen e ushqimit; nuk do e njihnin partnerin e vet. Praktikisht ato do të silleshin në mënyrë shumë instinktive, edhe pse do ta kishin të zhvilluar shqisën e dëgjimit, shikimit, etj.

Sipas shumë eksperimenteve me shtazë, të cilave u është nxjerr truri i madh, është konstatuar se ato shtazë kanë treguar sjellje shumë të pakoordinuara. P.sh. gjarpri, pa trurin e madh, mund të lëvizë shumë mirë, por nuk i njeh armiqtë e vetë.

Pëllumbi, pa trurin e madh, qëndron pa lëvizur sikur mumie, pra nuk tregon kurrfarë interesi për ndodhitë që zhvillohen rreth tij. Qeni pa trurin e madh, nuk e njeh pronarin e vet, nuk e dallon ushqimin e nuk e njeh as frikën. Majmuni pa trurin e madh, nuk posedon kujtesë ose inteligjencë dhe jeton deri në tri javë. Bretkosa dhe peshku, pa trurin e madh, kanë sjellje gati normale. Kurse, fëmija pa trurin e madh, në një rast ka jetuar tri vjet e nëntë muaj, edhe pse nuk e ka njohur nënën e vet e as që ka mundur të mësojë diçka.

Ndërsa tek njeriu, gjatë eksperimentimeve, kemi këto rezultate: Çrregullimi i funksionit të trurit të vogël ka si pasojë jostabilitetin e theksuar gjatë qëndrimit me sy hapur, luhatet tepër, është jostabil, kurse symbyllur rrëzohet. Te çrregullimet apo ngacmimet e trurit të mesëm, shkaktohet humbja e ndjenjës mekanike, termike, akustike, optike ose shkaktohet ndjeshmëria e tepruar (hiperstezia). Çrregullimi i trurit të madh, respektivisht i kores së trurit, mund të shkaktojë humbjen e plotë të kujtesës (amnezi) ose të shkaktojë rritjen enorme të saj (hipermnezi).

Neokirurgu nga SHBA-ja, dr. Waiti, i pari arriti që ta izolojë trurin. Mbi 100 tru të majmunëve, Waiti arriti t'i ndajë nga kafka dhe për orë të tëra t'i mbajë në jetë. Ndërsa tre shkencëtarë japonezë (Sudo, Kito dhe Adaqi), arritën që disa tru të maceve t'i ngrijnë nën -20º C, t'i ruajnë në frigoriferë me ngrirje të thellë dhe prapë t'i ringjallin. Kur arritën ta ndajnë trurin nga trupi, atëherë lindi edhe ideja për mundësinë e përanditjes (shartimit) së trurit. Dr. Waiti arriti i pari ta realizojë këtë eksperiment në vitin 1965, nëpërmjet transplantimit të trurit të qenit. Prapë lindi pyetja: a mund të bëhet kjo edhe te njeriu? Waiti mendon se po, por thotë se ai nuk do e bëjë

i pari, pasi ende nuk e ka gjetur daljen nga dilema se a është kjo e drejtë apo jo.

Nga shembujt e mësipërm vërejmë se me heqjen e trurit, pasojat mund të jenë shumë të mëdha. Nga këto eksperimente shihet se truri, përveç qendrave që i pranojnë ngacmimet nga jashtë, përmban edhe veti tjera, siç janë: rikonstruktimi, forca e kujtesës, që posaçërisht vërehet te gjallesat me zhvillim të lartë. Ky pushet shërben që të mund të bëhen kombinime të ndryshme nga përshtypjet e marra nga mjedisi i jashtëm. Për këtë edhe quhen: kombinime rikonstruktive. Funksioni i këtij pushteti për kombinim konstruktiv parqet shkallën e inteligjencës njerëzore dhe përmban dy drejtime: konstruktive dhe mistike. Në funksion konstruktiv bëjnë pjesë: zbulimet dhe të gjitha aktivitet tjera që lidhen me empirizmin dhe shkencat ekzakte. Në funksion mistik bëjnë pjesë: letërsia dhe të gjitha aktivitet tjera, që paraqitja e tyre nuk mund të dimensionohet në kritere empirike (eksperimentale). Edhe funksionet konstruktive e, edhe ato mistike funksionojnë në mënyrë të posaçme.

Shkaqet e zhvillimit të trurit nuk mund të jenë vetëm dëshirat dhe aktivitetet e qenieve të gjalla, gjithashtu nuk mund të jetë intensiteti i shqisave organike, të cilat me impulset e veta kryejnë aktivizimin e substancave trunore. Një ndër kushtet tjera të zhvillimit të trurit është edhe ambienti natyror, në të cilin është sjell dhe sillet edhe sot njeriu. Njeriu dhe ambienti janë faktorë nga të cilët varet edhe zhvillimi i shpejtë ose i ngadaltë i trurit. Evolucioni i trurit nuk mund të përshkruhet vetëm te qeniet e gjalla më të vjetra të ambientit tokësor, por edhe te gjallesat e ambientit ujor; sepse gjallesat, kur dolën nga ambienti ujor në ambientin tokësor, veç posedonin një masë fillestare të zhvillimit të masës trunore. P.sh.: reptilët (zvarranikët), si gjallesa tokësore, gjatë zhvillimit të tyre, kanë pasur koeficient mjaft të ulët të inteligjencës (përafërsisht 0.00006), që është më i ulët se te peshqit dhe disa gjallesa tjera nënujore.

Emri	Vitet e jetës prapa për:	Pesha e trurit, gr.	Koeficioenti i inteligjencës
Prapithecus	45.000.000	-	-
Prekonsul	24. 000.000	-	-
Oreopithecus	14.000.000	-	-
Homo habilis	2. 300.000	680	0.0085
Australopithecus	1. 500.000	520	0.0065
Zinjantropus	1.500.000	530	0.0066
Pithecantropus	1.500.000	935	0.0117
Sinantropus	1.500.000	1.030	0.0129
Homo hedelbergenisis	500.000	1.400	0.0175
Homo neandertalenzis	100.000	1.400	0.0175
Homo sapiensis	60.000	1.400	0.0175
Njeriu bashkëkohorë	-	1.500	0.0185

Zhvillimi i inteligjencës tek njeriu dhe i masës së trurit nga e kaluara e deri më sot (sipas gjurmimeve të paleontologëve.)

Duke pasur parasysh se ngacmimet kanë nxitur krijimin e masës së trurit, në të cilën zbatohen perceptimet e pranuara nga rrethi i jashtëm, evolucionet nuk mund të trajtohen si akte të mbinatyrshme. Aktiviteti më i madh për kuptim, dituri, vetënjohje ka si pasojë nxitjen e zhvillimit të trurit. Duhet të cekim se inteligjenca trashëgohet nga paraardhësit në masë shumë të vogël, prandaj ajo arrihet dhe zhvillohet nga aktiviteti gjatë gjithë jetës. Pra, me të drejtë fiziologu Sherington, i cili zbuloi shumë ligje të funksionimit të trurit, e quajti atë „top magjik" dhe konsideroi se truri do të mbetet fshehtësia e natyrës, e cila e fundit do t'i zbulohet njerëzimit.

PSIKOLOGJIA

„Asgjë (që njeriu punon ose krijon) nuk mund të kuptohet pa psikologji”

Sigmund Freud

Psikologjia si disiplinë shkencore, që për objekt studimi ka dukuritë psikike të njeriut, është mjaft e re. Ajo, siç thotë psikologu gjerman Ebinghaus, e ka të kaluarën shumë të gjatë, por historinë e shkurtër.

Psikologjia si shkence, nga pikëpamja e veçantë, na e ndriçon tërësinë e proceseve psikike të individit si dhe na e bën të mundshme t’i kuptojmë më lehtë e më mirë aktivitet, sjelljet dhe veprimet e njerëzve me të cilët takohemi çdo ditë - në rrugë, në shkollë, në shtëpi etj. Pra, psikologjia studion realitetin psikik dhe jetën psikike të njeriut. Me veçoritë psikike nënkuptojmë cilësitë më të qenësishme dhe më të qëndrueshme të individit siç janë: ndjenjat, perceptimet, inteligjenca, kujtesa, mendimet, shprehitë, aftësitë, temperamenti, nevojat, interesat, stresi dhe cilësitë tjera të personalitetit, të cilat shprehen në reagimet dhe sjelljet e njerëzve.

Psikologjia, siç thonë disa psikologë, duhet të na përgjigjet në tri pyetje, të cilat janë:

-„Çka?”, respektivisht ajo duhet t’i paraqesë dhe t’i përshkruajë në mënyrë të plotë dukuritë psikike.

-„Si?”, respektivisht të tregojë si zhvillohen proceset psikike dhe si formohen cilësitë psikike.

-„Pse?”, respektivisht t’i zbulojë shkaqet e dukurive psikike veç e veç dhe t’i shpjegojë sjelljet dhe veprimet e njerëzve.

Detyra praktike e psikologjisë qëndron në të zbatuarit e rezultateve të gjurmimeve teorike me qëllim të kryerjes sa më me sukses të veprimtarive të ndryshme të njerëzve. Kështu p.sh.

rezultatet e gjurmimeve psikologjike zbatohen në organizimin sa më të suksesshëm të punës në prodhimtari, tregti, industri etj; për punë sa më cilësore në arsimim dhe edukim; për t'i lehtësuar ose larguar pengesat psikike tek individët, të cilat e vështirësojnë kryerjen e veprimtarive të përditshme apo kontaktin me njerëz të tjerë etj.

Pra, ç'rëndësi ka psikologjia?

Psikologjia e na bënë të mundshme t'i njohim njerëzit, vetveten dhe jetën në përgjithësi, duke na treguar rrugën se si të veprojmë në situata të ndryshme, që t'i evitojmë të metat dhe t'i zbatojmë cilësitë pozitive. Pra, na e tregon rrugën e formimit të vetive psikike të personalitetit.

Erosi dhe Psika

Fjala „psikologji" rrjedh nga gjuha e vjetër greke që do të thotë „psiko" (psyche) - shpirt dhe „logos" - shkencë. Kjo fjalë lidhet me mitin e vjetër për Psikën dhe Erosin. E shënoi historiani romak Apulej. Sipas atij miti kishte jetuar një vajzë shumë e bukur e quajtur Psika e në të cilën ishte dashuruar Erosi. Mirëpo nëna e Erosit, zonja e dashurisë Afërdita (Venera), e xhelozonte ketë dashuri dhe me çdo kusht mundohej ta shkatërronte, duke proklamuar se një djalë nga familja e zotave nuk mund të marrë një vajzë të klasës së ulët. Mirëpo, edhe pas gjithë këtyre peripecive dhe spekulimeve, kryezoti Zeus vendosi që edhe Psika të pranohet në Olimp, në mesin e zotave dhe kështu e bëri të mundshme martesën e Psikës me Erosin. Dashuria triumfoi mbi të gjitha, kurse ky mit mbeti nëpër shekuj si inspirim për poetë, piktorë e skulptorë, të cilët, zakonisht, Psikën e paraqesin si një vajzë shumë të bukur me krahë të fluturës (Rafaeli, Rodeni, La Fonteni etj.), ndërsa Frojdi thotë se Psika paraqet fluturën e cila fluturon nga lulja në lule dhe jeton nga nektari

dhe dashuria. Më vonë fjala „psikë” (psyche) përdorët për fjalën shpirt, duke përmbajtur atë kuptim deri në ditët tona, duke hyrë kështu me këtë kuptim në shkencën mbi shpirtin - psikologjinë. Ndërsa miti për psikën dhe Erosin mbetet edhe si tregues simbolik në kuptim të dashurisë për shpirtin njerëzor. Erosi, më vone, nga Frojdi do të hyjë në psikologji si një ndër nocionet më karakteristike për jetën, dashurinë, seksin, bashkëpunimin, krijimtarinë etj.



Është shumë vështirë të definohet fjala psikologji, respektivisht të jepet një definicion që do t’i përmbush të gjitha kriteret e njohura deri më tani për të. Në qoftë se nisemi nga shpjegimi etimologjik i fjalës: „psiko” - shpirt dhe „logos” - shkencë, dituri, del se psikologjia është shkencë mbi shpirtin. Mirëpo, pasi fjala shpirt është nocion që ka prioritet religjioz e filozofik, emërtimi shkencor mbi psikologjinë do të mund të na keqorientonte se psikologjia ka të bëjë me probleme të ndryshme e të llojllojshme metafizike me të cilat shkenca e sotme, de fakto, nuk merret.

Psikologjisë moderne, sot, nuk i interesojnë çështjet, siç janë: „ç’është shpirti?”, „a është shpirti material apo jomaterial?”, „a është i vdekshëm apo i pavdekshëm?”; pastaj „në çfarë marrëdhënie është ndaj trupit?” etj. Rreth këtyre pyetjeve janë bërë polemika të ashpra, që nga kohët e lashta e deri më sot, nga ana e idealistëve dhe materialistëve. Derisa idealistët mendonin se shpirti është i ndarë nga trupi (Platoni) materialistët, përkundrazi, mendonin se shpirti nuk është i ndarë nga trupi (Demokrati). Definicion të plotë, që e sqaron

përfundimisht dukurinë rreth shpirtit, edhe sot e kësaj dite nuk kemi.

PERIUDHA E ZHVILLIMIT TË PSIKOLOGJISË

Periudha e zhvillimit të psikologjisë është mjaft e gjatë dhe e pasur. Konkretisht ajo fillon që nga paraqitja e njeriut dhe të menduarit të tij e deri më sot. Shumë psikologë zhvillimin e psikologjise e ndajnë në disa periudha. Kthesë me rëndësi në të menduarit njerëzor mbi shpirtin dhe trupin u bë që në kohët antike, sidomos me sofistët (mësuesit endacakë) dhe Sokratin, të cilët për objekt të studimit të tyre, me kohë, filluan ta kenë njeriun. Pra, njeriu bëhet objekt studimi. Kështu p.sh. Platoni parashtroi mendimin se shpirti dhe trupi janë dy substanca të ndara nga njëra-tjetra. Ndërsa Demokrati, duke mos u pajtuar me mendimin e Platonit, shpirtin e shpjegon në mënyrë materialiste. Sipas tij edhe shpirti është i përbërë prej atomeve, grimcave të cilat janë më të vogla dhe më të lëvizshme se atomet e trupit, por që janë materiale. Aristoteli mendon se shpirti është ai që e ringjall natyrën, andaj ai edhe flet për tri lloje të shpirti:

- për shpirtin vegjetativ, të cilin e kanë bimët;
- për shpirtin vital, të cilin e kanë shtazët dhe njerëzit;
- për shpirtin intelektual, të cilin e kanë vetëm njerëzit.

Aristoteli është edhe autori i parë i një vepre e cila tërësisht i kushtohet psikologjise dhe quhet „Vepra mbi shpirtin”.

Meritë të veçantë për zhvillimin e psikologjisë si shkencë e pavarur kanë fiziologët, F. Veber, H. Helembol, M. Seqenov, F. Golton e sidomos V. Vunti i cili në vitin 1879, në Laipzig të Gjermanisë, themeloi laboratorin e parë për gjurmime eksperimentale psikologjike. Së shpejti përvoja tregoi se njeriu nuk është shumë i përshtatshëm për eksperimentim, prandaj eksperimentuesit u detyruan të eksperimentonin me kafshë (me

zhvillim më të lartë) e posaçërisht me sisorë: majmunë, qen, mace, minj etj. Një ndër shkencëtarët që është marrë më së shumti me eksperimentimin e kafshëve është fiziologu rus Ivan Petroviq Pavlov (1849 - 1936), i cili zbuloi shumë mekanizma të punës së trurit dhe i pari tregoi se si truri ndikon në organet e tretjes, për të cilin edhe mori Çmimin Nobel për Mjekësi. Duke punuar me qen në laboratorin e tij, ai zbuloi Refleksin e Kushtëzuar, që ka rëndësi të posaçme për psikologjinë dhe mjekësinë.

Nga mbarimi i shekullit XIX psikologjia u zhvillua në mënyrë të vrullshme. Në SHBA sot ekziston numër i madh institutesh psikologjike, ku punojnë numër i madh i psikologëve siç janë: Hansi, Koteli, Tolmani e sidomos B. F. Skineri, njëri ndër psikologët më me autoritet, e që pati ndikim kolosal për përdorimin e psikologjisë në edukim dhe në shoqërinë amerikane në përgjithësi.

Qëllimi themelor i Skinerit në psikologji ishte parashikimi dhe kontrolli i sjelljeve. Informacionet, të cilat i marrim nga analizat e sjelljeve, duhet të na tregojnë se në çfarë mënyrë zhvillohet sjellja dhe në çfarë mënyre mund të ndryshohet.

Rezultatet e kërkimeve të Skinerit kanë rëndësi të madhe për psikologjinë moderne, por njëkohësisht paraqesin edhe frikë, sepse na ofrojnë mundësi të pakufishme për keqpërdorim, përkatësisht për manipulim me njerëz, me plane të programuara qysh përpara.



Gjithashtu, rëndësi të posaçme për psikologjinë ka edhe themeluesi i Psikanalizës, Sigmund Frojdi, specialist për sëmundjet nervore, nga Vjena. „Jeta psikike - thotë Frojdi, i ngjan bregut të akullt i cili noton në det. Ashtu sikurse shihet vetëm pjesa e vogël e akullit, që del në sipërfaqe, kurse pjesa tjetër e tij, më e madhe, gjendet nën ujë, kështu,

edhe nga proceset psikike - vetëm një pjesë e vogël e tyre është e vetëdijshme kurse pjesa më e madhe i përket fushës jo të vetëdijshme (nëndijes)".

Personalitetin, Frojdi, e ndau në tri pjesë:

ID (ai),

EGO (uni)

SUPEREGO (mbi-uni)

Konfliktet në mes id-it, egos dhe superegos te individi shkaktojnë pasiguri, frikë, por kur këto konflikte janë të ashpra atëherë bëhet çrregullimi i sjelljes dhe ndodhin neuroza e sëmundje të rënda shpirtërore (psikoza).

Edhe përkundër psikologjisë laboratorike, psikologët nga Berlini, M. Verltajner. K. Kofka dhe V. Keler, fusin në psikologji një teori të re, të quajtur: „Teoria Geshtalt" (gjermanisht; gestalt - strukturë). Me zhvillimin e Teorisë Geshtalt dhe psikanalizës, psikologët fusin në psikologji edhe një degë të re të quajtur „Fenomenologji", e cila zbatohet vetëm në raste individuale specifike.

Edhe pse momentalisht nuk ekziston teoria definitive e psikologjisë që sqaron sjelljet njerëzore, një teori më të afërt jep psikologu amerikan, Kurt Levin. Sipas tij, secila qenie e ka botën e vet personale, pra edhe njeriu. Bota të cilën e vëzhgojmë nuk është e njëjtë për të gjithë, ta zëmë si për kafshët, ashtu edhe për njerëzit. Secili individ e ka botën e vet psikologjike e cila ndryshon nga psikologjia e individit tjetër.

Këto do të ishin disa paraqitje të teorive prej themelimit të psikologjisë e deri më sot.

Sot psikologjia është shkencë universale, kurse zbatimi i saj në jetën e njeriut bashkëkohor është shumë i madh. Në zhvillim e sipër asaj ia hapin dyert të gjitha fushat e jetës. Kohëve të fundit ajo ka depërtuar edhe në industri, tregti, armatë, politikë. etj. Njëkohësisht, ajo ka kontribuar në zhvillimin më të shpejtë të këtyre lëmive, duke iu dhënë atyre kuptim më të thelle e në masë më të madhe ka kontribuar në humanizimin e tyre.

KEQPËRDORIMI I PSIKOLOGJISË

Sot në botë ekzistojnë institucione, në të cilat, përveç punës psikologjike dhe profileve tjera shkencore, punohet në gjetjen e metodave për manipulime me njeriun. Këto institucione punojnë për nevoja të sigurisë shtetërore, armatës dhe shërbimeve kundërinformative dhe financohen prej tyre, ndërsa zbulimet e reja ruhen si Top-sekrete shumë të rëndësishme, kështu që deri tek ato vështirë mund të arrihet para se efekti i tyre të zbatohet në praktikë.

Qendrat kryesore për studimin dhe modifikimin e sjelljeve janë universitetet dhe institucione të ndryshme në mbarë botën, e sidomos në SHBA dhe Rusi. Problemet që i trajtojnë këto institucione janë të llojllojshme, ndërsa ekspertetë që punojnë në to janë të specializuar për çështje specifike. Një ndër ekspertët më eminent në fushën e mjekësisë, që punon për nevojat e CIA-s, është Mathan Kline me detyrë kryesore që t'i stërvitë operatorët, ndërsa në projektin ndërkombëtar, dirigjimin e mendimeve. Përndryshe, Kline është i njohur si kryetar i Komitetit ndërkombëtar kundër sëmundjeve mendore (ICAMI), një ndër planet e së cilës ishte edhe dhënia e barërave me efekt antidepresiv të porsalindurve, te të cilët duhej të veprojnë deri në fund të jetës së tyre. Kline, nga diktatori i dikurshëm i Haitit P. Duvalier, mori mirënjohje më të lartë për pastrimin e trurit të haitasve. Ekzistojnë fakte se organizata ICAMI, me ndihmën e narkotikëve, i ka shfrytëzuar njerëzit me të meta mentale si forcë pune në industri.

Keqpërdorimi i psikologjisë bëri që ajo sot, në duart e disa vendeve të zhvilluara dhe diktatorëve të ndryshëm, të bëhet armë me pasoja të paparashikueshme madje, një shkencëtar deklaron hapur, se bomba atomike është lodër fëmijësh në krahasim me mundësitë e metodave të reja psikologjike në luftë kundër njeriut.

Më poshtë po i parashtroj disa nga metodat, përmes së cilave mund të manipulohet me qenien njeri.

Shpëlarja e trurit

Është metodë e cila nuk shërben vetëm për pranimin e informatave të rëndësishme nga armiku, por edhe që t'i ndryshohen qëndrimet, mendimet dhe bindjet e tij. Përveç mundësisë së pranimit të informatave dhe ndryshimit të pikëpamjeve, kjo metodë shërben edhe për kthimin e armikut në një bashkëpunëtor aktiv, në mënyrë që armiku merr pjesë në mediume të shkruara, e sidomos elektronike, me pohime të rrejshme, duku u aktivizuar në propagandën e kundërshtarit ndaj kombit të vet.

Hipnoza

Sot është pranuar qëndrimi se hipnoza paraqet koncentrim specifik të vetëdijes, e cila është shumë më e madhe se ajo në gjendje të zgjuar, dhe mundëson pranim më të mirë të sugjestioneve që vijnë nga jashtë. Përndryshe, hipnoza kur përdoret nga ekspertët, shfrytëzohet me shumë sukses si metodë ndihmëse e psikoterapisë për shërimin e neurozave dhe psikozave.

Hipnoza është një ndër faktorët më bindës për ekzistimin e motiveve të pavetëdijshme dhe ndikimeve të tyre në sjelljet e njerëzve. Nëpërmjet sugjestioneve hipnotike është e mundur që të zbulohen e shqyrtohen motivet më të thella të sjelljeve të njerëzve, të korrigjohen ose ndryshohen e rrënjosen shprehitë e personalitetit dhe kështu, në vend të tyre, të regjistrohen të tjera,

të reja. Kjo metodë më vonë u quajt edhe si „serumi i së vërtetës”, që zakonisht keqpërdorej në „biseda informative” të policisë. Për t’u arritur gjendja hipnotike, përveç metodave klasike, përdoren edhe substanca kimike, pra lëndë narkotike.

ESB

Stimulimi elektrik i trurit (Elektrical Stimulation of the Brain), i quajtur edhe si radio-stimulues, është metode e re e psikofizikës për drejtimin (detyrimin) e sjelljeve të njerëzve. Njëri ndër iniciatorët e keqpërdorimit të ESB-së, njëkohësisht edhe njëri ndër themeluesit e organizatës ndërkombëtare për hulumtimin e trurit, është Deligardo. Ai ua ofron metodën e vet të interesuarve pasi, siç thotë ai, mund të ndalojë „parregullsitë politike” në baza fiziologjike - përmes stimulimit të trurit. Nëpërmjet ESB-së mund t’i kontrollojmë sjelljet e çdo personi ose grupi njerëzish, dhe në atë mënyrë të ndikojmë indirekt në ndryshime publike.

Narkotikët

Janë të njohura edhe metodat, që me anë të llojeve të ndryshme të drogave si: kokaina, heroina, hashashi, alkooli, LSD-ja etj., të depërtojmë në personalitetin e tjetrit me qëllim të marrjes së informatave të caktuara. CIA për qëllime të veta përdor zakonisht LSD-në por edhe disa lloje drogash të reja, që ende janë të panjohura, së paku për opinionin. Është e ditur se CIA është e interesuar për rreth 50 lloje drogash dhe ka kryer, e kryen edhe sot e kësaj dite, eksperimente të ndryshme me njerëz për të vërtetuar ndikimin e drogave në nëndijen e tyre. Këtë e dëshmon edhe Timot Liri, i cili i tregoi shkrimtarit dhe estetit Volter

Bovar, se një kohë të gjatë ka punuar si agjentë në CIA (deri sa nuk është burgosur) dhe se në Amerikë ekzistojnë afër 30.000 njerëz të cilët me ndihmën e drogës i kontrollon CIA.

Po e marrim vetëm një shembull, sa për ilustrim, për efektin e drogës LSD-25. Një sabotues me dy çanta udhëtimi të mbushura me këtë lëndë, nëpërmjet ujësjellësit, mund të paaftësojë përkohësisht të gjithë njerëzit e Evropës.

Udhëheqësit ushtarakë konsiderojnë se lufta me ndihmën e substancave psikoaktive është mënyra më humane e luftës. Përdorimet për paaftësimin e materies paralizojnë përkohësisht vetëm rezistencën aktive dhe nuk janë në mënyrë të drejtpërdrejtë vdekjeprurëse për kundërshtarin. Fabrikat, mjetet e komunikimit, transportit etj., mbeten të padëmtuara, ndërkaq njerëzit, brenda 24 orëve, prapë riaftësohen për drejtimin e tyre. Do të jetojnë edhe më tej në vendbanimet e tyre të padëmtuara... Por, në qoftë se mënjanojmë humbjen më të madhe - lirinë personale dhe kolektive, atëherë kjo luftë ndoshta edhe do të mund të quhej si „humane”.

Numri i njerëzve të kontrolluar me anë të këtyre metodave pa dyshim është i madh dhe atë në mbarë rruzullin tokësor. Gjithashtu këto metoda u përdorën edhe në luftërat e fundit në Ballkan, ku paramilitarëve dhe ushtarëve serbë, nëpërmjet substancave të ndryshme narkotike, u rritej morali luftarak, iu humbiste frika, iu ndryshoheshin sjelljet etj., duke i kthyer ata në njerëz të dëgjuar, pra në një lloj njerëzish „Zombi” në duart e udhëheqësve të tyre, për të kryer krime nga më barbaret që ka mundur të njohë ndonjëherë bota.

Ser Johan Acches, i cili për punë shkencore mori Çmimin

Nobel për Mjekësi, konsideron se kërkimi i trurit është problem themelor me të cilin është ballafaquar ndonjëherë njeriu. Atë, si shkencëtar dhe humanist, e shqetëson thellë edhe parashikimi, se hulumtimi i trurit ndoshta do të na zbulojë veprimet me të cilat njerëzit mund të bëhen anëtarë të dëgjueshëm të sistemeve totalitare, të cilët, pa protesta do t'i zbatojnë gjithnjë ato që iu urdhërohen. Të gjitha kërkimet në këtë drejtim, i duken Acches më të rrezikshme se bomba atomike.




Sabir Krasniqi

PARAPSIKOLOGJIA

„Askush nuk ka të drejtë të nënçmojë shkencën, të cilën nuk e njeh”

(Paracelzus)

Duke filluar nga shekulli XIX botëkuptimet shkencore, mbi botën në përgjithësi, kanë përjetuar ndryshime shumë të thella. Njohjeve të materies dhe energjisë, si dhe të shumë ligjeve të fizikës klasike, iu bashkëngjitën edhe njohuri të reja që, si pasojë, sollën edhe vështrim krejtësisht të ri dhe zgjerim të madh të horizontit.

Herci zbuloi vibracionet elektrike; Rëntgeni, dukuritë e panjohura të rrezatimit; çifti Curie, radioaktivitetin; pastaj, Ajnshtajni bëri të njohur se materia përmban energji të pamatur (gjë që solli deri te fizika nukleare, që në anën e saj pozitive mundësoi shfrytëzimin e energjisë përmes elektranave nukleare, kurse në anën tjetër negative e ballafaqoi njerëzimin me tmerrin e armës atomike).

Pastaj: telefoni, radioja, televizioni, automobilat, aeroplanët etj. u bënë dukuri të përditshme. U zbulua radio-teleskopi, që na mundësoi shikim në botën makrokozmike, ndërsa mikroskopi elektronik na i shpalosi thellësitë e mikrokozmosit. Nëpër frigoriferë me ngrirje të thellë u vendosën pjesë rezervë për trupin e njeriut, ndërsa kirurgët iu përveshën punës për transplantimin e organeve të rëndësishme për jetë. Kompjuterët (trutë elektronik) depërtuan në shkencë, industri, bujqësi etj. Sakaq, amerikanët lansuan anijen e parë kozmike me njerëz për në hënë, pastaj satelitë të tjerë për planetët më të largët si dhe satelitë të shumtë që pandërprerë i sillen rreth e përqark planetit tonë - Tokës. Zbulimet dhe prodhimet e ndryshme, të panumërta, „çuditëse”, që deri më dje ishin „science fiction” u

bënë realitet i kohës.

Megjithatë, përkundër gjithë këtyre shpikjeve, gjithë këtij përparimi, një pjesë të konsiderueshme të njerëzimit e ka kapluar një fobi e pakuptueshme. Trandjet psikike (streset), sëmundjet psikosomatike (psikofiziologjike), neurozat, psikozat si dhe vetëvrasjet janë në rritje e sipër... pra, lind pyetja: ku është arsyeja e gjithë kësaj?

Një kohë tepër të gjatë shkenca ishte e drejtuar vetëm në njërën anë të medaljes - në anën materiale, të njeriut dhe natyrës, në mikro dhe makrokozmos, duke e drejtuar shikimin vetëm në paraqitjet e jashtme fizike. Ajo filloi të masë e të analizojë, pra të studiojë njeriun dhe natyrën, duke u nisur vetëm nga pikëpamjet materiale dhe duke besuar se në atë mënyrë do të mund t'i zbulojë të gjitha sekretet dhe misteret e tyre. Kurse si masë e vetme vlente vetëm dukja fizike me konceptet e pastra mekanike. Përfytyrimi për botën, që në kohë dhe hapësirë zhvillohet sipas ligjit të shkakut dhe veprimit, u bë udhëheqës i shkencës bashkëkohore dhe me këtë ajo zgjodhi rrugën njëanësore.

Duke e ndjekur këtë rrugë, shkenca ka arritur përparime që s'merren me mend në kërkimet teknike, në industri etj. Por, shtrohet pyetja: Cilat nevoja i plotësojnë ato? A nuk janë vetëm nevoja të pastra materiale, fizike etj? A mund të jemi të lumtur vetëm me plotësimin e nevojave të tilla, materiale e fizike, duke lënë anash nevojat shpirtërore?

Pra, për shpirtin ajo u interesua shumë pak, për të mos thënë aspak.

Shpirti me të gjitha dukuritë tjera paranormale mbeti në prapavijë. Gjithashtu, në prapavijë mbeti edhe ana etike e njeriut, sikurse të mos kishte ekzistuar fare. U harrua formula e

sir Artur Eddingtonit në „New Pathways in Science” („Rrugët e reja të shkencës”) se „bota fizike nuk është e vetme” dhe në „Psysics and philosophy” se „bota e njohur për fizikën paraqet vetëm një prerje nga i gjithë realiteti”. Ajo gjithashtu harroi se pranë kauzalitetit fizik, ekziston edhe ai psikik dhe ai është shumë i rëndësishëm për jetën e njeriut.

Duke e lënë prapa këtë drejtim shkenca dhe duke i përdorë për nevoja të veta manipuluese grupet fetare, sektet e organizatat e ndryshme etj., ndodhi që njerëzit, duke mos qenë të kënaqur me realitetin dhe duke kërkuar harmoni shpirtërore, të bënin përpjekje për ta shpërthyer këtë errësirë teknologjike dhe për të kërkuar rrugë të reja kah vetvetja. Por, duke kërkuar këto rrugë, shpesh silleshin nëpër shtigje të gabuara, rëndom duke iu dhënë drogës, alkoolit etj., që në instancën e fundit kishin pasoja të rënda, ndonjëherë edhe vdekjeprurëse. Shumë prej tyre shkuan edhe në Indi e vende të tjera për të gjetur harmoninë shpirtërore të humbur, kryesisht nëpërmjet meditimit te jogistë të ndryshëm, guru etj., ku disa prej tyre edhe mbetën përgjithmonë nëpër tempuj e faltore të atjeshme.

Dhe të gjitha këto dilema hapën rrugë për një alternativë tjetër; alternativë që shumë seriozisht do t’iu qasej mu këtyre dukurive për t’i zhveshur përfundimisht nga velloja misterioze që mbizotëronte mbi to dhe për t’iu dhënë vlerësim të merituar logjik e shkencor. Kjo lëmi e re do të marr nocionin „Parapsikologjia”.

Hipnoza dhe sugjestioni, të cilat shkenca bashkëkohore sot i ka pranuar në gjirin e vet, vërtetojnë se në nëndijen tonë ekzistojnë forca dhe aftësi, për të cilat vetëdija jonë nuk di pothuajse asgjë. Kjo është edhe një dëshmi e fuqishme se njohuritë tona për ligjet e natyrës janë të mangëta, posaçërisht ato mbi jetën shpirtërore të njeriut.

Fatmirësisht, me pranimin e psikologjisë si degë shkencore, kohëve të fundit edhe parapsikologjia filloi të zhvillohet dhe të pranohet edhe nga pikëpamjet shkencore, sakaq shkollat e tilla

zunë të përhapen kudo nëpër qendra të ndryshme të botës. Kjo bëri, që sadopak, të zbutet ky tension dhe, më në fund, të fillojmë t'i kthehemi më shumë vetës, pra UN-it tonë.

Ç'ËSHTË PARAPSIKOLOGJIA?

Gjatë gjithë historisë së njerëzimit, kokat më të njohura të botës janë munduar që të kuptojnë të vërtetën për fenomene të ashtuquajtura „paranormale", fenomene të cilat kanë ekzistuar prej se ekziston njeriu.

Fjala „Parapsikologji" është formuar qysh në vitin 1889, por në rrjedhën e decenieve të fundit është pranuar ndërkombëtarisht. Sot, në vend të fjalës parapsikologji, shumë shpesh e hasim edhe termin më të ri, „Psikotronikë", por që në fakt kanë të njëjtën domethënie. Më herët këto dukuri anglezët i quanin „Kërkime psikike" (Psychical Research), francezët „Metapsikologji", ndërsa prof. dr. Hans Beneder, nga Universiteti i Freiburgut, e quajti „Der sechste Sinn" (shqisa e gjashtë).



Në Mesjetë, këto dukuri të pashpjeguara, i quanin „magji" dhe ishin të ndaluara. Dënoheshin të gjithë ata që merreshin me to. Që nga shekulli XVI, „për këtë punë të dreqit" u gjet emërtimi më i përshtatshëm: „Okultizëm". Emri është marr nga libri i shkrimtares gjermane A. Neteschein. Në këtë libër flitet për forcat e fshehta të materies dhe shpirtit, ndërsa fjala ka prejardhje latine, „Okultus" - sekret, fshehtësi, diçka e fshehtë.

Fjala „parapsikologji” rrjedh nga greqishtja dhe do të thotë: „para” - pranë, „psych” - shpirt dhe „logos” - shkencë, dituri, mendim. Parapsikologjia është degë e psikologjisë e cila merret me studimin e dukurive të cilat janë jashtë forcës së të kuptuarit të shqisave tona, që shpesh i tejkalojnë edhe ligjet ekzistuese të shkencës bashkëkohore e që në popull merren edhe si çudira.

Këto dukuri ekzistojnë që nga lashtësia, por qysh në fund të shekullit XIX dhe në rrjedhë të shekullit XX, studiuesit filluan të merren seriozisht me to dhe të vërtetojnë rëndësinë e tyre për njerëzimin e posaçërisht për ardhmërinë.

Parapsikologjia sot është në gjendje që disa nga ato dukuri, duke u bazuar në prova, t’i dokumentojë në mënyrë shkencore.

Është interesant të shikohen edhe disa enciklopedi të disa shteteve, të cilat bëjnë fjalë për dukuritë parapsikologjike. Enciklopedia amerikane, botuar më 1973, jep një artikull mjaft të zgjeruar nga prof. T. Rini, në të cilin parapsikologjia definohet si pjesë e psikologjisë. Ai jep historikun e parapsikologjisë, ofron shembuj bindës si dhe shpjegime shkencore nga kjo lëmi. Sipas tij, parapsikologjia është degë e psikologjisë, e cila merret me përjetimet dhe sjelljet paranormale, siç është: telepatia, parashikimi i ngjarjeve, bioenergjia etj., të cilat janë të pashpjegueshme e lidhen me ligjet e natyrës. Për këtë arsye ato quhen shpesh edhe paranormale, supernormale, pra aludohet se i përkasin anës tjetër, megjithëse në to nuk ka asgjë mbinormale dhe ato nuk janë asgjë tjetër veçse fenomene të natyrës normale.

Enciklopedia ruse e vitit 1975 jep një artikull trefaqësh, të shkruar nga dy psikologë dhe profesorë të universitetit, V. P. Zincenko dhe A. Leontijev, në të cilin thuhet se parapsikologjia bën gjurmime në lëmin e cila kryesisht studion: 1- Formën e ndjeshmërisë, e cila mundëson aftësinë e marrjes së informatave të cilat nuk janë të shpjegueshme për shqisat tona organike; 2- Format e përshtatshme të veprimit të krijesave të gjalla në paraqitjet fizike, të cilat zhvillohen jashtë organizmit, pa forcën

e muskujve.

Enciklopedia franceze e vitit 1967 shkruan: „Parapsikologjia është disiplinë që studion fenomene paranormale, siç janë: telepatia, parashikimi, parandjeshmëria etj. Shumë mashtrues janë futur dhe e kanë shkatërruar këtë lëmi, së cilës shkencëtarët ia kanë kthyer shpinën, duke e lënë si fushë të hapur për manipulime të sharlatanëve.”

Enciklopedia jugosllave e vitit 1961 shkruan se parapsikologjia është pseudodituri për fenomenet e okultizmit, ndodhitë shpirtërore, të cilat shkenca e sotme nuk mund t’i sqarojë.

Në enciklopedinë shqiptare nuk ka shënime fare për parapsikologjinë!

Sipas shënimeve, sot më se 50 shtete, në mënyrë shkencore, studiojnë dukuritë parapsikologjike dhe në këtë drejtim janë formuar rreth 150 institute për parapsikologji, të pavarur ose pranë universiteteve, diku edhe në rang fakultetesh. Në botë, sot janë botuar me mijëra libra dhe artikuj të shumtë gazetareskë, që flasin mbi këtë lëmi.

Midis shkrimtarëve dhe personaliteteve që kanë bërë kërkime mbi këto dukuri, gjenden edhe emrat e Albert Ajnshtajnit, Moska Plonkes, Anrije Brenksonit, Artur Shopenhauerit, J. V. Gëtes, Kami Flamarit, Karl G. Jungut, I. J. Pavlovit etj., të cilët me njohuritë e tyre kanë kontribuar shumë për konsolidimin e parapsikologjisë në rang shkencor. Një zbulim epokal në lëmin e parapsikologjisë e bëri shkencëtari rus, Sejman D. Kilirian (bashkë me të shoqen). Ai, kah fundi i viteve ’60, me ndihmën e rrymës elektrike të frekuencave të larta, zbuloi dhe arriti të fotografojë „aurën”, energjia e shndritshme dhe shumëngjyrëshe e së cilës i rrethon të gjitha qeniet e gjalla.

Parapsikologu amerikan, prof. D. Rajn, në librin e tij shkencor „Shpërndarja e shpirtit të njeriut” shkruan: „Është e pikëllueshme, por e vërtetë, që ne sot më mirë e njohim atomin sesa shpirtin, i cili na mundëson ta njohim atë. Kur do e njohim

shpirtin vetëm sa gjysma e asaj sa fizika njeh materien atëherë, me gjasë, do të ishim në gjendje të parashtronim ligje të karakterit parimor, të cilat për jetën e njerëzve do të ishin me rëndësi të madhe”.

Duke iu falënderuar punës kërkimore të këtij shkencëtari u zgjerua horizonti për parapsikologjinë në shumë shtete të zhvilluara dhe u përfshi në shumë universitete, si p.sh. në universitete të SHBA-së, Anglisë, Holandës, Gjermanisë etj. Në Gjermani është i njohur prof. Hans Beneder. Përveç këtij, në këtë shtet, duhet përmendur edhe tre profesorë: E. Jance nga Marburgu, prof. P. Jordan nga Hamburgu dhe filozofin H. Drischi, i cili qysh në vitin 1932, shkroi librin për parapsikologjinë.

Në Amerikë, përpos D. Zh. Rajnit, njihet dhe psikologu eminent V. M. Dungel, si dhe fiziologu me famë botërore Kurt Djukas. Në Angli, në lëmin e parapsikologjisë është i njohur nobelisti prof. Oliver Lodzh. Në Holandë, udhëheqësi i kësaj dege është prof. V. N. Tenacet, ndërsa në Suedi është prof. Jon Bjenhen. Në Francë me parapsikologji u mor, për kohë të gjatë, psikologu dhe fiziologu, nobelisti, Sharl Risha. Kohëve të fundit kjo degë filloi të shtrihet edhe në Evropën Lindore. Në Rusi, shkencëtari më i njohur në këtë drejtim është psikologu I. I. Vasiljev, i njohur gjithashtu si hipnotizues me famë botërore, si dhe M. Ryzel, i cili emigroi në SHBA dhe tash punon në Institutin për Kërkime të Natyrës Njerëzore. Janë të njohura fjalët e tij: „Civilizimi i sotëm i largon njerëzit nga jeta e brendshme e tyre”.

Në Gjermani, në vitin 1923, u paraqit libri i psikologut Georg Groddeck, një ndër ithtarët e S. Frojdit dhe themelues i mjekësisë psikosomatike (psikofiziologjike) me titullin e çuditshëm „Libri mbi ES-in”. „ES” në gjermanishte do të thotë: „kjo”, „këtë”. Dr. Grodeku thotë se trupi nga vetja nuk mund të

sëmuret, sepse ai pa psikën është i vdekur. „ES”, që ai e përmend, është forca e cila na shtynë të punojmë, të mendojmë dhe na e mundëson të jetojmë të shëndoshë, por njëkohësisht edha na i nxit sëmundjet. Me analiza duhet të zbulohet faktori i konfliktit dhe me largimin e tij të pamundësojmë shkatërrimin e të sëmurit.

Dukuritë paranormale, në format e veta të ndryshme, shpërthejnë kornizat e botës sonë shkencore. Epoka e shkencave natyrore është në kulm, por vlerat e shumta të tyre do të kenë ndryshime të mëdha me zhvillimin e parapsikologjisë, e cila qysh sot konsiderohet si shkencë dhe ka vendin e vet në botën shkencore.

„GJENERATORI PSIKOTRONIK”

Përveç anëve pozitive që ka për shkencën parapsikologjia, në qoftë se keqpërdoret, bëhet armë e fortë me pasoja të paparashikueshme për njerëzimin. Fatkeqësisht, në shumë

institute të lartpërmendura, punohet intensivisht për krijimin e një arme të tillë - psikike ose si e quajnë ndryshe „gjenerator psikotronik”, edhe pse gjurmimet në këtë lëmi, respektivisht përgatitjet për një lloj arme të tillë, kanë qenë të ndaluara me norma ndërkombëtare, sepse kemi të bëjmë me ndikim psikik, jo vetëm në mënyrë individuale, por në bashkësi të gjerë, që do të thotë se çështja është e rrezikshme për ardhmërinë e gjithë njerëzimit.

Hipotezat për zhvillimin e armëve psikike definitivisht janë vërtetuar në simpoziumin e dytë „Liritë dhe Kufijtë e Njeriut”, të mbajtur në Francë. Mirëpo, edhe përkundër ndalimeve me norma ndërkombëtare, shkencëtarët ukrainasë lajmëruan se mund të krijojnë menjëherë dhe pa mund të madh të ashtuquajturin „gjenerator psikotronik” për kontrollin e gjendjes psikike të njeriut nga largësia. Bëhet fjalë praktikisht për armën psikike, e cila mundëson që të ndikohet në psikën e ushtarëve, ashtu që ata të përmbushin çdo dëshirë të eprorëve të vet. Gjithashtu, ata mund të paralizojnë gjithë brigadën kundërshtare, duke i kthyer në gjallesa pa dëshirë e vetëpushtet.



Edhe armata amerikane në këtë drejtim ndan disa milionë dollarë në vit. Këtë e vërteton edhe gjenerali nga „Instituti Ushtarak për Informim”, Daniel O. Gream, i cili thotë: „Do të ishte e palogjikshme po të mos merreshim me të”. Edhe gazeta e vitit 1980 „Military Review” jep një artikull të autorit Xhon Aleksandër, ekspert ushtarak, i cili shpjegon se sot funksionon një armë e tillë, e cila me forcën e trurit është paralizuese por mund të jetë edhe vdekjeprurëse, si për individin ashtu edhe për masën. Aty pohon se forca e saj veçse është demonstruar dhe shton se arma psikike është e barabartë me armën nukleare.

Esenca e këtij „gjeneratori psikotronik ” qëndron në atë se

veprimi i tij nuk shihet, nuk dëgjohet, nuk zbulohet dhe mund të bartet në largësi të mëdha. Personi, në të cilin ka ndikuar „gjeneratori psikotronik”, në fillim nuk ndien asgjë, por në kohën e caktuar humb vetëkontrollin, dëshirën për veprim dhe bëhet vegël e huaj. Gjithashtu mund të arrihet edhe vdekja, por që nuk është qëllimi, sepse ai edhe ashtu është i nxjerrë nga rendi.

Supozohet se arritje më të mëdha në këtë drejtim ka SHBA-ja. Dr. i shkencave filozofike nga Rusia, Todor Diçev, thotë se një gjenerator i tillë ka ekzistuar në kohën e puçit në rusi, më 18-19 gusht 1991, në anijen e fluturakeve amerikane „Belkap” në Portin Varna, e nga ku është kontrolluar mendimi psikik i turmës. Ai gjithashtu thotë se M. Gorbaçov dhe B. Jelcin janë njerëz nën ndikimin e këtij „gjeneratori psikotronik” apo si thirren ndryshe, njerëz „zombi”.

Disa shkencëtarë mendojnë se këto kërkime janë të pavlera, se njeriu nuk mund të ndikojë në njeriun tjetër nga largësia dhe gjithë diskutimet rreth „gjeneratorit psikotronik” nuk kanë bazë. Mirëpo, me eksperimente të shuma, është vërtetuar se jo vetëm secili njeri por edhe secila qelizë e gjallë posedon forcë për rrezatimin e informatave në largësi. Këto aftësi psikike mund të aftësohen shumë mirë me ushtrime të ndryshme e që e vërtetojnë ushtrimet telepatike për komunikim në largësi. Këto eksperimente ishin të suksesshme edhe kur njëri nga pjesëmarrësit (si medium) ishte në komorën, e cila deri në 100 mijë herë e zvogëlon ndikimin e rrethit magnetik të tokës, që do të thotë se këto rrezatime nuk janë burime magnetike. Edhe bioenergjia na tregon qartë aftësitë dhe potencialin e organizmit njerëzor, gjithashtu na zbulon fusha të panjohura të energjisë deri më sot.

Te ne në Kosovë, por edhe në Shqipëri dhe trojet tjera shqiptare, kjo lëmi ende merret si pseudoshkencë dhe përveç disa personave, që në mënyrë individuale merren me parapsikologji, institucion të posaçëm nuk ka.

Duhet të theksojmë për fund se shkenca mundohet që të gjitha këto dukuri t'i sqarojë me ndihmën e ligjeve të caktuara, por në shumë raste nuk ka sukses.

Shumica e parapsikologëve parapsikologjinë e ndajnë në disa grupe si: Telepati, hipnozë, parashikim, spiritizëm, telekinezë, bioenergji, radiestezi etj., për të cilat do të bëjmë fjalë në vazhdim.


Sabir
Krasniqi

SUGJESTIONI DHE AUTOSUGJESTIONI

„Forca e imagjinatës është më e rëndësishme se dituria”
Albert Ajnshtajn

NATYRA E MENDJES

Sipas fizikës, realiteti objektiv është vetëm lëvizje e vazhdueshme e llojeve të ndryshme të energjisë, të cilat njeriu i regjistron falë organeve shqisore dhe sistemit nervor. Kështu që, çdo gjë që përjetojmë gjatë gjithë kohës, vjen deri tek ne nëpërmjet shqisave. Shqisat: të pamurit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit si dhe shqisa e gjashtë (e padefinuar ende) janë të ndërtuara për të kapur llojet e veçanta të ngacmimeve për të cilat ne bëhemi të vetëdijshëm përmes proceseve të ndijimit dhe perceptimit. Sipas psikologjisë së sotme, ndijimi konsiderohet si proces pasiv, përmes të cilit ngacmimet kapen nga receptorët ndijues dhe shndërrohen në impulse nervore, ndërsa perceptimi si një proces më aktiv, në të cilin impulset nervore përcillen përmes sistemit nervor deri në tru, ku bëhet organizimi dhe interpretimi i tyre.

Pasi që mjedisi ku jetojmë është i mbushur me ngacmime të llojllojshme ne, në çdo moment, përjetojmë një numër të madh të tyre. Meqenëse s’mund t’i përgjigjemi njëkohësisht këtij numri kaq të madh të ngacmimeve të jashtme, ne i zgjedhim dhe u kushtojmë vëmendje vetëm një numri të kufizuar të tyre, të cilat kanë ndikim më të thellë në jetën tonë. Kështu që, gjatë eksperiencës, ne mësohemi që t’i kapim vetëm të dhënat që kanë të bëjnë me qëllimet tona, dhe ky frymëzim dhe ndikim në psikën tonë quhet sugjestion.

„Për ta kuptuar më mirë funksionin e mendjes suaj - thotë

Xh. Marfi (Joseph Murphy), paramendojeni atë si një kopsht. Ju jeni kopshtari që tërë ditën diçka mbjell (mendon v.j.). Atë që e keni mbjellë në nëndije, do ta korrni në trupin tuaj në marrëdhënie me botën e jashtme". Me fjalë të tjera: Ju jeni mendimi juaj.

„Nëndija (ose subkoshienca) mund të krahasohet me tokën ku rriten të gjitha llojet e bimëve, si ato të mirat, ashtu edhe ato të dëmshmet. Dikush korr fruta e dikush baroja. Secili mendim, qoftë i juaji apo i imponuar, është shkas ndërkaq të tjerat janë vetëm pasoja". Mu për këtë duhet t'u kushtohet rëndësi mendimeve, gjegjësisht sugjestioneve, pavarësisht se a janë tuajat apo të huajat, sepse kur ato i pranon vetëdija, kalojnë në nëndije, pastaj si forcë krijese nga thellësitë e nëndijes udhëheqin veprimet e individit. Kështu që, tek ata individë që janë më të ndjeshëm emocionalisht, edhe sugjestionet më të thjeshta bëjnë efektin e vet, qoftë pozitiv, qoftë negativ.



Ç'ËSHTË SUGJESTIONI DHE AUTOSUGJESTION?

Njerëzit sugjestionin e përcaktojnë në mënyra të ndryshme. Prof. Ch. Baudauin thotë: „Sugjestioni është krijim i një ideje nëpërmjet nëndijes", ndërsa psikologu Fritz Lambert konsideron: „Gjithçka që në ne ndikon shpirtërisht, është sugjestion, sepse në momentin kur i nënshtrohemi ndikimit shpirtëror lind besimi që i përgjigjet atij ndikimi".

Kurt Tepperwein thotë: „Sugjestioni është thelbi i çdo ndikimi hipnotik". Prof. Georgi Lozanov në librin e tij

„Sugestiologia”, botuar në Sofje më 1971, paraqet 27 karakteristika, me të cilat autorë të ndryshëm u munduan ta përcaktojnë konceptin e sugjestionit.

Me sugjestion, kryesisht dhe më së shpeshti, nënkuptohet pranimi i një ideje apo mendimi të huaj. Sipas fjalorit, fjala sugjestion, që rrjedh nga latinishtja, do to të thotë frymëzim, zgjim i mendimeve të caktuara në mendjen e dikujt, gjegjësisht pranim në procesin mendor, në kuadër të të cilit ndonjë mendim pranohet, adaptohet a jetësohet.

Nga jeta e përditshme dimë se ndikimi i faktorit psikik në organizmin e njeriut (përgjithësisht), si dhe në organet veç e veç, është shumë i madh. Posaçërisht janë të ndjeshme enët e gjakut. Kur njeriu ka frikë ose gëzim të papritur, mund të ketë si pasojë apopleksinë etj. Të gjithë e kemi të qartë se, para ndryshimit të disponimit, ndryshohet ngjyra e fytyrës. Pastaj, një fëmijë është në gjendje ta ndërpresë tërë orkestrën, në qoftë se para tyre befas lëpin një limon. Gjithashtu, na është e njohur se, nëse dikush tërheq pirunin nëpër pjatë, mund të na nxisë të dridhura nëpër trup, ndonjëherë edhe vetëm mendimi në një gjë të tillë e bën efektin e njëjtë. Apo, në qoftë se në një sallë koncerti dikush papritmas bërtet „ikni zjarri!”, nuk është rast i rrallë kur, jo vetëm individët, por edhe masën e gjerë e kaplon paniku, ashtu që të gjithë fillojnë të ikin dhe bërtasin. Ose, në aeroplan, ku është frika e pranishme vazhdimisht, një provokim më i vogël nxit panik marramendës etj. Ky do të ishte një sugjestion i suksesshëm i cili tek të pranishmit automatikisht do të shndërrohet në autosugjestion, sepse sugjestioni si i tillë mund të veprojë vetëm atëherë kur nga personi tjetër pranohet dhe shndërrohet në autosugjestion. Në qoftë se në rastet e lartpërmendura, të pranishmit së



pari pyesin: „ku është zjarri?” „Ku është defekti?” „Në cilën pjesë?”, atëherë, ai më nuk është sugjestion i suksesshëm, pra nuk është pranuar nga masa, sepse është përzier gjykimi kritik normal dhe ka krijuar rrugën e gjykimit normal.

Kur tregtari lavdëron mallin, i riu i fletë vajzës, nëna e ledhaton fëmijën etj., të gjitha këto, diku më shumë e diku më pak, në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, kryejnë ndikim sugjestiv. Sesa do të jetë i suksesshëm sugjestioni, në radhë të parë varet nga sugjestibiliteti i personit (ose grupit), si dhe nga cilësitë sugjestive të sugjestionit. Pa marrë parasysh se për çfarë flet dhe me ç’fakte disponon, ne më shumë do t’u besojmë atyre fjalëve që mund të na i thotë ndonjë personalitet i lartë apo ndonjë person më i vjetër, sesa kur ato rrjedhin nga goja e ndonjë personi të ri ose të rëndomtë.

Për ne, gjithsesi sugjestioni është me interes si mundësi më e shpejtë dhe më e mirë për mësim dhe shërim. Në librin e tij, Lozanov më së shumti ndalet në sugjestopedi - mësim me ndihmën e përdorimit të sugjestionit, sepse atëherë mund t’i zbulojmë, jo vetëm rezervat e personalitetit tonë në lidhje me kujtesën, por edhe shumë mundësi të tjera, si p.sh.: mund të aktivizohen procese të ndryshme intelektuale, mund të formohen shprehitë e të folurit bukur etj. Lozanovi gjithashtu thekson rezultatet e programit të madh kërkimor, të ndërmarra në bashkëpunim me UNEKS-in, lidhur me mësimin e gjuhëve të huaja. Rezultatet ishin befasuese, sepse shpejtonin procesin e mësimit të gjuhëve të huaja për pesë-gjashtë herë.

Por edhe diçka duhet ta kemi të qartë: sugjestioni ndikon vetëm atëherë, kur me ndihmën e autosugjestionit pranohet si i vërtetë. Pra, që të veprojë sugjestioni, duhet atë ta pranojmë, dhe në imagjinatën tonë, ta transformojmë në autosugjestion. Kështu

që, çdo sugjestion, i cili vije nga jashtë, në fakt është autosugjestion, dhe të gjitha paraqitjet hipnotike janë pasojë e sugjestioneve, gjegjësisht, autosugjestioneve.

Përdorimi i sugjestionit është i madh edhe në mjekësi për shërimin e neurozave, astmës, alergjisë, të thatit në bark etj., në përgjithësi te të gjitha sëmundjet psikofiziologjike. Sidomos Frojdi, dhe shumë të tjerë pas tij, e kanë përdorur këtë mënyrë shërimi. Frojdi, siç e kemi cekur edhe disa herë, pasi vëren se të gjithë pacientët nuk mund t'i hipnotizojë, e zhvillon metodën e njohur të psikanalizës e cila, krahas metodave tjera, përdoret edhe sot e kësaj dite si terapi shumë e suksesshme, e që është e bazuar plotësisht në mënyrën e shërimit verbal, pra nëpërmjet sugjestionit.

Gjithashtu, me anë të sugjestionit është arritur (pa anestezi) operim pa dhembje te pacientët. Për intervenim kirurgjik pacienti është përgatitur 20 ditë me radhë, me anë të bisedave dhe sugjestioneve për operim pa dhembje. Më në fund, intervenimi është kryer plotësisht me sukses, pa dhembje, dhe me një shërim të shpejtuar pas intervenimit. Ky intervenim kirurgjik u xhirua edhe në film dhe u paraqit në Kongresin Ndërkombëtar për Mjekësi Psikosomatike, që u mbajt në Romë, në vitin 1967.

Nëpërmjet bisedave dhe sqarimeve bindëse, të zhvilluara në ambiente të posaçme, duke i folur me zë të ulët pacientit që gjendet i shtrirë dhe i relaksuar, mjeku ndikon në psikën e tij në mënyrë sugjestive. Shërimi zgjatë disa ditë, varësisht nga sëmundja, me tretman 30 deri në 50 ditë

FORCA E SUGJESTIONIT DHE AUTOSUGJESTIONIT

Sugjestioni dhe autosugjestioni paraqesin forcën, e cila me veprimin e vet shumë herë tejkalon të gjitha parashikimet tona.

Por nuk duhet harruar se kjo forcë mund të jetë e drejtuar si në kuptimin pozitiv ashtu edhe në atë negativ.

Sistemi nervor qendror dhe ai periferik janë në lidhje të ngushtë mes veti. Gjithashtu, secili organ, secila qelizë, qëndron nën ndikimin e përhershëm të sistemit nervor parasimptik. Ashtu sikurse organizmi i njeriut që përbën një tërësi të përbashkët, ashtu edhe çrregullimet në cilindo organ do të influencojnë në organin tjetër. Sistemi nervor është shumë i ndjeshëm dhe në ngacmime të ndryshme reagon në mënyra të ndryshme. Si shembull ilustrues po marrim kompozicionin e një treni, ku lokomotiva, padyshim, është pjesa më e rëndësishme, sikurse që është truri tek njeriu. Në qoftë se treni rastësisht has në pengesa, do të shkatërrohen, përveç lokomotivës, edhe vagonët që janë të lidhur me të. Ashtu edhe tek njeriu, secila tronditje shpirtërore shkakton ndryshime të dëmshme edhe në organet e veçanta. Përveç këtyre, vagonët kanë edhe parashtysat si dhe pjesë tjera amortizuese, sikurse trupi i njeriut që ka pjesë të posaçme për këtë qëllim, sepse, përveç sistemit nervor qendror dhe atij periferik, ekziston edhe sistemi autonom për zemër, zorrë, mushkëri etj., i cili në raste të përgjithshme nuk u nënshtrohet ndikimeve të dëshirës. Në qoftë se në rastin e mësipërm, ndeshja e lokomotivës është jashtëzakonisht e fortë, atëherë është e mundur që, përveç lokomotivës, të shkatërrohen edhe vagonët, pa marrë parasysh amortizatorët. Po në të njëjtën mënyrë, traumat e papritura psikike, munden që në rrethana të ndryshme të çrregullojnë punën e organeve të veçanta në atë masë saqë funksioni i tyre i mëtejmë është i pamundur, kështu që mund të vijë edhe deri te vdekja. A do të vijë kjo më herët a më vonë, varet nga forca e tronditjes shpirtërore.

„Unë askujt asgjë nuk i predikoj. Unë thjesht i mësoj njerëzit të bëjnë atë që dëshirojnë ta bëjnë. Në mes meje dhe atyre nuk ekziston konflikt, por bashkëpunim. Në ta nuk ndikoj unë, por forca që ekziston në ta. Unë i mësoj si të shërbehen me të...” - kështu thoshte farmacisti i njohur francez nga Nanci, Emil Kue (Emile Coué), në librin e tij „Si ta zotërojmë veten”. Kue e mendoi një sistem shumë të thjeshtë të sugjestionit dhe autosugjestionit, i cili u bë i njohur dhe shumë i përhapur në botë.

Në barnatoren e Kues hyn një njeri dhe kërkon një ilaç, i cili jepej vetëm me recetë. Kue, për të mos e kthyer të dëshpëruar, në vend të ilaçit ia mbush një gotë me ujë të distiluar dhe e udhëzon për përdorim. Pas një jave kthehet njeriu i shëruar plotësisht duke e falënderuar farmacistin për ilaçin që e shëroi. Kue erdhi në përfundim, se atë e shëroi autosugjestioni, sepse ai as që kishte pirë ilaç, por ujë të distiluar, dhe prej atëherë filloi interesimi i tij për sugjestionin dhe autosugjestionin dhe formoi formulën shumë të njohur: „Nga dita në ditë, në çdo aspekt, jam mirë e më mirë”.



Kue preferon që formula të përsëritet në mbrëmje para gjumit dhe në mëngjes posa të zgjohemi, kur edhe kotemi, pra: jemi në gjendje alfa, sepse atëherë mendimi i përmbledhur në atë fjali kalon në nëndije, nga ku pastaj ndikon në të gjithë organizmin tonë. Kjo formulë duhet të përsëritet nga njëzet herë (në mbrëmje e mëngjes), me zë të ulët dhe në mënyrë pëshpëritëse.

Kurt Tepperwein, mjek gjerman, udhëheqës ndërkombëtar për kërkime me hipnozë, në librin e tij „Shkolla e lartë e hipnozës” na jep një shembull nga Tibeti, ku disa mjekë kishin shkuar për hulumtimin e disa „çudirave” që i bënin klerikët tibetas (Lamët). Pas 20 vjet ushtrimesh, disa nga këta klerikë

kishin arritur që të ngriheshin në ajër dhe të mbeteshin një kohë mjaft të gjatë ashtu horizontalisht (pezull), afër një metër mbi tokë. Njëri nga mjekët gjatë bisedës, grindet me një klerik tibetas dhe ai i nevrikosur i thotë: „Pas një viti, në këtë ditë, do të vdisni!" Pas kthimit në vend, përkundër rezistencës që u bënte, mjeku u nënshtrohet sugjestioneve (të klerikut tibetas) dhe, sa më afër që afrohej ajo ditë, ai e ndiente vetën më keq. Dy ditë para asaj date kërkon ndihmë në klinikë. Kolegët vërtetojnë se nuk ka kurrfarë çrregullime organike dhe e tëra ajo ishte autosugjestion i pastër i klerikut tibetas. Atëherë vendosin që ta hipnotizojnë dhe i japin sugjerime të thella hipnotike: „Tani do të hysh në një gjumë të thellë dhe do të flesh katër ditë e katër net..." Kur u zgjua pas katër ditësh, i thanë se „dita e gjykimit" kaloi. Kështu i „sëmuri" u shërua shpejt dhe vazhdoi punën si mjek.



Rastin tjetër, që koincidon me të parin, por që pati një epilog tragjik, na e përshkruan autori Xh. Marfi. Një kushëri i tij, gjatë qëndrimit në Indi, viziton një parashikues telepatik. Ai, duke shikuar në sferën e qelqit, ia zbulon një sëmundje të zemrës dhe ia parashikon vdekjen gjatë kohës së hënës së re. Kushëriri kur kthehet në shtëpi u tregon për këtë parashikim anëtarëve të familjes; madje e shkruan edhe testamentin. Sugjestioni i fuqishëm ia pushtoi nëndijen, sepse ai iu dorëzua atij. Kushëriri vdiq ashtu siç i qe paralajmëruar, duke mos ditur se ai vetvetes ia kishte shkaktuar vdekjen.

Shembuj të këtillë na jep edhe Frojdi, i cili u mor edhe me zakonet sociale dhe religjioze të popujve primitivë. Në disa fise ishte krijuar besimi i shenjtë, se secili që prek ndonjë plaçkë të shenjtë, duhet patjetër të vdesë. Një kryeparë nga Zelanda e Re, la një pjesë të racionit të drekës në rrugë. Kaloi atypari një rob i fortë dhe i shëndosh dhe, pasi ishte i uritur, mori dhe hëngri atë

që kishte lënë kryepari. Duke ngrënë, atypari kalon një anëtar i atij fisi dhe i tmerruar i tregon se ai ishte ushqim i kryeparit dhe se me këtë kishte thyer besimin e shenjtë. Robi, i fortë dhe i shëndoshë, siç ishte, me të dëgjuar këtë, i kapluar nga frika fillon të dridhet dhe pas pak rrëzohet për tokë. Të nesërmen, pa aguar dielli, vdes.

Edhe Jungu na jep shembuj të këtillë: një grupi zviceran, gjatë qëndrimit në Afrikë, ia sjellin një grua të sëmurë nga hematoksia për shkak të një aborti. „Ne - thotë Jungu, vetëm i rrudhëm krahët, duke u thënë se mjekësia jonë është ende e paaftë për të bërë diç në këtë rast”. E dërguan ashtu te magjistari. Ai e mblodhi fisin dhe filloi ritualin me këngë dhe lojë, derisa magjistari me të sëmurën qëndronin në mes. Duke bërë lëvizje të ndryshme, ajo ra në një lloj gjumi. Atëherë ai i tha të sëmurës se „satanai kishte hyrë në të”. Lëviznin rreth e rrotull, derisa e gjetën një zgavër afër gardhit, e atëherë magjistari tha: „Këtu kaloi satanai!” E mbylli zgavrën dhe gruaja me të vërtetë u shërua!...



Shembull tjetër është edhe i mjeku të famshëm persian Rhazes (Abū Bakr Muḥammad ibn Zakaryā ar-Rāzī) i cili jetoi në shekullin e IX. Njëherë atë e thërrasin që ta shërojë Sulltanin Emir që vuante nga një paralizë e rëndë. Mjeku Rhazes i luti që të dilnin të gjithë jashtë dhe ta linin vetëm me sulltanin. Atëherë, ai papritmas, nxjerr shpatën dhe duke u çjerrë dhe bërtitur në Sulltanin (shpatëzhveshur) iu kërcënua: „Tani do të të therë që më thirre në këtë kohë!” I frikësuar dhe i nemitur nga ky qëndrim, Sulltani kërcen në këmbë, nxjerr shpatën, por... mjeku Rhazes kërcen mbi kalë dhe ik. Më vonë, natyrisht, Sulltani e shpërbleu për këtë shërim dhe e pranoi si mjek në pallatin mbretëror.

Nga këta shembuj shihet qartë se sa ndikuese është forca e

sugjestionit dhe autosugjestionit. Sugjestioni dhe autosugjestioni gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm në krijimin dhe formimin e opinioneve, të individualitetit personal ose kolektiv. Andaj, çdo fjale apo fjalie që e përdorim gjatë të shprehurit në jetën e përditshme, duhet t'i kushtojmë rëndësi shumë të madhe.




Sabir
Krasniqi
Peizazh 94

HIPNOZA

HISTORIA E HIPNOZËS

Të gjitha lëmitë e definuara shkencore (empirike), burimin e kanë në paragjykimet, besëtytnitë etj., me një fjalë, në magjitë e ndryshme. Hipnoza në këtë rrafsh, edhe pse e pranuar shkencërisht, edhe sot e kësaj dite nuk është liruar plotësisht nga sharlatanizmat, absurditetet dhe keqkuptimet.

Fenomenet e hipnozës, padyshim janë të njohura për njerëzimin që nga kohët më të lashta, pasi që për to ekzistojnë të dhëna historike dhe zakonisht janë shfrytëzuar për nevoja fetare e mjekësore.

Shënimet e ruajtura nga popujt e lashtë, që jetonin rreth lumenjve Eufrat dhe Tigër, tregojnë se populli më i vjetër i njohur për kulturë në botë - Sumerët, qysh 4000 vjet p.e.r. e kanë njohur hipnozën dhe janë shërbyer me të.

Gjithashtu është i njohur edhe miti për Eskulapin, i cili të sëmurët i shëronte në atë mënyrë që, së bashku me barërat popullore, u pështpëriste në vesh fjalë sekrete magjike.

Në Indi, Asiri dhe në vendet e tjera të Lindjes së Largët, hipnoza përdorej kryesisht për të rritur rolin e fesë në masat e gjera të popullit. Si klerik pranohej vetëm ai që zotëronte në mënyrë të mjaftueshme hipnozën. Gjatë ceremonive fetare, predikuesit e fesë, duke folur kryenin veprime të çuditshme me anë të duarve: bërtisnin kur i lexonin „librat e shenjtë” dhe në këtë mënyrë arrinin t’i sugjestiononin dëgjuesit, apo edhe ta hipnotizonin ndonjërin prej tyre, i cili pastaj kthehej në një kukull që u nënshtrohej verbërisht urdhrave të

klerikut. Të tjerët mund të humbnin zërin, t'u paralizoheshin këmbët etj. Ngjarjet e tilla, natyrisht i magjepsnin të gjithë të pranishmit, e sidomos ata që hipnotizoheshin. Në këtë mënyrë përhapej dhe forcohej bindja në masat e gjëra të popullit, se klerikët ishin të pajisur me forca të mbinatyrshme. Një besim tipik mbizotëron edhe sot në mesin e besimtarëve Sufi.



Në Egjiptin e Vjetër, gjithashtu është përdorur hipnoza si metodë terapeutike. Në papirusin e vjetër, 3000 vjet p.e.r., i ashtuquajturi „Papirusi i Ebersonit", janë përshkruar metoda me të cilat janë shëruar njerëzit, e që s'janë gjë tjetër, pos metoda të hipnozës. Klerikët egjiptianë njëherit ishin edhe si mjekë popullorë. Për hipnotizimin e të sëmurëve ata përdornin një pllakë të shndritshme metalike, që ia vinin të sëmurit para syve, për t'ia lodhur sytë (kjo metodë e fiksimit përdoret edhe sot), si dhe metodën e të përshkuarit me duar nëpër trupin e të sëmurit, duke përcjellë veprimin me fjalë të posaçme „magjike". Kështu është e njohur thënia, që figuron në një dokument të vjetër egjiptian: „...vendosi në të pëllëmbët e duarve që t'ia qetësosh dhembjet dhe thuaj se do të shërohet."

Asokohe kanë ekzistuar edhe faltore, ku të sëmurit kanë kaluar natën duke iu lutur Zotit që t'i shërojë. Më e njohura ka qenë faltorja e Serapsit në Kanape dhe faltorja e Izdinit.

Hipnozën e kanë njohur edhe grekët e vjetër si „gjumë i faltores". Ata, të cilët shkonin për t'u shëruar në faltore, duhej të flinin aty, por edhe të përgatiteshin nëpërmjet dietave dhe ritualeve të ndryshme, për t'u arritur gjumi hipnotik. Atëherë klerikët (derisa ata flinin) u afroheshin dhe iu pëshpëritnin atyre sugjestionet e caktuara e që ata, nën ndikimin e atmosferës së faltores dhe besimit në të, të aktivizonin forcën e tyre shëruese. Para se të binin për të fjetur, të sëmurët këshilloheshin, se duhej t'u përmbaheshin dhe t'i kryenin të gjitha veprimet që „Zoti do

t'ua thotë gjatë gjumit". Të nesërmen, kur ata zgjoheshin, klerikët ua interpretonin ëndrrat dhe i këshillonin edhe njëherë, seriozisht, se duhej t'i përmbaheshin vullnetit të Zotit, në qoftë se dëshironin të shëroheshin.

Pasi në atë kohë, sikurse edhe sot, disa njerëz nuk i nënshtrohen sugjestionit hipnotik, në shumë faltore, arritja e gjendjes hipnotike bëhej nëpërmjet bimëve të caktuara narkotike.

Ndikimi i një individi mbi tjetrin dhe vënia në gjumë për qëllime mjekuese, njihej edhe nga populli i vjetër romak. Shkrimtarët romakë, Marciali, Apuleu dhe Plauti, njihnin metoda për t'i vënë në gjumë njerëzit, veçanërisht metodën e prekjes së trupit me duar, shoqëruar kjo edhe me lutje e „fjalë magjike".

Metoda e hipnozës në formë të „gjumit të faltores" u praktikua deri kah mesi i shekullit të gjashtë. Më pas këtë metodë, gjithnjë e më shumë, filluan ta përdornin murgjit e krishterë, duke arritur shërime të çuditshme me anë të lutjeve, ujit të bekuar, prekjes me anë të duarve e metodave tjera.

Me këto rituale u morën edhe mbretërit, si dhe vetë Papa. Në Dhiatën e Re mund të lexojmë: „Do t'i vendos duart në të sëmurët dhe ata do të ndihen më mirë..."

Hipnoza, posaçërisht u praktikua në Indi. Jogistët indianë, me qëllime të posaçme religjioze, kanë provokuar në vetvete gjendje të njëjtë si të gjumit. Atë gjendje e kanë arritur duke e vështruar një objekt me shikim të fiksuar, derisa u lotonin sytë. Ata, në fakt, provokonin gjendje autohipnotike, dhe pastaj me forcën habitëse të vullnetit të tyre, demonstronin fenomene të ndryshme, që edhe sot e kësaj dite janë të pashpjegueshme.

Në mesjetë, shfaqjet e ndryshme të hipnozës filluan të shpjegohen në mënyrë mistike, metafizike e fetare, si futje e djallit në trupin e njeriut dhe, nën këtë pretekst, fillon edhe „gjuetia e shtrigave". Klerikët kudo gjurmonin të „djallëzuarit" (të pushtuarit nga djalli); mëkatarët që ia kishin shitur shpirtin

djallit. Të dyshimtët torturoheshin në mënyra të ndryshme, që të pohonin bashkimin me „frymën e keqe”. Për ta vërtetuar bashkëpunimin me djallin, të dyshimtët (sidomos gratë), hidheshin në ujë (lumë) me këmbë dhe duar të lidhura.

Në qoftë se ata fundoseshin atëherë ishin të pastër, e në qoftë se rrinin mbi sipërfaqe, vërtetohej një bashkëpunim i tillë dhe pastaj pasonin ndëshkimet duke i djegur për së gjalli, në mënyrë që bashkë me trupin e mëkatarëve të bëhej hi edhe djalli (demoni).

„Pavarësisht se çfarë është objekti i besimit tuaj, qoftë i vërtetë qoftë i imagjinuar, do të arrini rezultat të njëjtë”. Këta rreshta që i ka shkruar natyralisti dhe mjeku Theophrastus Bombastus nga Honhenheimi (1493-1541), i njohur me emrin humanitar Paracelsus, disa shekuj më parë na i vërteton sot psikologjia moderne. Paracelsusi ndër të parët u mor me ndikimin e poleve magnetike në organizmin e njeriut. Ai vërtetoi se faktori vendimtar i shërimeve të përgjithshme është „mjeku i brendshëm”, pra vetë besimi.

Në vitin 1646, Athanasius Kircher (1606-1680), në librin e tij „Eksperimentum Mirabile” tregon se si e ka hipnotizuar gjelin. Kjo ishte paraqitja e parë për të ashtuquajturën „hipnozë e shtazëve”.

Astronomi, prof. Maximilian Hell (1720-1792) bëri disa kurime magnetike. Ai i punonte magnetet në formë të organeve të sëmura dhe ato i lidhte në pjesët e sëmura të trupit. Me këtë mënyrë të kurimit ai arriti suksese të papritura: shëronte 60 - 70% të të sëmurëve.

Në fund të shekullit XVIII u bënë përpjekjet e para për ta shpjeguar natyrën e hipnozës. Një ndër personalitetet që i filloi kërkimet në baza shkencore ishte dr. Franz Anton Mesmer (1734-1815). Në moshën 32 vjeçare, Mesmeri përfundon studimet e mjekësisë duke mbrojtur disertacionin „Ndikimi i

planetëve në trupin e njeriut”. Kështu ai e formoi teorinë e veçantë të quajtur „Magnetismus animalis” (magnetizmi shtazor), për shërimin e njerëzve nëpërmjet „fluidit” magnetik. Ai erdhi deri te njohuritë e reja, se për paraqitjen e kësaj dukurie (hipnozës) nuk nevojitet kurrfarë magnetizmi qiellor ose mineral, por është e mjaftueshme vetëm një pjesë e veprimit „fluid” për „magnetizimin” e të sëmurit.

Mesmeri fjalën hipnozë nuk e kishte përmendur kurrë, sepse në atë kohë nuk njihej ky nocion, dhe për një periudhë mjaft të gjatë kjo dukuri u quajt mesmerizëm. Mesmeri njihet si baba i hipnozës dhe me të fillon lindja e hipnozës moderne. Ai „fluidin” e vet e përcillte tek i sëmuri, duke e shikuar dhe duke e prekur me shuplakë të dorës, nga lart deri poshtë. Ky veprim edhe u quajt „shikim i mesmerit”. Më vonë ai e ndryshoi metodën e shërimit. Në një pishinë me „lëng të magnetizuar” shfaqeshin disa shufra të metalta, të cilat pacientët duhej t’i kapnin me duar, në atë mënyrë që „rryma magnetike” të kalonte prej njërit te tjetri. Gjithashtu, edhe atmosfera karizmatike të cilën e krijonte vetë Mesmeri, duke lëshuar muzikë relaksuese, duke e errësuar sallonin dhe duke lëvizur vetë prej njërit pacient te tjetri, i mbështjellë me një pelerinë të zezë, provokonte gjendje sugjestive. Sigurisht, që ky sugjestion dhe autosugjestion i vetë pacientit, si rrjedhim nga pritjet e ndera, provokonte te pacienti krizën e pritur të shërimit. Sapo një pacient binte në atë krizë, shembulli i tij provokonte krizën edhe tek të tjerët. Me sukseset e veta të shërimit, ai arriti famë shumë të madhe, saqë, ndër pacientët e tij, kishte edhe anëtarë të oborrit mbretëror francez, si Maria Antoaneta etj. Mirëpo, në qarqet mjekësore ai u bë i



padëshiruar, kështu që u formua një komision për t'i vërtetuar këto dukuri, i përbërë nga anëtarë të Akademisë Franceze: Gullotini, Joirei dhe Sollina D' Arcetasi dhe anëtarë të tjerë të Akademisë së Shkencave: De Baryt, Franklini etj. Ky komision e hodhi poshtë teorinë e „magnetizmit fluid" si joshkencor dhe e ndaloi përdorimin e mëtejmë duke e vlerësuar atë si metodë mashtruese.

Edhe pse Mesmeri filloi nga parashikimet e gabuara, megjithatë dha nismën që në fushën ndërkombëtare të dijes të shqyrtohet hipnoza, me atë edhe u bë avangardist i psikologjisë moderne. Mesmeri, përndryshe ishte edhe njëri ndër personalitetet më me kulturë në kohën e vet, i njohur jo vetëm në Vjenë e Paris, por edhe në mbarë Evropën. Ishte adhurues dhe mbrojtës i muzikës së Mocartit, dhe kompozitori i famshëm për këtë mbrojtje të artit, iu revanshua duke e përjetësuar në libretin e operës së tij „Cosi fan tutte".

Mesmerizmi u ndalua, por adhurues të shumtë të tij nuk pushuan së eksperimentuari. Sipas literaturës, hipnozën e parë arriti rastësisht ta provokojë një nxënës i Mesmerit - Markiz Pijsiger, të ai cilën e quajti „somnambulizëm artificial". Pijsigeri, duke u munduar ta shërojë një djalosh (Viktorin), vëren se djaloshi, në vend se të reagojë në prekjet e tij, thjesht flinte në një gjumë plotësisht tjetër nga gjumi normal. Dhe, ja çudia! Kur e urdhëroi që të zgjohet, djaloshi u zgjua dhe bëri disa hapa me sy të mbyllur. Dhe kështu, me sy të mbyllur, djaloshi sillej si njeri i dëgjueshëm duke i zbatuar ato që e urdhëronte Markizi. Pasi zgjohet, atij nuk i kujtohej asgjë nga përjetimet gjatë kohës së këtij gjumi të çuditshëm. Pra, ishte kjo në të vërtetë hipnoza e parë të cilën një njeri e aplikoi në tjetrin, dhe nga atëherë fillojnë kërkimet intensive të kësaj paraqitjeje dhe „mesmerizmi" ose „somnambulizmi artificial" fillon të praktikohet në mbarë botën. Pastaj paraqiten teori të ndryshme duke e emërtuar me nocione të ndryshme si: „biomagnetizëm", „zoomagnetizëm" etj.

Nxitje të mëtejme shkencës mbi sugjestionin hipnotik i dha portugezi Abbé Faria (1755-1819), me prejardhje nga kolonia portugeze Goa, por i shpërngulur në Paris në vitet e fundit të jetës. Ai në Indi i kishte studiuar paraqitjet hipnotike dhe kishte përfunduar, se për provokimin e gjumit hipnotik, hipnotizuesit nuk i nevojitet kurrfarë „fluidi", siç besonte Mesmeri, por gjumin hipnotik e provokon vetë sugjestioni. Në vitin e fundit të jetës (1819), ai demonstroi në Paris ekzibicione publike para më se 5000 njerëzve, duke konstatuar se secili njeri mundet, me anë të dëshirës dhe fantazisë së tij, të ndikojë në njeriun tjetër ose edhe në masën publike, nëse ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë.

Në fund të viteve '70 të shekullit XIX, u formuan dy kuptime themelore për esencën e hipnozës. Protagonistët e „Shkollës së Parisit" e lidhën hipnozën me patologjinë. Ata konsideronin se hipnoza është një gjendje abnormale. Një ndër udhëheqësit kryesor të kësaj shkolle ishte Jean Martin Charcot (1825-1893), mjek në spitalin e Parisit „La Salpetriere" dhe profesor i anatomisë patologjike. Si neurolog gëzonte reputacion ndërkombëtar dhe studimet e tij për sëmundjet nervore ishin epokale. Charcot erdhi në përfundim se hipnoza është vetëm një provokim artificial i histerisë. Ai ishte edhe një kundërshtar i madh i drejtimit tjetër të quajtur „Shkolla e Nancysë".

Derisa „Shkolla e Parisit" e drejtuar nga dr. Charcot eksperimentet i bënte me njerëz të sëmurë psikikë, „Shkolla e Nancysë" eksperimentonte me njerëz normalë. Këtë shkollë e udhëhiqnin dr. A. A. Liebeault dhe prof. Hypolyke Bernheim. Ndër nxënësit e shumtë të kësaj shkolle ishin edhe Frojdi, Foreli, Coue etj.

Sipas Liebeaultit dhe Bernheimit, hipnoza reduktohet në sugjestion të pastër. Njeriu është, me gjasë, i gatshëm që të bjerë

nën sugjestionin e rrethit dhe, si i tillë, paraqet objekt të volitshëm për hipnozë. Ai i cili nuk dëshiron të hipnotizohet, nuk mund të shërbejë kurrë si medium.



Këta dy mjekë që i kanë shëruar mbi 12.000 pacientë, dhe që njihen edhe si novatorë të psikologjisë moderne, konsiderojnë se hipnoza është funksion i sjelljeve normale, duke e kundërshtuar kështu tezën e neurologut Charcot, i cili konsideronte se hipnoza është formë e histerisë dhe për këtë shkak edhe e rrezikshme.

„Shkolla e Nancysë" pa dyshim i dha interpretim racional kësaj dukurie, por as ajo nuk e sqaroi hipnozën plotësisht, duke u mbështetur vetëm në sugjestione dhe asgjë më tepër.

Hipnoza mori hov më 1933, pas botimit të librit „Hipnoza dhe sugjestioni" nga autori Klark Hol. Atëherë filluan, posaçërisht në Angli dhe Amerikë, kërkime të shumta eksperimentale dhe klinike të cilat u munduan që, më në fund, ta sqarojnë fenomenin e hipnozës dhe të tregojnë rëndësinë e saj. Kështu, në vitin 1936 fillon edhe një epokë e re e hipnozës, e quajtur nga Horsley „epoka e narkoanalizës". Edhe pse kjo mënyrë e të hipnotizuarit njihej nga lashtësia, tani zuri vend të rëndësishëm në mjekësi dhe qarqet e tjera shtetërore si në polici, ushtri etj.

Hipnoza me anë të barbiturateve (medikamente për qetësim dhe gjumë) u përdor gjatë kohës së luftës nga amerikanët. Psikiatrit amerikanë, sidomos Babinski dhe Vensani, duke punuar me ushtarë të sëmurë neurotikë nëpërmjet hipnozës, dhe duke e parë se të gjithë të sëmurët nuk mund të futeshin në atë gjendje me rrugë normale, e praktikuan në mënyrë sistematike metodën e narkoanalizës.

Në vitin 1955 edhe Shoqata Britanike „British Medikal Association" paraqiti fakte për dobinë e hipnozës në shërimin e

psikoneurozave si dhe mundësinë e aplikimit të saj në fushën e anestezisë (hipnoanestezioni), si për lirim nga dhembjet gjatë lindjes, gjatë intervenimeve kirurgjike etj. Për këtë, të gjithë studentëve të mjekësisë dhe mjekëve u rekomandohej që të njiheshin në mënyrë fundamentale me hipnozën. Tri vite më pas, shoqata për sëmundje mentale e Shoqërisë Mjekësore Amerikane vendosi që instruksionet nga hipnoza të përfshihen në të gjitha shkollat mjekësore si dhe në qendrat tjera postdiplomatike mjekësore.

Hipnoza, viteve të fundit, më së shumti përdoret në psikologji dhe psikiatri për shërimin e shumë çrregullimeve shpirtërore, gjithashtu ajo përdoret me sukses edhe në obstetrikë, stomatologji etj.

Në Amerikë hipnoza është duke gjetur zbatim gjithnjë e më të gjerë në kurimin e të sëmurëve nga kanceri, e sidomos atyre që vuajnë nga mortaja e shekullit- AIDS-i. Kjo ka të bëjë posaçërisht me pacientët që në teste kanë rezultuar pozitivisht, por tek të cilët ende nuk ka filluar zhvillimi i kësaj sëmundje në formë aktive.

Sot në botë qendra të ndryshme (SHBA, Rusi, Evropë, Kinë, Indi etj.) merren seriozisht me studimin e hipnozës në mënyrë shkencore, duke e përdorur atë në lëmenj të ndryshëm, gjithnjë në plan më të gjerë.

Ç¨ËSHTË HIPNOZA

Në një anketë që kam bërë në lidhje me hipnozën, në pyetjen: „Çfarë ju bie ndër mend kur përmendet hipnoza?” mora këto përgjigje: „misteri”, „gjumë”, „çmenduri”, „punë dreqi”, „mashtrim”, „nuk ekziston”, „nuk e di” etj. Dhe në të vërtetë, në lidhje me hipnozën, gjithçka mbetet paqartësi (e fshehtësi), prandaj një definicion i plotë për hipnozën është vështirë të jepet.

Fjala hipnozë (hypnos) rrjedh nga greqishtja, dhe do të thotë „gjumë”. Ky nocion është marr nga mitologjia e lashtë greke, me të cilin personifikohej zoti i gjumit „Hypnos”. Hypnosi është edhe babai i Phantasos si dhe zotit të ëndrrave, Morpheus, i cili me ndihmën e një harpe vallëzonte në një lloj gjendje transi.

Vështrimet e sotme moderne përjashtojnë çfarëdo tretmani të hipnozës si satanizëm, sharlatanizëm ose ndonjë formë tjetër të ndikimit parapsikologjik, dhe e fusin atë në gjirin e shkencës. Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, hipnoza pranohet si degë shkencore dhe definohet si: „...gjendje e afërt me gjumin, në të cilën mund të vihen njerëzit ose kafshët e larta me anë të sugjestionit për t’i mjekuar nga ndonjë sëmundje ose për t’i bërë që të sillen sipas vullnetit të dikujt”. Prof. Çarls Mater, nga Universiteti i Majamit, thotë: „Hipnoza është gjendje e ndryshueshme e vetëdijes, të cilën e karakterizon rritja e koncentrimit, rritja e relaksimit dhe rritja e sugjestibilitetit”. Ndërsa, Shoqata e Mjekëve Britanikë e definon hipnozën kështu: „Hipnoza është gjendje kaluese e kujdesit të zvogëluar të pacientit, gjendje në të cilën mund të shfaqen paraqitje të ndryshme nga vetvetja ose të provokuara nga rrethi i jashtëm”. Edhe pse gjendja hipnotike është përafërsisht e njëjtë me gjumin, sepse korja e trurit të madh gjatë ëndërrimeve gjendet në gjendje inhibicioni, ajo prapëseprapë ndryshon shumë nga gjumi. Kështu kërkuesit kanë konstatuar se shkalla e përhapjes së inhibicionit, si dhe shkalla e intensitetit të tij, është shumë më e vogël te gjumi hipnotik. Inhibicioni që krijohet gjatë hipnozës nuk përhapet në mënyrë difuze nëpër koren e trurit të madh, por vetëm nëpër zonat e caktuara të kores, ashtu që, në mes zonave që janë të përfshira nga inhibicioni ekzistojnë edhe zona me ngacmime normale. Me inhibicion në hipnozë më së shumti janë të qëlluara zonat motorike të kores së trurit të madh.

Kërkuesit gjithashtu kanë konstatuar se, në mes të gjendjes

së fjetur dhe asaj të zgjuar ekziston një lloj „gjysmë-vetëdijeje”. Në atë gjendje, funksionet trupore janë të zvogëluara, ndërsa ato shpirtërore janë më aktive. Në gjumin hipnotik, i hipnotizuari nuk e humb kontaktin me botën e jashtme, gjë që ndodh gjatë gjumit normal, por ato kontakte i zhvillon nëpërmjet hipnotizuesit dhe atë me një sugjestibilitet shumë të rritur. Gjatë kohës së gjumit normal, ritmi i rrymave aksionale në koren e trurit të madh ndryshohet shpejt, alfa-valët humbin plotësisht, ndërsa te gjumi hipnotik ndryshohet ngadalë dhe alfa-valët nuk humbin plotësisht. Në gjumin normal mediumi nuk e pranon përshtypjen e jashtme, ndërsa gjatë gjumit hipnotik, dëgjon edhe pëshpërimat më të vogla. Në gjumin normal, aktivitetet mentale janë të spostuara, ndërsa gjatë gjumit hipnotik ato janë të gjallëruara etj.

Në qarqet mjekësore sot janë të pranishme dy rryma. Njëra rrymë e konsideron hipnozën si „kontinuitet të gjendjes normale të vetëdijes”, derisa rryma tjetër si „gjendje të ndryshueshme të vetëdijes”. Rryma e parë quhet shkalla e imitimit të rolit, ndërsa e dyta shkalla e disocimit.

NDIKIMI I HIPNOZËS

Teori të plotë për hipnozën, në kuptimin e definicionit të plotfuqishëm, edhe sot e kësaj dite nuk ka. Por, pavarësisht nga kjo, ndikimi i thellë i hipnozës në gjithë organizmin është i pamohueshëm, si dhe zbatimi i saj në qarqet e ndryshme mjekësore është gjithnjë në rritje. Në gjendje hipnotike mund të shpejtohen apo edhe të ngadalësohen: pulsi, frymëmarrja; gjithashtu, mund të ndikohet edhe në ndryshimin e materies:

djersitje, urinim, kollitje, vjellje, hiperestezi, hipestezi, kriptomenzi, amnezi etj. Për këtë, hipnoza edhe përdoret me sukses për shërimin e shumë sëmundjeve organike, të cilat janë të lidhura me probleme psikike (sëmundjet psikofiziologjike), siç janë: të thatët të zorrë, në lukth, shprehitë negative përgjithësisht, urinimi i pakontrolluar etj.

Në obstetrikë hipnoza ndihmon në lindje pa dhembje; në stomatologji dhe kirurgji, për largimin e frikës nga intervenimet (në shumë raste edhe si anestezi) etj. Gjithashtu, hipnoza me shumë sukses përdoret edhe në shërimin e alkoolizmit, duhanit, narkomanisë etj. Kjo nuk do të thotë se hipnoza është „ilaç" që i shëron të gjitha sëmundjet, por në kombinim me metodat tjera terapeutike, ndihmon shumë në shërimin e të sëmurit.

Gjatë gjendjes hipnotike, mediumit mund t'i sugjerohen edhe sugjestione të rrejshme për secilën shqisë veç e veç, qoftë në planin pozitiv apo në atë negativ. Mediumi mund të ndiej, dëgjojë ose të shohë gjithçka që i sugjerohet (edhe nëse ato janë jashtë realitetit), si dhe të mos i ndiej, dëgjojë ose shohë ato që objektivisht ekzistojnë. Pastaj, mund të provokohen gjendje të

ndryshme shpirtërore si: gëzimi, hidhërimi, dashuria, xhelozia etj; po kështu mund t'i imponohet kryerja e cilitdo aktivitet, të cilin i hipnotizuari e ka kryer dikur ose e kryen tani, ose vetëm e ka parë se si të tjerët e kanë kryer, gjë të cilën e shfrytëzojnë zakonisht hipnotizuesit profesionalë nëpër seanca (shfaqje) të ndryshme publike.

Përveç këtyre, në gjendje të thellë hipnotike, mund të krijohet edhe i ashtuquajturi „regresim i kohës" ose „kthim në të kaluarën", ku mediumi kthehet në cilëndo periudhë të jetës së tij, sillet si në atë kohë dhe i kujtohen të gjitha ndodhitë detajisht.

Me rëndësi është gjithashtu fakti se personi i hipnotizuar gjendet plotësisht nën pushtetin e hipnotizuesit. Pasi që sugjestibiliteti në atë gjendje është mjaft i rritur, ndërsa censura e logjikës njëkohësisht tejet e zvogëluar (në minimum), personit të hipnotizuar mund t'i sugjerohen jo vetëm ndjeshmëri të ndryshme dhe mashtrime të shqisave, por edhe të kryejë probleme mjaft të ndërlikuara dhe atë, jo vetëm gjatë gjendjes hipnotike, por edhe pas zgjimit nga ajo (kjo gjendje quhet posthipnozë dhe një sugjestion i këtillë posthipnotik mund të veprojë me vite të tëra, që mundëson keqpërdorimin e hipnozës për qëllime të ndryshme, si: vjedhje, mashtrime, dhunime e deri në vrasje. Gjithashtu, mundëson keqpërdorimin e hipnozës në luftëra të ndryshme, për propagandë ekonomike si dhe për qëllime politike).

Hipnoza ndahet në disa faza (stadiume) që kalohen nga njëra në tjetrën, e që mediumi gjatë kalimit nëpër këto faza futet gjithnjë thellë e më thellë në gjumë hipnotik, varësisht prej sugjestibilitetit të tij dhe aftësive të hipnotizuesit, gjegjësisht terapeutit.

Hipnotizuesit këto faza i ndajnë në mënyra të ndryshme, por shumica e tyre i ndajnë në tri grupe: gjumi i lehtë, i mesëm dhe i rëndë ose shkalla më e thellë - katalepsia.

Siç e theksuam, hipnoza nuk është gjendje gjumi

(fiziologjik), edhe pse në të parë duket kështu, por, besohet se, ekzistojnë ndryshime të caktuara në tru, të cilat në një të ardhme jo të largët do të mund të identifikohen. Është i njohur fakti se gjatë një intervenimi kirurgjik në tru (pacienti ishte nën anestezi hipnotike dhe duhej t'i mënjanohej një tumor), kirurgu rastësisht prek një strukturë në tru dhe pacienti papritmas zgjohet nga hipnoza. Mjeku që punonte me hipnozë e kthen prapë pacientin në gjendje hipnotike. Nga kjo del, pa dyshim, se regjionet e caktuara në tru ndryshojnë mekanizmat fiziologjikë.

Edhe pse sot mjaft njerëz mendojnë (edhe sipas anketës) se hipnoza është „çështje e magjisë", dhe në të kanë ndikim forcat mbinatyrore, shkenca bashkëkohore ka bërë përparime të mëdha në këtë drejtim, duke e zhveshur atë nga këto paragjykime dhe duke e trajtuar si degë të mirëfilltë të shkencës.

Kërkimet e pareshtura në zbulimin e mistereve të trurit, shpresojmë se do ta sqarojnë edhe fenomenin e gjumit të quajtur HIPNOZË

SI ARRIHET HIPNOZA

Sot ekzistojnë mënyra të ndryshme për të hipnotizuar, prej atyre klasike e deri te substancat kimike.

Dihet se te gjithë njerëzit nuk i nënshtrohen njëlloj sugjestionit, pra edhe hipnozës. Gjithashtu, secila hipnozë nuk është e njëjtë. Përveç njerëzve, hipnozës i nënshtrohen edhe shtazët e disa prej tyre arrijnë t'i hipnotizojnë edhe të tjerat. P.sh. gjarpri vetëm me shikim hipnotizon bretkosën, e cila i afrohet ngadalë atij, sakaq ai e pret me kokë të ngritur lart 10-15 cm. mbi tokë. Kur afrohet në distancë të mjaftueshme, me një lëvizje të shpejtë e kape për kokë. Ose; huti, i cili gjithashtu me shikim hipnotizon zogjtë, të cilët sillen rreth tij duke cicëruar, derisa njëri ndahet nga turma dhe hyn në kthetrat e tij.

Hipnoza ndahet në tri shkallë:

- Hipnoza e lehtë: që nënkupton relaksim derisa vetëdija është ende e zgjuar, por mediumi i pranon sugjestionet e hipnotizuesit.

- Hipnoza e mesme: kjo fazë vjen pas hipnozës së lehtë, relaksimi është më i thellë, vetëdija është ende aktive, ndërsa mediumi i pranon dhe i kryen të gjitha sugjestionet, por që nuk bien në kundërshtim total me strukturën e personalitetit të tij.

- Hipnoza e thellë: këtu relaksimi është absolut, vetëdija është e kyçur dhe mediumi i kryen edhe sugjestionet e palogjikshme, të cilat ia parashtron hipnotizuesi. Në këtë gjendje të thellë hipnotike mund të arrihet edhe shtangimi i plotë i trupit (katalepsia), humbja e plotë e dhembjes (anestezia), humbja totale e ndjeshmërisë (analgjezia) etj. Ne këtë gjendje, te mediumi janë të pranishme edhe mashtrimet pozitive ose negative si dhe është i mundshëm regresimi.

Autorët japin shënime të ndryshme për atë se kush i nënshtrohet hipnozës. Psikologu Ajzen thotë se 15% e njerëzve fare nuk bien ne gjumë hipnotik: 40% bien në gjendje të lehtë;

25% në gjendje të mesme, ndërsa vetëm 20% bien në gjendje të thellë hipnotike. Dr. Kurt Tepperwin e kundërshton këtë tezë. Ai, nga eksperimentet e veta me pacientë, ka konstatuar se secili person që fle i nënshtrohet edhe hipnozës. Ai thotë se në gjendje të lehtë bien 52%, në të mesmen 28%, ndërsa në të thellën 20% e individëve. Sipas fjalëve të Tepperwinit, secili njeri që është psikikisht aktiv dhe që ka siguri të plotë në vete, mund të jetë hipnotizues i mirë, ndërsa ai që është psikiskisht pasiv, më lehtë iu nënshtrohet ndikimeve te huaja dhe është më i mirë për medium se sa për hipnotizues.

Procesi i hipnotizimit zhvillohet në shumë mënyra dhe nëpër disa faza. Qoftë kur hipnoza ekzekutohet në ordinancë, qofte në shoqëri private, themelorja është të zgjojmë interesimin dhe të krijojmë atmosferë disponuese, duke biseduar për anët pozitive dhe efektet e këndshme të hipnozës. Dhoma duhet të jetë e ngrohtë, pa zhurmë, pa ndonjë erë të rëndë, të jetë pak e errësuar dhe preferohet të ketë muzikë relaksuese. Mediumi ulet në një karrige të butë ose shtrihet në krevat, dyshek etj. Së pari me të bëhet biseda hyrëse për rëndësinë e kësaj seance duke u munduar që ta largojmë çdo prani droje apo frike nga personi. Pastaj zhvillohet testi i sugjestibilitetit. Testet e sugjestibilitetit janë të shumta, ne po marrim vetëm një si shembull - testin e baraspeshës. Mediumit i urdhërohet që të qëndroje në këmbë drejt, me këmbët e bashkuara dhe duart e palosura për trupin, kurse sytë t'i ketë të mbyllur. Hipnotizuesi qëndron prapa tij dhe shuplakat e veta i mbështet lehtë mbi shpatullat e mediumit. Pastaj i sugjeron se do të numëroj deri në 10 dhe gjate secilit numër, mediumi do të ndiejë një forcë të rëndë që e shtynë prapa; gjithashtu i sugjerohet që asnjë force të mos

i kundërvihet, por të lirohet në pushtetin e saj, pa pasur frikë se do të rrëzohet, sepse hipnotizuesi që rri prapa do ta mbajë. Ky është një ndër testet që ka më së shumti sukses. Ndodh që mediumi bie ende pa arritur numrin 10.

Pas këtij testi, mediumit i sugjerohet që të ulet dhe lihet ashtu 10 - 15 min. për relaksim, por me sy të mbyllur. Edhe mënyrat e hipnozës janë të ndryshme, por ne po marrim si shembull vetëm një - tekniken e numërimit. Pasi që hipnotizuesi paralajmëron mediumin se po fillon procesin e hipnozës, e lutë që të dëgjojë me vëmendje çdo fjalë, pra të ketë koncentrim të plotë. Pastaj i thotë se do të numërojë deri në 10 dhe gjatë secilit numër mediumi duhet që ngadalë t'i hapë sytë e pastaj menjëherë t'i mbyll dhe gjatë gjithë procesit të mos i interesojë asgjë tjetër, përpos gjumit hipnotik. Kështu, mediumi do të ndiejë se pas çdo numri, sytë do t'i rëndohen dhe do t'i mbyllen vetë. Pastaj, hipnotizuesi fillon numërimin nga një deri në dhjetë dhe në secilin numër i sugjeron se kapakët e syve po i bëhen shumë të rëndë, gjithnjë me të rëndë... „Sytë i keni të lodhur, gjithnjë e më të lodhur. Kapakët e syve gjithnjë e më shumë po ju rendohen. Po ju bëhen plumb të rëndë. Aq të rënde, saqë ju nuk po mund t'i hapni sytë. Sytë po ju mbyllen gjithnjë e më shumë... Ju i mbyllët sytë,..” etj. Sa me shumë që i afrohemi numrit 10, do të shohim se mediumit gjithnjë e më shumë po i mbyllen sytë dhe kur ta themi numrin 10, ai nuk do të mund t'i hapë më, pra hipnoza do të ketë sukses. Por, nëse mediumi do t'i hapë sytë, duhet përsëritur i gjithë procesi ose të përdoret metodë tjetër.

Kur të bie në gjendje hipnotike, mediumit i jepen sugjestionet e caktuara, duke pas parasysh çdo sugjestion. Pasi të kryhet procesi i dëshiruar dhe i jepen sugjestionet e caktuara,

mediumi nxirret nga gjendja hipnotike ne këtë mënyrë: I sugjerohet se „kur të numërojë deri në tre, ju do të dilni nga gjumi hipnotik. Me ju do të jete gjithçka në rregull. Do të jeni të qetë, do të ndiheni mirë, do të jeni të disponuar dhe plot energji (numërohet ngadalë); 1 - 2 - 3: Tash jeni në gjendje të zgjuar”.

Krahas kësaj metode kemi qindra të tjera, por ne po i cekim vetëm disa: metoda e fiksimit, metoda e ngjyrave, metoda e shpejtë, metoda indiane, metoda me lavjerrës, hipnoza në largësi, hipnoza në gjumë, hipnoza zinxhirore etj. Por, në qoftë se këto metoda nuk japin rezultate, atëherë kemi edhe metoda të tjera; p.sh.; metoda elektrike, biofidbeku ose substanca kimike: eteri, kokaina, LSD-a etj.

AUTOHIPNOZA

Çdo gjë që është folur për hipnozën dhe për sugjestionin, si procese të hipnotizimit, vlejnë edhe për autohipnozën. Dallimi qëndron vetëm në faktin se në këtë rast ne jemi vetëhipnotizues. Pra, vetë vendosim se çfarë do t’i sugjerojmë vetes. Ndoshta duket pak e çuditshme që njeriu mundet vetveten ta hipnotizojë, por kjo është plotësisht e saktë. Ashtu sikurse mund ta hipnotizoni individin tjetër, ashtu mund ta hipnotizoni edhe vetveten.

Edhe te autohipnoza përmbajtja e sugjestioneve tona duhet t’u përshtatët qëllimeve, të cilat me anën e autohipnozës dëshirojmë t’i realizojmë. Sugjestionet duhet t’i formulojmë, si gjithnjë, me përmbajtje pozitive ose indiferente e assesi të mos jenë me përmbajtje negative a as të bëjmë presion mbi vetveten. Gjithashtu është shumë me rëndësi që, para formulimit të sugjestioneve, t’i largojmë urdhëresat dhe ndalesat. Kurrsesi nuk guxojmë të themi: „Koka më nuk po më dhemb”, por duhet të themi: „Kokën e kam të kthjellët dhe të lehtë”; ose, jo: „Duhet të kem sukses” por, „Do të kem sukses” e të tjera të ngjashme.

Kulmin e forcës së autohipnozës e paraqesin fakirët indianë me demonstrimet e tyre mahnitëse. Një forcë të tillë autohipnotike paraqesin edhe dervishët tanë si dhe shumë individë e sekte të ndryshme. Fakirët indianë, si dhe njerëzit që posedojnë këtë aftësi, me forcën e vullnetit të tyre e bien vetveten në një gjendje të thellë autohipnotike. Në këtë gjendje të thellë autohipnotike, ata provokojnë edhe dukuri fenomenale si: ecja nëpër zjarr, qëndrimi disaditor nën dhe, qëndrimi i tyre lakuriq në temperatura tepër të ulëta etj. etj.

Ashtu, sikurse me anë të hipnozës dhe sugjestioneve që mund të arrijmë zhvillim psikik e fizik, shërim nga shumë sëmundje, përmirësimin e shëndetit tonë, dukjen tonë, arritjen e sukseseve në shkollë ose në punë, eliminimin e shprehive negative e shumë të arritura tjera, ashtu njëjtë edhe me anë të autohipnozës mund t'i arrijmë po ato efekte në vetvete. Dallimi këtu është vetëm në atë, që personi i hipnotizuar është njëkohësisht edhe dhënësi i sugjestioneve e edhe „medium" i cili duhet t'i pranojë ato, pra sugjestionet e dhëna nga vetvetja. Por, për ta lehtësuar këtë proces, është e preferuar që së paku një herë para kësaj t'i shtroheni hipnozës. Gjatë kësaj seance, hipnotizuesi i mirë ua sugjeron shifrën, të cilën ua regjistron në nëndije ose në ndonjë audioregjistrues (kompjuter, Tel, CD, kasetofon etj.), dhe sa herë që ta përsëritni atë shifër ose dëgjoni audioregjistruesin, do të bini në gjendje hipnotike, gjegjësisht në autohipnozë.

Për ta arritur autohipnozën duhet, sikurse te induktimi i hipnozës, të krijoni atmosferë të qetë, mund të lëshoni muzikë relaksuese dhe mundësisht të krijoni gjysmerrësirë. Uluni në pozitë të përshtatshme dhe para jush vendoseni një objekt vezullues (të ndritshëm, mund të jetë edhe bateri xhepi) ose



ndonjë objekt tjetër (fotografi, vizatim etj) i cili do të ndikojë në lodhjen e syve. Mund ta vendosni edhe pasqyrën para vetes dhe ta fiksoni veten në mes të syve. Fiksojeni objektin vezullues dhe filloni me sugjestionet e përgatitura për futje në autohipnozë ose filloni t'i dëgjoni sugjestionet e regjistruara në audioregjistrues.

Kur të thelloheni në gjendje autohipnotike filloni me sugjestionet e dëshiruara (të përgatitura më herët ose të regjistruara në audioregjistrues) për arritjen e qëllimeve apo plotësimin e nevojave të caktuara.

Pasi t'i përfundoni sugjestionet e dëshiruara, vazhdoni me sugjestionet për daljen nga gjendja autohipnotike p.sh., „Kur të numëroj deri në tre do të dal nga kjo gjendje autohipnotike. Këmbët dhe duart do më jenë prapë normale, të lira, të lehta dhe të lëvizshme, siç kanë qenë më parë. Do t'i hapë sytë dhe do të ndihem shumë mirë. Do të jem plotësisht i kthjellët dhe plot energji. Një, dy, tre. Po i hapi sytë. Çdo gjë me mua është në rregull."

Sugjestionet e regjistruara në audioregjistrues mund t'i dëgjoni edhe kur të bini për të fjetur. Pasi që në atë kohë jeni edhe ashtu të lodhur dhe organizmi kërkon pushim, ndikimi i sugjestioneve do të jetë më i madh dhe suksesi nuk do të mungojë.

Gjatë këtij procesi një gjë duhet ta keni gjithnjë parasysh: të përpiloni fjali sa më të përshtatshme për plotësimin e qëllimeve tuaja. Aventurat me autohipnozë janë plotësisht të ndaluara. Meqë në atë gjendje nuk ekziston as hapësirë e as kohë, mundësitë manipuluese janë të panumërta e që më së shumti dëmtojnë vetë të autohipnotizuarin, prandaj edhe autohipnoza preferohet të aplikohet vetëm me udhëzim të terapeutit.

HIPNOZA NË MJEKËSI

Përdorimi i gjumit hipnotik për shërime të ndryshme daton që nga kohët më të lashta. Këtë e ilustrojnë edhe fjalët e Hipokratit: „Sëmundjen, nga e cila vuan trupi, shpirti e sheh shumë mirë me sy të mbyllur”. Zakonisht me të janë shërbyer klerikët fetarë. Por, përdorimi i hipnozës si mjet shërues, masovikisht filloi të zbatohet nga mjeku F. A. Mesmer, në bazë të së cilit edhe e gjithë kjo u quajt „mesmerizëm”. Këtë valë të „mesmerizmit” në Angli e përhapi mjeku dr. John Ellitson, kështu që më 1843 në Londër u themelua spitali „mesmerik”. Pastaj vazhdoi hapjen e spitaleve edhe në shumë qytete të tjera si në Dablin, Edinburg etj.

Për hipnozën, si mjet shërues, u interesua edhe babai i psikanalizës Frojdi, i cili e përdori me të madhe në shërimin e pacientëve të tij, dhe atë me sukses të madh.

Me përsosjen e anestetikëve në vitet e fundit të shekullit 19, përdorimi i hipnozës filloi të zbehet, por gjatë luftës së parë botërore, pasi që mjekët në situata të tilla nuk kishin gjithmonë anestetikë, prapë u kërkua riaktivizimi i saj për të ndihmuar të plagosurit e shumtë.

Në vitet e pasluftës, shumë mjekë filluan ta aplikojnë hipnozën në ordinancat private të tyre si dhe në shumë spitale ku punonin ata. Në vitin 1946, kirurgu amerikan Kolman e përdori hipnozën gjatë një intervenimi kirurgjik në lukth; pastaj, në vitin 1953, mjeku Anglez Over Ford e aplikoi në intervenimin kirurgjik të Apendix-it (zorrës qorre), e kështu me radhë...

Operimi i parë, i bërë në ndikimin e hipnozës dhe i regjistruar në shiritin e filmit celuloid, u zhvilluan në vitin 1959 në Angli. Paciente ishte një 25 vjeçare, mësuese e vallëzimit. Asaj gjatë operimit iu tha se ndodhej në piknik, kështu që fare nuk e ndjeu dhembjen. Gjithashtu janë të njohura rastet e intervenimit me anë të hipnozës gjatë operimeve të rënda dhe të

komplikuara, posaçërisht në rastet kur, për arsye shëndetësore, nuk lejohej të përdorej anestezia. Në një rast pacientja e hipnotizuar, jo vetëm që nuk pati dhembje, por as gjakderdhje nuk kishte. Gjithashtu, asaj i është sugjeruar se pas operimit, gjatë marrjes së ushqimit, asgjë nuk do t'i pengojë, nuk do të kollitet, nuk do të vjellë dhe të gjitha këto u realizuan.

Pas kongresit botëror për hipnozën dhe sëmundjet psikosomatike (psikofiziologjike) që u mbajt me 1965 në Paris, ku u lexuan shumë referate që verifikonin ndikimin pozitiv të hipnozës në mjekësi, në shumë fakultete të mjekësisë hipnoza u fut si lëndë obliguese për mjekët e ardhshëm.

Përdorimi i hipnozës në mjekësi është shumë i madh. Ajo zëvendëson anestetikët dhe shpejton procesin e shërimit. Në stomatologji ajo është shumë e përhapur dhe një numër i madh stomatologësh, sidomos në Britani, Gjermani, Zvicër etj., aplikojnë këtë metodë me sukses shumë të madh në nxjerrjen e dhëmbëve pa dhembje, ndërsa në Itali është hapur shkolla speciale për nxjerrjen e dhëmbëve me hipnozë.

Intervenim stomatologjik i zviceranes dr. Bea Bucher në pacienten e hipnotizuar

Gjithashtu, me hipnozë bëhen lindje pa dhembje. Në Britani është shumë e popullarizuar lindja me anë të hipnozës dhe është metodë shumë e preferuar. Ndërsa në Itali është e njohur klinika „Bianko", në Limbiat, 15 km afër Milanos, ku bëhen lindjet pa dhembje me anë të hipnozës, nën përkujdesjen e dr. Giampiera Mosokania.

Duhet thënë se hipnoza, si metodë psikoterapeutike, mund të përdoret si mjet mjaft efikas në parandalimin e frikës, duke u mundësuar kështu miliona grave lindje pa dhembje dhe pa pasoja tjera.

Në ditët tona, duke jetuar gjithnjë nën tensione psikike, nën

trandje, shpesh të përcjella me emocione të forta, njerëzit gjithnjë e më shumë po u nënshtrohen sëmundjeve psikofiziologjike, që kanë si pasojë: të thatin të lukth ose zorrë, astmën, hipertoninë (ngritjen e tensionit të gjakut) etj. Në të gjitha këto sëmundje, hipnoza mund të ndihmojë shumë. Në librin e tij „Hipnoza në klinikën e sëmundjeve të brendshme", studiuesi rus P. I. Bulj, shkruan se si në Petërsburg ka bërë kërkime 15 vjeçare në shërimin e këtyre sëmundjeve në rreth 6000 pacientë. Kështu, për shërimin e të thatit të lukth, jep këto rezultate: nga 92 pacientë - 30 janë shëruar plotësisht vetëm me hipnozë; 33 janë shëruar plotësisht me hipnozë dhe me anë të medikamenteve; ndërsa 29 të tjerë kanë pasur përmirësime të dukshme (kanë pushuar dhembjet, të vjellat etj); këta të fundit kanë qenë pacientë të cilët nuk kanë mundur të hipnotizohen. Autori thotë se suksesi varet nga thellësia e gjumit hipnotik.

Për shërimin e astmës është përdorur metoda e njëjtë. Nga 200 pacientë (128 femra dhe 72 meshkuj) të moshës 10-60 vjeçare, kanë rezultuar këto rezultate: 84 janë shëruar plotësisht dhe janë liruar nga spitali; 56 të tjerë kanë pasur shërim të dukshëm (sulmet kanë qenë të rralla); ndërsa te 60 pacientë të tjerë (30%) nuk ka pasur kurrfarë efekti, sepse nuk kanë mundur t'i nënshtrohen lehtë gjumit të thellë hipnotik.

Gjithashtu, nga tensioni i lartë i gjakut, janë shëruar 160 pacientë (60 meshkuj dhe 100 femra), të moshës 20-60 vjeçare. Prof. Bulj thotë se nuk duhet ta konsiderojmë hipnozën si mjet universal për shërimin e të gjitha sëmundjeve, por shton se hipnoza në kombinim me medikamente ose me metoda tjera terapeutike është terapi mjaft efikase për shërimin e një vargu sëmundjesh.

Hipnoza gjithashtu mund të shërbejë edhe si metodë mjaft e suksesshme për shërimin e shumë sëmundjeve psikike dhe neurotike, dhe atë në mënyra të ndryshme. Na është e njohur psikanaliza e Frojdit, ku Frojdi pacientët e vet i kthente në kohën e mëparshme (me hipnozë) dhe i kërkonte konfliktet,

situatat, të cilat kanë mundur të jenë faktorë të sëmundjes.

Te sëmundjet e rënda psikike, intervenimi me anë të metodës hipnotike lejohet vetëm në disa raste të jashtëzakonshme përndryshe, në këso rastesh, psikologët nuk preferojnë të hipnotizohet i sëmuri, sepse është konstatuar se hipnoza tek disa sëmundje provokon efekt negativ dhe thellon sëmundjen edhe më. Por, në kombinim me disa medikamente, efekti i saj është shpresëdhënës për shërimin pjesërisht të disa simptomave, të provokuara nga këto sëmundje të rënda psikike.

Edhe për alkoolizmin, narkomaninë si dhe pirjen e duhanit, që janë gjithnjë në rritje e sipër, hipnoza mund të përdoret si mjet mjaft efikas në parandalimin, e edhe në shërimin e këtyre sëmundjeve të varësisë, por këtu duhet vullneti dhe dëshira e pacientit për t'u shëruar. Gjithashtu, varet edhe shkalla e helmimit nga këto elemente. Pirja e duhanit me hipnozë mund të shërohet për vetëm disa seanca, ndërsa alkoolizimi është më i vështirë për shërim, prandaj duhet terapi më e gjatë. Edhe narkomania, me anë të hipnozës dhe me ndihmën e treningut autogjen (metodë e Heinrich Schulz), mund të shërohet plotësisht.

Hipnoza mund të ndihmojë edhe në lehtësimin dhe zgjidhjen e problemeve seksuale. Impotenca tek meshkujt dhe frigjiditeti (ftohtësia) te femrat, janë probleme mjaft të përhapura në mbarë rruzullin tokësor, diku më shumë e diku më pak. Hipnoza mund të ndihmojë të tejkalohen këto vështirësi të cilat, si sëmundje psikogjene, provokohen nga shumë faktorë, siç janë: qëndrimi i gabuar ndaj seksit, frika nga mossuksesi, turpi, problemet apo ngarkesat familjare, puna intensive intelektuale, brengosjet e ndryshme, urrejtja ndaj partnerit apo mungesa e dëshirës dhe emocioneve etj.

Edhe frigjiditeti tek femrat provokohet nga shumë faktorë të ndryshëm, siç janë: mungesa e dashurisë, edukimi dhe qëndrimi i gabuar ndaj seksit e, mbi të gjitha, kuptimi i gabuar mbi orgazmën - kuptimi i së cilës merret nga leximi i fletushkave të ndryshme apo përmes filave pornografikë ku gratë çirren, bërtasin, humbin vetëdijen etj; ndonëse orgazëm të tillë mund të përjetojnë vetëm numër i vogël grash histerike. Autori Albert Elsie, i cili shkroi një tekst për orgazmën e femrave si përjetim i shumëllojshëm e me mijëra nuanca, mori shumë letra dhe falënderime nga gratë amerikane të cilat i kishte liruar nga konstatimi i gabuar mbi veten si „gra jonormale”. Deri te ai konstatim, ato gra, kishin ardhur duke lexuar revista e shikuar filma me përmbajtje çoroditëse pornografike.

Në të gjitha këto raste, barërat nuk mund të ndihmojnë gjatë, ato janë të efektit të kufizuar. Edhe psikoterapia e edhe sugjestioni ndonjëherë mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtyre problemeve, ndërsa hipnoterapia, pavarësisht nga të arriturat e reja mjekësore, mbetet ende metoda më efikase për largimin e gjykimeve të gabuara mbi seksin dhe shërimin e plotë të kësaj sëmundjeje.

Gjithashtu, kur jemi këtu, nuk mund të mos e përmendim edhe eksperimentin të cilin e ka zhvilluar dr. K. Tepperwein, i cili për ta vërtetuar ndikimin e hipnozës në organizmin njerëzor, para ekspertëve mjekësorë, demonstroi këtë proces: Një vajze, e cila nuk kishte gjinj të zhvilluar normalisht e që dëshironte të kishte zhvillim normal të tyre si vajzat e tjera, si dhe për t’i bindur ekspertët për forcën e madhe të hipnozës, ia nxiti zhvillimin e të dy gjinjtë në gjendjen e dëshiruar prej saj. Për ta thelluar edhe më shumë bindjen mbi forcën e hipnozës, dhe për të shmangur çdo dyshim për ndonjë veprim manipulues, ai së

pari i sugjeroi asaj, pra pacientes e cila gjendej në gjendje të thellë hipnotike, se njëri gji do t'i rritet në madhësinë e caktuar brenda një jave. Dhe, pas një jave, ai e arriti madhësinë e caktuar të njërit gji, derisa gjiri tjetër mbeti në madhësinë e mëparshme. Pastaj, prapë derisa pacientja gjendej në gjendje të thellë hipnotike, i sugjeroi se edhe gjiri tjetër, brenda një jave, do ta marrë madhësinë e gjirit të parë. Dhe prapë, pas sugjestionit, gjiri tjetër arriti madhësinë e caktuar dhe atë, më shpejt se i pari.

Më poshtë po i cekim edhe dy eksperimente të zhvilluara nga vetë autori i këtij libri:

Rasti i parë

Pacientja X (emrin nuk ia kam shënuar) e moshës 50 vjeçare, banuese në Prizren. Vuan nga depresioni i thellë sporadik, sidomos i theksuar në muajin shtator. Në atë muaj asaj i humbte oreksi, i humbte vullneti për jetë dhe për disa javë detyrohej të qëndronte e shtrirë në krevat dhe të ushqehej me anë të infuzionit.

Edhe kjo grua kishte kërkuar ndihmë nëpër shumë institucione shëndetësore, por pa sukses. Edhe pse pas qëndrimit në spital dhe kurimit me anë të tabletave dhe terapive tjera ajo „shërohej", në shtatorin e ardhshëm sëmundja i paraqitej prapë dhe me të njëjtin intensitet.

Pasi arritëm që pacienten ta vëmë në gjumin hipnotik, nëpërmjet sugjestioneve e udhëzuam që ta bëjë një retrospektivë, nga rezultati i së cilës e kuptuam edhe burimin e sëmundjes. Në muajin shtator, para disa vitesh, asaj i kishte vdekur djali. Në atë moment, kur ajo e kishte marrë atë lajm kobzi, ndodhej në parkun e spitalit. Ai lajm tronditës ishte përcjellë dhe rrënjosur në psikën e saj bashkë me pamjet e ambientit që e rrethonin në atë moment, pra me pamjen e vjeshtës dhe, për çdo vit, në shtator, ajo përjetonte të njëjtën traumë. Vetë pamja e natyrës në vjeshtë provokonte tek ajo

simptoma të njëjta sikurse në ditët e para të atij viti kobzi që përcillej me anoreksi dhe depresion, e që vazhdonte për disa muaj.

Me anë të sugjestioneve arritëm t'i neutralizojmë ato simptoma traumatike dhe t'ia stabilizojmë baraspeshën mentale, duke e kthyer atë prapë në rrjedhat normale të jetës.

Rastit i dytë

Pasi e kam futur mediumin (S. K.) në hipnozë të thellë, i kam sugjeruar: „Pasi të dilni nga gjendja hipnotike, pas 20 min., do të shkoni te biblioteka ime (e cila ndodhej në dhomë) dhe do ta merrni librin me titull „Ne të tre". Këtë sugjerim do ta regjistrojë vetëm nëndija juaj, derisa vetëdija nuk do të dijë asgjë..."

Saktësisht 20 minuta pas daljes nga gjendja hipnotike, ai u ngrit në këmbë dhe u afrua tek biblioteka. E kërkoi librin derisa e gjeti. E mori, e shikoi dhe e ktheu prapë në vendin e mëparshëm, pa e ditur as ai vetë arsyen e këtij veprimi!

KEQPËRDORIMI I HIPNOZËS

Keqpërdorimi i hipnozës, padyshim, është mjaft i hershëm. Më së shumti me këtë çështje u morën klerikët, të cilët me anë të hipnozës provokonin fenomene të ndryshme të „mbinatyrshme", duke shkaktuar frikë në masat e gjera të popullit.

Duke pasur parasysh mundësitë dhe forcën e madhe të veprimit hipnoza, po qe se keqpërdoret, mund të bëhet armë shumë e fortë me pasoja të shumëfishta.

Me përdorimin e suksesshëm të narkoanalizes në mjekësinë legale për hipnotizim, në rrethet policore, u shtua interesimi për hipnozën dhe filloi aplikimi i saj si mjet shumë efikas për zbulimin e së vërtetës që u quajt „serumi i së vërtetës". Duke hipnotizuar personat, në të cilët dyshohej se kanë kryer akte

kriminale ose amorale (me anë të substancave kimike dhe pa dëshirën e tyre), inspektorët merrnin informata të sakta për krimet e kryera, pa përdorimin e dhunës.

Edhe pse në vitin 1945 një asociacion francez bëri protestë të rreptë, duke thënë se është e papranueshme ndërprerja e vullnetit të lirë të një personi me ndihmën e substancave kimike, sepse shkatërrimi i integritetit moral të individit mund të sjellë edhe gjer te keqpërdorimet tjera të ardhshme, kjo metodë merr përmasa gjithnjë e më të gjera dhe gjithnjë e më të rrezikshme. Duke ditur se hipnoza është një nga faktorët më bindës për ekzistimin e motiveve të pavetëdijshme dhe të ndikimeve të tyre në sjelljet e njerëzve, është e mundur që nëpërmjet sugjestioneve hipnotike të zbulohen dhe të shqyrtohen motivet më të thella të sjelljeve të njerëzve, pastaj të korrigjohen, të ndryshohen e të çrrënjosen shprehitë e personalitetit dhe në vend të tyre të regjistrohen të tjera, të reja.

„Shpëlarja e trurit" është metoda më bindëse e keqpërdorimit të hipnozës. Kjo metodë, përveç ndryshmit të qëndrimeve, mendimeve, bindjeve të personit, mundëson edhe kthimin e armikut në një bashkëpunëtor aktiv. Dr. M. T. Ormantar, anëtar i Institutit të Filadelfias, u mor shumë me zbatimin e hipnozës për çështje të armatës; p.sh. me anë të hipnozës forconte imunitetin e ushtarëve, që të mund të përballonin dhembjet, mundimet, izolimet, sëmundjet e detit etj. Rëndësinë më të madhe ia kushtoi mënyrës se si t'i hipnotizonte ushtarët dhe, në gjendje të thellë hipnotike, t'u jepte detyra të rëndësishme të përcjella me amnezi totale. Njëkohësisht u jepte shifrën, me të cilën mund të vet-hipnotizoheshin dhe mund t'i pranonin detyrat vetëm nga personat e posaçëm. Supozohet se të gjithë funksionarët e lartë

ushtarakë në SHBA dhe në paktit NATO, që janë të njohur me materiale me rëndësi shumë të madhe politike dhe ushtarake, kalojnë nëpër procesin e indoktrinimit për neutralizimin e efektit.

Timon Liri, i cili ishte kohë të gjatë bashkëpunëtor i CIA-s, thotë se vetëm në Amerikë, me anë të drogave, CIA kontrollon rreth 30.000 veta.

Te hipnoza me ndihmën e medikamenteve, në vend të futjes në hipnozë në mënyre normale, përdoren narkotikë të përshtatshëm, të cilët jepen në doza të vogla, ashtu që nuk provokojnë narkozë por vetëm relaksim. Qëllimi është që vetëdija të ngushtohet (kufizohet) e me këtë manipulim të arrihet deri te gjendja që i përngjan hipnozës. Për secilin psikoterapeut, që merret me hipnozë, janë të njohura ndikimet e narkotikeve në psikën e njeriut. Wetterstraungu dhe Kraftebingu përmendin klorofilin si mjet adekuat për hipnotizëm, ndërsa Mooli i jep përparësi klorohidrateve; Shupi përdor brometilin, kloretilin etj. Ekstaza (dehja) e shkurtër, e arritur me anë të kloretilit, përdoret te induksioni i hipnozës së parë.

Si sedativ dhe hipnotik, posaçërisht është veprues edhe parahdetiti, doza minimale e të cilit përmban 3 deri 5 gramë ndërsa doza maksimale deri në 10 gramë. Thithja e dioksidit të karbonit (përzierja e tri pjesëve, thartira e karbonit dhe shtatë pjesët e oksigjenit) gjithashtu është veprues dhe plotësisht i padëmshëm. Thithja e asaj përzierjeje shkakton te njeriu ndryshime të caktuara shpirtërore të cilat e rrisin sugjestibilitetin.

Metoda të këtilla, jashtëligjore dhe antinjerëzore, u përdoren me të madhe, sidomos në shtetet ish - socialiste, d.m.th. edhe në ish - Jugosllavi. Edhe pse në ligjin e ri të ish-Jugosllavisë, në paragrafin 3 të nenit 259, pranojnë se ekzistojnë veprime dhe ndikime të tilla, ku thuhet: „Nuk është e lejueshme

që ndaj të pandehurit ose dëshmitarit të aplikohen intervenime mjekësore ose t'u jepen mjete të atilla me të cilat ndikohet në vullnetin e tyre me rastin e paraqitjes së deklaratës", UDB-ja prapëseprapë përdori mënyra të tilla ndaj të burgosurve të pathyeshëm, sidomos atyre politikë të kombit shqiptar, duke i paaftësuar ata për jetë normale dhe duke ua shkatërruar personalitetin dhe moralin e tyre. Rasti më i fundit, që dokumenton një veprim të këtillë, është ai i procesit kundër 21 shqiptarëve të akuzuar për „terrorizëm" që u mbajt në muajt e fundit të vitit 1997, ku i pandehuri A. Neziri, 23 vjeçar, student i vitit të katërt të mjekësisë, u mor në pyetje nën ndikimin e hipnozës.

RILINDJA

NGJARJE DITE

VAZHDOI PROCESI I 21 SHQIPTARËVE NË GJYQIN SERB TË PRISHTINËS

MARRJA NË PYETJE NËN HIPNOZË!

Gjatë seancës së pardjeshme u tha se me asnjëren nga armët e ekspozuara në gjykatore nuk është shtëne, siç ngarkohen të akuzuarit.- Fjala përfundimtare e prokurorit- më 24 nëntor

Pas tri ditë ndërprerjeje, dje në gjyqin serb të qarkut të Prishtinës vazhdoi gjykimi kundër 21 shqiptarëve të akuzuar për terrorizëm dhe, pas refuzimit të shumë propozimeve të mbrojtësve, përfundoi e ashtuquajtura procedurë e provave.Siç u kumtua, për shkak të përgatitjes, fjala përfundimtare e prokurorit Miodrag Surla pritet të jepet të hënën e ardhshme

het vëllai i të akuzuarit Selim Lokaj, Hamdi Lokaj siç dihet gjatë janarit të këtij viti regjimi serb arrestoi katër anëtarë të familjes Lokaj:vëllezërit Selimin, Musën, Hamdiun dhe motrën e tyre Havën(kjo u mbajt gjashtë muaj në paraburgim).Inspektorët u kërcënuan se do ta arrestojnë edhe motrën tjetër të tyre, se edhe kjo "është marrë me terrorizëm".Hamdiun pas katër ditësh e lëshojnë nga paraburgimi, ia caktojnë rolin e dëshmitarit. I bëjnë presion të vazhdueshëm që të

të akuzuarit, janë kopje të fletëdënoncimeve penale të policisë. Në ç'mënyrë janë sajuar këto procesverbale treguan të akuzuarit, të cilët e thanë troç: inspektorët na kërcënoheshin me likuidim që të mos i ndryshojmë deklaratat e dhëna tek gjykatësja hetuese. Inspektorët na sillnin, pritnin para zyres së gjykatëses së përmendur e pastaj na çonin nga na kishin marrë.

Avokati Bajram Kelmendi kërkoi që si provë të merret

Ky nuk është rast i vetëm, ku UDB-ja, me qëllim të zbulimit të „grupeve armiqësore e terroriste", zbatoi këso metoda si dhe metoda tjera antinjerëzore për ta shuar Lëvizjen tonë Gjithëkombëtare. Ajo, këso lloj metodash përdori edhe kundër I. Hajredinit (burgu i Pejës) nga Gllogjani i Deçanit, i cili u dënua 12 vjet burgim, si dhe ndaj S. Sutajt (burgu i Beogradit), kolonel i AUSH-it në Beograd, i dënuar me 5 vjet burgim, si dhe ndaj shumë të burgosurve tjerë politikë, të cilët mbetën me pasoja të përjetshme. Gjithashtu, sipas informatave të QIK-ut (23 mars 1994, Rilindja - botimi në Zvicër) bëhej e ditur se ndaj ish-eprorëve shqiptarë, gjatë torturave, inspektorët serbë po përdornin substanca kimike dhe metoda tjera jashtëligjore.

Një veprim të këtillë të organeve policore dhe ushtarake e pohonte edhe gazeta londineze „Times”, e cila kishte ribotuar një artikull të revistës Beogradase „Profil”, në të cilën ish-zëdhënësi i APJ-së, kolonel L. Stojadinoviq, theksonte se strategjia serbe gjatë luftërave ballkanike është mbështetur në mistikë dhe astrologji!...

Në kornizat e përdorimit të hipnozës, shumë shpesh, përdoret sugjestioni posthipnotik apo posthipnoza. Ky lloj sugjestioni është paraqitje shumë e rëndësishme në hipnozë dhe përbëhet nga fakti se sugjestionet e dhëna gjatë hipnozës realizohen pas daljes nga ajo gjendje dhe ato mund të veprojnë me kohë të pacaktuar, varësisht nga sugjestioni i dhënë. Në bazë të kësaj, lind pyetja: A është e mundur që me anë të hipnozës të detyrohen njerëzit që të kryejnë veprime që janë në kundërshtim me besimin, moralin, etikën dhe traditën religjioze të tyre? Ekzistojnë shumë fakte që vërtetojnë këtë: Stefan Cvajgu, në librin e tij „Shëruesit mental”, përmend „rastin e Leidelbergut”, ku një grua 34 vjeçare u shërua disa vjet me anë të hipnozës dhe pastaj u shfrytëzua për nevoja seksuale dhe u shit tek të tjerët për atë nevojë.

Po marrim disa raste nga ndodhitë reale:

Rasti i parë

Dr. Mayer Walteri e kishte hipnotizuar Julia Krantzin dhe i kishte sugjeruar: „Kur ta shtyp gishtin e vogël të dorës së majtë dhe ta shqiptoj fjalën „filofi”, ju do të bini në gjendje gjumi dhe do t’i zbatoni të gjithë urdhrat që do t’ua jap unë. Askush nuk do të mund ta dëgjojë atë që unë do t’ju them. Asgjë, nga veprimet e kryera, nuk do t’ju kujtohet...”

Pasi kishte arritur ta fusë këtë vajzë në kthetrat e hipnozës, dr. Walteri e kishte shfrytëzuar për nevoja seksuale. Për nevoja të njëjta, por me para, e shet edhe tek të tjerët. Julia vetëm me Walterin mbeti tri herë shtatzënë, dhe secilën herë Walteri e kishte detyruar me anë të sugjestioneve hipnotike të bëjë abort,

për të cilat më vonë ajo as që kishte dijeni. Abortin e bënte te një i njohur i tij, Franz Walter, i cili për këso punësh kishte përvojë dhe fitonte shuma të majme parash.

Dr. Walteri, për qëllime përfitimi, Julian e kishte shitur edhe te një mishshitës që quhej Bodmer. Gruaja e mishshitësit i bie pak në gjurmë kësaj dukurie dhe i vihet në përcjellje të shoqit derisa e zë në vepër. I shoqi e pranon fajin dhe betohet se ishte hera e parë, mirëpo pasi zbulohet rasti, dhe gruaja merr vesh nëpërmjet shtypit se kjo ishte një praktikë e rregullt e keqpërdoruesve, e revoltuar, paraqitet para gjyqit dhe jep deklaratën e vet, me të cilën e ngarkon rëndë të shoqin, e edhe Walterin.

Më 13 qershor 1936, gjyqi i qarkut të Heidelbergut (Gjermani), pas shqyrtimit treditor vendos:

Mishshitësit Bodmer: katër vite burgim për shkak të atentatit në moralin publik dhe pjesëmarrjes në një vepër të ndyrë kundër dinjitetit njerëzor.

Dr. Walterit: 10 vite burgim për mashtrim; lëndime të rënda shpirtërore e fizike; atentat në moralin publik si dhe për keqpërdorime tjera jonjerëzore.

Gjithashtu, dr. Walteri u ngarkua edhe me barrën e shpenzimeve të gjyqit si dhe iu mor e drejta qytetare për pesë vjet, pas mbajtjes së dënimit. Pasi në atë kohë, kur në pushtet ishte Hitleri, ishte e ndaluar kritika ndaj institucioneve shtetërore opinionit, i cili priste dënim më të rreptë, nuk iu lejua të reagonte. Por, në fakt, ishte krejt e njëjtë se sa do të dënohej Walteri, pasi katër vite më vonë ai, si dhe shumë të burgosur tjerë, u liruan dhe u dërguan në të ashtuquajturën „Strafbatalion” (batalioni i të dënuarve), i cili luftoi së pari në Poloni, pastaj në ish-BRSS-në. Mbetet supozimi se çfarë ka bërë ai atje dhe sa krime ka kryer...

Rasti i dytë

Në vitin 1903, në një gjimnaz të Budapestit (Hungari), festohej mbarimi i vitit shkollor. Pasi në atë shkollë ishte si zakon që gjatë kësaj feste të shpërbleheshin nxënësit më të mirë me ndonjë dhuratë simbolike drejtori i shkollës, për ta bërë atmosferën sa më disponuese e argëtuese, e thërret edhe një hipnotizues, profesor Leon, që t'i demonstrojë shkathtësitë e veta.

Dukej shumë i vogël ai profesor Leo. Madje aq i vogël sa linte përshtypje qesharake. Dhe m'u për këtë, e bartte mbi kokë një kapelë të zezë në formë cilindri, për t'u dukur më i gjatë. Zërin e kishte të thellë e melodik, ndërsa sytë e zinj me një shkëlqim të mahnitshëm që të shponte.

- Mos u frikësoni nxënës! Le të afrohet një vullnetar dhe le të ngjitet në podium, i thërriste prof. Leo. Por, nxënësit vështirë përcaktoheshin.

- Ejani nxënës, mos u frikësoni, unë nuk jam kurrfarë djalli i zi, unë jam vetëm njeri i shkencës... Afrohuni...

Një djalosh 11 vjeçar, i cili qëndronte ulur në rendin e parë, duke menduar se profesori po e thërriste atë, pasi shikimin e kishte drejtuar nga ai, ngrihet dhe drejtohet kah podiumi.

Prof. Leo filloi të bëjë lëvizje me duar rreth kokës së tij, duke i pështpëritur diç me zë monoton dhe, ja çudia: djaloshi bie në një gjendje gjumi. Profesori, për ta dëgjuar të gjithë, e urdhëron: „flini, unë këtë e dëshiroj!"

Të gjithë ishin të bindur se ai po flinte, por po flinte zgjuar. Zëri i sugjeron se ai gjendet në një tren. Lokomotiva po fishkëllen; treni fillon të lëvizë; i gjithë kompozicioni po lëviz gjithnjë e më shpejt. Gjithçka që zëri i prof. Leos thoshte, ai e shihte para vetes dhe, në një moment, ai nuk sheh më binarë: lokomotiva fluturon prej tyre dhe i tërheq edhe vagonët e tjerë. Djaloshi e sheh se do të ndodh diçka e tmerrshme dhe fillon të bërtasë me sa zë që kishte...

Para nxënësve ai fillon të bërtasë, të qajë, mblidhet në vete

duke e kapur kokën me duar (pasi ato i përjeton në hipnozë si të vërteta), pra duke u përgatitur për një ndeshje të tmerrshme... Dhe, atëherë, dëgjon zërin e profesorit:

-Zgjohu! Unë po të urdhëroj!

Nxënësit tjerë, që deri në atë moment ishin si në ankth, filluan të qeshin. Të gjithë e kishin të qartë se seanca hipnotike kishte pasur sukses, e më së shumti kjo i konvenonte prof. Leos, në kokën e të cilit filluan të krijoheshin planet të reja e të përgjakshme.

Prof. Leo e shikon vogëlushin me simpati dhe e pyet se si quhet.

-Silvester Matushko, zotëri - përgjigjet djaloshi.

-Vetëm edhe një ekzibicion Matushko... E juve të tjerëve, ju lutem, edhe pak durim - u drejtohet profesori arsimtarëve dhe nxënësve.

-Merre këtë revolver Matushko dhe qëllo mbi mua. Lirisht qëllo, mos ke frikë.

Djaloshi, sikur të ishte ende në gjumë, e merr revolverin, merr në shenjë profesorin dhe kërcet. Një herë, dy herë, tri herë... dhe secilin plumb, prof. Leo e kap në ajër me duart e tij të çuditshme. Duartrokitja bombastike e masës e përshëndet këtë truk magjistar të prof. Leos.

Shfaqja mbaroi me sukses dhe drejtori i kënaqur me këtë e shpërbleu profesorin . Të gjithë do ta mbajnë mend atë ditë, e më së shumti vetë Silvester Matushko, sepse prof. Leo do ta shfrytëzojë më vonë për qëllime tjera të tmerrshme...

28 vjet pas shfaqjes në gjimnazin e Budapestit, me 12 shtator 1931, në orën 22, niset treni i shpejtë, i mbushur plot njerëz, nga Budapesti për në Vjenë. Gjysmë ore më vonë, në viaduktin afër Torbagys, shpërthen një eksploziv i fuqishëm! Dëshmitarët okularë kishin vërejtur se si lokomotiva, së bashku me vagonët, kishte dalë nga shinat dhe kishte rënë në humnerën e thellë 30 metra.

Ekipet shpëtimtare arritën të nxjerrin një numër të madh të

lënduarish rënd, ndërsa ata që kishin pësuar lëndime të lehta ishin shpërndarë nëpër pyllin e afërt me frikë se do të vije deri te ndonjë detonim i ri. Për 25 të tjerë, çdo ndihmë ishte e kotë. Ata kishin mbetur në vendin e fatkeqësisë të copëtuar: pa gjymtyrë, pa kokë... Ishte kjo fatkeqësia e tretë brenda atij viti në Evropë. Për dy të tjerat supozohej se kishin të bënin me atentate politike, pasi në vendin e fatkeqësisë, në njërën nga këto, ishte gjetur një copë kartoni ku shkruante: „Fitore, Revolucion, Atentat”, ndërsa për këtë të fundit, supozohej se kishin të bënin me akt kriminal.

Në vendin e fatkeqësisë kishin dalë edhe organet hetuese. Shefi i komisariatit filloi ta kërkojë porosinë e atentatorit, pasi ishte i bindur se ajo ishte diku. Organet përkatëse të hetuesisë kishin filluar t’i legjitimonin dhe t’i merrnin në pyetje të gjithë udhëtarët. Në mesin e tyre gjendej edhe një udhëtar i cili lëvizte me një nervozë të theksuar andej-këndej. Disa herë ishte paraqitur tek mjeku i urgjencës, pasi kishte një plagë të lehtë në dorë, pastaj edhe para policëve hetues, duke u treguar për fatin që kishte pasur në këtë fatkeqësi.

- Është fat i madh, çudi! Quhem Matushko, jetoj në Vjenë dhe ndodhesha në vagonin e parë. I shenjti Ante më shpëtoi! Nuk di as vetë si shpëtova, me të vërtetë nuk e di! Gjatë kësaj kohe, një gazetar e kishte fotografuar Matushkon.

Ndërkohë, shefi i policisë kishte arritur ta gjente edhe letrën me mesazhin e atentatorit. Në të ishin të shkruara me dorë tri fjalë: „Përgjigjja e të shtypurve - Hakmarrje - Revolucion”. Në fillim u mendua se atentati ishte vepër e ndonjë grupi revolucionar, të cilët i kishin bërë edhe atentatet e mëparshëm, pasi që edhe shtypi e përmbante këtë hipotezë, por hetimet vazhduan më tutje.

Duke gjurmuar nëpër fotografitë e shumta, shefit të

komisariatit i bie në sy edhe fotografia e Matushkos, të cilin e kishte parë atë natë aty dhe i cili kishte thënë se gjatë fatkeqësisë ishte në vagonin e parë! Aty lind edhe dyshimi për të, pasi të gjithë personat që gjendeshin në atë vagon, ose kishin vdekur ose kishin pësuar lëndime të rënda, ndërsa Matushko kishte vetëm një plagë të lehtë në dorë dhe fillojnë hetimet për të. Gjatë hetimeve, paraqitet edhe një epror i lartë i quajtur Palf, i cili kishte kaluar pa lëndime në atë fatkeqësi. Ai i tregon shefit të komisariatit se deri sa shkonte për t'i ndihmuar të tjerët, e kishte parë këtë njeri: „Gjestet i bënte shumë të çuditshme; ndizte fije të shkrepëses dhe fliste vetë me vete! Kur më vërejti mua, filloi të më sqarojë se si kishte shpëtuar... Por jam i sigurt se nuk ishte fare i lënduar."

Këtë version e pohojnë edhe dy udhëtarë të tjerë, dhe shefi i policisë së Budapestit ua dërgon dosjen e tij kolegëve në Vjenë. Matushko thirret në hetuesi, në kabinetin e z. Böhma, që ishte edhe drejtor i policisë në atë qytet. Ishte shumë i shqetësuar dhe imitonte njeriun e ofenduar.

-Unë jam njeri i ndershëm, zotëri inspektor, merrem me punë të ndershme. Në atë fatkeqësi kam humbur bagazhin me rroba të vlefshme, e në vend që të më kompensohet ajo humbje, ju po më merrni në pyetje duke ma humbur edhe kohën e çmueshme...

-Për ç'arsye keni udhëtuar në Budapest, zotëri Matushko - pyet z. Böhm?

-Për çështje pune.

-Për çfarë pune? Sipas informatave tona agjensioni juaj është shuar.

-Për shkak të kreditorëve të mi.

-I keni shkruar edhe stacionit hekurudhor që t'ua kompensojë dëmin?

-E saktë.

-A janë këto rrobat tuaja?

Matushko zbehet! Rrobat që i mbante inspektori, para se të

vinte në polici, i kishte lënë në banesë. Dr. Böhmi e sqaron:

-Derisa ju prisnit këtu, ne e bastisëm banesën tuaj. Ekspertët tanë në xhepat e rrobave tuaja gjetën thërmija të ekrasitit, eksploziv i njëjtë që u përdor edhe në atentatin në viaduktin afër Torbagysë. Dëshmia e dytë ndaj jush është edhe letra e dërguar ndërmarrjes hekurudhore: grafologët vërtetuan se edhe letra e gjetur në vendin e atentatit është e shkruar me të njëjtën dorë, pra nga dora juaj. Nga ky moment jeni i arrestuar!

Me gjithë protestat e bëra, Matushko mbahet në paraburgim për shkak të dyshimit se ka kryer atentat... Për në Vjenë udhëtojnë edhe përfaqësuesit e policisë hungareze dhe asaj gjermane, që së bashku me policinë austriake ta çojnë deri në fund hetimin.

Shpejt e konstatuan se Matushko nuk ishte kurrfarë revolucionari, e as që i takonte ndonjë organizate politike a militante. Nuk kishte kurrfarë arsye për sulmin e bërë ndaj udhëtarëve në tren!

Pas tronditjeve të para, Matushko në burg sillet në mënyrë korrekte, edhe pse assesi nuk e pranonte veprën me të cilën ngarkohej. Me tregimet e veta ai i habit edhe hetuesit, që ishin të bindur për fajin e tij. Megjithatë, dalëngadalë fillon të zbulohet një Matushko tjetër, plotësisht i kundërt nga ai „burrë i mirë dhe familjar”. Ishte vizitues i rregullt edhe i shtëpive publike, e edhe dëshmitë e atyre „damave të natës” flasin në mënyrë evidente për një personalitet labil. Duke i vërejtur këto dukuri, shefi i policisë vendos të përdorë një metodë e cila do të mund ta nxirrte Matushkon nga baraspesha. Deri atëherë, ai mbrohej në mënyrë shumë të mençur dhe inteligjente duke e fshehur aq mjeshtërisht krimin, saqë organeve hetuese u sillte vështirësi serioze për zgjidhjen e lëndës.

Një mëngjes, në tavolinën e gjatë të hollit, që shërbente për mbledhjet e policisë së Vjenës, ishin renditur fotografitë e ngjarjes tragjike të Torbagysë. Në ato fotografi, që ruheshin në arkivat e policisë dhe që nuk i ishin ekspozuar as shtypit,

shiheshin detaje nga trupat e gjymtuar të viktimave; fytyrat e copëtuara e të gjakosura etj. Të gjitha fotografitë u mbuluan me një pëlhurë, ashtu që nuk dihej se çfarë ndodhej nën të.



Matushko u habit kur pa se, në vend që të dërgohej në dhomën e hetimeve, ishte në hollin e madh ku e priste dr. Böhmi me disa bashkëpunëtorë. Pasi urdhërohet të ulet përballë dr. Böhmit, fillon biseda. Se pari ai pyetet për familjen: gruan, fëmijët dhe çështje tjera që nuk kishin të bënin fare me veprën, derisa ai lirohet dhe qetësohet plotësisht. Dhe atëherë papritur, dr. Böhmi nxjerr një fotografi dhe ia hedh në duar të akuzuarit. Silvester Matushkos nuk i nevojitej sqarim për fotografinë. I heshtur e shikoi fotografinë dhe, pas pak, trupin e tij fillojnë ta kapin të dridhura... atëherë dr. Böhmi e tërheq pëlhurën e cila ndodhej mbi tavolinë dhe i thotë: „Shikoje veprën tënde Matushko!”

Dr. Böhmi e shikonte me kujdes atë njeri sesi po dridhej dhe shtangej para pamjes, së cilës nuk do të mund t’i përballonte as njeriu me sistem të fortë nervor... Por u habit kur e pa se Matushko nuk po dridhej e as shtangej nga pamjet rrëqethëse të fotografive, por nga një përjetim krejt tjetër mallëngjyes! Plot me pasion, e rrëmben një fotografi dhe, në mënyrë të pakontrolluar, fillon ta puthë! Duke i thënë disa fjalë të pakuptimta rrëzohet për tokë dhe humb vetëdijen!

Pasi vjen në vete me ndihmën e mjekëve, kërkon nga të pranishmit gjysmë ore pushim duke u thënë se pastaj do t’i tregoj të gjitha. Pas 30 min. kthehet dhe pranon: „Unë jam përgjegjës për të tri katastrofat! Dua të them se ia kam arritur vetë, pa ndihmën e askujt, këtij qëllimi. Njerëzimi, një ditë, do të më falënderohet për këtë vepër, pasi ai duhet t’i vuajë mëkatet që i meriton! Para se ta vendosja eksplozivin, i vizitova të gjitha kishat e Vjenës. Janë mbi njëqind. Të gjitha ishin të zbrazëta!

Askush nuk po mendon më në Zot! Por, unë i besoj atij!...”

Dhe, kështu, më në fund, paraqitet fytyra e vërtetë e Matushkos: e kriminelit të çmendur dhe maniakut seksual.

Pas ekzaminimit, disa mjekë mendonin se Matushko ishte një simulant shumë i shkathët dhe vetëm e imiton të çmendurin, për të kaluar sa më lehtë në gjyq. Por, psikologët që e ndiqnin procesin, bindeshin gjithnjë e më shumë se Matushko ishte një personalitet i ndarë, se në të ekzistonin dy personalitete, që e vërtetoi edhe vetë derisa u përgjigjej pyetjeve të gjykatësit: „paj, në të vërtetë, nuk kam qenë unë, dikush tjetër e ka kryer atentatin, dikush që përngjanë në mua. Ai më ka urdhëruar të veproj ashtu brutalisht, prandaj edhe e kam vendosur eksplozivin, duke mos e ditur as vetë se pse po e bëja atë...”

Megjithatë, gjyqi ishte i mendimit se Matushko ishte i vetëdijshëm për gjithë atë që ka bërë, dhe e dënoi me 6 vite burgim. Por ishte vetëm dënimi i parë që iu shqiptua.

Në shtator të vitit 1934, Hungaria kërkon dorëzimin e Matushkos për shkak të katastrofës së Torbagysë, ku humbën jetën 25 persona dhe u lënduan rëndë e lehtë mbi 160 të tjerë. Këtu Matushkon e priste dënimi kapital me vdekje.

Matushko, edhe para gjykatësve hungarezë nuk e ndryshoi qëndrimin e vetë. I çmendur apo simulant, ai vazhdonte avazin e vet. Në pyetjen e kryetarit të gjykatës se çfarë profesioni ka, ai përgjigjet:

-Specialistë për katastrofa!

-Përgjigjuni drejtë në pyetjet e mia, i drejtohet kryesuesi.

-Mirë, pra: shkatërrues profesional i trenave.

Pas këtyre veprimeve ekstravagante, ai qetësohej. Pastaj prapë fillonte të luajë rolin e mistikut, e kështu me radhë.

„Dikush më udhëhiqte gjithnjë. Dikush gjithnjë vendoste për veprimet e mia, dikush që është gjithnjë dhe gjithkund me mua, i cili kurrë nuk ndahet nga unë. Ai më tha: „Matushko, duhet t’i hedhesh trenat në ajër”. Ai është, edhe në këtë moment, këtu, përskaj jush zotëri gjykatës, po e shoh qartë se si po

qëndron para jush!”

Në kërkesën që ta përshkruajë atë, Matushko e përshkruante vetveten!

Gjykatësit u shikuan mes veti, dhe pastaj vazhduan:

-Mirë, e si quhet ai njeri?

Matushko pa u lëkundur u përgjigj:

-Profesor Leo.

-Prej kur ju përcjell ai profesor?

-Që nga ditët e gjimnazit...

Gjyqi vendosi ta ndërpresë procesin për disa ditë për t’i vërtetuar thëniet e tij. Për dëshmitar u mor edhe ish-drejtori i gjimnazit, i cili edhe pse ishte mjaft i shtyrë në moshë, memorien e kishte të kthjellët. Para gjyqit ai tha: „Silvester Matushko ishte vetëm 11 vjeçar kur e solla atë njeri në shkollë. Unë jam fajtor që e thirra atë njeri të mallkuar, profesor Leon. Ai e hipnotizoi Matushkon dhe i sugjeroi se ai ishte në një tren, i cili për një moment del nga binaret dhe bie në humnerë... Më sa më kujtohet, pas asaj, hipnotizuesi e urdhëron djaloshin, i cili bërtiste nga frika dhe tmerri, që t’i harrojë të gjitha...”

Çfarë të themi mbi këtë? A i regjistroi me të vërtetë Prof. Leo në trurin e njomë të një fëmije sugjestionet obsesive, dëshirën për të shkatërruar trena duke i minuar me eksploziv?

Rasti i tretë

Para Luftës së Dytë Botërore, holandezët kishin kolonitë e tyre në juglindje të Azisë. Në një garnizon të ushtrisë holandeze në ishullin Balu, shërbente si nënoficer Jan Opdam, i cili ishte i martuar me një bukuroshe vendase. Nga ajo martesë ata lindin një fëmijë, Johannes Opdamin, të cilin shkurt e thërrisnin Hanes. Ai në moshën 15 vjeçare largohet tinëzisht nga ishujt më të bukur të botës dhe kthehet në vendlindje të babait.

Një mbrëmje krijon shoqëri me një njeri të cilit askush nuk ia dinte emrin saktësisht. Të gjithë e thërrisnin „maestro”. Me profesion ishte mjek, por për shkak të disa veprimeve

jashtëligjore, i ishte marrë diploma.

Maestros i pëlqen ky djalosh dhe e mori nën përkujdesje. Ai i thotë: „Hanes, ti je një djalë i zgjuar dhe do ta studiosh mjekësinë. Unë do të të përgatis ty për studime, por do të të pasuroj edhe me njohuri tjera...”

Këto njohuri tjera ishin kombinime të zen-budizmit, hermetizmit, jogës, e ç’ishte më me rëndësi, djaloshit ia mësoi hipnozën.

Opdami punonte natën në një shtypshkronjë, derisa ditën studionte. Edhe pse nuk arriti ta përfundojë fakultetin, provimet e dhëna ia mundësuan të drejtën që të punojë si mjek.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Opdami paraqitet si pronar i një shtëpie të madhe e të bukur në Berkel, një vend i pasur dhe plotë gjelbërim. Pasi që e respektonin si mjek punëtor, askush nuk e kishte vënë në pyetje pasurinë e fituar, edhe pse ai aty kishte ardhur pa asnjë metelik.

Disa vite më vonë martohet me Arnoldën e bukur dhe bëhet baba i tre fëmijëve. Në fillim jetonin në harmoni të plotë, por me kalimin e kohës, raportet midis tyre fillojnë të ftohen. Arnolda, e cila ishte edhe më e re se ai, fillon të mos i zbatojë dhe t’i refuzojë urdhrat e tij... Shkaqet e kësaj plasaritjeje nuk i dinte askush!

Në janar të vitit 1955, Arnolda gjendet e vdekur në shtëpi. Biopsia vërteton: e helmuar me cianid kaliumi. Pranë saj gjendet edhe letra lamtumirëse, e shkruar me dorën e saj, në të cilën paralajmëronte shkëputjen nga jeta në të cilën nuk ishte e lumtur. Pas hetimeve, jepet leja për varrimin e Arnoldës. Mirëpo, fill pas kësaj, fillojnë thashethemet se fajtor për vdekjen e Arnoldës ishte vetë i shoqi, pasi ai e dashuronte shërbëtoren dhe, mu për këtë, e kishte helmuar edhe Arnoldën. Edhe familjes së viktimës i arrijnë letra anonime, ku akuzohej Opdami dhe

kështu dyshimi vjen gjithnjë duke u rritur. Gjykatësi hetues bën ekshumimin e kufomës dhe përsërit obduksionin për ta vërtetuar edhe një herë shkaktarin e vdekjes. Arnolda me të vërtetë kishte vdekur nga doza e tepërt e cianid kaliumit por ajo, edhe para kësaj, ditë me radhë kishte qenë e helmuar me doza më të vogla të këtij helmi vdekjeprurës. Edhe letra lamtumirëse merret në ekspertizë nga grafologët, të cilët shprehin dyshimin se letra mund të ishte falsifikuar, pasi ka disa ngjashmëri me dorëshkrimin e Opdamit.

Për shkak të dyshimeve, arrestohet Opdami, shtëpia i mbyllet, ndërsa fëmijët dërgohen në çerdhe. Askush nuk i jepte rëndësi Janit 6 vjeçar, i cili thoshte: „Nëna flinte derisa shkruante letrën”!... Për këtë vepër, ai dënohet me burgim të përjetshëm. Pas aktgjykimit, Opdami, me sy të përlotur, thotë: „Unë jam i pafajshëm! Nuk e kam helmuar Arnoldën! Kurrë nuk e kam e pasur shërbëtoren dashnore! Por tani do t’ua zbuloj një sekret: nuk e kam tradhtuar unë Arnoldën, por ajo më ka tradhtuar mua! Ishte dashnore e njëfarë Piet Bergerit, dhe kjo lidhje ka shkaktuar vdekjen e saj”. Mirëpo, tani gjithçka ishte e kotë. Gjyqi kishte marrë vendimin, dhe Opdamit i mbetej ta mbronte pafajësinë në ankesën drejtuar gjyqit të lartë.

Opdami dërgohet në burgun e Leeuwardenit për ta mbajtur dënimin dhe me gjithë protestat në disa gazeta, se është dënuar njeriu të cilit nuk i është dokumentuar faji, aferën dalëngadalë e mbulon pluhuri i harresës. Por, ky ishte vetëm akti i parë i dramës, vazhdimi i saj, aspak më i lehtë, do të zhvillohet brenda në burg.

Gjatë qëndrimit në burg, Opdami njihet me Adrianus Lodderin, i cili gjithashtu ishte dënuar për vepër të njëjtë (kishte helmuar të shoqen me arsen dhe për këtë ishte dënuar me burgim të përjetshëm) dhe krijojnë miqësi të ngushtë. Dy njerëz që kishin bërë krim të njëjtë dhe që kurrë më parë nuk ishin njohur, tani po kalonin jetë të përbashkët në hapësirën e burgut të ndarë vetëm me një mur të hollë.

Kështu kaluan tri vite burgimi derisa një natë, më 17 shkurt 1958, roja e natës, derisa e bënte kontrollimin rutinor të qelive, vëren se diç nuk është në rregull me të burgosurin në qelinë numër 24. Pasi e thërret me zë të ulët, afrohet afër krevatit, dhe atëherë vëren se i burgosuri Adrianus Lodder nuk jetonte më.

Mjeku i burgut mundi të konstatojë se Lodderi kishte vdekur nga helmimi me cianid kaliumi. Nën kokën e viktimës gjendet edhe letra lamtumirëse e shkruar me dorën e tij! Gjithçka u zhvillua në heshtje të plotë, për të mos u zgjuar të burgosurit tjerë dhe fill pas kësaj fillojnë hetimet.

Të nesërmen në zyrën e drejtorit thirret shoku më i ngushtë i Lodderit, Opdami. Plotësisht i qetë futet brenda ku e prisnin shefi i burgut, mjeku, inspektori dhe shefi i ndërrimit. Të gjithë e kishin fiksuar shikimin kah Opdami, por ai nuk tregoi as shqetësimin më të vogël. Pastaj, drejtori e pyet se a ia kishte dhënë ky shishen me cianid kaliumi.

-Unë jam i pafajshëm. Kurrë nuk kam pasur rast që të afrohem në kasafortën e barërave.

-Nuk është fjala vetëm për atë. Ka edhe diç tjetër. Do t'jua lexoj letrën që është gjetur pranë kokës së Lodderit. Pas asaj do t'jua jap edhe letrën pasi juve ju është drejtuar.

„I dashur dr. Opdam, po ju shkruaj që ta dini se pse bëra vetëvrasje. Dua t'ju tregoj gjithçka hapur. Është e vërtetë se në vitin 1952 jam paraqitur në shtëpinë tuaj me emrin e rrejshëm Piet Berger, duke ua dhënë edhe adresën e rrejshme. Mund të vërtetoj se ju jeni i pastër dhe këto vite burgu i keni mbajtur kot. Kur u pata vizituar atëherë në ambulancë, isha njoftuar dhe dashuruar në gruan tuaj Arnoldën. Duke kuptuar se martesa juaj ishte në krizë, nuk e pata vështirë ta përvetësoj Arnoldën. Vija tek ju kinse për dhembje të barkut por, në fakt, unë vija për ta parë Arnoldën. Mbaja me të lidhje dashurie derisa ju ishit në udhëtime. Gjithashtu shfrytëzonim rastin kur ju punonit, nga ora 13 gjerë në ora 15, për të çuar dashuri. Gjithçka u zhvillua në rregull deri në gusht të vitit 1954. Atëherë Nola (ashtu e thirrja

Arnoldën) më njoftoi se ishte shtatzënë dhe më njoftoi se ju nuk kishit pasur marrëdhënie intime me të. Muajin tjetër e vërtetoi shtatzëninë. Ishte e tmerruar se si do të reagonit Ju, kur ta kuptonit këtë. Nuk munda të martohem me të dhe kështu fillova të largohem duke u takuar gjithnjë e më rrallë. Meqenëse ajo e dinte adresën time, filloi të më përcillte duke m'u lutur që t'ia gjeja dikë i cili do ta bënte abortimin, por unë nuk munda t'i ndihmoja se nuk njihja askënd.

Duke konstatuar se cianid kaliumi në masë të vogël mund të ndihmojë që në mënyrë spontane të bëhet aborti, Arnolda e mori në ordinancën tuaj një shishe me cianid kaliumi dhe e përdori në doza të vogla. Disa herë më kishte thënë se, në qoftë se nuk do të ketë sukses aborti, do të bënte vetëvrasje. Bile më tha se një herë veç kishte provuar ta bënte atë me morfinë, por ju kishit intervenuar me kohë. Por, duke e parë se nuk ka sukses në doza të vogla i thashë që ta rrisë atë. Edhe tani i kam ato fotografi para sysh kur i thashë: duhet ta rrisësh dozën. Do të ndihesh keq, do të vjellësh, por kjo do të ndihmojë që ta bësh abortin. Megjithatë, pak u pendova dhe i thashë që të mos ngutet, se ndoshta edhe kështu do të ketë sukses, por ajo e kishte rritur dozën dhe kur të nesërmen, duke folur me zë gruaje, ju telefonova juve dhe kërkova Arnoldën, më thatë se kishte vdekur.

Shpresoja se kurrë nuk do t'ju takoja dhe kjo lidhje do të harrohej, por fati e deshi që të takohemi në burg. Në fillim u frikësova se do të më zbuloni dhe për këtë tentova t'ju helmoj..."

Drejtori e ndërpret leximin dhe i drejtohet Opdamit:

-A është e vërtetë se ka tentuar t'ju helmojë?

-Besoj... me një lloj pluhuri.

-Pse nuk na keni treguar asgjë për këtë?

-Për atë se nuk isha i sigurt dhe nuk dëshiroja të bie në sy si njeri i keq duke i akuzuar të tjerët që fati i ka katandisur si mua.

-Do të kishte qenë mirë të na lajmëronit me kohë neve, përfundon drejtori dhe vazhdon leximin e letrës.

„Por, duke qëndruar më gjatë me ju, pashë se jeni njeri i mirë dhe, duke e ndier veten fajtor për dënimin tuaj, vendosa të bëj vetëvrasje. Edhe ashtu nuk do të dalë kurrë nga kjo birucë. Për mua jeta në këtë ambient është më e vështirë se vdekja. Pasi u frikësohesha dhembjeve, vendosa ta bëjë këtë vetëvrasje me helm. Më besoni se kam përjetuar çaste të tmerrshme! Kjo është e gjithë e vërteta që kam pasur për t'jua thënë. Po e përfundoj letrën duke u nënshkruar me emrin e rrejshëm, Piet Berger."

Opdami e dëgjonte i qetë drejtorin derisa e lexonte letrën. Në fytyrën e tij nuk u paraqit as më e vogla grimasë. Drejtori e lëshoi letrën mbi tavolinë dhe iu drejtua Opdamit duke e vështruar në sy:

-Çfarë mendoni për këtë?

-Është e pabesueshme - ia ktheu ai.

-Me të vërtetë! A besoni se Lodderi e ka helmuar veten me vetëdëshirë për shkak të ndërgjegjes?

-Është vështirë të besoj... por, faktet janë këtu...

Të gjithë i habiti ky rast! Kjo rastësi e pabesueshme që dy njerëz që duhej të ishin armiq, u gjendën gati në qelinë e njëjtë! A është e mundur që Opdami të mos e njohë njeriun që e kishte vizituar disa herë?!... Megjithatë, pas ekspertizës së letrës nga ana e grafologëve dhe vërtetimit se ajo ishte e shkruar nga dora e vet Lodderit, lirimi i Opdamit ishte vetëm çështje kohe derisa formalisht të zhvillohej gjykimi tjetër. Edhe pse mendohej se Opdami do të lirohej brenda dy-tre muajve, procesi zgjati 11 muaj dhe, më në fund, gjyqi vendosi me shumicë votash që Johannes Opdami të lirohet.

Opdami kthehet prapë në shtëpinë e vet në Berkel. Gjithashtu i kthehen edhe fëmijët dhe fillon përsëri punën në ordinancën e vet.

Askujt, në një bankë të Amstredamit nuk i shkonte ndërmend, se pse Opdami e kishte hipotekuar shtëpinë e vet për një shumë të madhe parash. Supozonin se kishte rënë në vështirësi financiare për shkak të qëndrimit të gjatë në burg. Vetëm ai vetë e dinte se pse i nevojitej aq urgjentisht ajo shumë e madhe të hollash. Duhej paguar rojtari i katit të burgut, ku kishte qenë edhe vetë Opdami! Për këtë humbje të hollash ai nuk ankohej. Tani ishte i qetë... Por një mbrëmje, në orën 22, në derën e Opdamit troket një ish-i burgosur, Jan Steeni, i cili gjatë burgimit ua shpinte ushqimin të burgosurve nëpër qeli. Ishte i dënuar për një delikt të lehtë, e kishte mbajtur dënimin dhe tani kishte ardhur për ta „vizituar" shokun e burgut.

Opdami e gostit me pije, por papritur mysafiri e pyet:

-Opdam, e di se Klaasin (rojtarin e burgut) e ke shpërblyer me shumë të madhe të hollash. Sa para i ke lënë për mua?

Fytyra e zverdhur e Opdamit, zbehet edhe më, buzëqeshja i shuhet.

-Si po mendon?

-Thjesht. Të kam parë atë natë se si Klaasi të ka lëshuar të futesh në qelinë e Lodderit.

-Pse s'e ke dëshmuar këtë para gjyqit? -i thotë Opdami duke kaluar në ofensivë.

-Çfarë përfitimesh do të kisha nga ajo? Për një informacion të tillë gjyqi nuk do të m'i jepte 10.000 guldenë...

-10.000... ti je i marrë Steen! Prej nga mua 10.000 guldenë?

-Nuk më intereson. Përveç kësaj, prej nga gjithë ajo shumë për Klaasin?

-Nuk i kam dhënë asgjë.

Steeni ngrihet dhe duke dalë i thotë:

-Opdam, nëse deri nesër nuk ma sjell atë shumë, do të shkoj të të lajmëroj në polici.

-Prit pak! Ndalu ta pimë nga një e të bisedojmë... Dhe, gjatë bisedës, filloi ta shikojë drejt në sy, por ky e kthente kokën.

-E, mua nuk do të mund të më hipnotizosh!

Opdami detyrohet të nesërmen t'ia dërgojë të hollat. Në pamundësi që t'ia mbledh të gjitha, ia jep një pjesë dhe i premton se shumën tjetër do t'ia japë pas tre muajsh. Steeni pranon por, një ditë, duke dalë nga një pijetore, Steeni sulmohet nga dikush duke e lënduar rëndë me thikë. I frikësuar nga kjo, Steeni kërkon të bisedojë me komisarin e policisë dhe i tregon gjithçka që kishte ditur për këtë rast.

Opdami ishte shoqëruar shpejt me rojtarin, të cilit i jepte këshilla për gruan e sëmurë dhe pasi që të dy, si Opdami ashtu edhe Lodderi, kishin shprehur dëshirën që të qëndrojnë dhe të bisedojnë së bashku, ky ua kishte mundësuar. Steeni që kishte dëshirë t'i fusë hundët gjithkund, e kishte parë njëherë Opdamin duke e hipnotizuar Lodderin.

Opdami prapë burgoset dhe dështmitar në këtë gjyq e kishte Steenin. „Ladderi ishte armë e verbër në duart e Opdamit, i cili e kishte hipnotizuar dhe në hipnozë e ka urdhëruar që ta shkruajë letrën lamtumirëse..."

Klaasi e pranon fajësinë e tij dhe pohon se ua kishte mundësuar të rrinë së bashku në një qeli dhe se ai ia kishte dhënë tri elementet kimike, prej të cilave ishte përfituar cianid kaliumi. Nuk kishte pasur njohuri se në çfarë rrjeti po futet, por kur kishte marrë vesh për vdekjen e Lodderit i kishte thënë në sy Opdamit se do ta lajmëronte, por ky i kishte thënë të mos bëhej i marrë sepse nga ajo nuk do të përfitonte asgjë kurse, po të heshtë, ky do t'ia jepte një shumë të madhe të hollash.

Gjatë hetimeve, dikujt i kujtohet edhe rasti i letrës së

Arnoldës dhe fjalët e djaloshit 6 vjeçar „nëna flinte derisa shkruante letër” dhe merret në pyetje edhe ai, i cili tregon gjithçka që kishte parë. Opdami, viktimën e kishte hipnotizuar dhe atëherë e kishte ulur në tavolinë, duke e urdhëruar që ta shkruante letrën lamtumirëse, nën diktatin e tij. Këtij vogëlushi i dukej se nëna po flinte.

Gjykatësit i bie ndërmend se, pasi e kishte shkruar letrën, Lodderi e kishte pirë helmin dhe nuk kishte mundur ta ngjiste zarfin. Pasi bëhet ekspertiza e pështymës, vërtetohet se atë e kishte bërë Opdami, dhe kështu hipnotizuesi gjenial kapitulloi dhe u detyrua që kësaj here të kthehet me të vërtetë në qeli, deri në fund të jetës.

FENOMENET E HIPNOZËS

Gjatë hipnozës dhe autohipnozës, pamë se sugjestioni i hipnotizuesit fuqizohet dhe rritet deri në përmase ekstreme dhe mund të provokojë fenomene të çuditshme.

Ndër fenomenet e shumët (si burim i forcës së brendshme të njeriut), por në dukje rrëqethës, është edhe fenomeni i therjes së pjesëve të ndryshme të trupit me mjete të mprehta metalike. Ky veprim rrëqethës demonstrohet zakonisht gjatë ceremonive fetare nëpërmjet të cilave, anëtarë të besimeve të ndryshme ndër shumë popuj të botës, paraqesin forcën e gjithëfuqishme të Perëndisë. Kështu p.sh. në jug të ishullit Ceylona (Indi), gjatë një ceremonie fetare për nder të Hyjnisë hinduse, anëtarë të këtij besimi, të shpuar me mjete metalike dhe të kapur nëpër pjesë të trupit me çengel, rrinë varur për një kohë të gjatë. Duke shqiptuar fjalë magjike, ata bien në gjendje transi dhe nuk ndiejnë kurrfarë dhembje.

Pastaj anëtarët e sektit Sadhu, të cilët për nder të Zotit Shiva dhe gruas së tij Minakshi, për çdo vit mblidhen në tempullin e njohur në qytetin Madurai, në jug të Indisë, ku

„njeriu i shenjtë” me një shpatë të madhe i shpon te dy anët e fytyrës dhe gjatë asaj gjendje ekstaze ai nuk ndien kurrfarë dhembjeje.

Majtas: anëtari i fisit hindu duke qëndruar i varur në çengela gjatë një ceremonie fetare që u mbajt më 23 janar 1997 në qytetin e Indisë Madras Djathtas: „Njeriu i shenjtë” i shpuar në dy anët e fytyrës me shpatë

Gjithashtu, rast konkret i kemi edhe demonstrimet e dervishëve tanë (Kosovë), ceremonia e të cilëve mbahet në Prizren. Dervishët tanë (që i takojnë rendit të Rufaive) për çdo vit, me 22 mars, me rastin e Sulltan Nevruzit, ditës së lindjes së hz. Alisë (trashëgimtarit të parë të hz. Muhamedit), në Teqenë e Prizrenit e festojnë këtë ditë me një ceremonial të veçantë gjatë të cilit kryhen therje me shpata, pinjall e hanxhar.

Ceremonia fillon me këndimin disaorësh të ilahive, pas të cilave vjen Ziqri (Ziqri është një lutje e dervishëve, nëpërmjet së cilës ata ndahen nga bota e përditshme, prej Nefisit (egos) dhe i dorëzohen Allahut). Përsëritja e pandërprerë e emrit të Allahut, e cila shoqërohet me thirrje karakteristike „Hu”, dhe lëvizjet e kombinuara ritmike, herë në një anë e herë në tjetrën, i sjell ata në një gjendje transi (autohipnozë). Pas kësaj, nën tingujt e instrumenteve të posaçme, fillon dërgimi i viktimave të përgjakura Allahut, pra fillon therja rituale nëpër faqe, gjuhë, bark etj. me anë të mjeteve të mprehta metalike si: shpata, hanxhar, pinjall etj. të cilën dervishët e quajnë „zarpa”.

Gjithashtu është interesant të ceket se edhe gjatë ritualit,

por edhe pas daljes nga ai, ata nuk ndjejnë dhembje në trupin e tyre fizik, si dhe gjurmët e plagëve të marra nga mjetet metalike vërehen fare pak e edhe gjakderdhje nuk kanë.

Disa demonstrime të dervishëve në Prizren

Një dukuri të njëjtë e demonstroi edhe holandezi Mirina Daja, në vitin 1947, dhe atë para ekspertëve të njohur mjekësor. Ai lejoi që publikisht t'i futet shpata në cilëndo pjesë të trupit. Kështu ai me shpatë të ngulur nëpër mëlçi e veshkë, lëvizte rreth spitalit pa vështirësi, bile edhe vraponte. Profesorët, të cilët e



Lart: mjekët duke e kontrolluar Dajën. Majtas: M. Daja duke vrapuar me shpatë në trup

kontrollonin Dajen në spitalin e kantonit të Cyrihut dhe Bazelit (Zvicër), bënë edhe fotografimin me rëntgen, për të evituar çdo manipulim, dhe në fund konstatuan se vërtet Dajes i ishte shpuar veshka dhe mëlçia (këtë e vërteton edhe fotografia e rëntgenit). Dhe pas nxjerrjes së shpatës, plagët iu shëruan shumë shpejt dhe pa gjakderdhje.

Fenomen tjetër është edhe ecja mbi zjarr (gaca). Edhe kjo dukuri, si shumë të tjera, praktikohet ndër shumë popuj të botës, por më e theksuar është sidomos në Indi. Rituale për ecje mbi zjarr mbahen edhe nëpër shtete të ndryshme të Evropës. Në vitet e'80-ta, në një ritual që është mbajtur në ish - Jugosllavi, morën pjesë, me sukses, edhe dy miqtë e mi, S. Basha dhe A. Kolgeci.

Nga viti 2006, Shoqata për krijimin e njeriut të ri „Vegimi Mistik," nga Prizreni, e sjell këtë ritual edhe në Kosovë, duke organizuar në Prizren disa herë ecjen mbi prush dhe atë pikërisht më 21 mars, në ditën e parë të pranverës, në ditën e rifillimit të së resë, stinës më të bukur të vitit - të lulëzimit, ripërtëritjes, ringjalljes së natyrës e shpirtit... që tashmë është kthyer në një traditë.

Fotografi nga rituali i ecjes mbi prush, organizuar nga Shoqata „Vegimi Mistik," në Prizren

Këtij rituali, përveç anëtarëve të Shoqatës „Vegimi Mistik" nga Prizreni, gjithnjë e më shumë po i bashkohen pjesëmarrës nga të gjitha trojet shqiptare.

Personat përgatiten një kohë të gjatë (disa orë) nëpërmjet sugjestioneve dhe autosugjestioneve, në gjendje normale apo hipnotike, për të mënjanuar frikën nga zjarri dhe, pasi ta arrijnë këtë, ecin nëpër shtegun e gjatë deri në 12 m, i cili është i shtruar me prush dhe me këtë rast, që është më me rëndësi, ata nuk marrin kurrfarë djegieje në këmbë.

Ata të cilët patën rastin ta shohin këtë fenomen, e një pjesë e tyre edhe të kalojnë vetë mbi zjarr, u fascinuan nga kjo mrekulli. Zakonisht, ky ritual praktikohet gjatë ceremonive të ndryshme fetare. Në Indi ekzistojnë me mijëra sekte dhe secili prej tyre praktikon mënyrën e vet rituale. P.sh. sekti Sadhu e praktikon ecjen nëpër guralecë të skuqur. Ata gjatë ceremonisë e hapin një kanal me gjatësi, gjerësi dhe thellësi të caktuar, e ndezin një zjarr të madh në të dhe pastaj atë kanal e mbushin me guralecë. Deri sa të arrihet skuqja e guralecëve, një anëtar i sektit Sadhu, i dërguar posaçërisht për këtë punë, i përgatit pjesëmarrësit për ritual. Pasi të arrihet skuqja e tyre ai kalon i pari nëpër guralecët e skuqur dhe pas tij pjesëtarët e tjerë.

Një ekspert evropian që kishte marrë pjesë aty, thotë se guralecët ishin plotësisht të skuqur, dhe përjashtonte çdo mundësi manipulimi. „Anëtarët e sektit Sadhu mënjanojnë frikën nga zjarri dhe pasojat e tij, nga vullneti i fortë i tyre, i bëjnë të paefektshme, kështu që nuk pësojnë djegie. Edhe pse ende e pasqaruar, është realitet ” - përfundon ai.

Gjithashtu, është interesant edhe rasti i Jatoo Bhait, nga Kalkuta (Indi), i cili mund ta përpijë gacën e ndezur; mund të kapë dhe ta mbajë në dorë hekurin e skuqur si dhe mund të vallëzojë mbi zjarr, pa pësuar kurrfarë lëndimi fizik. Por edhe ky, para se t’i demonstrojë aftësitë e veta, futet në një gjendje ekstaze.

Jatoo Bhai duke vallëzuar mbi zjarr

Fenomen më vete është edhe „ngjitja nëpër litar”, që e praktikojnë fakirët e Indisë si atraksion para turmës.

Njerëzit janë ulur përreth tij, kurse fakiri qëndron ulur në mes. Afër tij qëndron edhe një djalosh. Pas pak çastesh, fakiri e hedh litarin drejt përpjetë. Ai shkon duke u zhdredhur deri sa humbet nga syri i masës. Litari pastaj frenohet dhe qëndron në atë pozitë. Fakiri e urdhëron djaloshin që ndodhet pranë tij që të ngjitet nëpër litar. Djaloshi nuk kundërshton, ngjitet shpejt derisa mbërrin në re dhe humb nga syri i masës së mahnitur. Atëherë fakiri e urdhëron që të zbresë, mirëpo djaloshi nuk përgjigjet. Pas disa thirrjeve, fakiri i inatosur merr shpatën dhe ngjitet edhe ai vetë nëpër litar për ta arritur djaloshin. Pas ca momentesh pritjeje, dëgjohet një britmë e tmerrshme, e më pas fillojnë të bien pjesët e prera të trupit të djaloshit: koka, këmbët, duart, trupi; më pas zbret edhe fakiri me shpatën e përgjakur.

Ngjitja nëpër litar- truk apo realitet?

Duke i parë fytyrat e trishtuara të të pranishmëve, ai fillon t’i mbledhë pjesët e prera të trupit dhe i futë në një thes. Pasi i shtie të gjitha, e thërret djaloshin në emër dhe, për çudi të të gjithëve, para tyre paraqitet prapë djaloshi i shëndoshë dhe duke qeshur.

Kështu zhvillohet ky fenomen i çuditshëm indian për të

cilin u bënë aq shumë debate të nxehta, por pa ndonjë përfundim konkret. Një pjesë e madhe e studiuesve të këtij fenomeni mendojnë se kemi të bëjmë me hipnozë masive, që
është edhe më afër logjikës, e që e vërteton edhe ky rast: Një gazetare angleze, e cila ndodhej për vizitë në Indi, e kishte
regjistruar tërë këtë ngjarje me kamerë filmike, ishte befasuar kur në ekran kishte parë vetëm një fotografi të njëjtë: fakirin e ulur këmbëkryq në një qilim dhe djaloshin pranë tij.

Nga kjo del se fakiri, me forcën e dëshirës së vet, i kishte detyruar shikuesit të shohin atë që ai kishte dëshiruar. Pra, ai ka arritur t'i koncentrojë mendimet e veta të cilat kanë rrezatuar aq fort në rreth saqë të pranishmit, edhe pse të vetëdijshëm dhe në gjendje të zgjuar, janë magjepsur dhe para syve të tyre u është paraqitur ngjarja, të cilën fakiri e ka menduar.

Fotografi e vitit 1934

Ndoshta tingëllon pak çuditshëm dhe duket si paradoksale që një njeri të qëndrojë për disa orë, ditë ose javë nën dhe, dhe pastaj të dalë pa pasoja! Por ja që, duke iu falënderuar forcës së nëndijes, është e mundur.

Në vitin 1935, nën kontrollin e mjekëve francezë, me vetëdëshirë, pranoi të eksperimentohet jogisti Haridas. U mor vendimi në bazë të pëlqimit të dyanshëm që Haridasi të futet nën dhe, të qëndrojë aty për 40 ditë e net. Jogisti për këtë u përgatit brenda disa ditësh. Pinte vetëm qumësht dhe kos, lahej me ujë të nxehtë, ndërsa ditën e fundit nuk mori asgjë nga ushqimi. E pastroi organizmin duke përbirë një shirit të pëlhurës, të gjatë 27 cm. sytë dhe veshët i mbylli me dyllë, u ulë në pozicionin „lotos" dhe u vendos në sëndukun e përgatitur enkas për këtë eksperiment. Sipas shënimeve të mjekëve, pas disa minutash,

nuk ishte më e mundur t'i matej pulsi! Kështu, sipas mjekësisë moderne, ai kishte pësuar vdekje klinike. Atëherë jogisti mbështillet me pëlhurë dhe mbyllet në sëndukun të cilin e vendosin në dhe. Sënduku është vulosur dhe rreth vendit ku është „varrosur" jogisti, disa ushtarë ruanin ditë e natë.

Pas kohës së caktuar (40 ditë) jogisti nxirret nga dheu dhe hapet sënduku. Trupi fare nuk tregonte shenja jete. Pulsi nuk mund t'i matej. Kokën e kishte të mbështetur për kraharor. Pasi ia largojnë dyllin nga sytë dhe veshët, ia fërkojnë duart dhe këmbët dhe, dalëngadalë fillon të vijë në gjendje normale. Kështu, jogisti i „varrosur" dyzet ditë nën dhe, „ringjallet" prapë.



Në vitin 1953, Graf Ostaja qëndroi disa ditë nën dhe, dhe mbijetoi

Në vitin 1974, ky jogist qëndroi disa orë me kokë nën rërë dhe mbijetoi me një frekuencë pulsore prej dy të rrahurash në minutë

I. Sanderson, në librin e tij „More Things", shkruan për rastin e një „varrimi" ku jogisti qëndroi për 24 orë i mbuluar me dhe të lagur, i cili ishte shkarkuar nga dy kamionë të mëdhenj, dhe e tërë kjo u bë nën kontrollin e pesë mjekëve anglezë, dhe mbijetoi, si dhe shumë e shumë raste të tjera.

Edhe rasti i Tereza Najmanit nga Konstrajti është fenomen interesat. Çdo të premte ajo binte në një gjendje ekstaze dhe në atë kohë në trupin e saj paraqiteshin shenja në pjesë përkatëse - hapeshin „plagët e Krishtit", nga të cilat rridhte gjaku, ndërsa

nga sytë e saj pikonin lot të përgjakur. Në atë çaste ishte në gjendje të parashikonte dhe shëronte.

Gjithashtu, shkrimet e romaneve, vizatimet automatike si dhe kompozimet e shumë pjesëve muzikore gjatë gjumit hipnotik, janë fenomene më vete.

Kah fundi i shekullit 19, zonja Krishanovskaja Rochester nga Estonia, kishte arritur t'i shkruajë rreth 50 romane me një vëllim bukur të madh, nga lëmi i okultizmit. Ajo thoshte se, derisa gjendej në trans, i diktonte një „indian i materializuar" se çfarë duhej të shkruajë. Gjatë asaj kohe dora e saj aq shpejt lëvizte mbi letër saqë as ajo vetë nuk mund ta përcillte përmbajtjen. Është çudi se ajo një pjesë të romaneve e kishte shkruar në gjuhën franceze të cilën, në gjendje normale, fare pak e zotëronte. Gjithashtu u vërtetua se shkrimet, nga këndvështrimi gjuhësor, ishin të shkruara në mënyrë të përsosur dhe pa asnjë gabim drejtshkrimor. Përveç kësaj, ekspertët që merreshin me shkrimet e saj, u mahnitën me të dhënat aq të sakta për kohën e egjiptianëve të vjetër, për të cilën ajo bënte fjalë në romanet e veta. Aq në detaje ishin të përshkruara të dhënat për atë kohë saqë vetëm një egjiptolog mund të kishte njohuri për to e assesi një laik. Dhe, për këto njohuri kaq të sakta, u nderua me një dekoratë të posaçme nga Akademia e Parisit.

Si medium që shkruante në trans njihet edhe Geraldina Cummins, vajzë e një profesori nga Corka e Irlandës. Shkrimet e saj, të shkruara në trans, zgjuan sensacion të madh pasi ishin të shkruara në gjuhën e vjetër angleze me të cilën askush më nuk shërbehej. Ajo filloi papritmas të shkruajë automatikisht në dhjetor të vitit 1924. Edhe pse në jetën e zakonshme shkruante ngadalë dhe mendueshëm, në gjendje transi arriti rekord në shkrim automatik. Arriti të shkruajë 1750 fjalë për një orë e pesë minuta! Habit fakti se zonja Cummins asnjëherë nuk ishte marrë me shkrime. Nuk kishte studiuar as arkeologjinë e as teologjinë dhe as që kishte dëgjuar, e as lexuar, për vendet të cilat i

përshkruante në romanet e veta!

Në vitin 1905, argjendari Frederico L. Thompson, brenda një nate u bë piktor! Nga natyra ishte plotësisht i painteresuar për art, prandaj as që ishte marrë ndonjëherë me të. Por, një natë, bie vetvetiu në gjendje transi dhe i paraqiten halucinacione të ndryshme të cilat e frymëzonin të skicojë dhe vizatojë, dhe kur dilte nga ajo gjendje, as që besonte se i ka punuar vetë. Ky sugjestion i fortë mbisundon mbi argjendarin dhe e detyron atë të bëhet piktor. Kur e pyetnin se prej nga motivohet, nuk dinte të përgjigjej: nuk e di as vetë se nga burojnë motivet! Thompson, brenda dy viteve arriti të bëjë rreth dy mijë punime, përgjithësisht të formatit të vogël.

Tre muaj pas vdekjes së artistit të madh Pablo Pikaso (vdiq në mars të vitit 1974), u paraqit në opinion anglezi Matthew Manning, i cili në gjendje transi imitonte shkëlqyeshëm stilin e tij. Ai thoshte se kishte „vënë kontakt shpirtëror" me artistin spanjoll dhe, nëpërmjet dorës së tij, Pikaso vazhdonte veprimtarinë e vet. „Përveç kontaktit me Pikason, thotë ai, kontaktoj edhe me shumë piktorë të famshëm, si: Leonardo Da Vinçin, Albrecht Dyrerin, Isaac Oliverin etj. Por, lodhje më të madhe ndiej kur nëpërmjet meje krijon Pikaso! Gjithë ditën ndihem i rraskapitur. "

Dy punime të M. Manningut: I pari në stil të A. Beardsleys, ndërsa i dyti në stil të P. Pikasos

Është e çuditshme se si mundet Manningu t'i imitojë aq mirë të gjitha ato stile arti figurativ që ndryshojnë aq shumë njëri nga tjetri.

Rosemary Browna është një grua nga Londra e cila me kompozimet, të cilat i bënte gjersa ishte në hipnozë, i mahniti

edhe kompozitorët më të mëdhenj të kohës. Në jetën e zakonshme ishte amvise dhe as që kishte njohuri për kompozime, por një ditë, derisa ishte vajzë e re, i paraqitet në vizion një njeri i vjetër i cili i sqaron se ai, dhe kompozitorë tjerë të famshëm, do të krijojnë së shpejti shoqëri me të dhe nëpërmjet saj do të vazhdojnë të kompozojnë. Dhe, shumë vite më vonë, ajo e sheh një fotografi të Franz Listzit (1811-1886) dhe e njeh atë menjëherë: ishte ”shoku fantazmë„ i cili iu kishte paraqitur në vizione (hipnozë).



Është i njohur edhe kompozitori John Lill nga Britania. Takimin e parë me ”mësuesin shpirtëror„ e përjetoi derisa përgatitej për konkurs në Konservatorin e Moskës. Ai ndjeu papritur se dikush e vrojtonte. Ishte një figurë me pamje të jashtëzakonshme. J. Lill mendon se ai është vet Bethoveni i cili i ndihmon. ”Është shumë vështirë t’i kuptojë njeriu ato inspirime derisa vetë të mos i përjetojë. Është diç që njeriu e ndjen, e kap. Kur unë paraqitem në skenë, i mënjanoj të gjitha njohuritë që i kam mësuar deri atëherë dhe e zgjoj inspirimin.”

Po e shënojmë edhe një eksperiment që e ka bërë vetë autori:

Prizren, më 27.3.1989

Mediumi (Sh. S.) gjendet në gjendje të thellë hipnotike. I është sugjeruar të gjejë unazën e arit, të fshehur në dhomë. - Në këtë dhomë e kemi fshehur një unazë ari. Mundohuni ta gjeni!

Unaza ju fsheh para fillimit të seancë nga një person i pranishëm, i cili pastaj largohej nga dhoma ku mbahej seanca deh askush, përveç tij, nuk e dinte ku gjendej e fshehur unaza.

Mediumi u ngrit dhe filloi të shikojë nëpër dhomë. Pas disa minutash, ai u drejtua ka vendi ku ishte e fshehur unaza. Kur u afrua, bëri një pauzë të shkurtër, dhe e drejtoi dorën në vendin

ku ishte fshehur unaza e arit.

Eksperimenti është përsëritur disa herë me sukses dhe atë me mediume të ndryshme.

MËSIMI ME NDIHMËN E HIPNOZËS

Shumë zbulime epokale që janë bërë, e kanë burimin në forcën e pakufishme të nëndijes (trurit). Kështu p.sh. shkencëtari Nils Bor në ëndërr (autohipnozë e pakontrolluar) e kishte parë modelin e atomit të cilin që moti e kërkonte; pastaj kirurgu kanadez Frederik Benting në ëndërr e zbuloi insulinën; kimisti gjerman Fridrih Kekule derisa udhëtonte me autobus për një moment e humb vetëdijen, e kur zgjohet nga ajo gjendje kllapie veç e zotëronte strukturën dhe formën e benzolës, e shumë e shumë raste të tjera.

Por lind pyetja: si mund të arrihet deri te mënyra dhe qasja për stimulimin e kreativitetit? Eksperimenti i parë në këtë drejtim daton që nga viti 1936, kur në klinikën e Leningradit, prof. dr. i shkencave mjekësore A. M. Svejdoshc ua lexoi tri vajzave, të cilat flinin (ishin në gjumë hipnotik), disa tregime interesante. Në mëngjes të tri vajzat e përsëritën këtë përrallë si ëndërr të tyren.

Ky eksperiment është ndër të parët që është regjistruar si i tillë, edhe pse ekzistojnë mendime se qysh në tempujt e vjetër budistë, klerikët u përsëritnin nxënësve, derisa ata flinin, tekstet e librave të shenjtë.

Në vitin 1940, në këtë fushë, filloi të hulumtonte L. A. Blizncenko, nga Kijeva. Ai e formoi një klasë speciale në të cilën mësohej vetëm natën dhe e përdori metodën e hipnopedisë (metodë e të mësuarit në gjumë). Ligjëruesit gjatë ditës i mbanin ligjëratat e zakonshme, ndërsa në mbrëmje bëhej konfirmimi i dijes. Rezultatet ishin të mrekullueshme. Këtë më së miri e ilustron rasti i inxhinierit të kimisë, 23 vjeçarit V. Voloshcin. Ai

p.sh., për 22 net u mësua të flasë anglisht. Pas mësimeve të natës, në mëngjes ai zgjohej i kthjellët dhe deklaronte se kishte fjetur shumë mirë.

Koha e mësimit te Bliznicenko, që ishte njëherit edhe udhëheqës i laboratorit, në institutin e gjuhëve të Akademisë së Shkencave te Bashkimit Sovjetik, zgjaste një muaj. Për një natë nxënësit mësonin 40-100 fjalë të huaja, që do të thotë se për një muaj ata mund të mësonin rreth 2000 fjalë e që janë të mjaftueshme për komunikim.

Gjithashtu është interesant të ceket, se gjatë mësimit me hipnozë, rezultate përafërsisht të njëjta tregojnë si të rinjtë, ashtu edhe njerëzit e moshës 50 vjeçare. Pra, këtu nuk ka dallim moshe siç ndodh në rrethana normale.

Vëmendje të veçantë në botë tërhoqi edhe eksperimenti të cilin e udhëhoqi hipnotizuesi Mario Belin nga Italia. Ai e kishte zgjedhur një grup studentësh nga Instituti ”San Vincenco„ në Borgen dhe me ta kishte eksperimentuar. Ai u vinte studentëve kufjet (dëgjueset) dhe nëpërmjet mikrofonit i hipnotizonte. Më pastaj, mikrofonin ia jepte profesorit të rregullt, i cili e mbante ligjëratën.

Pas zgjimit, u konstatua se studentët e kishin mbajtur në mend gjithë ligjëratën dhe, që është me rëndësi, e kishin kuptuar plotësisht esencën e saj. Pra, në atë gjendje, jo vetëm që e kishin mbajtur në mend mekanikisht, por edhe e kishin kuptuar përmbajtjen. Për studentët që i ishin nënshtruar njëherë pushtetit hipnotik, Belini, pas një kohe shfrytëzonte kasetën e magnetofonit në të cilën ishte i regjistruar zëri i tij, të cilën profesori i rregullt ua lëshonte atyre. Efekti ishte i njëjtë.

Mario Belini zhvilloi eksperimente edhe me fëmijë, duke u mësuar atyre, gjatë gjumit hipnotik, këngë franceze. Ai dokumentoi se fëmijët gjatë gjumit hipnotik, pavarësisht se a janë nxënës të mirë apo të dobët, tregojnë rezultate të njëjta.

Roberto Provana, psikolog italian dhe hipnolog i njohur, kërkimet e veta vitet e fundit i ka drejtuar në fushën e shkencës dhe teknologjisë. ”Pasi që në këto fusha kërkohen gjithnjë ide të reja, nevoja e zbatimit të hipnozës në këtë drejtim është më se e nevojshme, pra, zgjidhja e problemit është: si të bëhen njerëzit më kreativë?„ - thotë ai. Të hipnotizuarit, Provana i urdhëron që të projektojnë, vizatojnë etj. ide të ndryshme, posaçërisht nga fusha tekniko-shkencore, dhe pasi që në këtë drejtim ai arriti rezultate të lakmueshme, shumë organizata iu drejtuan për ndihmë.

”Ekzistojnë teste me anë të të cilave përcaktohet kodeksi mentalo-operativ dhe potenciali i të dy hemisferave të trurit - thotë Provana. Me metoda të posaçme është e mundur që të arrihen shumë rezultate. Këto teknika „për mendim kualitativ” aktivizojnë fushat e fjetura të nëndijes dhe na mundësojnë që të zbulojmë: se të gjithë jemi kreativë, pasi që mënjanohen inhibicionet, që janë fryt i mendimeve tona të gabuara. Kjo është, mund të them njëjtë, sikur ta fërkojmë llambën e Aladinit! Në këtë mënyrë, njeriu mund të kontribuojë shumë, si në zhvillimin dhe ngritjen individuale, ashtu edhe në fushat tekniko-shkencore, që janë shumë të rëndësishme për prosperimin e shoqërive të sotme”, përfundon ai.

Po e japim edhe eksperimentin e autorit në këtë fushë:

Prizren, më 15.2.1989

Mediumeve (B. K, L. K dhe L. B), të cilët gjendeshin në stadin e hipnozës së thellë, u janë lexuar fjalë nga gjuha gjermane. Në seancën e par mbajtën në mend 10-20 fjalë, ndërsa në seancat tjera vazhduese, numri i fjalëve të mbajtura mend vinte duke u shtuar dhe kështu arriti deri në 40-50 fjalë gjatë një seance.

Edhe në këtë fushë, hipnoza mund të ndihmojë dhe lehtësojë mjaft shumë në përvetësimi e lëndëve ose gjuhëve të huaja për një kohë shumë të shkurtër.

Sabir Krasniqi 94

GJUMI DHE ËNDRRAT

Se gjatë „udhëtimit" të natës kalojmë në një dimension paksa më tjetër nga ai që jemi mësuar ta përjetojmë gjatë gjendjes së zgjuar, pra në dimensionin e botës së ëndrrave, pajtohemi pothuajse të gjithë. Hulumtimet shkencore kanë konstatuar se gjatë gjumit (normal) të natës gjithnjë ndodhin jo vetëm një, por më shumë ëndrra. Mirëpo, disa njerëz i harrojnë plotësisht ato që ëndërrojnë dhe pohojnë se nuk kanë ëndërruar fare, derisa disa të tjerëve u kujtohen ëndrrat deri në detajin më të imët. Shumica e njerëzve i mbajnë në mend pjesërisht ëndrrat dhe vetëm ndonjëherë, përkohësisht, iu kujtohet në tërësi ndonjë ëndërr e cila për ndonjë arsye vepron më fuqishëm dhe në mënyrë të veçantë.

Ç'JANË ËNDRRAT?

Pasi është fjala për veprimtari themelore të trurit, në këtë pyetje është vështirë të jepet përgjigje adekuate.

Zbulimet më të hershme për jetën e njeriut tregojnë se ëndrrat kanë qenë gjithnjë të rëndësishme në procesin e tij zhvillimor e jetësor. Kështu, egjiptianët kanë besuar se ëndrrat janë mesazhe nga Zoti dhe qysh në vitin 1300 p.e.r. e kanë përpiluar librin e ëndrrave me mbi dymijë interpretime të atyre mesazheve. Libra të ëndrrave gjithashtu kanë pasur edhe shumë popuj tjerë, si: asirët, babilonasit, persianët, grekët etj. Madje për asirët besohet se në bibliotekën e mbretit Asurabanipalu (669 -626 p.e.r.) ka ekzistuar libri i interpretimeve të ëndrrave

nga viti 2000 p.e.r.

Me zhvillimin e shkencës së psikologjisë, çështja e ëndrrave u bë objekt studime edhe për shumë psikologë të njohur, si: Alfer Mor, Karl G. Jung, N. N. Elis, A Bergson, S. Frojd etj., të cilët i kanë interpretuar ëndrrat në mënyra të ndryshme. Por, pothuaj që të gjithë, pa përjashtim, pajtohen në një pikë: Ata konsiderojnë se ëndrrat paraqesin mesazhe nga nëndija, nga thellësitë e personalitetit tonë, thellësi me të cilën në mënyrë të vetëdijshme nuk jemi në kontakt.



Frojdi thotë se ëndrrat janë shfaqje shumë të rëndësishme të jetës sonë të brendshme, fshehurazi të mbushura ngandonjëherë me dëshirat më intime të ëndërruesit të cilat truri i tij, për shkak të botëkuptimeve kundërthënëse dhe censurës shoqërore, shpesh i refuzon. Ai këto shfaqje përgjithësisht i lidhë me dukuritë seksuale. Meqë seksi është instinkti më i fuqishëm i njeriut, i cili njëkohësisht është edhe më i kufizuari nga normat e përcaktuara shoqërore, këto dëshira të fshehura individi i „realizon” në ekranin e ëndrrave.



Jungu mendon se asnjë simbol, që na paraqitet gjatë ëndërrimit, nuk mund të jetë i ndarë nga personi që ëndërron dhe nuk ekziston interpretim i përcaktuar i cilësdo ëndërr. Me fjalë të tjera, ëndrra juaj ju takon vetëm juve.

Sipas Bergsonit ëndrrat janë kujtime të harruara që burojnë nga pjesët e largëta të trurit për arsye të ngacmimeve të jashtme etj.

Gjatë këtyre 50 viteve të fundit, për ëndrrat janë kryer shumë eksperimente në laboratorë të ndryshëm të botës. Në të gjitha këto hulumtime vërtetohet se gjatë gjumit, në disa momente, truri ynë formon lloj-lloj fotografish të cilat paraqiten

në ekranin privat të trurit tonë dhe ato fotografi, në atë gjendje, ne i pranojmë si të vërteta dhe vetëm rrallë, tejet rrallë, mund të kemi vetëdijen se ato janë ëndrra. Por, që të mund të mësojmë përafërsisht diçka më shumë për ëndrrat, mendoj se në radhë të parë duhet të flasim diçka më shumë për gjumit.

Ç'ËSHTË GJUMI?

Për tu mbrojtur nga rraskapitja dhe problemet tjera organizmit të lodhur i nevojitet së paku 1/3 e kohës, brenda 24 orëve, të jetë pushim fjetjeje.

Gjatë kohës së gjumit funksionet fiziologjike dhe psikike të organizmit bëhen më të dobëta dhe më të ngadalshme. Organizmi nuk reagon në një numër të madh ngacmimesh të jashtme, ndërsa i tërë aktiviteti shpirtëror zvogëlohet në minimum, duke qenë më pak intensiv dhe më pak i orientuar. Por, megjithatë, as truri e as trupi, gjatë gjumit, nuk ndodhen në komë të plotë. Gjatë gjumit ne shpesh e ndërrojmë pozitën e

trupit dhe atë 20 deri në 40 herë brenda një pushimi normal. Reaksionet tona ndaj ngacmimeve të jashtme gjithashtu ndryshojnë. Gjatë gjendjes së zgjuar shqisat e ndryshme në trup gjithnjë i dërgojnë mesazhe trurit, i cili i analizon dhe në bazë të situatës përkatëse dhe përvojës së mëhershme, vendos se cilin aktivitet mental apo fizik ta ndërmarrë. Në qoftë se prekim diçka të lagur, truri ynë bëhet i vetëdijshëm në atë dukuri dhe na detyron ta largojmë dorën. Por, në qoftë se e marrim dorën e një personi të fjetur dhe e vendosim në diçka të lagur, ai nuk do ta tërheqë menjëherë. Faktikisht ekziston njëfarë ndërprerjeje apo ndryshim në rrugën, në të cilën shqisa e të prekurit e dërgojnë ndjeshmërinë në tru gjatë gjendjes së fjetur, edhe pse kjo ndjeshmëri në të vërtetë arrin deri tek truri dhe ndonjëherë mesazhi arrin që të depërtojë edhe në ëndërr, përvojë që e kemi përjetuar pothuajse të gjithë.

VALËT CIKLIKE TË GJUMIT

Siç dihet, ciklin e gjumit e rregullon diçka që quhet ritëm cirkadioni, respektivisht procese biologjike që zhvillohen parimisht gjatë periudhës 24 orëshe. Fjala rrjedh nga latinishtja „cicera dies”, që do të thotë, përafërsisht një ditë.

Brenda ritmit, i cili e bind trupin tonë që të fle, veprojnë edhe ritme të tjera, të cilat i rregullojnë sjelljet e tij gjatë gjumit. Rezultatet e marra nga laboratorët për kërkimet në sferën e gjumit, nga e gjithë bota, na japin fotografi bindëse për atë se çfarë na ndodh përderisa ne flemë. Elektroencefalogramet (EEG-ja) janë aparate të cilat shënojnë aktivitetin bioelektrik në tru dhe tregojnë nivele të ndryshme të aktivitetit të trurit derisa njeriu është duke fjetur. Përfytyrimi i pranuar është i njëjtë për secilën periudhë fjetjeje normale dhe mund të ndahet në disa stadiume rreshtore, të cilat përsëriten, duke filluar nga stadi që përngjan në gjendje të zgjuar (stadiumi i parë) e deri te ajo e

njëjtë me komën (stadiumi i katërt).

Nëpër këto valë ciklike të gjumit, nga i lehti deri te më i thelli dhe anasjelltas, kalohet disa herë gjatë periudhës së gjumit dhe secili cikël zgjatë rreth 90 minuta.



Stadiumi i parë: Gjumi më i lehtë, që nuk e regjistron EEG-ja. Më shumë i përngjan gjendjes së zgjuar. Fillon me „hyrjen" graduale në gjumë ku muskujt lirohen, ndërsa bioritmi ngadalësohet.

Stadiumi i dytë: Fillimi i gjumit të thellë, i cili pason pas gjumit të lehtë. Bisedat në gjumë dhe somnambulizmi zakonisht paraqiten në këtë stadium.

Stadiumi i tretë: Gjumi i cili shoqërohet me impulse të forta bioelektrike nga truri. Derisa gjatë gjendjes së zgjuar truri rëndom prodhon vetëm deri në 60 mikrovalë në sekondë, në këtë stadium gjumi, ai arrin të prodhojë edhe gjer në 300 mikrovalë për sekondë.

Stadiumi i katërt: Është gjumi më i thellë. Në këtë stadiumi kalojmë mjaft kohë gjatë ciklit të parë 90 minutësh të

pushimit të natës. Në këtë gjendje vështirë zgjohemi, marrim frymë ngadalë, zemra rrahë më ngadalë, ndërsa temperatura e trupit bie.

Gjatë një nate normale, kohën më të madhe e kalojmë në stadiumin e katërt gjatë ciklit të parë 90 minutësh i cili, siç duket, ka një rëndësi të veçantë për ne, pastaj kjo periudhë kohore vjen gradualisht në rënie. Për aq sa jemi psikofizikisht më të lodhur, për aq na është më e nevojshme kjo gjendje. Në rastet normale i fjeturi kalon 30 ose më shumë minuta në periudhën e parë të 90 minutëshit të stadiumit të katërt të gjumit. Pastaj, deri sa rrëshqasim ngadalë kah periudha e ciklit të dytë, kalojmë në situatë paradoksale kur edhe pëshpëritja më e vogël, e ndonjë njeriu të njohur, mund të na zgjojë derisa ndonjë krismë a zhurmë e fortë nuk na pengon fare. Tani fillon pjesa më e çuditshme e ciklit tonë gjatë fjetjes. Arrijmë prapë në stadiumin e parë, por me një dallim: Derisa në orët e para të fjetjes të stadiumit të parë përfytyrimet përcjellëse janë të paqarta dhe të palidhura, kthimi në atë stadium nga fundi i ciklit (90 min.) paraqet momentin kur në të vërtetë fillojmë të ëndërrojmë. Gjumi në këtë stadium dallohet me lëvizje të shpejta të syve dhe kjo fazë rëndom shënohet me shkurtesën **REM - repid eye movement.** Në këtë fazë kokërdhakët e të dy syve lëvizin shpejt dhe kjo lëvizje vërehet qartë nëse e shikojmë të fjeturin në këtë gjendje. I fjeturi duket sikur shikon andej - këndej nën kapakët e syve. Nga ky moment pushojnë lëvizjet nëpër krevat, frymëmarrja bëhet më e lehtë dhe ndonjëherë vjen deri te rënia e oksigjenit në gjak, në nivelin, i cili do të ishte në kufirin e tolerancës për gjendjen zgjuar.

PERIUDHA REM DHE FENOMENET TJERA TË GJUMIT

Gati të gjithë të eksperimentuarit laboratorikë, të cilët janë zgjuar nga kjo REM - periudhë, ishin në gjendje të tregojnë në mënyrë të qartë dhe të plotë ëndrrat e tyre.

Faza REM është më frekuentuese gjatë periudhës së fëmijërisë dhe vjen duke u zvogëluar me kalimin e kohës (në pleqëri). Njerëzit me koeficient të ulët intelektual dhe ata me të meta psikike e kanë shumë të shkurtër fazën e gjumit REM. Ekzistojnë, në të vërtetë, edhe disa fenomene tjera fizike të cilat ndërlidhen me fazën REM. Aktiviteti bioelektrik i trurit kurrë nuk pushon, kurse në fazën e gjumit REM vjen deri te rritja e aktivitetit neurologjik, ngritja e shpejtë e tensionit të gjakut, pulsi bëhet jo i rregullt, frymëmarrja çrregullohet dhe të gjitha simptomat tjera paraqesin një gjendje të jashtëzakonshme e që, në gjendje të zgjuar, do të mund të paraqitnin tronditje të mëdha, që do të mund të eskalonin deri në panik.

Në këtë kontekst duhet pranuar se fenomeni i lëvizjes dhe rrotullimit të kokërdhokëve të syve është një fenomen ende i pasqaruar përfundimisht. Por një gjë është vërtetuar saktësisht: se lëvizjet e shpejta të kokërdhokëve të syve janë të lidhura ngushtë me ëndërrimet, në të cilat jemi shumë aktivë. Po kështu është vërtetuar se ne ëndërrojmë jo vetëm gjatë fazës REM, por edha gjatë asaj jo-REM, atëherë kur kokërdhokët e syve nuk lëvizin fare. Por këto ëndrra, pra ëndrrat gjatë gjumit jo-REM, janë ëndrra më tepër të karakterit intelektual. Gjatë këtyre ëndërrimeve të gjumit jo-REM jemi të aftë të mësojmë apo të vijmë deri te disa zgjidhje të problemeve, të cilat në gjendjen tonë të zgjuar nuk kemi mundur t'i zgjidhim dot. Për këtë ekzistojnë fakte të dokumentuara. P.sh. prof. i matematikës Xhon Najmon, i cili vuri themelet e shkencës bashkëkohore llogaritëse, shpesh i shkruante teoritë derisa flinte. Pra, është

plotësisht e mundur që në ëndrrat tona të kërkojmë ndihmë për zgjidhjen e problemeve që na mundojnë. Simbolet që na paraqesin përgjigje gjatë ëndërrimit lajmërohen pikërisht në fazën jo-REM të gjumit.



Para disa vitesh, gjatë eksperimentimeve në Qendrën Mjekësore të Bruklinit, është vërtetuar se personat që mendojnë se nuk flenë gjatë natës, d.m.th. vuajnë nga pagjumësia, flenë normalisht. Megjithatë, regjistrimet në EEG tregojnë se ata edhe gjatë gjumit më të thellë janë në kufijtë e zgjimit, dhe kur zgjohen nuk e ndiejnë vetën mirë (të kthjellët) sikurse ata që flenë normalisht dhe kjo ndikon në ta që të mendojnë se nuk kanë fjetur fare.

Shumica e njerëzve e ndiejnë vetën të kthjellët kur „udhëtimi i natës” (gjumi) zgjatë 7-8 orë. Ka edhe raste kur kjo periudhë është edhe më e shkurtër p.sh. Napoloni, Frederiku i Madh, Tomas Edisoni etj. kanë jetuar normalisht edhe me nga 3-4 orë pushim të natës. Dr. Jan Osvald, studiues i gjumit nga Norvegjia, ka eksperimentuar në dy meshkuj të shëndoshë të cilët ishin biznesmenë të suksesshëm. Gjatë një jave (në kushte laboratorike) njëri nga ata flinte çdo natë vetëm 2 orë e 50 minuta ndërsa tjetri vetëm 2 orë dhe që të dy, çuditërisht,

ndiheshin shumë të kthjellët gjatë veprimtarive në bizneset e tyre.

Zhvillimi i industrisë së barnave dhe gatishmëria e disa mjekëve që t'u japin medikamente për gjumë pacientëve të tyre që vuajnë nga insomnia (pagjumësia), me lehtësi dhe pa dallime, kanë si pasojë çrregullime të mëdha në procesin normal të gjumit e veçanërisht tabletat me përbërje kimike. Njerëzit të cilët flenë me ndihmën e tabletave ose alkoolit (është vërtetuar laboratorikisht) e kanë shumë të shkurtër fazën REM të gjumit, e dihet se periudha e gjumit gjatë fazës REM dhe ëndrrat, bartin pasoja fiziologjike e biokimke. Medikamentet dhe alkooli në fillim duket se ndihmojnë për zbutjen e problemit të pagjumësisë, por kur merren për kohë të gjatë dhe në mënyrë të pakontrolluar, ato mund të jenë shumë të rrezikshëm pasi prekin aftësitë intelektuale dhe sociale, aq rëndë, saqë mund të jenë shkaktarë të shfaqjes së panikut, të krijojnë konfuzione, probleme me kujtesën (demencën) etj.

Një fenomen tjetër, që ndërlidhet gjithashtu në këtë kontekst dhe që është fare pak i studiuar, është somnambulizmi (zgjimi dhe ecja, por edhe bërja e veprimeve tjera më të ndërlikuara, nëpër gjumë). Ky fenomen nënkupton ngritjen dhe ecjen e njeriu gjatë procesit të fjetjes, pra në gjumë, e shpeshherë edhe kryerjen e punëve të ndryshme duke bërë veprime fizike shumë të ndërlikuara gjatë kësaj gjendjeje. Përgjithësisht konsiderohet se veprimi fizik në këtë rast vije si pasojë e ndonjë ndodhie nga ëndrrat. Por kërkimet rezultojnë se somnambulizmi nuk ndodh në kohën e gjumit të fazës REM ku, siç u tha, lëvizjet e trupit janë shumë të kufizuara, por në fazën e stadiumit të dytë.

Dr. Natanijel Kleistman nga Çikago, qysh para 40 vitesh kishte vërejtur se njerëzit derisa flenë, i lëvizin kokërdhakët e

syve dhe në qoftë se i zgjojmë gjatë kësaj kohe (fazës REM) do të deklarojnë se të gjithë kanë qenë duke ëndërruar. Sot është pranuar mendimi se lëvizjet e syve gjatë fazës REM do të thotë se ne me të vërtetë shikojmë përreth në ëndërr. Lëvizja e syve, madje ndodh edhe tek personat e verbër që nga lindja, ëndrrat e të cilëve konsiderohet se janë vetëm ëndrra të të prekurit dhe të shijuarit.

PSE ËNDËRROJMË?

Megjithatë, ende mbetet pyetja: Pse ëndërrojmë? Natyra e ëndërrimeve ende është një mister, edhe pse ato ekzistojnë dhe të gjithë ëndërrojmë. Disa njerëz pohojnë se kurrë nuk ëndërrojnë, por të gjitha faktet shkencore e vërtetojnë të kundërtën. Njerëzit të cilët mendojnë se „nuk ëndërrojnë”, në të vërtetë, vetëm i harrojnë ëndrrat në çastin e zgjimit. Harresa e ëndrrave është normale siç i harrojmë edhe shumë gjëra e ngjarje nga përditshmëria jonë, nga jeta jonë, sepse nuk kemi kohë as mundësi që t’i kujtojmë të gjitha. Në ëndërr, si dhe gjatë gjendjes së zgjuar, ne zgjedhim atë që ka ndikim më domethënës për ne, pra zgjedhim atë çfarë dëshirojmë ta kujtojmë. Mundohemi të mbajmë mend ëndrrat e rëndësishme dhe me përshtypje të pashlyeshme, ndërsa harrojmë ato të pakuptimtat, ose të cilat në shikim të parë duken si të tilla dhe ato që i konsiderojmë si të padëshiruara.

Edhe pse gjatë viteve të fundit është arritur në zbulimin dhe njohjen e asaj që ndodh gjatë ëndërrimit, ekspertët vazhdojnë të diskutojnë edhe më tej në këtë drejtim. Megjithatë, njëra ndër përgjigjet në pyetjen - pse ëndërrojmë, do të ishte: „ëndërrojmë që të mund ta mbajmë baraspeshën mentale dhe emotive”.

H. Xhekson (1855 - 1911) vërteton se gjumi na mundëson që t’i fshijmë ato ndjeshmëri të ngjarjeve të ditës, të cilat nuk jemi të gatshëm t’i mbajmë në tru, dhe t’i regjistrojmë ato që i

konsiderojmë më të rëndësishme për ne. Pra, t'i ruajmë ato që na nevojiten gjithnjë, dhe t'i fshijmë ato të cilat nuk na nevojiten më. Esencialisht pranohet mendimi se ëndrrat janë të lidhura me baraspeshën dhe jobaraspeshën në jetën tonë emotive dhe se ato shprehin dhe komentojnë gjendjen tonë të vetëdijshme emotive nëpërmjet simboleve. Kështu, psikologët dhe psikiatrit nëpërmjet hulumtimeve të ëndrrave tona, mund të na tregojnë shumë rreth karakterit tonë. Duke u marr me analizimin e ëndrrave, hulumtuesi i shquar Sigmund Frojd, konkludoi se ëndrra është rruga mbretërore kah nëndija. Deri në botimin e veprës së tij, „Interpretimi i ëndrrave", ëndrrat janë konsideruar si paraqitje pa kuptim, të ngacmuara nga tronditjet e brendshme ose të jashtme.

Frojdi, ndër të parët, vëren se ëndrrat mund të interpretohen në mënyrë shkencore dhe kështu i futi ato në shkencë. Me këtë praktikisht fillon zhvillimi edhe thellimi i kërkimeve psikoanalitike të nëndijes - psikanalizës e cila, sipas Frojdit, zë dy të tretat e personalitetit të njeriut. Edhe K. G. Jungu u pajtua me këtë se ëndrra është rruga mbretërore për nëndije dhe se gjuha e saj është simbolike. Bazat funksionale të ëndrrave, sipas tij, nuk janë vetëm zbulimet e dëshirave tona të brendshme por, para së gjithash, tentime të nëndijes sonë për të vendosur baraspeshën psikike.

Megjithatë, mesazhet nga ëndrrat nuk duhet të na befasojnë. Një ditë, shpresojnë studiuesit, kërkimet në mekanizmin e ëndrrave dhe në natyrën e gjumit do të na zbulojnë hapësirat e brendshme të diturive tona. Megjithatë, ende nuk është e lehtë të kuptojmë pse mesazhet të jenë të shifruara në figura, të cilat

shpeshherë janë të pakuptimshme. Por, ndoshta nuk është fjala për atë se nuk mund t'i kuptojmë, por se nuk dëshirojmë t'i kuptojmë! Ndonjëherë supozojmë se mesazhet janë të rëndësishme e ndonjëherë na vije mërzi t'i deshifrojmë ato. Ky është një veprim i gabuar. Ëndrrat burojnë (ose duket se burojnë) nga thellësitë e shpirtit tonë andaj, dëshirojmë ne apo jo, gjatë ëndërrimeve ne bisedojmë me vetveten dhe do të ishte mirë që ato komunikime t'i dëgjojmë dhe t'i deshifrojmë.

ÇFARË NDIKON NË GJUMIN TUAJ?

1. Që të jemi në formë duhet të flemë së paku 8 orë.

E gabuar - Ka persona të cilëve u mjaftojnë vetëm 4 orë gjumë, por ka edhe të tjerë, të cilëve u duken pak edhe 12 orë. P.sh. Edisoni ka fjetur rreth dy orë, N. Bonoparta rreth 5 orë ndërsa Ajnshtajni 10 orë etj. Secili duhet të fle sipas nevojës që ia kërkon organizmi.

2. Mund të jem shumë i hershëm ose edhe „zog i natës".

E saktë - Njerëzit e „ditës", ata që bien herët në gjumë (para orës 22) edhe zgjohen herët, ndërsa ata të „natës", që rrinë vonë, flenë deri në drekë, por mund të rrinë zgjuar gjatë gjithë natës.

3. Gjumi i orëve të mëngjesit (pas orës 7) na mundëson kthjelltësi psikike e fizike më të mirë.

E gabuar - Gjumi i mëngjesit përshkohet nga faza REM (në të cilën ëndërrohet), përderisa ka pak gjumë të thellë. Prandaj është më mirë të ngrihemi herët e të pushojmë pastaj pak pasdite.

4. Sa më shumë që të flemë aq më të lodhur ndihemi.

E saktë - „Dehja nga gjumi", si thonë amerikanët, e ndryshon ritmin e orës biologjike.

5. Edhe kur është shumë e dobët, zhurma e dëmton kualitetin e gjumit.

E saktë - Studimet kanë rezultuar se edhe zhurma më e vogël e zvogëlon numrin e orëve të gjumit të thellë dhe ndikon në rritjen e numrit të zgjimeve.

6. Ngjyrat kanë efekte ndikuese në gjumë.

E saktë - Mbulesat me ngjyrë të kuqe asnjëherë nuk e kanë penguar ndonjë gjumash që të thellohet në gjumë, por kjo nuk vlen edhe për personat nervoz. Ata duhet t'u ikin ngjyrave agresive dhe të përcaktohen për ngjyra të shndritshme.

7. Një filxhan kafe pas darke çrregullon gjumin.

E saktë dhe e gabuar - Kofeina (e cila gjendet në përmasa të caktuara në çaj, çokollata, Coca-Cola, kafe etj.), kur merret në sasi më të madhe rezulton edhe me efekte shqetësuese, mirëpo një filxhan kafeje përmban sasi shumë të vogël të saj saqë nuk ka efekte anësore. Gjithashtu, këtu luan rol edhe ndjeshmëria e individit.

8. Ankthi të mundon gjatë gjumit.

E saktë - Ankthi, që paraqitet rrallë gjatë fazës së gjumit të thellë, bënë që të zgjohemi të shqetësuar dhe të djersitur, me pulsin e shqetësuar dhe me pak kujtesë për atë që ka ndodhur. Ndërsa ankthi, që paraqitet më shpesh gjatë fazës REM të gjumit, ka si pasojë shqetësimin, pothuajse përgjatë gjithë ditës.

9. Ai që fle shumë është depresiv.

E gabuar - Pjesën më të madhe të depresionit e karakterizon pagjumësia e natës (posaçërisht zgjimi i hershëm) dhe lodhja e mëngjesit. Personi depresiv qëndron gjatë në krevat, jo për të fjetur e për t'u çlodhur, por aty ndihet më i sigurt.

10. Për gjumë të rehatshëm duhet ta kthejmë krevatin kah veriu.

E saktë - Studimet amerikane kanë rezultuar se atëherë shtypja është minimale ndërsa gjumi më i thellë.

11. Alkooli e ndihmon gjumin.

E gabuar - Në fakt, përshtypja është e tillë sepse më shpejtë flemë, por në të vërtet gjumi është i çrregulluar dhe

numri i zgjimeve është shumë më i madh.

Ç'ËNDËRROJNË FËMIJËT?

Sipas dr. V. Vadoviq dhe dr. V. Puden, punëtorë shkencorë në Qendrën për Sëmundje Mentale në Zagreb, fëmijët, ëndrrat e tyre i interpretojnë vetëm pas moshës 5 vjeçare. Kjo ndodh për arsye se deri në atë moshë, ata nuk mund t'i dallojnë ëndrrat nga realiteti. Ekziston mendimi, siç e pohon edhe Frojdi, se në fëmijërinë e hershme ëndrrat në mënyrë të drejtpërdrejtë i përmbushin dëshirat. Megjithatë, shumica e ekspertëve pajtohen me mendimin se edhe në fëmijërinë e hershme paraqiten ëndrra të frikshme, pas të cilave fëmija ndihet i shqetësuar. Konsiderohet se ego-ja e fëmijës zhvillohet ngadalë e më të rritet edhe censura e ëndrrës ndaj dëshirave të ndryshme te nëndija e fëmijës. Kurse kah vitet e pesta të jetës, fëmijët kanë gjithashtu shumë shpesh ëndrra të pakëndshme, me skena sulmesh ku dominuese është frika nga shpirtrat, lugetërit,

përbindëshit, hajdutët etj., të cilët në ëndërr dëshirojnë ta rrëmbejnë fëmijën. Të gjitha këto paraqitje janë në funksion të zhvillimit të psikes së fëmijës dhe janë normale për kohën e caktuar.


Sabir
Krasniqi

MAGJIA

ESENCA E MAGJISË

Magjia (që nënkupton mrekulli, çudi etj.) është tërësi veprimesh që bëhen përmes lëvizjeve të sendeve ose përmes fjalëve, lutjeve etj., e të cilat kanë fuqi të ndikojnë mbi njerëzit dhe dukuritë e natyrës. Pra, thënë shkurt, magjia është aftësi e pazakonshme, që ka dikush, për të ndikuar tek tjetri, individualisht apo në mënyrë kolektive.

Sipas mësimeve të hermetizmit, jeta është një dhe e pandarë, por format në të cilën ajo paraqitet janë pambarimisht të shumëllojshme dhe të ndryshme. Materia, energjia dhe jeta janë tri shikime të manifestimit ekzistencial. Nuk ka materie të vdekur. Ndarja e botës në materie të gjallë dhe të vdekur është koncept i gabuar. Pasi nuk ka materie të vdekur atëherë nuk ka as materie të palëvizshme. Sakaq, çdo lëvizje është jetë, kështu që i gjithë universi fizik vibron në jetë. P.sh.: a është plumbi materie e vdekur? Në shikim të parë duket se po, por në formën e jashtme të pandryshueshme, ç'thuren energji të jashtëzakonshme të atomit. Elektronet, duke lëvizur në rrethe dhe në mënyrë harmonike rreth bërthamës (protonit) me shpejtësinë e tyre të madhe, paraqesin ngurtësinë e metalit të plumbit. Në mes të këtyre lëvizjeve të vazhdueshme, të afrimeve dhe të dëbimeve të pjesëve të materies, ekziston harmoni universale dhe e plotkuptimshme.

Të gjitha format e jetës u janë nënshtruar ligjeve të

evolucionit, gjithçka lëviz drejt formës më të lartë dhe më të përsosur të ekzistencës. Synimi i natyrshëm i njeriut për deponimin e përpjekjeve për zbulime (në mikrokozmos) paraqet pasqyrimin e ligjit të përgjithshëm të evolucionit (në makrokozmos). Ato lëvizje, thënë shkurtimisht, janë përparime kah format më të larta dhe më të përsosura të dijës.

Në traditat e hermetizmit në perëndim gjithçka është dije. Gjithçka që lëviz, që ekziston, që manifestohet në cilëndo mënyrë, përmban në vete dije spirituale.

Gjatë evolucionit, dija spirituale mbetet vazhdimisht e njëjtë dhe e pandryshueshme, ndryshon vetëm forma e jashtme e saj. Në universin fizik shkallën më të ulët të zhvillimit e përbën bota minerale.

Valët e materies, të përqendruara deri në shkallën e jashtëzakonshme të dendësisë dhe të izolimit, mbështjellin dhe bartin dijen në vete, dijen e cila u referohet strukturave të ligjshme dhe lëvizjeve harmonike të elektroneve.

Prandaj, evolucioni kozmik nuk mbaron me njeriun. Njerëzimi në tërësi përparon ngadalë dhe shkallë-shkallë. Sakaq, në spiralen kozmike ka forma më të larta të dijës, që thirren „dije kozmike” si: Satari, Samadhi, Mbidije etj. Ata njerëz që bëjnë përpjekje më të mëdha kah përsosmëria, mund të përparojnë më shpejt. Këtu vlen parimi i njëjtë, i cili vlen për lëvizjet mekanike të trupave – sa më e madhe shpejtësia, rezistenca duhet të jetë më e fortë. Pra, shpejtësia në tejkalimin e valëve të mosdijes dhe në mënjanimin e pengesave, varet nga rezistenca që haset në rrugën kah „uni” ynë i vërtet ose dija jonë spirituale.

Ky është qëllimi i evolucionit psikik: arritja kualitative e një shkalle të re të dijes dhe funksionimi i dëshirueshëm në atë nivel. Thënë me fjalë të tjera: qëllimi i evolucionit, kah anojnë të

gjitha disiplinat dhe mësimet hermetike, është shikimi tërësor në natyrën personale, në botën dhe në marrëdhëniet me to. Disa atë e quajnë „dije kozmike”, sepse në të nuk ekzistojnë kufij midis subjekteve dhe objekteve, andaj gjithçka ekziston dhe gjithçka është gjithçka. Pra, nuk ekziston objekt i izoluar, i cili vërehet dhe për të cilin mendohet. P.sh.: nuk ekziston vetëm gishti, gishti njëkohësisht është edhe dora. Dora është trupi e trupi është gjithë njerëzimi, e kaluara, e tanishmja dhe e ardhmja njëkohësisht.

Nga këndvështrimi i psikologjisë dinamike, kjo gjendje mund të shënohet si bashkim i të gjithë arketipave në kolektivitetin e dijes (Teoria e Jungut). Kjo gjendje është vështirë të përshkruhet ose të kuptohet, sepse është transcendentale. Ndoshta krahasimi më adekuat do të ishte krahasimi me orgazmën. Gjatë përjetimit të orgazmës humbin kufijtë midis objektit dhe subjektit. Njeriu nuk ka kurrfarë kuptimi në dije, por di gjithçka. Gjendje të ngjashme provokojnë edhe disa lloje drogash, por me efekt të shkurtër dhe me pasoja të dëmshme.

Këtu, pra, qëndron edhe esenca e magjisë. Mirëpo, edhe magjia, si çdo lloj tjetër i energjisë, është neutrale. Orientimi i veprimeve të saj përcakton qëllimin e paraparë. Prandaj, „Magjia e Bardhë” si rezultat ka produktin e së mirës në cilëndo mënyrë. Operimet e llojit të saj janë: shërimet psikike, lutjet, largimet e vetive të paqëndrueshme të karakterit, zhvillimi i aftësive mentale etj. Ndërsa, në krahasim me „Magjia e Bardhë”, „Magjia e Zezë” si rezultat ka produktin e së keqes.

Është interesant të cekim se shumë organizata që merren me „Magji të Zezë”, arsyetimin për ekzistimin dhe veprimin e tyre e gjejnë në moralin e kohës së re. E keqja, thonë ato, është universale. Në qoftë se ka Zot, Ai është personifikimi, si i të mirës ashtu edhe i të keqes, sepse bota është ashtu se e ka krijuar Ai!

HAJMALITË DHE TALISMANËT

Pa marrë parasysh se sa është njeriu materialisht i orientuar, dhe në jetën e përditshme i drejtuar kah mendimet e logjikshme, gjykimet racionale etj., prapëseprapë në thellësitë e shpirtit të tij fshihet një dozë e misteriozitetit.

Njeriu modern me admirim ndjek zhvillimet gjigante të shkencës dhe nuk pranon, ose nuk do të pranojë, kurrfarë dukurish transcendentale, edhe pse ato ndonjëherë janë mjaft bindëse. Kjo, megjithatë, nuk i pengon atij që edhe sot, si para disa mijëra vitesh, të lidhet ngushtë me disa dukuri të cilat, në biseda formale, vlerësohen si marrëzi supersticioze (besime të kota). Dallimi qëndron në atë se këto dukuri më herët ishin të njohura dhe të pranuara, kurse sot njeriu i „intelektualizuar" turpërohet nga vetvetja për to e të mos flasim se si do të dukej në sytë e të tjerëve. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, po ky njeri i shekullit XXI ende me xhelozi ruan shaminë, unazën, zinxhirin, fotografinë apo imtësi të tjera, të cilat ia dhuron ndonjë familjar, ndonjë mik, ndonjë shok, apo edhe dashnori/ja, për t'i sjellë atij, kujtim, fat, disponim, dashuri, lumturi etj.

Të gjitha këto imtësi janë të njohura me emrat: hajmali, amulet, talisman etj. Hajmalitë kanë për qëllim që personin përkatës ta ruajnë nga të këqijat, fatkeqësitë, sëmundjet; t'i sjellin fat, lumturi, dashuri etj. Krejtësisht është e parëndësishme se çfarë është ky send - a është ndonjë simbol, pjesë e rrobave, qime floku, stoli ari, thua, gurë i çmuar, lodër fëmijësh ose diçka tjetër. Kryesorja është se me çfarë qëllimi i është dedikuar

personit përkatës.

Shpesh na ndodh që ndonjë send, i blerë nga personat, të cilët kanë qenë të detyruar nga nevoja e jetës ta shesin atë, ta zëmë: orë, pallto etj., të na sjellë pengesa të ndryshme në jetën e përditshme, në punë ose të na humb fare. Për këtë arsye, shumë njerëz edhe nuk blejnë gjëra të tilla, pavarësisht nga çmimi i ulët i tyre; sepse i konsiderojnë si gjëra „ters".

Populli këtë dukuri e njeh dhe e çmon, sepse në shumë vendime të veta shërbehet më shpesh me instinkte të lindura se sa me kuptimin dhe logjikën.

Me zhvillimin e kulturës materialiste dhe të civilizimit bashkëkohorë, këto instinkte të lindura gjithnjë e më shpesh lihen në prapavijë. Është dukuri shumë e vjetër dhe me arsye psikologjike që gjatë shitblerjes së tokës ose të ndonjë gjëje tjetër, të shtrihet dora dhe të thuhet: „Hallall të qoftë!" Kjo fjali ka forcë të madhe magjike (psikologjike), sepse me fat dhe terse ndeshemi gjithkund, në çdo hap. Në natyrë asgjë nuk ndodh rastësisht, e as kjo, për të cilën u fol më lart. Së këndejmi, duke filluar nga hajmalitë e ndryshme e deri te gjërat më të llojllojshme që i përdorim gjatë jetës së përditshme, çdonjëra nga to e ka fatin e vet, historinë e vet dhe secili send, në rrethana, po e quaj magjike, mund të ndikojë.

Në botë gjithçka lëvizë. Asgjë nuk është e qetë. Lëvizja është relative, qetësia vetëm në dukej relative. Relative është gjithashtu, gjithçka që ne perceptojmë nëpërmjet shqisave tona, kurse absolute është vetëm ajo që mund ta kuptojmë me ndodhitë e drejtpërdrejta mistike. Pikërisht për këto arsye, pasi shqisat tona na mashtrojnë pandërprerë, bota e jashtme na paraqitet në këtë apo atë trajtë, kështu që dukuritë natyrore nuk mund t'i definojmë dhe sqarojmë në esencën e plotë të tyre. Duhet të pranohet se shkenca, dhjetëvjeçarëve të fundit, është larguar nga këto dukuri dhe sado që përpiqet të gjejë shkakun e fundit, pas secilës „zgjidhje" të re të problemit, lajmërohen me qindra enigma të reja.

Njeriu, gjithnjë e më shumë po largohet nga ajo që është themelore dhe më e rëndësishme, që të humb në labirintin sekondar të pakuptimtë të gjërave. Sot e dimë se secila pjesë e materies nuk përbëhet vetëm nga molekulat dhe atomet, si pjesë përfundimtare e më të imta të saj, por se edhe secili atom për vete duhet të konsiderohet si një botë e veçantë. Fjala „atom", që në greqisht do të thotë „i pandarë", nuk është më e qëndrueshme. Atomi përbehet edhe prej protoneve, elektroneve, neutroneve dhe grimcave më të imta, të cilat ndërtojnë kuarket (Kuarket paraqesin pjesë të energjisë së kuantizuar, që oscilojnë në hapësirë). Marrëdhëniet midis tyre, pozicioni dhe lëvizja i përngjajnë Sistemit Diellor në miniaturë. Është llogaritur se protoni pozitivisht i elektrizuar ka diametrin i cili është disa miliona herë më i vogël se milimetri, ndërsa elektronet e ngarkuara negativisht, që në shtigjet e përcaktuara rrotullohen rreth tij, janë edhe 1800 herë më të vogla. Sipas kësaj, atë që shqisat tona e perceptojnë si materie të ngurtë, ajo në realitet krijohet nga një sërë vrimash, në të cilat materia pothuaj as që vjen në konsideratë. Këto mes-hapësira paraqesin një fushë të posaçme të energjisë rrezatuese, e cila rrjedh nga lëvizjet e elektroneve. Rezultatet e fundit shkencore, veçanërisht ato në fushën e fizikës kuantike lidhur me dekompozimin e atomit, kanë rëndësi të posaçme për t'u kuptuar më mirë rrezatimet e ndryshme. Këto kërkime të reja na argumentojnë se gjëra „të vdekura", në kuptim të plotë të kësaj fjale, as që ka dhe se secila pjesë dhe secili lloj i materies ka zhvillim të posaçëm të jetës, i cili është i varur nga veprimet dinamike të energjisë së gjithëmbarshme të natyrës.



Ngase të gjitha gjërat u janë të nënshtruara lëvizjeve të

pandërprera të grimcave, ato pranojnë dhe emetojnë energji si dhe ndikojnë reciprokisht në rrezatime të shumëllojshme, kështu që edhe gjërat e vdekura janë në gjendje që t'i thithin rrezatimet e rrethit, atë energji të absorbuar ato mund ta mbajnë, ta transformojnë dhe, në rastet e dhëna, ta emetojnë.

Energjia e gjithëmbarshme natyrore përshkon në masë më të madhe ose më të vogël gjithçka që ndodhet në natyrë, pavarësisht në janë qenie të gjalla apo të vdekura. Flora dhe fauna në tërësi si dhe bota minerale në pjesët e veta më të imta, paraqesin ndërtim dhe parim të njëjtë të ndikimit. Vetëm nga numri i radhitjeve, distancës në mes vete dhe shpejtësisë së rrotullimit të elektroneve rreth bërthamës qendrore në atom, varet se a do të kemi para vetës bakër, ar, natrium, karbon apo ndonjë element tjetër, kështu që gjatë diferencimit të mëvonshëm, nën ndikimin e faktorëve të shumët, arrihet deri te materia organike. Gjithashtu, në këtë vijë, ligjeve të njëjta të natyrës iu nënshtrohen edhe materiet organike edhe ato inorganike. Pasi që çdo ndodhi dhe çdo proces natyror është i bashkuar në mënyrë të pashmangshme me pranimin dhe emetimin e energjisë, kështu që çdo send, në dukje i vdekur (ku bëjnë pjesë edhe hajmalitë dhe talismanët) detyrohet t'i nënshtrohet, më shumë a më pak, ndikimit të asaj energjie me të cilën vjen në kontakt. Objekti përkatës (pra edhe hajmalitë dhe talismanët) mbushet, ngarkohet me sasi të mjaftueshme nga ajo energji, ndikimit të së cilës i është ekspozuar. Ajo energji (e bartur) mund të mbetet latente, por në rrethana të caktuara dhe në kushte të volitshme, mund të transformohet dhe të bëhet aktive, siç ndodh në rastet e operacioneve të ndryshme magjike.

Personat sensibilë, gjatë kontaktit me gjëra të tilla, janë në gjendje që atë energji të akumuluar të atij objekti ta shndërrojnë

në paraqitje vizuale dhe në këtë mënyrë, nëpërmjet „shqisës së gjashtë”, ta lexojnë apo ta shohin gjithë historikun e tij. Sot, në kohën e zbulimeve të ndryshme elektronike, këto dukuri nuk duhet të na duken të çuditshme apo fantastike. Në mënyrë të njëjtë, sikurse energjia e emetuar përmes radio valëve apo valëve e formave tjera rrezatuese që barten nëpër eter, që në radioaparatet pranuese të shndërrohen në zë, fotografi, dritë etj., po kështu edhe truri ynë mundet që në rastet e volitshme të shërbejë si psikodetektor, i cili në vetëdijen tonë, energjinë e pranuar mund ta shndërrojë në ndjenë, përfytyrim, zë, fotografi etj.

Të gjitha dëshirat dhe mendimet tona paraqesin energjinë, e cila aq sa është e fortë, po aq nxit ndjeshmëri të pastër dhe të fortë. Por, në qoftë se ato janë në konflikt mes veti, gjithsesi vjen deri te disharmonia dhe atëherë edhe rrezatimet e tyre do të jenë të parregullta dhe të shkëputura, ashtu që edhe në rrethinë do të ndikojnë në mënyrë antipatike.

Tempoja e jetës sonë është shumë e shpejtë, automatike dhe e ngarkuar me mendime materialiste, saqë njeriu sot as që e konsideron të nevojshme që edhe kujdesin më të vogël t’ia kushtojë asaj që nuk përputhet me mënyrën e rëndomtë të të kuptuarit dhe të gjykimit të tij. Megjithatë, në qoftë se dikush, i shtyrë nga vullneti i tij i mirë do të mundohet që në këto dukuri „irracionale” të jap pak dritë e kuptim, atëherë në mënyrë të çuditshme do të hasë në mungesë të madhe tolerance dhe në gjykime abuzuese të masës, saqë gjithsesi do të jetë i detyruar të tejkalojë dëshirën e vullnetin e vet për punë të mëtutjeshme.

MAGJIA E BARDHË DHE E ZEZË

Ky nocion, që e ka një të kaluar shumë të largët e që përdoret edhe sot e kësaj dite në mbarë rruzullin tokësor, interpretohet në mënyra nga më të ndryshmet dhe zakonisht

merret si sinonim i së keqes, e që në fakt nuk është plotësisht e vërtetë. Magji do të thotë: mrekulli, çudi, aftësi e jashtëzakonshme që ka dikush për të ndikuar tek tjetri etj., e sipas Franc Bardonit ajo konsiderohet edhe si shkencë e shenjtë.

Siç dihet, në natyrë gjithçka rrezaton. Njeriu si qenie më komplekse ka llojin e veçantë të rrezatimit. Rrezatimi, sipas parimit të përgjithshëm të antipolaritetit, mund të jetë pozitiv ose negativ, tërheqës ose dëbues, i mirë ose i keq etj. Gjithashtu, rrezatimet varen edhe nga shkalla e zhvillimit të jetës shpirtërore të personit. Mendimet, dëshirat, ndjenjat tona paraqesin burim shumë të madh të energjisë rrezatuese. Në qoftë se jeta jonë shpirtërore është e drejtuar në një drejtim të caktuar, atëherë edhe rrezatimet përkatëse kanë karakterin e vet të caktuar. E në qoftë se në të kundërtën, u nënshtrohen labiliteteve të ndryshme, atëherë edhe rrezatimet pasuese do t'u nënshtrohen oscilimeve të përhershme dhe dobësimit të tyre.

Drejtimi i caktuar i mendimeve (energjisë psikike), i drejtuar qoftë për të mirë ose për të keq, në qoftë se ka karakter stabil formon rrymë të fortë psikike e cila rrezaton në rreth. Simpatia ose antipatia, dashuria ose urrejtja... janë pasojë e këtyre rrezatimeve mentale.

Kjo energji psikike, sikurse çdo lloj tjetër i energjisë, është neutrale: as e mirë as e keqe, i mirë ose i keq është përdorimi i saj. Te dyja këto komponente e ndjekin njëra-tjetrën. Sikurse nata që në mënyrë të pashmangshme ndjek ditën, po kështu edhe e mira zëvendëson të keqën në çdo hap. Dallimi qëndron vetëm në kuptimet individuale, sepse derisa diçka në sytë e dikujt është e mirë, për tjetrin ajo mund të ketë kuptim negativ. Parimi i përgjithshëm natyror formohet nga e mira, ndërsa e keqja është prodhim i mospranimit të së mirës. Këtu pra qëndron edhe esenca e magjisë.

Vetëm ai individ, që ka arritur ta njohë vetveten, i cili e ka transparent mendimin dhe esencën e jetës si dhe me ushtrime të gjata dhe të mundimshme, mund të arrijë të përqendrojë gjithë

forcën e vet psikike dhe ta përkryejë deri në atë masë mendimin saqë qëllimisht dhe vetëdijshëm ta përdorë me qëllim që t'i shërbejë së mirës ose së keqes. Dhe kur kjo energji përdoret me qëllim t'i shërbejë së mirës quhet „Magji e Bardhë" ndërsa, kur përdorët me qëllim t'i shërbej së keqes, quhet „Magji e Zezë". Te dyja këto paraqesin dy ekstremet, të cilat luftojnë në mes veti deri në shfarosje.

Në fushën e „Magjisë së Bardhë" vihen në dukje, në rend të parë, lutjet e ndryshme në të cilat: dëshira, besimi, dashuria, dhe shpresa e përqendruar veprojnë në mënyrë magjike, por edhe operime të tjera si: shërimin e problemeve psikike, largimet e vetive të paqëndrueshme të karakterit, zhvillimin e aftësive mentale etj. Kështu pra, secili mendim në qoftë se është i pastër, intensiv dhe stabil, ka tendenca që të realizohet. Në qoftë se në këtë bindje ekziston edhe besimi i patundur se ajo do të plotësohet dhe se dëshira e caktuar do të realizohet, atëherë veç janë të plotësuara kushtet kryesore që të vijë deri te realizimi i qëllimit. Gjithashtu edhe lutja a ndonjë dëshirë tjetër në përgjithësi, ne qoftë se është mjaft e fortë dhe e emituar me bindje të plotë, mund të realizohet.

Po të shikohen zakonet e popullit do të vërejmë se ato janë të mbushura me rituale magjike. Edhe pse këto rituale datojnë që nga lashtësi, edhe sot e kësaj dite janë shumë aktuale dhe praktikohen me shumë fanatizëm, e të cilave nuk mund t'iu shmanget as njeriu i kohës moderne. Në ato rituale dihet saktësisht secili veprim, si dhe kush duhet ta bëj!...

Për rituale magjike, te të dyja kaheve, zakonisht përdoren elementë të ndryshëm që janë në lidhje me personin ose grupin e caktuar, e në veçanti, pjesë të trupit dhe të rrobave. Duhet të cekim se të gjitha sekrecionet, si: jashtëqitja, urina, djersa, por edhe thonjtë, flokët, dhëmbët e sidomos gjaku e sperma, pas ndarjes, mbesin në gjendje okultike në raport me trupin nga i cili e kanë prejardhjen pasi ato përmbajnë energjinë rrezatuese të po atij trupi.

Edhe sot nuk është rast i rrallë kur dy shokë priten ose shpohen në gisht, apo pjesë tjetër të trupit, që pastaj njëri-tjetrit t'i pinë disa pika gjak. Konsiderohet se kjo mënyrë krijon lidhje të drejtpërdrejta të gjakut e cila mban dhe shoqëron miqësinë si dhe mundëson afrimin shpirtëror. Ritualet magjike mund të kryhen edhe me anë të fotografisë. Është e ditur se popujt primitivë nuk fotografoheshin, sepse konsideronin se fotografia iu merrte një pjese të shpirtit.

Këto dukuri nuk duhet vetëm t'i shënojmë, por edhe t'u gjejmë kuptimin e tyre që të mos i lëmë të interpretohen nga populli në mënyre tejet të cekët, duke u bazuar vetëm në fakte fetare, por të gjejmë esencën e vërtetë të tyre në bazë të ligjeve themelore të jetës. Të marrim vetëm një rast nga zakonet e martesës. Nëpër fshatra, diku edhe në qytet, ku jeta modeme ende nuk ka arritur t'i shlyejë botëkuptimet e vjetra patriarkale, rëndësi e posaçme u kushtohet dokeve dhe zakoneve tradicionale. Dihet saktësisht se si dhe në ç'mënyrë duhet të shkojë nusja; me cilën këmbë ta kalojë pragun, si të shërbehet, si t'i përshëndesë të pranishmit e shumë veprime tjera.

Sikurse „Magjia e Bardhë”, që operon me veprime

shumëdimensionale në shërbim të së mirës, po ashtu edhe „Magjia e Zezë” operon me shumëllojshmëri ceremonish, rrjedhash e kahesh për orientimin e mendimeve. „Magjia e Zezë” ka për qëllim që të prishë dhe të shkatërrojë gjithçka që është lartësuar si e bukur dhe si e mirë, ashtu që e keqja të triumfojë mbi të mirën. Veprimet e individit, që praktikon „Magjinë e Zezë”, janë të lidhura ngushtë me interesat materiale dhe plotësimin e motiveve nga sferat më të ulëta shpirtërore e sidomos asaj seksuale nëpërmjet së cilës, pasionet e shfrenuara, duhet të gjejnë kënaqësi. I lidhur për këto veprime të llojit më të ulët, ai gjen kulmin e kënaqësisë në dhimbjet e huaja. Nderi, dinjiteti, dhembshuria, keqardhja... janë ndjenja të cilat qysh në fillim i shuan në vete. Magjitë e zeza është shumë vështirë të zbulohen! E para - ato kamuflohen shumë mirë dhe e dyta - njeriu modern u jep atyre fare pak rëndësi.

Pamje nga një ritual i “magjisë së zezë”

Siç e thamë, çdo send që vjen në kontakt me ndonjë person, mbushet me një lloj subtil të energjisë së tij, energji kjo, që mbetet edhe më tej në lidhje okulte me personin e caktuar. Aq më i fortë është ndikimi, nëse kemi në dispozicion ndonjë pjesë të trupit, të rrobave apo fotografi të tij. P.sh., tek rasti i „Magjisë së Zezë”, marrim një fotografi të personit që e urrejmë dhe në këtë fotografi, me një gjilpëre, i shpojmë sytë, zemrën ose ndonjë pjesë tjetër dhe njëkohësisht drejtojmë gjithë urrejtjen tonë në drejtim të tij. Nga kjo energji krijohet një rrymë e fortë psikike e cila do të ndikojë shumë dëmshëm në atë person, të cilit i është drejtuar kjo urrejtje. Ai ndikim i dëmshëm mund të shfaqet në formë të sëmundjes, pakënaqësisë apo të shqetësimeve të ndryshme psiko-fizike. Kjo, siç u tha më lart, varet në radhë të parë nga forca e mendimit dhe nga bindja, që si urrejtje e përqendruar orientohet kah personi i caktuar. Por,

duhet të kemi parasysh se ky sukses varet shumë edhe nga gjendja përkatëse shpirtërore e personit të sulmuar. Për të qenë efektiv dhe i suksesshëm ky emetim, personi i sulmuar duhet të ketë gjendje të njëjtë, apo të përafërt, shpirtërore me sulmuesin, respektivisht me atë që transmeton urrejtjen dhe të mos jetë nën mbrojtjen e masave adekuate.

Në lidhje me operimet e ndryshme magjike, të cilat në esencën e vet bazohen në aktivizimin e energjisë psikike, duhet sidomos të theksojmë se suksesi i një rituali të tillë është ngushtë i lidhur me kualifikimin moral, si të personit që operon me këtë lloj energjie, ashtu edhe të atij kundër të cilit është drejtuar energjia. Duhet gjithnjë të kemi parasysh se mendimet kanë bazën e vet reale dhe që forca dinamike e tyre është shumë e madhe. Njëlloj sikurse te radio-valët, mendimi mund të rrezatojë më fort ose më dobët, varësisht nga fuqia e energjisë me të cilën janë të përcjella. Në qofte se emetimi është më i fuqishëm, edhe radio-valët do të transmetohen më larg dhe dëgjimi i tyre do të jetë më i mirë. Në qoftë se mendimi është intensiv, edhe veprimi i tij do të jetë më i fuqishëm.

Sot secili e di se radio-valët në aparatet pranuese shndërrohen në zë. Por është gjithashtu e njohur se ajo energji rrezatuese mund të shndërrohet edhe në forma tjera. Me ndihmën e radio-valëve mund të ndizen dritat me qindra kilometra largësi; ose të kontrollohen automjetet, anijet, aeroplanët etj. Me rëndësi është ta kemi parasysh se mendimet kanë veprimin e anasjelltë të tyre i cili shfaqet në një mënyrë të veçante. P. sh.: në qoftë se kultivojmë ndjenja pozitive dhe ia drejtojmë dikujt, të përqendruara e të mbushura me dashuri, me dëshira të mira atëherë, te personi i caktuar, kjo energji e orientuar do të fuqizohet edhe më shumë, sidomos në qoftë se përputhet me vijën e njëjtë të mendimit të tij ose, ashtu e fuqizuar, të na kthehet ose do të zvogëlohet e dobësohet, nëse has në kundërshtim dhe detyrohet të hyjë në konflikt me anën e kundërt të rrezatimeve.

Me „Magji të Bardhe” dhe të „Zeze”, përveçse merren persona në mënyrë individuale, ekzistojnë edhe grupe të ndryshme (sekte) që merren në mënyre të organizuar e që kohëve të fundit janë në shtim e sipër, si në Amerikë ashtu edhe në Evropë.

Nga kjo mund të konsiderojmë se secili mendim i yni ka peshën e veçantë në krijimin dhe formimin e jetës sonë. Prandaj duhet t'iu kushtojmë rëndësi të posaçme mendimeve tona para se t'i pranojmë si reale dhe të formojmë bindjen tonë për rrethin, shoqërinë, artin, natyrën etj.

SIMBOLET

„Simboli është makinë psikologjike që transmeton energji”, - thotë Jungu. Simbolet dhe formulat janë afër kuptimit për logjikën e njeriut sepse ndikojnë mbi kuptimet tona nga fëmijëria. Sa më shumë që simboli është në përdorim dhe sa më i madh të jetë investimi emocional në të, aq më e madhe do të jetë vlera operative e tij.



Kur njeriu investon sasi të madhe të energjisë emocionale në simbole, ai simbol përmban karakteristikat e tij, dhe në një mënyrë bëhet pjesë e tij. Më kalimin e kohës paraqitjet simbolike marrin kuptim gjithnjë e më të madh dhe provokojnë reaksione emocionale më të mëdha. Mirëpo, simbolet universale kanë në bazën e tyre diçka nga parimet kozmike, të cilat nuk janë të kufizuara vetëm në racën njerëzore.

Simboli themelor është rrethi. Sipas këtij modeli zhvillohen proceset themelore mekanike, biologjike, elektromagnetike, psikike etj. Në rrugë rrethore shkojnë të gjithë trupat qiellorë,

elektronet, uji në natyrë, modusi i mendimeve shoqërore e shkencore etj. Për këtë arsye rrethi është simbol universal.

E gjithë forca e simboleve, pa marrë parasysh formën e tyre, qëndron në atë se sa kanë akumulim psikik të energjisë. P.sh. flamuri, si simbol kombëtar, ka forcë madhore sepse në të kanë investuar numër i pafund njerëzish energji tejet të madhe, kanë dhënë jetën për të me mijëra të tjerë duke ia drejtuar forcën, shpresën dhe besimin e vet të fundit këtij simboli. Të gjitha këto janë manifestime psikike dhe vetëm për këtë flamuri ka forcë të madhe magjike.

HERMETIZMI DHE NJERIU BASHKËKOHORË

Shkenca, si sistem më i ri për hulumtimin e së vërtetës, rëndësi kryesore u jep fakteve. Ajo përgjithësisht bazohet në frymën racionale e cila është mjaft e ngushtë në krahasim me kapacitetin e përgjithshëm që posedon qenia njeri.

Fusha e shkencës po zgjerohet çdo ditë e më shumë, me shpejtësi rapide, dhe fundi i zhvillimit të saj është i pamundur të parashihet. Mirëpo, kur shkenca dhe filozofia na denoncojnë, është plotësisht e arsyeshme që të mbështetemi në sisteme dhe forma tjera hulumtimi për ta kërkuar të vërtetën - sisteme dhe forma, që na mbushin hapësirën e zbrazët dhe na ofrojnë zgjidhjet e tyre përkatëse.

Diku në sferën ku gërshetohet shkenca, filozofia dhe religjioni, e gjen hapësirën e frymimit të vet tradita hermetike. Lidhja e saj me sisteme dhe forma tjera të mendimit njerëzor është më shumë e theksuar në Lindjen e Largët sesa tek ne (mendoj në Perëndim). Tradita e Lindjes së Largët është e pamundur të ndahet nga religjioni, filozofia dhe shkenca, sepse

është e lidhur dhe e gërshetuar në mënyrë të pandashme me to. Ne, në këtë pjesë të globit, deri më sot kemi pasur më pak përvojë, e natyrisht edhe më pak njohuri dhe fakte në këtë drejtim.

Kërkimi i çfarëdo vlere në punimet e alkimistëve si: Paracelzusi, Elifasi Levi, Papuasi etj. përmban në vete rrezik të madh që kolegët, por edhe të afërmit, të na përqeshin, të na proklamojnë si sharlatanë ose edhe të marrë, dhe t'na i mohojnë të gjitha vlerat, jo vetëm të lëndës që dëshirojmë ta hulumtojmë, por edhe motivet që na shtyjnë kah ajo. Për këtë arsye njerëzit vështirë vendosin për t'u marrë, së paku publikisht, me interesime të tilla.

Njerëzit që mendojnë se shkenca e kompjuterëve do t'i zgjidhë dilemat tona, mashtrohen shumë keq! Ata e shqiptojnë fjalën „shkencë" si të ishte ajo magjistare e gjithëmundshme e cila, sikur me shkop magjik, do t'i zgjidhë e shërojë problemet e shumta me të cilat përballet njerëzimi në vazhdimësi, siç janë: ndjeshmëria, traumat, urrejtjet, dhuna, konfliktet, vuajtjet etj. Por, përkundër faktit se ajo në këtë lëmi ka kontribuar shumë, megjithatë përparimi i shkencës dhe teknologjisë ka karakter të dyanshëm. Për anën e errët të saj, fanatikët nuk dëshirojnë as të mendojnë! Shkenca vërtet lehtëson dhe e bënë më atraktive jetën tonë, format elementare të saj, por nuk mund t'i zgjidhë dot dilemat që na preokupojnë. Bile, në shumë raste, ajo na bënë që t'i ndjejmë edhe më qartë ato.

Zbritja e kozmonautëve në truallin e Hënës krijoi botëkuptim dhe ndjenja të veçanta mbi forcën njerëzore, respektivisht për forcën e produktit të mendjes së tij - shkencës dhe teknikës. Por, pak kohë pas kësaj, njeriu filloi ta ndjejë

fuqishëm inferioritetin e vet, pasi u vetëdijesua për pafundësinë e gjithësisë.

Motivet reale të këtyre shprehive, në mënyrë vizionare, i lakuriqësoi psikologu i njohur, K. G. Jung, me fjalë të thjeshta por shumë kuptimplote: „Fluturimet kozmike janë thjesht ikje na vetvetja, sepse më lehtë është të arrihet në Hënë ose Mars, se sa të depërtohet në qenien personale, në unin tonë."

Synimi themelor i secilës qenie njerëzore është që të zhvillohet, të shprehet dhe të krijojë në cilëndo formë a mënyrë. Forca e tij krijuese është e pakufishme. Jeta e tij është shesh ku zhvillohen procese të panumërta emocionale, mendore e trupore. Dhe në qoftë se aktivitetet e tij janë të orientuara kah një qëllim i arsyeshëm, si dhe janë në harmoni me momentin, kohën dhe ambientin, atëherë çdo lëvizja e tij, çoftë e duarve, e gjuhës apo trupit, është krijuese.

Artet në përgjithësi janë pasardhëse të drejtpërdrejta të vezullimeve spirituale, që burojnë thellë në ne, të cilat nëpërmjet poreve të jashtme depërtojnë në hapësirën ndërnjerëzore dhe aty, po nga ne, bëhen të njohura.

LIGJI I HERMESIT

Hermesi është emër i greqizuar i perëndisë egjiptiane, Thoti, i cili konsiderohet pionier i shumë shkencave, posaçërisht i alkimisë e i shumë shkathtësive të tjera.

Nocioni „Hermetizëm" rrjedh nga greqishtja dhe ka kuptimin e diçkahi të mbyllët dhe të pakuptueshme, për shkak të gjuhës së vështirë ose të ideve e të figurave të paqarta.

Një ndër ligjet e hermetizmit është edhe ligji i analogjisë, ngjasimit ose Ligji i Hermesit.

Ligji i Hermesit thotë: „Si është lart, ashtu është edhe poshtë, e si është poshtë, ashtu është edhe lart". Një formulë shumë e thjeshtë, prapa së cilës fshihet një fushë shumë e gjerë e

përdorimit praktik.

Shprehja „si është poshtë, ashtu është lart”, në kuptim të parë do të thotë: „si është fotografia juaj psikike, ashtu është edhe në botën tuaj reale”. Fotografia që krijohet nëpërmjet imagjinatës kreative u takon planeve të ekzistencës, planeve të mendimeve (lart), ndërsa plani fizik, që është më i ulët, i takon planit material (poshtë).

Në qoftë se dëshirojmë të krijojmë diçka në botën materiale, duhet që së pari ta krijojmë atë në planin psikik. Duhet të formojmë përfytyrim të kthjellët dhe të qartë. Në atë moment që një gjë e krijojmë në imagjinatë, ajo tani më veç ekziston, por në botën e mendimeve. Në çoftë se bëhet mbushja e mjaftueshme e fotografisë së imagjinuar me energji (kjo do të thotë se sa më shumë energji emocionale dhe mendore të derdhim në të), për një kohë të caktuar, ajo do të kalojë nga plani mendor në atë material.

Elementet kryesore kozmike, pa njohjen e të cilave nuk mund të lidhemi me hermetizmin janë:

Shpata - simbol i elementit të ajarit;

Shkopi - simbol i elementit të zjarrit;

Kupa - simboli i elementit të ujit;



Simboli i ajrit

Simboli i zjarrit

Simboli i ujit



Simboli i tokës

Akasha

Monedha - simbol i elementit të tokës.

Nuk duhet t’i krahasojmë këto elemente kozmike me elementet reale në tokë, që mbajnë të njëjtin emër. Elementet kozmike: ajri, zjarri, uji dhe toka nuk janë fizike. Toka fizike, nëpër të cilën ecim, përbëhet nga humusi, gurët, rëra etj., pra, kjo është përzierje e elementeve kimike. Ose ajri, në planin fizik, përbëhet nga gazrat, tymi, avulli, grimcat e pluhuri etj.

Kur flasim për këto elemente, nuk mendojmë në elemente

fizike, por mendojmë në shfaqjet e energjisë universale kozmike. Pra, me energji kozmike nënkuptojmë mënyrën në të cilën shfaqet energjia e përgjithshme kozmike në universin dhe në njeriun.

Këto katër elemente kozmike nuk janë forca kozmike, por mënyra të shfaqjes në universin e pafund nga mijëra anë dhe përthyerja e tyre në dijen e njeriut, nga ana tjetër. Ato janë dukuri me të cilat forcat kozmike paraqiten dhe ndryshojnë, duke kaluar nga një gjendje në tjetrën.

Ekziston edhe elementi i pestë kozmik, nga i cili burojnë të gjithë elementet tjerë dhe quhet AKASHA. Për këtë element ka pak të dhëna. Ky element konsiderohet si element fillestar krijues. Akasha, thonë kaballistët, është diçka joekzistuese. Por si mund të jetë joegzistuese kur thuhet se ajo ekziston?! Përgjigja është në atë se ajo „diçka" ka plotësisht dimensione tjera në krahasim me botën tonë të mendimeve, të ndjeshmërisë dhe të realitetit material. Disa religjione Akashën e krahasojnë me Zotin.

Gjithçka që ekziston, si në univers, ashtu edhe në shpirtin e njeriut, ekziston në njërën nga gjendjet që i quajmë elemente kozmike. Gjithçka që është krijuar, që krijohet, kalon nëpër këto katër elemente kozmike. Këto katër elemente kozmike shfaqen te njeriu si katër procese psikologjike:

Ajri - lindja e ideve ose bota e mendimeve në vetëdije;

Zjarri - paraqitja e emocioneve. Ky është investimi i energjisë emocionale, zgjerimi i ideve origjinale në të gjitha drejtimet;

Uji - përmbledhja e dëshirave të flakta në një drejtim konkret;

Toka - shndërrimi i ideve në realitet: pra materializimi i

tyre.

Këtu qëndron edhe sekreti i sukseseve për realizimin e planeve dhe dëshirave të caktuar në secilën fushë.

MAGJIA SEKSUALE

Magjia seksuale është një ndër metodat më efikase, por edhe ndër më të vështirat. Kësaj dege të magjisë rëndësi dhe zhvillim të posaçëm i dha magjistari dhe okultisti i njohur Alister Krouli i cili, në shoqërinë që e formoi vetë O. T. G., e praktikoi në mënyre intensive. Problemi themelor i magjisë



është se si të mobilizojmë sasi më të mëdha të energjisë për realizimin e qëllimeve të caktuara. Mu për këtë qëllim u krijua magjia rituale e cila, si veprim psikologjik, e lartëson vetëdijen tonë në nivel të tensionit të lartë dhe atë nivel e mban një kohë të caktuar. Në parim të njëjtë funksionon edhe energjia seksuale.

Në këtë kontekst duhet të theksojmë se zgjimi më i madh i energjisë emocionale ndodh pikërisht gjatë orgazmës. Kjo gjendje është më së afërmi pragut të mbidijes. Shkarkimi i energjisë gjatë orgazmës është i shkurtër, por i fuqishëm dhe i qëndrueshëm. Ajo shkarkesë, si dhe gjendja emocionale që i paraprinë, shfrytëzohen si forca tepër të fuqishme të erupsionit shpirtëror të vetëdijes. Këto forca energjetike Jungu i quan „demonë”.

Kushtet më ë mira dhe forca më e madhe e energjisë është atëherë kur partnerët e kanë qëllimin e njëjtë. Në atë rast ata kanë kontroll mbi veten dhe kujdesen që periudha e kohës së aktit seksual të jetë sa më e gjatë, duke përjetuar njëkohësisht orgazmën, me përqendrim të përbashkët në cakun e tyre.

Gjatë marrëdhënieve seksuale duhet që me çdo kusht, pa ndërprerje, të mbahet imagjinata dhe të ruhet vetëdija për qëllimin kryesor. Të gjitha shqisat duhet të marrin pjesë në ndërtimin e formës astrale - mendore. Ndjeshmëria e kënaqësisë, që do të thotë aktivizim i energjisë emocionale, duhet të shfrytëzohet që me të të tejkalohet përqendrimi psikik, i krijuar me anë te fantazisë. E kjo nuk është vështirë, sepse energjia e zgjuar emocionale automatikisht drejtohet kah modeli astral i cili është formuar në mendime. Derisa energjia depërton në dije duhet fuqishëm të mbahet e fokusuar, në syrin shpirtëror, fotografia e zgjedhur.

Një ritual i magjisë seksuale

Siç e thamë më lart, sa më e gjatë të jetë periudha seksuale, aq më e fortë do të jetë energjia dhe më i sigurt do të jetë suksesi. Gjatë marrëdhënieve për kohë të gjatë (së paku 1-2 orë) arrihet deri te „kufiri i gjendjes së vetëdijshme”, i cili paraqet kalimin në mes të gjendjes së zgjuar dhe gjumit, kjo gjendje është e njohur në psikologji si gjendje hipnotike, kur njëra këmbë gjendet në prag të nëndijes, kurse tjetra është ende në dritën e vetëdijes.

Magjia seksuale është një ndër format e magjisë e cila më së shumti përdoret për shërbime negative, për ritualet e „Magjisë së Zeze” dhe, në këtë kuadër, është një nga metodat më të suksesshme.

MAGJIA NË VEPRIM

Operimet magjike për qëllime, zakonisht të errëta, nuk janë operime të kohës më të re. Bile në „civilizimin” e sotëm, ceremoni të tilla, mund të hasësh shumë rrallë. Në kohët më të

hershme aplikimi i „magjisë së zezë”, për qëllime të llojllojshme, ka qenë dukuri bukur e shpeshtë. Të cekim, sa për informim, se Asirët e vjetër (që kanë jetuar shekuj më parë, në Iranin e sotëm) si mbrojte nga ndikimet e „magjisë së zezë”, në pragjet e shtëpive të tyre, kanë futur figura qensh të punuara nga argjila, të bindur, se shpirti i qenit nuk do t’i lejojë forcat e errëta të depërtojnë në brendi të shtëpisë. Zbulimet arkeologjike kanë vërtetuar se nën pragje janë gjetur edhe deri më dhjetë figura të tilla. Dhe kjo formë mbrojtëse, të cilën Asirët mendohet se e kanë bartur nga Babilonasit, është përcjell edhe tek shumë civilizime pasuese si tek egjiptianët, grekët e vjetër, romakët etj.

Natyrisht, që kjo dukuri, nuk ka mundur të jetë e huaj as për popullatën shqiptare e as për paraardhësit tanë, Ilirët. Mirëpo në mungesë dëshmish, ne sot kemi pakë të dhëna për mitologjinë tonë, edhe pse mendohet se duhej të ishte mjaft e pasur edhe në fushën e mistikës. Janë të njohura shprehjet „syri i keq”, „lugati”, „hijet” etj., pas të cilave, gjithsesi, fshihet kuptimi për „satanin”, „demonin”, „fantazmat” etj.

Pothuajse nuk ka njeri që nuk ka dëgjuar për ndonjë rast, qoftë tek të afërmit, në lagje, fshat, qytet apo më gjerë, ku si pre e ndonjë ceremonie të „magjisë së zezë”, e aplikuar ndoshta edhe në format më primitive, ka pësuar dikush. Natyrisht, që këto forma veprimi nuk janë të pranueshme për të gjithë, por kjo pak ka rëndësi. Besimi dhe bindja janë çështje individuale dhe e drejtë e secilit njeri në botën „demokratike”, por ata fatkëqij që janë „takuar” ose „atakuar” nga këto „qenie të tmerrshme”, pra nga këto forca të errëta, mendojnë tërësisht ndryshe.

Shërbimet me porosi!

Megjithëse në shekullin 21 dhe, pavarësisht sesa e vlerësojmë apo nënçmojmë ne sot ekzistimin e forcës ndikuese të magjisë, akoma gjenden njerëz që e njohin sekretin e saj dhe të cilët janë të gatshëm, natyrisht për interes financiar, që shërbimet e tyre t’i vënë në dispozicion të të interesuarve. Me

ndihmën e „forcave të errëta”, ata besojnë në plotësimin e dëshiroava të klientëve, duke iu sjellë atyre, qoftë fat në biznes, dashuri etj., apo edhe për ta shkatërruar kundërshtarin, apo mallkuar personin e urryer duke i sjellë atij fatkeqësi në jetë.

Në një fshatë të vogël, jo fort larg Londrës, në mënyrë legale merret me „magji të zezë” Danile Suginham, që i ka kaluar të ’70-at. Ai e ka çmimin e caktuar, me të cilin saktësisht dihet tarifa e së keqes që duhet bërë.

Në një fshat të vogël, jo fort larg Londrës, në mënyrë legale merret me „magji të zezë” 65 vjeçari Daniel Suginham. Ai ka çmime fikse, me të cilat saktësisht dihet tarifa e së keqes që duhet bërë.

„Secili nga ne, që në zemër kultivon urrejtje ndaj dikujt ose diçkahit, duhet atë ta zbrazë nga vetja në qoftë se nuk dëshiron të ketë probleme psikike. Unë vetëm i ndihmoj që ta bëjnë atë. Pra, në të vërtet, unë ia shëroj shpirtin dhe me këtë bëj vepër të mirë” - thotë Suginhami.

Sikurse magjistarët e tjerë, edhe ky punon natën duke u shërbyer me kukulla të ndryshme, të cilat i punon vetë nga

pjesët e rrobave të vjedhura nga viktima e ardhshme. Në qoftë se bëhet fjalë për ndonjë mallkim më të rëndë atëherë kërkon ndonjë pjesë të trupit si flokë, thonj ose lëkurë. Ndërsa për raste më të rënda, të cilat - thotë ai - i ka pasur pak dhe të gjitha me sukses, kërkon gjakun ose spermën e viktimës.

Duhet që dikë ta urrejmë nga gjithë zemra, që magjia të ketë efekte sa më të mëdha. Sa më e madhe të jetë urrejtja, aq më e suksesshme është edhe magjia, sepse unë, me forcat e mia të errëta, shërbej vetëm si lidhje midis urrejtjes të cilën klienti im e mban në vete dhe viktimës. Unë urrejtjen nuk e prodhoj, por atë e transferoj, - thotë D. Suginhami.

Ndryshe nga kolegu i saj Suginhami, i cili porositësit e vet i lente të mermin pjesë ne ritualet e errëta të „magjisë së zezë", Barbara Foxyl këtë nuk e lejon sepse, thotë ajo, klientët e mi nganjëherë e lëshonin dhomën ku mbahej rituali duke vrapuar e bërtitur të frikësuar nga ajo që kishin përjetuar dhe kështu duhej ta përsërisja të gjithë ritualin që nga fillimi. Por kjo është e kuptueshme, sepse nuk mund të qëndrojë njeriu i qetë me atë që ndodh në dhomë gjatë ritualit ku paraqiten demonë me fytyra të ndryshme, trishtuese, që fluturojnë nëpër dritare dhe dëshirojnë të hyjnë brenda; pastaj kur ndodh paraqitja e tymit dhe e zërave të ndryshëm, të cilët dëgjohen qartë në rrethin e „magjisë së zezë".

Gazetari holandez Gordon Stephenny mendonte se kjo është një lidhje mes magjistarëve të „magjisë së bardhë" dhe atyre të „magjisë së zezë" për përfitime materiale ku, të dyja palët, do të përfitonin nga naiviteti i njerëzve. Ai për këtë shkroi edhe fejton në të cilat i vërtetonte thëniet e tij dhe paralajmëronte se kërkimet për zbulimin e fakteve më bindëse do të vazhdojnë. Por, mjerisht, nuk pati rast sepse e gjetën të vdekur me fëlliqësirën e vet në gojë! Policia nuk arriti ta zbulojë kurrë rastin, ndërsa të orientuarit nga ceremonitë e errëta thonë se Stephenny ishte viktimë e një rituali të tillë ku janë thirrur forcat e errëta.

Për ceremonitë e errëta dhe mallkimet e „magjisë së zezë” në kohën tonë edhe nuk do të dihej aq shumë po të mos shkruhej ndonjë artikull, apo të mos bëhej ndonjë emision televiziv për rastet tmerruese që janë në kufij të imagjinatës së bujshme. Ja disa raste tipike që flasin për keqpërdorimin e „magjisë së zezë” nëpër sekte të ndryshme të përhapura në mbarë rruzullin tokësor.



Incizime dokumentare nga TV-ja Italiane ku është dashur të tregohet e vërteta mbi njerëzit që merren me magji të zezë. Emisioni është incizuar por kurrë nuk është emituar (thonë, „me arsye”!)

Në „kthetrat” e sekteve

Ata të cilët patën sukses të ikin nga kthetrat e sekteve të errëta, flasin me tmerr të veçantë për sjelljet e magjistarëve dhe adhuruesve të tyre. Marion Paula është njëra nga ato. Ajo ishte gjashtë vjet anëtare e një sekti të tillë. Pas largimit nga ky sekt përfundoi në klinikën psikiatrike me çrregullime të rënda psikike, duke lënguar nga halucinacionet dhe skizofrenia e përhershme.

Rasti i saj është interesant. Ajo, pasi njoftohet me grupin, bëhet e varur prej tyre. Largohet nga shkolla dhe familja dhe bashkëngjitet me ta. Ata e shfrytëzojnë maksimalisht, duke e torturuar dhe shfrytëzuar edhe seksualisht, për ritualet e tyre të errëta. E kur fizikisht dhe psikikisht bëhet e paaftë, ata e hedhin në rrugë si të panevojshme. Nga deklaratat e saja në polici mësojmë edhe shumë tmerre tjera: „Një anëtare e grupit, e cila ishte shtatzënë, pasi e lind fëmijën (djalë), pranon ta bëjë viktimë të ceremonialit të forcave të errëta. E therë fëmijën e saj dhe të gjithë të pranishmit pinë gjakun e njomë të fëmijës së porsalindur”. Policët, që e mermin në pyetje Paulën, pranojnë se

kurrë në jetën e tyre nuk kishin dëgjuar raste më të tmerrshme dhe më trishtuese se sa ky, nga kjo vajzë, e cila edhe vetë kishte pirë atë gjak.

Ceremonialet e tyre ishin të mbushura përplot me histeri kolektive, orgji seksuale si dhe me viktimizimin e minjve, qenve, maceve, gjelave etj.

Gjëra të tmerrshme janë bërë edhe në shumë sekte të Berlinit - qytet i cili sipas dëshmive, në vitet e 20-ta (të shekullit të kaluar), ishte qendër e okultizmit evropian. Në njërën ndër sektet, anëtarët përshëndeteshin çdo natë mes veti, duke e puthur njëri-tjetrin në prapanicë. Sa më kundërmuese të jetë ceremonia, aq më i madh është edhe suksesi - thonë anëtarët e këtij sekti.

Për këtë arsye është përdorur edhe „nevoja e madhe" si dhe gjëra të tjera që flasin për një logjikë plotësisht të errët.



Anton Szandor LaVey (11.04.1930 - 29.10.1997), gjatë një rituali të „magjisë së zezë". LaVey është themelues i organizatës „Church of Satan" (Kisha e Satanit), të cilën e themeloi më 30.04.1966 në San Francisko të SHBA-ve. Kjo organizatë internacionale (zyrtarisht është e njohur dhe e regjistruar si Kishë nga organet amerikane) është reprezantuese e „Satanic Bible" (Biblës satanike) e cila, po ashtu, u kodua nga LaVey.

Stephanie Wiekers, 37 vjeçare, jeton në Londër. Qe dhjetë vjet është anëtare e një sekti satanist që merret me „magji të zezë." Ajo rrëfen: „Pacientet tanë janë njerëz afaristë. Kërkojnë nga ne, që me anë të forcave të errëta, të ndikojnë në suksesin e punës së tyre, e njëkohësisht t'ua shkatërrojmë konkurrentët. Njëri nga ata e ka lyer të gjithë dhomën me ngjyrë të zezë dhe qenin e vet e viktimizoi që në altarin tonë të rridhte gjak i freskët. Me atë biznes, me të cilin merrej ai afarist, arriti të bëhej

milioner. Nëpër mure e dysheme vizatonim simbole magjike, ndiznim qirinj e si altar na shërbente trupi lakuriq i një vajze të re. Mbi të kryenim rituale dhe rreth saj bënim orgji që ta fuqizonim forcën e magjisë”.

Gisella Pauher nga Gjermania, anëtare e një sekti në Gelsekirchen, tregon: „Duhej të isha e qetë derisa më ushqenin me ushqime të paketuara me lloj-lloj mbeturinash, pjesë të merimangave, të gjarpërinjve, të bretkosave etj. Duhej të isha e duruar dhe të mos bëja zë derisa më fusnin në vagjinë një bri të ngjyrosur me ngjyrë të zezë. Nuk guxoja të lëshoja zë as kur më rrihnin me litarin e marrë nga varrezat. Në qoftë se do të qaja apo bërtisja, i gjithë rituali përsëritej nga fillimi e unë isha e dënuar me tortura, nga të cilat më pëlciste lëkura dhe më rridhte gjak”.

Madlena Stillieker tregon: „Udhëheqësi ynë (quhej Hans) i shponte me gjilpërë viktimat (shtazët) dhe neve na detyronte të pinim gjakun e tyre e pastaj duhej që dikujt t'i bënim magji. Kur i bëmë magji një mjeku, i cili refuzonte të martohej me një grua njëzet vjeçe më e vjetër, aq shumë e munduam saqë më në fund beri vetëvrasje. Nga ai rast m'u hapën sytë dhe vendosa të largohesha përgjithmonë. Edhe pse më nuk marr pjesë në ceremonitë e tyre dhe e kam ndërruar vendbanimin, prapë nuk më lënë të qetë, mezi mbrohem nga sulmet e tyre psikike”...

Në pushtetin e „forcave të errëta”, Hendrik M. nga Thuringeni i Gjermanisë, më 29.4.1993, së bashku me dy shoqërues, në mënyrë më të paskrupullt e kishin mbytur, në një kasolle, moshatarin e tyre, Sandro B., duke i mbështjellë rreth fyti një kabllo elektrike.

Autorët e krimit i takonin një klike të cilët, sipas shtypit, visheshin me të zeza, bënin makijazh me ngjyra të mbyllëta, shkonin natën në varreza, ku me verë të kuqe ose gjak vizatonin pentagrame mbi sipërfaqe të ndryshme. Për shtypin ishte e qartë: „Vrasje me urdhër të Satanit” figuronin titujt me shkronja të mëdha në faqet e para të gazetave të tyre. Edhe vendimi

gjyqësor merret duke u bazuar në faktet se ndikim parësor, për aktin e kryer, kishin filmat me mesazhe satanike dhe përmbajtje kriminale.

Me 10 janar 2002, po në Gjermani, pranë gjykatës së Bochumit, fillon procesi kundër dy të akuzuarve, Daniel dhe Manuela Ruda, për vepër të rëndë penale: ritualin vrasës në mjedisin e satanistëve. Danieli dhe Manuela e kanë mbytur një njeri, dhe ata besojnë se këtë gjë e ka kërkuar nga ta Satani.

Daniel R. qysh si nxënës shihte „ëndrra" të përgjakshme. Ai e shihte veten në një trup monstruoz, i cili „rrëshqiste" netëve të errëta, duke i kafshuar njerëzit në kokë. Në moshën 14 vjeçare, gjatë një ore të mësimit, atij i paraqitet „Samieli"(„Sammael" - një demon nga Talmudi Hebraik, i cili përpiqet t'i dëmtojë njerëzit). Ruda filloi ta lexojë „Biblën satanike", të pijë gjakun e vet dhe u emërtua si „Sundown" - perëndimi dielli.

Në mars të vitit 2001 Danieli i pranoi dy urdhra drejtpërdrejtë nga Satani që lidheshin me numrat „6667". Me 6.6.2001 duhej të martohej me Manuelen dhe me 6.7.2001 në trupin e tij do të futej djalli, i cili kishte nevojë për një shpirt! Urdhri i parë ishte i qartë, të dytin Danieli e interpretoi si hap drejt viktimizimit: vrasje, kërkim viktimash, sjellje e shpirtrave. Dhe për zbatimin e urdhrave fillon të përgatitet: blenë një sëpatë, disa thika dhe dy çekanë.

Sipas dëshmive, por edhe shtypit, besohet se më 6.7.2001, ditën e krimit, tre persona ishin të ftuar në katin e tretë të banesës në rrugën „Breite Strase 55", në Witten të Gjermanisë. Frank Hacker, 33 vjeçar, ishte i vetmi që ra në grackë dhe u masakrua tmerrësisht në ritualin satanik. 66 goditje nga mjete të forta dhe të mprehta, - konstatuan hetuesit e mjekësisë ligjore.

„66” është numri i djallit! Danieli u dënua me 15 vjet burgim, ndërsa Manuela me 13.

Kur jemi te sektet, nuk mund të mos e përmendim edhe organizatën (kishë) tepër të njohur në botë, „Scientology”, pjesëtarë të së cilës janë dhe disa nga artistët më në zë të Holivudit, si Tom Kruz dhe Xhon Travolta.

Themelues ose ideolog i saj është shkrimtari amerikan L. Hubbard. Kjo organizatë, për t’i ikur nocionit „sekt”, nocion i cili rrjedh nga fjala latine „secto” - pasues, doktrinë, parti etj., që ka kuptimin e një grupi besimtarësh të shkëputur nga një bashkësi më e madhe dhe që për shkak të historisë së saj, dhe nën presion të kishës (krishterimi konsiderohet si sekt, pas shkëputjes nga Judaizmi), me kohë, mori karakter negativ - u emërtua si „Lëvizje e Re Religjioze”.



Edhe pse ky sekt në dukje të parë të lë përshtypjen e një organizate më shumë të orientuar kah psikologjia moderne e zhvillimit dhe ngritjes shpirtërore, nga shumë qeveri e religjione të ndryshme, por edhe nga vetë ish - anëtarët e saj, shihet me mjaft dyshim.

Ja se ç’thotë njëri prej tyre, W. Handel, për gazetën gjermane „Berliner Zeitung”: „Scientologjia ndikon njëjtë sikurse droga, bile edhe më keq, pasi një i varur nga droga së paku e di se është i varur prej saj. Neve na është grabitur guximi, ndjenjat, morali, ne ishim si robotë. Personaliteti ynë u ndryshua rrënjësisht. Ne merreshim në pyetje të kyçur në një E-metër, një lloj detektori për zbulimin e gënjeshtrave, ku detyroheshim të rrëfeheshim për gjithçka. Scientologjia është si një prift, i cili dëgjon rrëfimet e tua për t’i përdorur ato më vonë kundër teje. Dhe e gjithë kjo vetëm për para. Shuma e parasë ishte matësja e suksesit.” Për përjetimet e veta gjatë kohës që ishte anëtarë i saj,

Handel ka shkruar edhe një libër.

Scientologjia nuk është organizatë e vetme që me fuqinë e saj bindëse, pavarësisht formave dhe mënyrave aplikative, ka arrit të „gllabërojë" ose grabit personalitetin e anëtarëve të saj duke i kthyer në pjesëtarë të dëgjueshëm dhe servilë për qëllimet e veta të pacaktuara, qofshin ato edhe materiale. Kemi sekte të tjera që anëtarët e vet i kanë dërguar në vdekje, bile në vdekje me vetëdëshirë!

„Tempulli i popullit" quhej sekti që e udhëhiqte Jim Jones, një predikues i njohur i kishës katolike. Ai u fliste dhe u premtonte pasuesve të vet „parajsën"... dhe ata e ndoqën atë deri në vdekje. 923 njerëz vdiqën në nëntor të vitit 1978 pasi që udhëheqësi karizmatik i këtij sekti ashtu dëshironte.



(Vetë)vrasja masive në Guyana të SHBA-ve (lart) dhe udhëheqësi "karizmatit" Jim Jones (djathtas)

„Ai citonte Martin L. Kingun, fliste për drejtësinë, entuziazmonte me ide të reja, tërhiqte vëmendjen dhe të bënte për vete. Kishte një aurë që të përvetësonte aty për aty." - kështu shprehet njëra nga anëtaret e këtij sekti, Deborah Layton, në librin e saj dokumentar, „Vetëvrasja në parajsë" e cila, pak para vetëvrasjes masive, arriti të largohet nga ky sekt.

Falë aftësive të Jim Jonesit, me qindra pasues u rreshtuan pas tij. I përkuleshin sikurse një profeti dhe ishin të gatshëm ta

ndiqnin rrugën e tij deri në fund. Dhe kjo bindje, ky besim i fuqishëm në prijësin e tyre, u vërtetua më 1978, ku u vetëvranë mbi 900 njerëz.

„Heaven's Gate" (Porta qiellore) quhet sekti i udhëhequr nga Marshali Applewhite dhe Bonie Nettles. Një sekt që besonte në jashtëtokësorë.

Më 26 mars të vitit 1997, në villen e tyre në komunën Rancho Santa të Kalifornisë (SHBA), u gjetën trupat e pajetë të 39 anëtarëve të këtij sekti. Kjo tragjedi ndodhi gjatë shfaqjes së kometës Hale Bopp. Udhëheqësi Applewhite kishte arritur t'i bindte 38 anëtarët e vet për një suicid të përbashkët si rruga e mundshme që shpirtrat e tyre t'i dërgojë në një udhëtim ndërplanetar përmes një anijeje kozmike. UFO-t (objektet e paidentifikuara - jashtëtokësorët) qëndronin prapa qëllimit të kësaj komete (që asokohe iu afrua planetit tonë në një largësi prej 197 milion km) që mund të vrojtohej për një kohë bukur të gjatë, edhe atë vetëm me shikim të lirë, gjatë gjithë natës.



Trupat e pajetë të anëtarëve të sektit "Heaven's Gate" (majtas) dhe Marshali Applewhite (lart)

Vdekja kishte pasuar nga përzierja e Phenobarbitalit (lëndë që përdorët në mjekësi për narkozë) me lëngë mollash dhe raki „Wodka". Në videon që u publikua në media, pas aktit tragjik, shiheshin trupat e pajetë të shtrirë nëpër krevat dykatësh dhe të veshur tërësisht me të zeza. Të mbuluar me mbulesa të purpurta dhe, që të gjithë, kishin të mbathura në këmbë atlete të njëjta

dhe të reja të firmës së njohur „Nike”. Po ashtu, të gjithë kishin nga një valixhe dhe mjaft para, si „taksë” për trupat fizik që i konsideronin si „kontejnerë” transportues të shpirtrave të tyre jashtëtokësorë.

Udhëheqësit e sekti tjetër „OTS = Ordre Temple Solaire” (Urdhri - Tempulli i Diellit) Joseph Di Mambro und Luc Jouret, gjatë viteve 1944 - 1997 në Zvicër, Kanada dhe Francë, udhëhoqën drejt vdekjes (vetëvrasjes) 74 anëtarë të tyre. 47 prej tyre vetëm në Zvicër, në mesin e të cilëve ishin edhe pesë fëmijë. Në një kopsht në Weilers Cheiry (kantonit i Freiburgut), policia zbuloi 23 kufoma ndërsa, vetëm tri orë më vonë, në një fashat turistik në Granhes-sur-Salvan (kantoni i Wallisit) u gjetën edhe 25 kufoma të karbonizuara nën një ndërtesë prej druri e cila ishte djegur tërësisht.

Disa nga viktimat e sektit "OTS"

Te dy këta udhëheqës, të këtij sekti, e konsideronin veten si „rilindje” e Osirisit (zot egjiptian i „së andejshmes”, i „rilindjes” dhe „vdekjes”) dhe Mosesit (Moisiut / Musait). Mësimet që zhvilloheshin në këtë sekt ishin një përzierje e mistikës, astrologjisë, „New Age” (koha e re), natyrës, religjionit etj. Secili anëtar konsiderohej si reinkarnim i një personaliteti historik ose legjendar dhe identifikohej me të. Di Mambro e kishte një vajzë, me një të dashur, që quhej Emanuella e të cilën e konsideronin si „Fëmijë kozmik” - si Avatar (manifestim i zotit në formë njerëzore; mësues i përjetshëm).

Besimi i tyre në ditën e fundit, në apokalipsin (shkatërrimin e botës), forcohej gjithnjë e më shumë. Për ta, viti 2000 ishte edhe fundi i planetit tonë. Dhe për t’i ikur kësaj, pra zhdukjes së qenies njerëzore, nën moton se: „Vdekja nuk ekziston, ajo është

vetëm një iluzion”, ata kërkonin zhvendosje përmes vdekjes së qëllimshme (vetëvrasjes) në një sistem tjetër dhe pikërisht në yllin më të ndritshëm gjatë natës, të quajtur „Sirius”, duke u rilindur sërish atje dhe vazhduar trashëgiminë e mëtejme të kësaj rase. Dhe nën këtë moto, me vetëdëshirë, shkuan drejt vdekjes 74 anëtarë (për tu rilindur sërish).

Rastet e përshkruara më lart nuk janë raste të izoluara, ka edhe grupe, sekte, organizata të tjera që aktivitetet e tyre i zhvillojnë në fshehtësi ose nën vellon e ndonjë institucioni, qoftë shoqëror, qoftë religjioz. Dhe derisa e përgatisja këtë material (prill 2009), në një gazetë lexova për fillimin e një procesi gjyqësor në Munih të Gjermanisë, që kishte të bënte me një rast rrëqethës. Sërish me urdhër të demonëve, 30 vjeçari Loras R., me një thikë të zakontë kuzhine e kishte therur 40 vjeçarin Arthur M. Së pari në bark dhe shpinë e, në fund, po me atë thikë, ia nxjerr te dy sytë. Dhe para trupit gjykues ai shumë qetë dëshmoi: „Ishte zëri i demonëve që më urdhëroi ta kryej krimin. Ata më thoshin: shpoj ata sy të këqij! Bëje atë! Bëje!...”

Rast i Grahama Nashes

Ekzistojnë edhe vende ku magjistarët e „magjisë së zezë”, gjatë ceremonialeve, i mallkojnë dhe nga ato vende gjithnjë rrezaton energji negative, e dëmshme dhe e rrezikshme. Ja një rast: Ndodhi me 8 maj 1984, në ora 10 e 30 minuta. Grahama Nashe me shokët Frank Porteron, Ehristopher Pikeomin dhe Kcithom Porterom kishin shkuar në një shtëpi të rrënuar për të matur terrenin për ndërtimin e një objekti të ri. Me ta ishte edhe fotoreporteri, i cili e bëri fotografinë e fundit të Nashes.

Duke matur terrenin dhe shënuar kuotat, Nashe drejtohet për të vendosur shtizën matëse drejt rrënojës së kulmit. Gjatë ecjes përnjëherë shtangohet.

Shokët i afrohen dhe, duke e parë ashtu të zbehur, fillojnë ta lëkundin, t'i bërtasin etj. Në një moment ai e kthen kokën sikur dëgjon diçka, kthehet andej dhe, në mënyre automatike, fillon të

lëvizë drejt njërës nga anët e kulmit. E largon derën e shkatërruar të hyrjes dhe futet brenda. E derisa shokët vrapojnë pas tij, dëgjohen britmat e tij të tmerrshme: „jo... më lësho!”...

Ashtu, me gjysmë vetëdije, shokët e nxjerrin jashtë. Pasi vjen në vete, nuk i kujtohet asgjë dhe nuk besonte në atë që i kishte ndodhur. Që ta vërtetonte këtë, ai edhe një herë drejtohet kah ai vend dhe përsëritet e njëjta gjë. Por, prapë, Nashes asgjë nuk i kujtohet.

Fotografia e fundit e Grahama Nashes (i fundit nga e djathta) me shokët, para se në terrenin që shihet në foto, të shkelë në burimin e rrezatimeve negative.

Atë ditë ata e ndërpresin punën dhe vendosin që të nesërmen të lajmërojnë policinë. Por Nasha nuk pati më rast, sepse të nesërmen e gjetën të vdekur në atë vend. Në trupin e tij nuk kishte kurrfarë lëndimesh vetëm fytyrën e kishte të shtangur dhe me një dukje të tmerrshme në të.

Disa muaj me vonë, shokët e Nashes, vijnë prapë në atë vend (ku as sot e kësaj dite nuk është ndërtuar gjë), por me veti e

kishin edhe njërin nga magjistarët e njohur të „magjisë së bardhë”, Elarene Wolfit.

Duke treguar saktësisht vendin kah kishte kaluar i ndjeri Nashe, ai drejtohet drejt hyrjes, por vërehej se si disa forca nuk e lejonin të hynte. Kur kthehet, tregon se e sulmonin disa forca të panjohura. „Ndesha, thotë, në një mur, i cili më shtynte prapa kisha ndjenjë sikur ecja në të kundërtën e uraganit. Njëkohësisht dëgjoja edhe zëra që nuk i kuptoja. E në atë mur pash një figurë të trishtueshme. Diçka e ftohtë më kaploi dhe u detyrova të largohem”.

Padyshim, thotë Wolfit, se bëhet fjale për vendin ku kanë bërë rituale forcat e errëta, pse dhe për çfarë nuk e di, por disa herë kam parë se si ato vende në mënyrë të tmerrshme ndikojnë tek njerëzit.

Të befasuar nga të dhënat e Wolfit-it, të tre djelmoshat, e publikojnë në shtyp këtë rast, duke kërkuar ndihmë nga lexuesit. Nga shumë letra që u kishin arritur po e veçojmë njërën të cilën e kishte dërguar hulumtuesi i fenomeneve okultike, Eolin Vilson.

„Ekzistojnë vende të cilat befasojnë me energjinë e dhunshme e cila rrezaton dhe ndikon në të gjithë ata që ndodhen aty. Në ato vende, njerëzit sensibël, mund të ndjejnë nevojë të fuqishme për vetëvrasje. Edhe vetë e kam përjetuar këtë në disa vende. E kur i kam studiuar në mënyrë të detajuar, kam konstatuar se në ato vende forcat e errëta kanë mbajtur rituale të „magjisë së zezë.” Energjia, e cila është nxjerrë nga forcat e errëta në ato vende, vepron edhe pasi të jetë kryer ceremoniali. Shoku juaj, Nashe, pa dyshim se është viktimë e një vendi të tillë”.

Pas një kohe, në po atë derë ku kishte bërë vetëvrasje Nashe, në mënyrë misterioze paraqitet shenja e fytyrës së tij. Policia konstaton se ajo shenjë duhej të ishte bërë me hekur të skuqur, por kush ishte artisti i saj misterioz? Hetimet vazhdonin dhe atë shtëpi e ruanin dy policë. Një mesnatë, nga vetvetja, në

atë shtëpi shpërtheu një flake. Sipas dëshmive të policëve flaka nuk kishte filluar në një vend por përnjëherë gjithkah! Shtëpia ishte djegur plotësisht dhe nga ajo kishte mbetur vetëm hiri, të cilin e shkapërderdhte era.

Rast i Jeams Deanit

Edhe objektet e ndryshme, pavarësisht çfarë janë ato, kur të mbushen me energji, qoftë ajo pozitive apo negative gjatë ceremonive të ndryshme magjike, akumulojnë në vete forca të mëdha të energjisë të cilat rrezatojnë dhe kanë efekt të pacenueshëm të veprimit. Rasti i Xhemjs Dinit (Jeams Deanit), aktorit nga Kalifornia, është rast interesant.

Dini ishte anëtar i një sekti satanist dhe pjesëmarrës në shumë rituale të tyre. Edhe përkundër kërcënimeve ai largohet nga ky sekt. Por një ditë, në një fatkeqësi komunikacioni, e gjejnë të vdekur në automobilin e vet „porshe”.

Pas fatkeqësisë, karrocerinë e automobilit, e bleu mekaniku George Burms. Mirëpo, gjatë shkarkimit të saj, ajo shkëputet dhe i thyen te dy këmbët mekanikut të mjerë. Sakaq, pas dy muajsh, i vdes edhe gruaja në rrethana misterioze.

Jeams Dean-i ulur mbi automjetin e tij të tipit “Porshe” (majtas) dhe automobili i shkatërruar pas ndeshjës (lart)

Motorin e „porshesë” Burmsi ia shet një mjeku i cili, gjatë një vozitjeje sportive, pëson fatkeqësi (ndeshet në mur) dhe në vend mbesin të vdekur mjeku dhe vozitësi i automjetit. Në të njëjtën vozitje sportive rrotullohet edhe automjeti, në të cilin ishte vendosur ndërruesi i shpejtësive, me ç'rast vozitësi pëson lëndime të rënda...

Por me këtë nuk përfundojnë fatkeqësitë që i provokonte ky automjet. Karroceria e dëmtuar e „porshe-së” së Dinit, që mekaniku Burms e kishte ekspozuar pranë një rruge automobilistike, bie dhe ia thyen këmbët një fëmije që ndodhej duke luajtur rastësisht aty. Disa ditë më vonë, e njëjta karroceri e dëmtuar, derisa po dërgohej me kamion në një vend tjetër, pëson fatkeqësi dhe vozitësi i kamionit fluturon jashtë, duke përfunduar i vdekur nën karrocerinë e cila prapë shkëputet dhe rrëshqet në tokë. Ndërsa një vozitës tjetër, që i kishte blerë gomat e automobilit të Dinit, gati sa nuk e humb kokën, kur befasisht i pëlcasin gomat pa ndonjë arsye. Në vitin 1960, gjatë transportit për në Los Anxhelos, karroceria e „porshe-së” zhduket përgjithmonë...



Florinda Bolkan dhe Natalia Wood, dy aktore që mendohet se janë marrë me “magji të zezë”

Me magji të zezë u morën edhe shume artistë e artiste me famë botërore, siç janë Florinda Bolkan, Frenk Sinatra, Gilbert

Besaud, Don Johans, Evelyn Dersay, Natalia Wood etj. Por për përjetimet e tyre pakkush pranon të flasë. Ja çka mendon njëra prej tyre, Florinda Bolkan: „Gjithçka që për magjinë dhe ritualet e saj mund të lexohet nëpër libra ose gazeta të ndryshme, është vetëm një pjesë e vogël e destinuar për opinion: Magjia është diçka më shumë, diçka më e fortë, e që e dinë vetëm një numër i vogël i magjistarëve. Atyre nuk iu nevojitet fama, nuk iu nevojiten dhurata e për ta shumë pak dihet. Ata janë magjistarë të vërtetë të „magjisë së bardhë ose të zezë" dhe merren me gjëra të cilat njerëzit ndoshta kurrë nuk do t'i dinë. Të gjitha mënyrat tjera janë forma më të ulëta të magjisë".

„Ekzistojnë shumë demonë, dhe forca tjera me emërtime të ndryshme, të cilët gjatë ceremonive të posaçme mund ta thërrasin „princin e errësirës", vetë Satanain. Satanai mund t'i mbarsë gjërat me energjinë e vet negative, e cila provokon edhe vdekjen" - thotë prof. Toubba Cilmenar, shkencëtar nga San Francisko, i cili merret me kërkimet e „magjisë së zezë". „Varësisht nga vetë ceremoniali, forca e errët e thirrur, mund të veprojë për momentin, për kohë të shkurtër ose më të gjatë. E keqja mund të vuloset në ndonjë gjë, gjatë ceremonialeve të posaçme, të cilat „mbjellin" gjurmët e këqija". Ato fusha quhen T, të marrë nga fjala „Thought - fields", që do të thotë - fushat e mendimeve. Mendohet se në rastet e ndryshme, gjatë thirrjes së Satanait, mendimet e errëta thithen nga objektet (materialet) përkatëse dhe më vonë, në kohë të caktuar, ato mendime rrezatojnë nga ai material, ku thirret Satanai. Bëhet fjalë për thirrje të posaçme të forcave të mëdha negative, të plotfuqishme dhe me efekt të lartë të veprimit, të rrezikshme për jetën. Ato forca të mëdha negative të veprimit e thërrasin Satanain ose „princin e errësirës". „Princi i errësirës" ose Satanai është në të vërtetë mendimi i fuqishëm negativ, i përqendruar e i fuqizuar, forcë e keqe psikike e cila mundet edhe të mbys, përfundon prof. dr. Cilmenar".

Mekanizmi i forcave të errëta është ky: Embrioni i tyre

ndodhet tek njeriu përgjithësisht, në secilin prej nesh, por ata që merren me „magji të zezë”, nëpërmjet ceremonialeve të ndryshme, të posaçme, e kanë zhvilluar dhe fuqizuar këtë forcë të energjisë, të cilën ashtu të shumëzuar e të fuqizuar, e orientojnë me përqendrim të fortë, si rreze laseri, drejt objektivit të caktuar. Këto mendime, kjo dëshirë e përqendruar vepron si forcë e keqe në jetën normale.

Rasti i vajzës nga Reçani

Raste të tilla, të ritualeve për thirrjen e „forcave të errëta” me qëllime keqbërëse, ka sa të duash edhe në shoqërinë tonë. Dhe secili prej nesh, së paku ka dëgjuar një histori të këtij lloji. Ky rast ka ndodhur në rrethin e Prizrenit, pikërisht në fshatin Reçan. Miku im S. Basha, që ka asistuar në këtë rast dhe të cilin e ka publikuar në librin e tij „Hipnozë...”, ja seç shkruan: „Më kanë kërkuar ndihmë për një femër shumë të sëmurë nga fshati Reçan i Prizrenit, për të cilën prindërit e saj më thanë që e kishin dërguar për shërim tek shumë mjekë, por pa sukses. Pasi unë në atë kohë nuk mund t’i shëroja njerëzit nga „magjia e zezë”, kam kërkuar ndihmë nga dervish Destani, i cili vinte pa përtesë.

Ishte një vajzë e re, 17-18 vjeçare (nuse e re) e cila alivanosej - e humbte vetëdijen, grindej pa vetëdije me persona të panjohur dhe të imagjinuar e të padukshëm për sytë e të tjerëve. E rroknin katarza apo llahtari psikike me dhimbje të mëdha e britma të padurueshme për të tjerët, britma të cilat ta fusnin frikën. Kësaj vajze shpesh i zihej edhe fryma, ku dukej si e vdekur, dhe në këtë gjendje rrinte me orë të tëra. Kur zgjohej e rraskapitur dhe vinte në vete, rrinte normalisht por nuk dinte se çfarë kishte bërë gjatë asaj kohe dhe çfarë kishte folur.

Dervish Destani më urdhëroi që ta marr një fletë të pastër dhe një laps kimik. I nxori tespihet e veta, të gjata, prej 1001 kokrrash. Derisa ne ishim aty, ajo vajza e sëmurë ishte me vetëdije të plotë dhe e qetë, pra në gjendje normale. Dervish Destani e urdhëroi këtë vajzë që të ngrihej në këmbë dhe e

përbiroi nëpër rrathët e tespiheve tri herë, duke kënduar me vete disa lutje. Sapo e përfundoi ritualin, vajza u sëmurë! Ishte vërtet e dhembshme ta shohësh një vajzë të bukur e cila sapo ishte martuar dhe nuk mund ta shijonte muajin më të bukur të martesës. Edhe gëzimi i familjes ishte kthyer në dhembje. Dhembje që provokonte pikëllim. Ajo shtëpi e ndërtuar aq bukur, për një kohë të shkurtër, ishte shndërruar në një ferr të vërtetë nga një dorë e zezë e pamëshirshme dhe e mallkuar.

Dervishi, në tespihet e veta, i kishte të ndara 7 kokrra nga tërë rrethi i tyre. U lut dhe e thirri në ndihmë një emër. Ai emër ishte një qenie hyjnore. Gjatë kësaj kohe dervishi e urdhëroi këtë vajzë që të tregonte se kë po e shihte. Kush ishte ai/ajo që i ka bërë magji. Kush e kishte sjell në këtë gjendje. Vajza nuk foli nja gjysmë ore fare. Ajo vetëm shkarravitej, bërtiste dhe i zihej fryma. Dervishi e prekte trupin e saj me tespihe dhe e urdhëronte që të fliste... dhe lutej. Më në fund vajza filloi të flasë dhe të tregojë një emër. Atëherë dervishi më urdhëroi mua që ta shkruaj atë emër në fletë. Pas kësaj ajo filloi të thoshte edhe emra të tjerë. U bënë 10 emra të ndryshëm, si femrash

ashtu edhe meshkujsh, që ishin të familjarëve, miqve, shokëve e shoqeve. Unë i befasuar e pyeta dervishin se si është e mundur që kaq shumë njerëz t'i bëjnë magji? Ai më tha se personi që i ka bërë „magji të zezë" fshihet dhe maskohet në lloj-lloj figurash, bile edhe në figurë të prindërve të saj.

Dervishi e mori fletën me emra, foli diçka, dhe i fryu asaj flete. Pastaj i vuri flakën... Por një qoshe e fletës mbeti pa u djegur, e në të ishte një emër femre. Unë prapë e pyeta dervishin se pse ajo qoshe nuk po kallej?! Ai tha: kallet... dhe dikur, me disa lutje, mori flak edhe ajo qoshe. -Ky emër është i një femre që merret me „magji të zezë" dhe paska një mbrojtje të madhe, për këtë arsye nuk kallej - tha dervish Destani.

Vajza tregonte emra të tjerë që u bënë 24. Vetëm një nuk e tregonte kurrsesi. -Kur po tentoj ta tregoj atë emër, ajo grua po më furë e po më thotë se do të të mbys po tregove kush jam... - tha në vaj vajza." Dervishi e përdori një teknikë psikologjike: I bërtit me zë të lartë dhe iu vërsul vajzës me tespihe për ta goditur, duke i thënë: -A po e tregon atë emër a të bëra copë-copë! Vajza e tha emrin me vështirësi, unë e shkrova shpjet e shpejt dhe ia dhashë dervishit. Ai e mori letrën, u lut diçka me vete, i fryu letrës dhe e kalli. Si u kallë tërësisht, vajza u zgjua nga ajo llahtari e madhe dhe tha: -U çlirova... Po kush jeni ju? Çka keni lypur këtu me mua në dhomë?! -Në rregull është, i tha dervishi, ne kemi ardhur të të shërojmë. Mos ki frikë tash je e shëruar. Vajza (nusja) e thirri vjehrrën me „nënë", kur ata hynë brenda në dhomë të gëzuar që ishte shëruar e reja...

Pas një kohe kam dëgjuar se kjo nuse më nuk kishte pasur sulme dhe kishte filluar një jetë normale" - thotë S. Basha.

Basha mendon (bazuar në studimet e shumta dhe eksperimentet me hipnozë) se çdo magji që bëhet, bëhet me urdhër në nëndije, sepse nëndija i lexon dhe i pranon valët më të imta psikike që dërgohen drejt saj dhe i merr ashtu siç janë të dërguara, në çfarëdo forme dhe mënyre, pa marrë parasysh largësinë apo vendin. „Magjinë, qoftë të zezë, qoftë të bardhë,

unë e quaj virus mental” - shprehet S. Basha.

„Magjia bëhet me të gjitha llojet e elementeve kozmike, duke filluar prej elementit të zjarrit, ajrit, ujit apo tokës; çdo element e ka fuqinë e vetë magjike, e cila është si një shpatë me dy tehe - kah t’i jep luftëtari, ajo pret ose mbron”.

Basha thotë se në Kosovë, por edhe në të gjitha trojet shqiptare përgjithësisht, përdoren rituale të magjisë primitive, dhe kjo ndoshta është pozitive, pasi magjia profesionale do të ishte shumëfish më e rrezikshme...

Rasti i 15 vjeçares L.

Dhe për fund të këtij artikulli po e shënoj një rast ku e edhe vetë kam asistuar. Një vajzë 15 vjeçare, që ishte edhe fqinje imja, kishte shfaqur probleme psikike. Familjarët ishin të bindur se „ka të bame” dhe ishin shumë të shqetësuar për fatin e fëmijës së tyre. I kishte humbur oreksi dhe ushqehej vetëm me infuzion. E kishin pasur tek shumë mjekë dhe të gjitha analizat rezultonin në rregull. Vajza organikisht ishte e shëndoshë. Çdo intervenim mjekësor ishte i kotë: shpirti i saj mbahej vetëm në bazë të ushqimit artificial. Dhe për këtë arsye atë e vizitonte përherë një mjek. Edhe atë ditë, kur ne shkuam në atë shtëpi të ftuar nga familjarët për ta provuar edhe këtë formë shërimi, mjeku ndodhej aty.

Meqë e dinim se pacientja vështirë se mund të hipnotizohej, morëm me vete dhe dy mediume (Sh. G. dhe L.B.) të cilët në raste të tilla shërbenin si „urë lidhëse” mes nesh dhe pacientes. Procesin e udhëhiqte S. Basha.

Të dy mediumet i futëm në gjendje të thellë hipnotike dhe i „lidhëm” në mënyrë telepatike me pacienten (me shpirtin e saj), e cila qëndronte indiferente. Duke hulumtuar në brendi të psikës së saj, mediumet thanë se shpirti i kësaj vajze ishte „rob” i një ceremoniali të „magjisë së zezë” që i ishte dedikuar dikujt tjetër, por që fatkeqësisht, në të kishte shkelur ajo. Ajo që kishte bërë magji (një e afërme), ia kishte thithur të gjithë energjinë kësaj

vajze dhe këtë energji e kishte mbyllur në formë rrethi në majë të kulmit të shtëpisë. Kështu raportonin mediumet që hulumtonin në gjende të thellë hipnotike. Miku im Basha, duke e aplikuar metodën mesmerike (magnetismus animalis - magnetizëm shtazorë), na urdhëroi që të kapemi të gjithë dorë për dore duke e krijuar kështu formën e një rrethi. Përmes energjisë së dy mediumeve, si dhe me ndihmën e energjisë kolektive (pasi kishim krijuar një qark të mbyllur), filluam sulmin psikik për shkatërrimin e asaj sfere, zhbllokimin e asaj energjie dhe lirimin e shpirtit të kësaj vajze nga ai rreth i mallkuar që i kishte sjellë kësaj familjeje shqetësime serioze.

Pas përpjekjeve të mundimshme të mediumeve (të cilët dukeshin sikur të ishin në gjendje histerie), u arrit që të shpartallohet ajo sferë dhe, po në atë moment, vajzës (pacientes) iu kthye energjia e bllokuar - fytyra e saj ndryshoi, mori krejtësisht pamje tjetër.

Me ndihmën e mediumeve, që gjatë gjithë kohës ishin nën hipnozë, rreth trupit të vajzës krijuam një shtresë (eterike) mbrojtëse, si mburojë nga sulmet tjera eventuale. Gjithashtu, asaj i dhamë edhe një simbol që ta bartë me vete, po ashtu, si mbrojtje nga çdo energji e keqe...

Ndonëse ky rast, ndokujt edhe mund t'i duket si ngjarje nga filmat fantastikë, e ndoshta shumëkush mund ta cilësojë si patologji shpirtërore, por kjo, siç e kam thënë edhe në fillim, është çështje besimi e gjykimi individual... E rëndësishme është se ajo vajzë, më vonë, është martuar dhe është bërë nënë.


Sabin Krasniqi

BIOENERGJIA

Sikurse të gjitha aparatet teknike që funksionojnë duke u furnizuar me anë të energjisë, me të cilën janë të lidhura, po ashtu edhe njeriu ekziston duke u shërbyer me energji universi.

Në fizikë, energji do të thotë aftësi veprimi për kryerjen e një pune, ndërsa në psikologji do të thotë forcë, gjallëri e aktivitet psikik.

Energjia fizike paraqitet dhe vepron me forcën e saj në botën e jashtme materiale, ndërsa energjia psikike, mentale, emocionale... paraqet aftësi për kryerjen e veprimeve psikike, kuptimeve mentale, përjetimeve emocionale... pra, nxitje dhe rezultate të proceseve shpirtërore. Natyra e rrezeve fizike (dritës, rrezeve elektromagnetike, rrezeve rëntgen etj.) na është e njohur dhe e dokumentuar me anë të fakteve vepruese si materiale, ndërsa natyra e rrezeve biologjike ende mbetet e papranuar shkencërisht, e pasqaruar definitivisht, e mbështjellë me vello mistike etj., edhe pse fakte për t'u dokumentuar ka mjaft!

Duhet të kuptojmë se njeriu nuk është i kufizuar vetëm me lëkurën e vet, por me potencialin e pakufishëm të rrezeve në hapësirë dhe kohë. Këto rreze, kjo energji qarkullon edhe nëpër trupin e tij, nëpërmjet qendrave përkatëse energjetike (që në kulturën e lashtë indiane quhen çakra) dhe mban organizmin në harmoni me ambientin e jashtëm. Kjo energji, ndryshe quhet

bioenergjia.

Fjala bioenergji rrjedh nga fjalët greke: bios - jetë dhe energji - punë, veprim. Bioenergjia i është e njohur njerëzimit që nga lashtësia dhe është përdorur atëherë, e përdoret edhe sot për shërimin e shumë sëmundjeve ose lehtësimin e dhembjeve tek të sëmurët, me anë të furnizimit natyror me energji, pa ndihmën e medikamenteve dhe aparateve, por duke transferuar energjinë tonë personale, me anë të duarve, mbi trupin e të sëmurit, pa e prekur atë.

Edhe Jungu, në teorinë e tij të „Vetëdijes kolektive dhe të simboleve të arketipave", thotë se njeriu është qenie psikoenergjetike dhe se shëndeti i tij varet shumë nga ajo se si energjia qarkullon nëpër trupin e tij, madje, çfarë ndien, mendon, dëshiron etj.

Siç thamë më lart, bioenergjia i është e njohur njerëzimit që nga kohët më të hershme. Indianët e njohin këtë energji qysh para 5000 vjetësh dhe e quajnë „prana". Këtë energji universale ata e konsiderojnë burim të jetës. Me anë të ushtrimeve të Jogës, ata manipulojnë edhe sot me këtë energji, nëpërmjet teknikës së frymimit, meditimit dhe ushtrimeve fizike, për ta mbajtur organizmin në gjendje të kthjellët, të qetë dhe të shëndoshë.

Edhe kinezët e njohin këtë energji dhe e quajtën Ch'i. Sipas filozofisë së tyre, e gjithë materia e gjallë apo edhe ajo që konsiderohet e „vdekur", është e përbërë dhe e përshkuar nga kjo energji. Energjia Ch'i përmban dy pole të forcës, Jin dhe Jang. Kur Jin dhe Jang janë në baraspeshë, sistemi i gjallë (organizmi) është i shëndoshë, ndërsa kur midis tyre sundon disharmonia (jo-baraspesha), si rezultat i saj kemi gjendje të sëmurë.

„Kabala" - teoria mistike e hebrenjve, që ka filluar të paraqitet rreth 450 vjet para Krishtit, bën fjalë për këtë energji si

dritë e shndritshme, dritë astrale. Krishterimi portreton figurën e Isait dhe figurat tjera të larta shpirtërore të rrethuara me dritë të lehtë e të shndritshme (aureolë) mbi kokë. Shumë mësime ezoterike, si tekstet e vjetra hinduse, teozofistët, tibetasit, budistët e Indisë, zen - budistët e Japonisë, Zonja Blavocki, Rudolf Shtajner e shumë personalitete tjera, që janë marrë me çështje shpirtërore, flasin dhe e përshkruajnë këtë energji.

Në fillim të shekullit XII, Buraku dhe Liberi kanë vërejtur se qeniet njerëzore kanë energji, e cila mund të provokojë ngacmime edhe në largësi. Ata kanë cekur se një person, me vetëdëshirë, mund të provokojë efekte pozitive ose negative tek personi tjetër, pa prekje fizike. Edhe Paracelzusi, në Mesjetë, këtë energji e ka quajtur „Ilaster" dhe thoshte se Ilasteri është i përbërë nga forca e jetës dhe materies.

Dukurinë e „Energjisë universale", në vitin 1800, e vëren edhe Mesmeri, i cili në bazë të kësaj energjie e krijoi „mesmerizmin". Më vonë, Mesmeri këtë energji e përshkruan si hipnotizëm. Wilhem von Rajhenbah kaloi 30 vjet duke eksperimentuar në lëmin, të cilin e quajti „forcë tërheqëse". Ai zbuloi se forca në trupin e njeriut prodhon polaritet të njëjtë me atë që gjendet në kristale. Në bazë të këtij eksperimenti, Rajhenbahu e përshkruan anën e majtë të trupit si pol negativ, ndërsa të djathtën si pol pozitiv. Ky sistem është pothuajse i njëjtë me sistemin kinez: Jin dhe Jang.

Në vitin 1919, dr. Wiliam Killner bëri publike kërkimet e tij rreth energjisë njerëzore, për të cilën thotë se e ka parë nëpërmjet ekraneve të ngjyrosura dhe filtrave. Ai shkruan se ka parë tri shtresa në formë të mjegullës rreth trupit të njeriut. Këtë mbështjellës ai e quan „aura". Killner zbuloi gjithashtu se paraqitja e aurës tek njerëzit është e ndryshme, varësisht nga mosha, vetitë mentale - emocionale dhe gjendja e tyre shëndetësore. Në bazë të kësaj, Killner zbuloi sistemin e diagnostikimit në bazë të ngjyrave, përmbajtjes dhe dukjes në përgjithësi të mbështjellësit të trupit, pra aurës.

Dr. Wilhelm Rahj, psikiatër dhe koleg i S. Frojdit, këtë energji e quajti „orgon”. Në periudhën 1930-1950, Rahji eksperimentoi me këtë energji, duke shfrytëzuar instrumentet



më të reja mjekësore të kohës. Ai vërejti se si energjia pulsonte në natyrë dhe rreth të gjitha lëndëve organike dhe joorganike. Kishte vërejtur gjithashtu, pulsimin e energjisë që rrezatonte nga mikroorganizmat, duke shfrytëzuar mikroskopin e fortë, të konstruktuar posaçërisht për këtë. Gjithashtu, Rahji kishte konstruktuar vetë edhe aparatet për matjen e polit të orgonit.

Para disa vitesh, një grup shkencëtarësh nga ish- Bashkimi Sovjetik, në Institutin e Bioinformatikës „A.S. Popov”, paraqesin zbulimin se organizmat e gjallë emitojnë vibracione energjetike në frekuenca rreth 300-2000 nanometra. Ata këtë e quajtën energji biopolare ose bioplazëm. Ata zbuluan se personat që kanë aftësi për transformimin e energjisë e kanë fushën polare më të gjerë dhe më të fortë. Këto zbulime i vërtetoi edhe Akademia e Shkencave të Mjekësisë në Moskë. Gjithashtu, këtë zbulim e përmbajtën edhe shkencëtarët nga Britania, Holanda, Gjermania etj.

Zbulim mjaft interesant rreth ekzistimit të aurës është edhe ai i dr. Valovit Hant nga UCLA. Në studimin për efektet e rolfingut (shërimi me anë të lëvizjeve të gishtave) në trup dhe në psikë, ai shënoi frekuenca të ulëta milivolitke të sinjaleve nga trupi gjatë serisë së seancës „Rolfing”. Për t’i regjistruar këto, ai shfrytëzoi një elektrodë të thjeshtë, të ndërtuar nga argjendi, duke e vendosur nën lëkurë. Njëkohësisht, me regjistrimin e sinjaleve, Rozalin

Brijer nga Qendra e Glendjelit për Bioenergji (Kaliforni), vërejti aurën tek personat, të cilëve u është bërë rolfingu. Ajo raportonte në mënyrë paralele edhe për ngjyrat, madhësitë dhe sjelljet e energjisë nëpër çakra si dhe mjegullat e aurës. Pastaj, shkencëtarët në mënyrë matematikore shqyrtuan strukturat e valëve të regjistruara me anë të analizës furike (të shpejtë) si dhe të analizës me anë të frekuencave të stenogramit. Te dy format e analizave ofronin rezultate interesante. Format konsistente të valëve dhe frekuencave u përshtateshin saktësisht ngjyrave, të cilat i thoshte Rozalin Brijer.

Dr. Hant e përsëriti të njëjtin eksperiment me shtat persona të tjerë, që e lexonin aurën. Ata vërejtën ngjyrat e aurës, të cilat ishin korrelative në strukturën dhe frekuencat e njëjta të valëve. Në shkurt të vitit 1985, rezultatet vazhduese treguan këto korrelacione të ngjyrave (frekuenca Hz - herc ose cikël - sekondë):

Ngjyra e kaltër - 250-270 Hz - 1200 Hz
Ngjyra e gjelbër - 250-475 Hz
Ngjyra e verdhë - 500-700 Hz
Ngjyra e portokalltë - 950-1050 Hz
Ngjyra e kuqe - 1000-1200 Hz
Ngjyra vjollcë - 1000-2000 Hz + 300-400; 600-800 Hz
Ngjyra e bardhë - 1100-2000 Hz

Shifrat e vazhduara të frekuencave të ngjyrave, e kaltra dhe vjollcë, janë si rrjedhojë e gjatësisë së ngjyrave. Frekuencat e matura janë shenja të instrumentit, se sa është energjia, e cila është matur.

SHIKIMI NË SHPIRTIN E NJERIUT

Fotografia e Kirlianit

Kah fundi i viteve ’60, u paraqit për herë të parë aparati për fotografimin e aurës (bioenergjisë), të cilin e zbuloi elektricisti

dhe fotoamatori Semjon D. Kirlian nga Krasnodova (Rusi), bashkë me të shoqen, Valentinën, dhe e quajtën me mbiemrin e tyre „Fotografia e Kirlianit”.

Fotografia e Kirlianit bazohet në fenomenet e profesorit nga Gjermania G. Lichtenberg, të zbuluara para më se dy shekujsh. Mirëpo, vetëm zbulimet e N. Tesllës (shkarkimi i tensionit të lartë) mundësuan realizimin teknik të këtij instrumenti. Duke u bazuar në këto studime, qifti Kirlian arriti konstruktimin e aparatit dhe zbatimin e tij në praktikë për regjistrimin e këtyre fenomeneve - fotografimin e shkarkimeve energjetike, të cilat dukshëm ndriçojnë dhe ndryshojnë mes materieve të gjalla dhe atyre të „vdekura” në fushën e tensionit të lartë dhe frekuencave të larta.

Semjon dhe Valentini Kirlian

Model i përpunuar i aparatit të Kirlianit

Ky aparat, me ndihmën e një transformatori, krijon fushë elektromagnetike me tension të lartë deri në 20.000 voltë në të cilën vetë objekti i fotografimit, qoftë ai gjeth bimësh, gisht njeriu apo diç tjetër, shërben si një elektrodë e cila emeton një energji të dukshme. Shkarkimi i kësaj energjie regjistrohet në një film shumë të ndjeshëm, që është i vendosur mbi një pllakë metalike, e cila është e lidhur me masën e aparatit. Dhe nga kjo

energji shndritëse, që krijohet mes objektit dhe pllakës metalike nga tensioni i lartë, përfitojmë pamjen e aurës të cilën e rrezaton objekti i caktuar.

Aura rreth gishtit

Aura rreth gjethit

Aura e autorit (S.K.) bërë nga „Art Studio Luzern" në Basel më 1998

Në këto fotografi shihet qartë një lloj drite, diku më e fortë e diku më e dobët (varësisht nga lënda), e cila duket në formë të flakës ose rrezeve. Kirliani, gjatë eksperimenteve të gjata, arriti të konstatojë se secila substancë e ka strukturën e vet tipike. P.sh. gishti i njeriut e ka strukturën krejt të ndryshme të dritës nga gjethi i ndonjë bime. Metali tregon dritë fare të dobët, ndërsa organizmat e vdekur nuk rrezatojnë fare dritë.

Ata gjithashtu vërejtën edhe ndryshime në shtresat e vetë aurës, si rezultat i vetë ndryshimit emocional të individit ose gjendjes së tij shëndetësore. Ato ndryshime reflektoheshin përmes intensitetit të dritës si dhe ndryshimeve variabël të ngjyrave në aurë.

Kjo i nxiti edhe shumë hulumtues që aparatin e Kirlianit ta përdorin si mjet diagnostikimi për shumë sëmundje të ndryshme, bazuar m'u në këto ndryshime variabël të aurës gjatë gjendjeve të ndryshme psikike e fizike. Disa prej tyre janë munduar ta përpunojnë atë „fotografi shpirtërore". Ata kanë eksperimentuar

edhe me regjistrimin e objekteve në largësi prej disa cm, pra pa i vendosur në pllakën metalike. Suksesi në këto veprime argumentoi se aura e regjistruar nga aparati i Kirlianit nuk është një fenomen, thjesht fizik i regjistrimit të dritës, por se organizmi rrezaton edhe energji tjera me karakteristika të posaçme, të paregjistruara deri më tani, që disa parapëlqejnë ta quajnë edhe Bioplazmë. Prandaj edhe shumë shkencëtarë mendojë se mu kjo plazmë biologjike mundëson edhe paraqitje të partikuluara psikotronike, respektivisht paraqitjen e fenomeneve parapsikologjike, në ekzistencën e të cilave sot as që dyshohet.

Ky aparat përdoret edhe sot për matjen e potencialit të energjisë dhe në bazë të këtij aparati, njerëzve, që kanë energji të madhe, u jepen diploma dhe leje për shërim me anë të duarve.

Fotografia e Kirlianit edhe më tej mbetet një ndër faktet më të forta dhe më bindëse për ekzistimin e bioenergjisë.

Aura

Mësimet ezoterike, shumë më herët se zbulimi i aparatit të Kirlianit, e kanë përshkruar aurën si manifestim i energjisë që është e lidhur ngushtë me baraspeshën e njeriut në harmoni me natyrën. Mund të përshkruhet si mjegull, që rrethon dhe e përshkon trupin fizik dhe emeton rreze karakteristike. Këtë fushë energjetike, që e rrethon njeriun dhe emeton rreze karakteristike, njohurit e lashta indiane e përkufizojnë në shtatë shtresa të lidhura me shtatë qendra të energjisë në trupin e njeriut, të quajtura çakra (Chakra).

Secila shtresë e aurës është e lidhur me shtatë çakrat. Kështu që shtresa e parë është e lidhur me çakrën e parë, e dyta me të dytën e kështu me radhë.

Shtresa e parë dhe çakra e parë është e lidhur me funksionet fizike, ndjeshmërinë e dhembjes fizike dhe kënaqësitë shqisore. Shtresa e dytë dhe çakra e dytë është e lidhur me aspektet emotive të njeriut. Shtresa e tretë dhe çakra e tretë është e lidhur

me jetën tonë mentale, me mendimet lineare. Shtresa e katërt dhe çakra e katërt është rruga nëpër të cilën krijojmë dashurinë, jo vetëm ndaj polit të kundërt, por edhe ndaj gjithë njerëzimit. Shtresa e pestë dhe çakra e pestë është e lidhur me dëshirat më të larta, me forcën e fjalës dhe me marrjen e përgjegjësisë për veprimet tona. Shtresa e gjashtë dhe çakra e gjashtë është e lidhur me dashurinë qiellore, me dashurinë e cila shtrihet jashtë rrethit njerëzor dhe përfshin gjithë jetën. Shtresa e shtatë dhe çakra e shtatë është e lidhur me mendimet e larta, inteligjencën dhe integrimin e forcës sonë fizike dhe shpirtërore.



Gjithashtu, ekzistojnë lokacione specifike në sistemin tonë energjetik për emocionet, mendimet, kujtimet dhe përjetimet tjera psiko-fizike. Pasi që simptomat fizike janë të lidhura me ato lokacione, do të thotë mund ta kuptojmë edhe natyrën e sëmundjes. Për këtë edhe studimi i aurës mund të jetë urë në mes mjekësisë tradicionale dhe asaj konvencionale.

Nëpërmjet këtyre çakrave supozohet se kalon e gjithë energjia universale nëpër trupin tonë dhe e mban atë në harmoni me natyrën. E në çoftë se ndonjë nga këto çakra çrregullohet, atëherë pason edhe sëmundja, të cilën bioterapeutët me anë të duarve, respektivisht bioenergjisë, e shërojnë, duke ia rregulluar drejtimin e rrotullimit energjisë nëpër çakra përgjatë gjithë organizmit.

Sa i përket bioenergjisë, sot në botë ekzistojnë tri teori: Njëra konsideron se është fjala për fushën e energjisë, e cila i

është e njohur fizikës moderne. E dyta konsideron se është fjala për energji ende të panjohur. Ndërsa e treta mohon bioenergjinë, ekzistencën e saj dhe pohon se fjala është për sugjestione dhe hipnozë.

Pavarësisht se cila teori është më afër të vërtetës, dhe mund të jetë e saktë, si dhe për çfarë forme të energjisë është fjala, ajo sot me sukses po përdoret për shërim dhe po tregon rezultate tepër inkurajuese.




Sabir Krasniqi

TELEKINEZA OSE PSIKOKINEZA

NDIKIMI I SHPIRTIT MBI MATERIEN

Siç na është e ditur edhe nga fenomene tjera, në botën në të cilën ne frymojmë, ekzistojnë shumë dukuri të cilat, me gjithë të arriturat shkencore, mbeten akoma të mbështjella me vellon e misterit. Shkencëtarët e pranojnë edhe vetë se edhe shkenca, në të gjitha fushat ku zhvillon veprimtaritë e veta, është në zhvillim e sipër. Ajo nuk disponon çelësin e çdo misteri por, për çdo ditë, mëson e zbulon diçka të re. Një ndër këto dukuri, për të cilën shkenca akoma nuk e ka thënë fjalën përfundimtare, është edhe „telekineza” ose „psikokineza”.

Telekineza ose psikokineza është energji psikotronike nga e cila provokohen ndryshime fizike në qeniet e gjalla ose në botën e jashtme, pa kurrfarë kontakti fizik. Këtë term i pari e përdori prof. Joseph Banks Rihne që nga viti 1920. Fjala „telekineza” rrjedh nga greqishtja që do të thotë: „tele” - largësi dhe „kinesis” - lëvizje. Kuptim pothuajse të njëjtë ka edhe fjala „psikokineze” („psyche” - shpirt dhe „kinesis” - lëvizje) që mund të definohet si „ndikim i njeriut, përmes forcës psikike, në ndryshimin e materies”.

Sikurse paraqitjet tjera të energjisë psikotronike, ashtu edhe telekineza ose psikokineza vështirë përkufizohet në kornizat e ligjeve të fizikës së sotme, edhe pse fizika, që nga teoria e Tesllës e këndej, intensivisht mundohet ta zgjidhë problemin e bartjes së energjisë në largësi, pa ndihmën e telave, pra pa kontakt fizik.

Kërkuesit e kësaj fushe janë përpjekur shumë herë që këtë dukuri ta dëshmojnë përmes eksperimentimeve laboratorike. Në të shumtën e rasteve kjo ka funksionuar me sukses, mirëpo, ripërsëritja e atij suksesi, nuk ka dhënë gjithnjë rezultatin e

kënaqshëm. Kështu që edhe nuk ka mundur, parimisht, të dëshmohet veprimi i saj përmes përvojave empirike. Mirëpo, ngjashëm ndodh edhe tek eksperimentet që zhvillon fizika kuantike me elementarë, megjithatë, kjo është e pranueshme për shkencën!

Kërkimet shkencore të këtij fenomeni filluan kah fundi i shekullit të kaluar, kur në seancat spirituale është vërejtur se mendimet në gjendje transi (hipnozë) kanë aftësi të ndikojnë në lëvizjen e objekteve pa përdorur energjinë e muskujve. Kjo i shtyri shumë shkencëtarë të fillojnë eksperimentimet në laboratorë me mediume të ndryshme.

Ndër të parët mund të llogaritet William E. Cox, një bashkëpunëtor shumëvjeçar i Institutit prapsikologjik në Durhan, i cili zhvilloi eksperimente me një medium amerikan që bënte gjëra mahnitëse. Për të Coxi shkruante: „Gota me ujë ngritej nga tavolina dhe lëvizte në ajër para pjesëmarrësve; një karrige nga qoshku lëvizte ngadalë në drejtim të mesit të

dhomës; një tavolinë e kuzhinës u ngritë dy-tri herë nga dhjet centimetra mbi tokë etj. Dhe të gjitha këto ndodhën në dritë të plotë dhe unë ia mbaja mediumit duart dhe këmbët".

Eksperimente psikokinetike bëri edhe fizikani dhe profesori i astronomisë, njëherësh edhe themeluesi i astrofizikës, Friedrich Zöllner nga Leipcigu, me mediumin Henry Slade dhe erdhi në përfundime të njëjta. Një harmonikë e dorës binte pa prekjen e askujt, një krevat u largua për disa centimetra nga muri, etj.

Prof. A. Vencel, në librin e tij „Filozofia dhe liria", paraqet këtë tezë: „Shpirti dhe materia nuk janë parimisht të ndarë njëri nga tjetri. Materia ka shtresa të vogël të shpirtit dhe lirisë, për atë edhe dallimi në mes të shpirtërores dhe materiales është vetëm relativ". Edhe prof. J. B. Rhine, nga „Universiteti i Dukës" në Karolinën Veriore, gjatë eksperimenteve të veta, ka vërtetuar se ekziston ndikimi i shpirtit në materie dhe shpreh mendimin se: „shpirti si materie jofizike, kur vepron rrugës jofizike në ndonjë objekt fizik, prodhon efekte fizike".

Përkujtimorja e F. Zöllnerit në Leipzig

Prof. J. B. Rihne gjatë një eksperimenti psikokinetik

Kërkimet e Rhines për psikokinezën filluan në mënyrë të rastësishme. Atij, një ditë të vitit 1934, i erdhi në laborator një bixhozçi profesionist, duke e bindur se me anë të dëshirës është

në gjendje të ndikojë që katrorët të rrotullohen dhe ndalen në pozicionin që ai dëshiron. Për t'u ikur mashtrimeve, Rhine ndërtoi një aparat që i përziente vetë katrorët dhe i hidhëte pastaj një nga një.

Eksperimenti u përsërit disa herë dhe Rhine vërtetoi se bixhozçiu kishte me të vërtetë forcë psikokinetike. Rihne erdhi në përfundim, pas eksperimenteve të shumta, se: „psikokineza është një aftësi e përgjithshme njerëzore që buron nga faktorë të pavetëdijshëm, por që shfaqet në forma të ndryshe dhe ndikon në materie, e cila u dëshmua statistikisht edhe në kushte laboratorike".

Pak më ndryshe nga Rhine, me katrorë eksperimentoi edhe William Cox. Ai kërkonte nga subjekti që në katror të hedhur mbi tavolinën që rrotullohej, të ndikonte në atë mënyrë që katrori të rrotullohej nga ana e majtë ose e djathtë e tavolinës. Nga eksperimentet e zhvilluara, ai vërtetoi se efekti është i njëjtë, pa marrë parasysh se çfarë madhësie kanë katrorët dhe nëse është hedhur një katror apo disa përnjëherë.

Vite të tëra u eksperimentua me katrorë të përbërë nga materiale të llojllojshme, saqë në vitet e '70-ta për këtë eksperiment u shfrytëzuan edhe kompjuterët e kohës. Personi testues duhej që me forcën e mendim të ndikojë në katrorë (Psi-lojë me katrorë), që rrotulloheshin nga një mix-gjenerator, dhe t'i vendos në pozicionin e dëshiruar.

Gradualisht në eksperimente u futën elemente që zëvendësonin katrorët. Rënia e pikës së ujit nga maja e zhiletës (brisku i vogël për rrojë) në të majtë ose në të djathtë; ndikimi në tymin e mbyllur në një enë qelqi ose ndikimi psikomotorik (sisteme që sillen lehtë mekanikisht, që ndodhen të mbyllura në enë të qelqta)...

Fizikanët gjithnjë dyshonin në këto gjëra duke përmendur ndikimet e mundshme të rrymimit të ajrit (edhe pse këto ishin të mbyllura në enë të qelqta), të ndikimit të nxehtësisë, të elektricitetit e kështu me radhë. Të gjitha këto dyshime i largoi

në fillimi të viteve ’70 dr. Helmut Schmidt (amerikan me rrënjë gjermane), kërkues shkencor në „Laboratorin për plazmë fizike” të kompanisë së njohur për prodhimin e aeroplanëve „Boing” (SHBA). Dr. Schmidt u nis nga supozimi se psikokineza nuk ndikon vetëm në objektet e dukshme fizike, siç është katrori, por edhe në nivelin mikrofizik. Në konstruksionin e aparatit të vet për kërkime psikokinetike shfrytëzoi zbërthimin e atomit radioaktiv „strontium 90”. Bërthama atomike e tij është shumë jostabile, ashtu që zbërthehet edhe pas 30 vjetësh. Megjithatë, nga momenti i shkatërrimit, në bërthamë nuk vërehet kurrfarë procesi i dezintegrimit, ashtu që „papritmas” zbërthehet. Për psikokinezën përparësi plotësuese e kësaj paraqitjeje ishte se ky zbërthim ishte shumë vështirë të arrihej me mjete fizike, elektrike, magnetike, termike etj. Sipas fizikës bashkëkohore, zbërthimi radioaktiv është plotësisht rastësi dhe kështu është i paparashikueshëm.

Dr. Schmidti e shfrytëzoi këtë dukuri për të konstruktuar aparatin që mundësonte rastësi totale dhe absolute. Kur të zbërthehet atomi „strontium 90”, ai ndez elektronet, të cilat sillen rreth bërthamës me shpejtësi të madhe e që lëvizjet e tyre i regjistron gypi i Gajger-Müllerit. Brenda aparatit gjendet regjistruesi tjetër, i cili, kur është aparati i kyçur, gjithë kohën kalon me shpejtësi të madhe nëpër katër pozicione: 1, 2, 3, 4 e kështu me radhë. Treguesi është i kyçur në oscilator, që oscilon miliona herë në sekondë, kështu që edhe treguesi kalon nëpër katër pozicione me qindra-mijëra herë në sekondë. Secili nga këto katër pozicione është i lidhur me nga një poç dhe katër susta, të cilat subjekti mund t’i shtypë gjatë eksperimentit. Subjekti qëndron para aparatit dhe mundohet të ndikoj në aparat, ashtu që të ndizet njëri nga katër poçet. Derisa subjekti nuk ndërmerr asgjë, poçet nuk ndizen, edhe pse treguesi kalon katër pozicionet miliona herë në sekondë. Çfarë ndodh kur subjekti vendos të ndikojë psikokinetikisht në njërin nga poçet dhe ta shtyp sustën e përshtatshme. Kur elektroni tjetër arrin në gypin e

Gjager-Müllerit dhe ndalon treguesin oscilues në njërin nga katër pozicionet e mundshme, në të njëjtën kohë krijohet kontakti me poçin dhe poçi, që i përgjigjet pozicionit të mësipërm, ndizet. Në qoftë se subjekti arrin ta ndezë poçin në të cilin është koncentruar, makina e dr. Schmidtit, automatikisht regjistron në ekranin e jashtëm „goditjen", e në qoftë se jo, ajo regjistron „dështimin". Pasi ekzistojnë katër pozicione të oscilatorit dhe katër poçe, gjasat e goditjeve të rastësishme janë 1 me katër ose 0,25%.



Dr. Schmidti pranë aparatit të tij





Numëratori i „Geiger-Müllerit"

Aparati i Dr. Schmidtit ka rëndësi të posaçme për saktësinë e psikotronikës (parapsikologjisë). Edhe në qoftë se nuk është aty eksperimentuesi gjatë eksperimentit, subjekti nuk mund të mashtrojë, pasi që rezultatet regjistrohen në mënyrë elektronike dhe është e pamundur që të korrigjohen. Eksperimentuesi nuk ka nevojë që të luajë rolin e policit, ndërsa subjektet janë të liruara nga ndjeshmëritë e pakëndshme, duke i trajtuar ata si mashtrues potencialë. Aparati është i vogël dhe shumë praktik për bartje, kështu që eksperimenti mund të zhvillohet në rrethana që më së shumti u përgjigjen subjekteve.

Eksperimentet e dr. Schmidtit vërtetuan bindshëm tezën e dr. Rhines: ndikimi shpirtëror (psikik) në materie është real dhe

këtë aftësi e kanë shumica e njerëzve. Meqenëse devijimet nga normat shkencore ishin minimale, kjo bëri që shumë shkencëtarë ta pranojnë veprimin e saj. Ndërkohë për aparatin e dr. Schmidtit shfaqën interesim edhe organizatat nga lëmi i ekonomisë. Kështu që kompania „Boing", eksperimentoi me këtë aparat për të hulumtuar ndikimin e energjisë negative (psikike) në elektronikën e bordit të aeroplanit, të krijuar nga nervoza dhe paniku i ekuipazhit e i pasagjerëve në raste rreziku.

Shkencëtarët nuk u kënaqën vetëm më kaq. Ata shkuan edhe më larg: nëse psikokinetikisht mund të ndikohet mbi materie, atëherë përmes kësaj force del se mund të ndikohet edhe në qeliza dhe atome!

Dr. F. Karger

Në këtë drejtim i pari eksperimentoi profesori i fizikës dr. Friedbert Karger në Institutin për fizikë plazmore „Max-Planck" në Munih. Ai konstruktoi një aparat përmes të cilit mund të bëhej procesi i shpërbërjeve radioaktive. Për medium eksperimentues kishte zgjedhur M. Wittelmeyerin, që kishte arritur të krijojë famë për atësitë e tij psikokinetike. Në një dhomë eksperimentuese në bodrumet e Institutit „Max-Planck", ky duhej që përmes forcës së mendimit, të ndikojë në ngadalësimin e procesit shpërbërës radioaktiv ose në përshpejtimin e tij. Edhe pse ky eksperiment nuk pati sukses, rezultatet e tij mbetën në kuotën e rastësisë.

Eksperimente të ngjashme zhvilloi edhe biologu francez, Remy Chauvin me bashkëpunëtorin e tij, L. Genthon në Strassburg. Personat testues, që përgjithësisht ishin fëmijë dhe të rinj, duhej përmes koncentrimit të ndikonin në ngadalësimin ose përshpejtimin e shpërbërjes së një preparati të uraniumit, që matej gjithashtu, përmes aparatit të „Geigerit".

Dy 13 vjeçarë arritën në këtë eksperiment rezultate fascinuese, ku kuota e rastësisë ishte jashtëzakonisht e ulët, që sipas tij ishte padyshim forca psikokinetike ajo që kishte ndikuar

në këtë proces.

Në vitin 1983, biologët Christian Sengstag dhe Jörg Kallen në Qendrën biologjike të Baselit testuan forcën ndikuese psikokinetike edhe mbi bakteret. Si person testues kishin ftuar mediumin e njohur dhe shëruesen alternative, Joan Cark. Detyra e saj ishte që të ndikojë në zhvillimin e kulturave bakteriale (Escherchia coli), të cilat ishin përgatitur në shishe qelqi, pra të ndikonte në burimin e energjisë të tyre: glukozës dhe laktozës, derisa ato ndodheshin në fazën e shpërbërjes. Edhe pse në eksperimentin fillestar suksesi mungoi, në përpjekjen e dytë që u zhvillua një ditë më pas, eksperimenti u kurorëzua me sukses të plotë. Veprimi i forcës mendore në baktere u dëshmua edhe në shumë laboratorë të tjerë, ku si persona testues, përveç mediumeve me famë, merrnin pjesë edhe vetë studentët.

Parapërgatitjet për eksperiment

Joan Clark në veprim

Në vitet e ’90-ta, biologët rus, Tatjan Krendeleva dhe Sergei Pogosyan, nga Universiteti i Bio-fizikës në Moskë, zhvilluan një varg eksperimentesh edhe me qelizat nervore, të cilat rezultuan të suksesshme.

Kërkuesit gjithnjë po zbulojnë mënyra dhe aparate të reja për matjen e forcës psikotronike. Kështu, Herbert Benson në Laboratorin profizik në Daunton, konstruktoi aparatin, tek i cili personat psikokinetik ndikojnë në rrezet e dritës dhe provokojnë

lakueshmërinë. Pastaj, Targu dhe Pato (më 1977), në Institutin kërkues të Stenfordit, konstruktuan aparatin me të cilin matet ndikimi përmes rrezeve laser, etj.

FORCA E MENDIMIT

„Fenomeni shkencor pa përgjigje” - ky është titulli i një shkrimi në revistën „Biologjia bashkëkohore”, botuar më 1983, në të cilin bëhet fjalë për një vajzë 13-vjeçare, Johana Gajevski nga Polonia.

Kjo vajzë, me anë të mendimit lëviz enët e ndryshme: gotat ngriten në ajër, lakohen metalet etj. Forcën më të madhe të veprimit e ka sidomos para kohës së keqe me shi. Ekipi televiziv nga Katovica bëri incizimin e këtyre fragmenteve „fenomenale” në prani të policisë. Vajza ankohej shpesh për dhembje të kokës, ndërsa temperaturën e trupit e kishte të rritur në 41.6^0 C. Shoqata e Bioenergjisë nga Polonia formoi komisionin special për studimin e fenomeneve të kësaj vajze, në krye me prof. Leh Radvanskin.

Aftësi të mëdha psikotronike, që nga vitet e ‘60-ta, demonstroi edhe Nina Kulagina (Ninel Sergejewna Kulagina), një amvise nga Leningradi. Psikologu Leonid Wassiliew ishte i pari që zbuloi aftësitë e Kulaginas dhe eksperimentoi me të. Më vonë me Kulaginan u morën edhe Z. Rejdak, një mik i Wassiliewit nga Instituti për psikologji „Uktomskii Institut” në Leningrad... pastaj inxhinieri E. Naumov e shumë të tjerë. Ajo koncentrohej në objekte të lehta që ndodheshin mbi tavolinë, p.sh. në fije shkrepëseje, kuti të ndryshme metalike dhe, pas një kohe, ato fillonin të lëviznin. Demonstrimet e Kulaginas janë zhvilluar, jo vetëm në prani të shkencëtarëve sovjetikë, por edhe të atyre perëndimorë si: G. Pratt, Ch. Ransom etj. dhe, pothuajse shumica pret tyre janë incizuar drejtpërdrejt me videokamera. E njohur u bë me aftësinë e saj për të lëvizur treguesin magnetik të

kompasit. Është konstatuar se Kulaginan, gjatë këtyre demonstrimeve, e lodhë shumë koncentrimi - ia dobëson dukshëm organizmin, ndërsa pulsi i rritet deri në 240 rrahje në minutë. Jurij Kabzorjev thotë se te Kulagina është zbuluar „rrezatim" elektromagnetik, i cili shfaqet nëpërmjet duarve të saj.



N. Kulagina, me forcën e mendimeve lëvizë gjërat e imta



...këtu treguesin magnetik të kompasit

Gjithashtu nga Moska është e njohur edhe Alla Vinogradova, e cila me shikim lëviz topat e ping-pongut dhe gjëra tjera të lehta nga metali. Prof. Venjamin K. Pushkin eksperimentoi me këto fenomene dhe i regjistroi në video dhe fotoaparat. Përveç Vinogradovas, medium të rregullt e kishte edhe Boris Jermoljevin. Lënda levitonte derisa Jermolevi e mbante ajrin në mushkëri. Pushkini, në librin e tij „Parapsikologjia dhe psikologjia eksperimentale", këto paraqitje i shpjegon kështu: „Lënda leviton për shkak të ndikimit të ngarkesës së energjisë biologjike të simbolit të kundërt. Ngarkesa e njërit simbol gjendet në lëndë, ndërsa ngarkesa e simbolit tjetër vazhdon të rrezatojë nga duart".

Djuna gjatë eksperimentit me bretkosën

Është e njohur edhe shëruesja alternative nga Bashkimi Sovjetik, Djuna Dawidaschwili, e cila në kohën e pushtetit të

mëhershëm, gëzonte reputacionin që shumëkush vetëm mund ta ëndërronte. Klientë të saj zakonisht ishin njerëz të pasur ose pushtetarët e kohës. Në Institutin e Psikologjisë në Moskë, u vërtetua se forca e mendimit, përveç që mund të jetë e dobishme, gjithashtu mund të shkaktojë edhe lëndime serioze. Djuna arriti që me forcën e vet psikokinetike, nën vëzhgimin e ekspertëve, një bretkose t'ia ngadalësojë pulsin e zemrës dhe, në fund, ta ndalë atë përfundimisht.

Një djalosh i ri në vitet e '70-ta filloi ta tërheqë vëmendjen e shkencëtarëve. Uri Geller nga Izraeli kishte aftësi që me forcën e mendjes të deformojë metale si lugë, pirunë etj. Demonstrimet e tij u transmetuan drejtpërdrejt nga shumë emisione televizive. Ai fitoi famë të madhe kur shikuesit filluan të raportojnë se gjatë emisionit të Gellerit, por edhe pas tij, në mënyrë „paranormale" lakoheshin metale të ndryshme në shtëpitë e tyre. Shumë fizikanë që studiuan aftësitë telekinetike të Uri Gellerit, jo vetëm që shfaqen interesim për parapsikologjinë, por filluan të formulojnë edhe hipotezat dhe teoritë e para, me të cilat mundoheshin që fenomenin e psikokinezëz ta sqarojnë në baza shkencore. Me këtë edhe u hap një epokë e re në kërkimet psikike: një bashkëpunim i ngushtë mes fizikanëve dhe parapsikologëve.

Uri Geller

Në fillim të viteve '80, atëherë kur lakimi i pirunëve nga U. Geller kishe marr dhenë, në shumë shtete tjera u paraqiten mediume të reja, që posedonin këtë aftësi. Një demonstrim publik u zhvillua në verën e vitit 1982 në kongresin jubilar: 100

vjetorin e themelimit të shoqërisë „Society for Psychical Research” në Cambridge. Një amerikan i ri demonstroi dhe dëshmoi para shkencëtarëve dhe parapsikologëve të mbledhur aftësitë e forcës psikokinetike.

Në një tjetër Psi-kongres, në atë të Bazelit, gjithashtu u zhvillua një demonstrim publik i deformimit të metaleve, nën udhëheqjen e Eli Weidenfeldit. Prezent, si i interesuar ishte edhe shkencëtari i njohur i fizikes molekulare dhe atomike John Hasted nga Britania.

Në Gjermani demonstrime publike në lakimin dhe deformimin e metaleve, organizoi etnologu nga Boni, Water Frank, dhe atë me studentët e vet. Ai është i bindur se secili njeri posedon këtë aftësi „paranormale”, por tek dikush kjo forcë është më e theksuar. „Këtu nuk kemi të bëjmë me truke magjistarësh, por me energji të paanshme kozmike, e cila në formë të koncentruar, funksionon si një rrezatim laseri, përmes duarve tone deri tek caku i dëshiruar” - thot Frank.

Eli Weidenfeld duke udhëhequr Psi-Kongresin në Bazel të Zvicrës

John Hasted dhe Eli Weidenfeld e shikojnë lugën e lakuar

Jean Pierre Girard arriti të lakojë shkopin „AU4G”



Etnologu gjerman Water Frank

Jean Pierre Girard njihet si Uri Gelleri francez. Me këtë djalosh eksperimentuan Psi-hulumtuesit, Hans Beneder dhe Elmar Gruber. Ata, për eksperimentet e tyre përdorën shkopinj metalikë me legura të ndryshme, bile edhe me përmbajte plastmase dhe qelqi, për ta vërtetuar sa më mirë dhe sa më saktë fuqinë vepruese psikokinetike. Në më pak se tre minuta, vetëm duke i fërkuar lehtë, ai arrinte t’i lakojë shkopinjtë nga legurat e

ndryshme. Në një rast, ai arriti ta lakojë një shkop të tipi „AU4G” i cili kishte përmbajte të torsionit, e për lakimin e të cilit nevojitet fuqi prej disa tonelatash.

Riksi Markus, 65 vjeçare nga Londra, ka aftësi që vetëm me shikim - jo vetëm t’i qetësoj kafshët, por edhe t’i shtang gjatë lëvizjes. Qentë dhe macet, kur ajo i shikon intensivisht, nuk mund të bëjnë asnjë hap përpara. Kur vë „kontakt të syve” me shtazë, ato mbesin të ngulitura në vend. Zonja Markus gjithashtu shtangon edhe kërmijtë dhe derrat, ndërsa shtazët e mëdha vrullshëm i qetëson dhe qëndrojnë në vend për disa sekonda.

Lija Huanun: Njeri që fërgon peshkun në shuplakë të dorës

Lija Huanunin nga Kina, teknik në një fabrikë të pajisjeve elektronike, e quajnë njeriu-bateri, sepse trupi i tij është në gjendje të akumulojë energji elektrike dhe atë ta emitojë nëpërmjet duarve. Kjo energji është e ngrohtë deri në të masë, saqë Lija mund ta fërgojë peshkun në shuplak të dorës dhe dora e tij ta përballojë atë ngrohtësi normalisht.

Ekspertët që e kanë studiuar këtë veti jo të natyrshme, vërtetojnë se teli i bakrit në duart e Lijas pas pak kohe skuqet. Gjithashtu, Lija mund të përballojë tensionin deri në 600 voltë, duke mos luajtur qerpikun.

Mirko Gorxhualo, nga Italia, është fenomen në vete. Ai, edhe pa koncentrim, vetëm kur kalon nëpër dhomë, rrugë, etj. i lëviz gjërat që ndodhen afër tij: bien fotografitë nga muri, fluturojnë enët e ndryshme etj. E gjithë kjo ka filluar para kërshëndellave, thotë babai i djalit, Antonio Gorxhualo. Një vazo mbi raftin e librave bie pa e prekur askush. U habitëm, por nuk i dhamë rëndësi të madhe. Megjithatë, kjo ishte ndodhia e parë në seritë që do të pasojnë. Nga atëherë kemi pasur rastin të

shohim si pëlcet vazoja, si levitojnë enët, si fluturojnë sendet e ndryshme dhe përplasen në mur etj. Në fillim këto paraqitje nuk i lidhnim me djalin tonë. Më pas e kuptuam se ai është shkaku. Në një rast, kur ai sapo kaloi, u shemb fotografia nga muri. Familja jonë gjendet para një situata të rëndë - thotë babai i djalit. Ne nuk guxojmë të dalim askund me djalin. Në shtëpi, përveç mobilieve (të cilat nuk mund t'i lëvizë), të gjitha gjërat tjera i kemi larguar, si: fotografi, gota, pjata, karrige e dekorime tjera, kështu që të gjitha dhomat duken si të boshatisura. Ne kemi kërkuar ndihmë nga mjekët e ndryshëm, por rrugëdalje nga kjo situatë nuk kemi gjetur akoma.

Marta Makarova, nga Shqorska e Polonisë, që në vitin e pestë të jetës së saj filloi të demonstrojë fenomene parapsikologjike. Shuplakat e saj i tërheqin gjërat e metalta. Këtë dukuri i pari e vërejti daja i saj, por nuk u besonte syve të vet dhe i thirri të gjithë pjesëtarët e familjes, pastaj fqinjët, gazetarët, reporterët e televizionit etj. Një kohë, kjo vajzë aftësitë e veta i përdorte për t'i zbavitur të pranishmit, por më pas filluan t'i vijnë edhe njerëz të sëmurë, me bindjen se prekja e saj do t'u ndihmonte.

Monica Tejada duke demonstruar aftësitë psikokinetike

Monica Nieto Tejada, nga Caceresi i Spanjës Jugore, që nga mosha 4 vjeçare shprehte aftësi psikokinetike. Kjo jo vetëm që i deformonte metalet, ashtu si ia kërkonin ekspertët shkencorë, por kishte mundësi që metalin e deformuar ta kthente sërish në gjendjen fillestare. Tejadas i shkoi për dore që ta deformojë edhe metalin e vendosur brenda një sfere qelqi, pa e prekur fare atë. Aftësitë e veta kjo vajzë i demonstronte edhe para kamerave televizive, bie edhe para një ekipi televiziv nga Japonia. Pas mbarimit të eksperimentit nuk

ndjente asgjë të posaçme, asgjë të veçantë. Këto dukuri të pashpjegueshme, që i demonstronte në metale, kjo vajzë i konsideronte si burim nga vetvetja. Nuk u frikësohej atyre dhe këto dukuri i konsideronte si „dhuratë nga Zoti".

Që nga viti 1987, një grup specialistësh (nëntë shkencëtarë dhe një motër medicinale) nën udhëheqjen e Rafale R. Maradiaga, rregullisht, për disa vite u morën me rastin e kësaj vajze. Dhe të gjitha kërkimet konstatojnë se Monica është një vajzë në gjendje plotësisht normale (këtë e vërtetojnë edhe testet psikologjike të komisionit) sikurse të gjitha vajzat tjera, moshatare të saj. Shkon në kinema, teatër, shëtitje etj.

Ted Serios, është njëri ndër mediumet më me famë. Emri i tij u bë i njohur në të gjithë botën më 1963, kur një gazetë e njohur shkroi për herë të parë për të: „Ted Serios, qytetar i Çikagos, ka aftësinë që në filmin polaroid të paraqesë fotografinë, të cilën ai e mendon". Që nga ai publikim shumë hulumtues u drejtuan për tek ai. Një ndër ta ishte edhe prof. Jule Eisendud, profesor i psikologjisë në Denever. Prof. Eisenbudi eksperimentoi me Tedin afër 3 vjet. Gjatë seancave me të, gjithnjë thërriste edhe dëshmitarë, si fizikanë, psikologë, kimistë etj. Tedi para seancave pinte një sasi bukur të madhe të alkoolit, siç thoshte ai, për ta zhvilluar „disponimin krijues". Pastaj fillonte koncentrimin në detyrën e marrë nga prof. Eisendudi. Kamera polaroid qëndronte para tij, e kontrolluar dhe e rregulluar nga ekspertët. Kur Tedi konstatonte se erdhi koha, shikonte drejt në kamerë, pastaj lëshonte një zë të fortë dhe me dorën e djathtë jepte shenjë për incizim. Përdorej kamera polaroid pasi filmi zhvillohet drejtpërdrejt në kamerë, dhe me këtë edhe mënjanohej mundësia e manipulimit. Në to paraqiteshin motivet e ndryshme, si automobila, shtëpi, rrugë etj. Prof. Eisenbudi shkoi edhe më tej. Ai e mbylli Tedin në „Kafazin e Faradeit" (kafaz në formë të kutisë, i ndërtuar nga rrjetet metalike, të cilat refuzojnë valët elektrike), derisa kamera mbetej jashtë kafazit. Edhe përkundër kësaj, në film,

paraqiteshin fotografitë.

Një dokumentar me Ted Seriosin e regjistroi me kamera edhe televizioni „Berlini i lirë”. Pas një kohe të gjatë pritjeje, ekipi televiziv arriti të regjistroj 11 herë motivin e dëshiruar, që ishte një kafkë e njeriut parahistorik.

Ted Serios dhe disa nga fotografitë e bërë përmes forcës së mendimeve



Fotografia e bërë nga Ted Serios (a) Fotografia origjinale (b)

Mirëpo Tedi nuk ishte i vetmi „fotografues mendimesh”. Në Japoni, prof. i Universitetit Mbretëror të Tokios, Tomokichi Fukurai, zhvilloi eksperimente të tilla me mediumin Tenshin Takeuchi (por edhe të tjerë), dhe atë para daljes në skenë të Tedit. Me të, mund të thuhet, edhe filloi lindja e „fotografimit të mendimeve”.

Pas Fukurait, për këtë dukuri u eksperimentua dhe në Institutin „Insitut of Space-Medico Engingeerig (ISME) në Peking (Kinë). Në këtë institut, që është në varësi të ushtrisë, prof. i fizikës, Lin Shuhuang zhvilloi një varg eksperimentesh me testues të ndryshëm. Ndër më të talentuarit ishte mediumi Zhang Baosheng, i cili jo vetëm që kishte aftësi për lakimin e shufrave metalike, por ishte në gjendje të ndikojë edhe në gjallesa, si p.sh. në insekte të ndryshme.

Masuaki Kiyota nga Japonia që në moshën 14 vjeçare fitoi famë të madhe për aftësitë e tija, kur filloi sikurse edhe Gelleri të lakojë e deformojë lugë, pirunë ose pjesë tjera metalike. Ky djalosh, jo vetëm që kishte aftësi psikokinetike për lakimin e

metaleve, por u tregua edhe shumë i suksesshëm në „fotografimin e mendimeve”, dhe të gjitha eksperimentet u zhvilluan nën kontrollin e ekspertëve shkencorë. Edhe pse fotografitë nuk ishin aq të qarta, megjithatë vërehej dhe identifikohej pa dyshim objekti testues, p.sh. siç është fotografia e „Statujës se Lirisë”.



Masuaki Kiyota dhe gjërat metalike të deformuara prej tij si dhe „Statuja e Lirisë”, e realizuar me ndihmën e forcës së mendimit

Gjithashtu, edhe gjermani, Willi Schwanholz, që jetonte në Chicako, kishte aftësinë për të t’i bartur mendimet e tija në filmin polaroid. Edhe me këtë medium eksperimentoi Prof. Jule Eisenbud. Karakteristikë e regjistrimeve të tij ishin fotografitë multiplikative, të cilat sikurse në shiritat filmikë - një pas një, shtriheshin në fotografinë e zhvilluar.

W. Schwanholz gjatë eksperimentimit me prof. Jule Eisenbud-in



Një nga fotografitë e shumta „multiplikative”

Dr. Xhulian Ajsak, nga Universiteti i Antonios (Angli) eksperimentoi me mbi 500 mediume dhe zbuloi se çdo i dhjeti

mund të lakojë metale, pa i prekur fare. Ai vërtetoi se suksesi i psikokinezës dhe aftësitë e mendimit varen nga tre elementë: nga besimi, gjegjësisht forca e besimit se psikokineza ekziston; nga relaksimi psikik si dhe nga gjendja emocionale e mediumit.

Kërkuesit francezë kanë konstatuar se organizmi njerëzor, posaçërisht shpirti njerëzor (pavarësisht nga truri material) emiton rreze psikike, të cilat kanë veti të mjaftueshme fizike për të krijuar fotografi.

Ne njohim gravitacionin, radioaktivitetin, energjinë nukleare, rrezet elektromagnetike etj. Gravitacioni është i dobët për lëvizje të këtij lloji. Radioaktiviteti këtu nuk paraqitet si ndërmjetësues, sepse numëruesi i „Gajgerit" nuk reagon. Forca nukleare i mban grumbull grimcat e bërthamës së atomit dhe ndikon në largësi të vogël. Por për këtë, rrezet elektromagnetike, të cilat formojnë vibrimin e elektroneve në atom, mund të ndikojnë edhe në largësi të mëdha. Është e mundur që në këtë spektër të gjerë të rrezeve elektromagnetike të ekzistojnë edhe disa forca të panjohura të rrezatimeve, të cilat janë të afta që në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndikojnë në strukturën e materies, që ta zbusin, deformojnë dhe të shkaktojnë lakimin e saj.

Një grup shkencëtarësh nga Amerika dhe Danimarka, kanë ndërtuar një model të hapësirës tetëdimenzionale, me ndihmën e të cilit, në mënyrë hipotetike, mund të shpjegohen mekanizmat psikokinetikë të lakimit të metaleve. Supozimi themelor i kësaj hipoteze është se shpirti ynë (energjia e trurit tonë) mund, në ndonjë mënyrë, t'i sillet rrotull ndonjë ligji tjetër termodinamik, në të cilin thuhet se të gjitha sistemet e nxehtësisë humbin energjinë me procesin irevesibil (të pakthyeshëm), të quajtur „entropi". Shpirti ynë, ndoshta, „tërheq" energjinë nga ambienti i vet me ndonjë lloj të entropisë negative, të cilën, Ilija Pregogin, fitues i Çmimit Nobel për fizikë më 1977, e quajti „Negentropi". Mendimi, me fjalë të tjera, e tërheq energjinë nga fusha energjetike, e cila ekziston rreth secilit njeri e kjo energji pastaj fokusohet si forcë për lakimin e metaleve.

Akademiku sovjetik M. Mikulin, konsideron se tek njeriu ekziston forcë e fshehur, e cila duhet të studiohet ose, siç thotë Kolin Vilsni, „ekzistojnë shumë fenomene, të cilat qëndrojnë jashtë paradigmës së shkencës moderne”.


Sabir
Krasniqi
94.

TELEPATIA

Telepatia ose biokmunikimi është njëri nga fenomenet shumë të njohura të lëmit të parapsikologjisë ose psikotronikës. Fjala „telepati” rrjedh nga gjuha e vjetër greke dhe do të thotë: „tele” - largësi dhe „pathe” - ndjeshmëri. Si themelues i saj njihet Fredrick Meiers, që është edhe njëri ndër themeluesit e Shoqatës Britanike për Kërkime Psikike, qysh në vitin 1882.

Ç’është në të vërtetë telepatia? Telepatia mund të definohet si një manifestim psikotronik gjatë të cilit vrojtohen mendimet, fotografitë psikike, dërgesa sensibël e një personi, respektivisht e dërguesit, nga ana e një personi tjetër, që në këtë rast është pranuesi. Këto mendime, kjo dërgesë sensibël që emetohet vetëdijshëm apo pavetëdijshëm nga dërguesi, është e „shpërndarë” në hapësirë, ashtu që me pesë shqisat normale të komunikimit, të cilat ne si qenie njerëzore i posedojmë, nuk është e mundur të pranohen dhe me to të komunikojmë. Pra, mund të thuhet se telepatia është komunikim valor i dy qenieve pa kontakt fizik, pa fjalë, por vetëm me anë të mendimit, pavarësisht largësisë së tyre.



Aftësi të komunikimit telepatik kanë të gjitha qeniet e gjalla, por ato që e kanë më të zhvilluar aftësinë e emetimit të

„neuro-rrezeve”, e kanë më të theksuar këtë dukuri. Vetë jeta është e mbushur plot me raste telepatike, të cilat paraqiten në mënyrë spontane midis personave që janë të lidhur ngushtë emocionalisht siç është rasti i nënës dhe fëmijës, motrës e vëllait, burrit e gruas etj.

Komunikimi telepatik, emetimi dhe pranimi i rrezeve, paraqet fundamentin në formimin e marrëdhënieve midis prindërit dhe fëmijës. Dashuria në mes nënës dhe fëmijës është e formuar kryesisht në parimet telepatike. Komunikimet telepatike ekzistojnë më së shpeshti në vitin e parë të jetës, kur fëmija nuk mund të flasë e dashuria në mes të nënës dhe fëmijës nuk është e „vetëdijshme” ose funksion i dëshiruar. Ky është një fenomen, po e quaj „jashtëshqisor”, i cili mund të shpjegohet vetëm si lidhje telepatike. Pa këso lidhjesh nuk do të ekzistonte as dashuria e vërtetë.

Gjatë luftës së dytë botërore kemi rastin e një nëne të një luftëtari në front, e cila papritur ndien dhembje në gjoks dhe bërtet: „Biro, të vrau armiku!” Lajmin për vdekjen e të birit, të cilin e mori më vonë, përputhej plotësisht me atë ditë dhe atë moment kur edhe iu kishte lajmëruar dhembja në gjoks. Rasti i mësipërm është vetëm një, nga shumë raste të ngjashme që na ndodhin në përditshmërinë tonë, por që ne i interpretojmë ato, varësisht prej bindjeve dhe këndvështrimeve tona.

Gati në të gjitha vdekjet, në çastin kur ndërron jetë i dashuri i tyre, të afërmit e familjes në mënyra të ndryshme e ndjejnë këtë. Këtë fenomen e sqaron edhe psikologu i njohur K. Jungu në teorinë e tij të sinkronicitetit, por edhe populli ynë i njeh shumë mirë koto shenja, që zakonisht quhen „isharete” (arab, isara - shenjë).

Kërkimet e ndryshme, për sqarimin e telepatisë në mënyrë shkencore, kanë filluar që nga koha e Mesmerit, Pjer Zhanas,

Sharl Rishees e vazhdojnë dhe në ditët tona. Tentativa e parë fillon me Mesmerin. Edhe telepatinë, sikurse të gjitha fenomenet e parapsikologjisë, ai e shpjegon si dërgim të informacioneve nëpërmjet energjisë magnetike universale, e cila i lidhë të gjitha qeniet e gjalla. Telepatia e tërhiqte vëmendjen e Mesmerit, sepse edhe ajo, si shumë dukuri jashtëshqisore, paraqitej shpesh gjatë gjendjes hipnotike. Mesmeri edhe mendonte se telepatia paraqitet vetëm gjatë gjendjes hipnotike.

Më vonë, Sharl Rishe - shkencëtar francez, fitues i Çmimit Nobel për fiziologji, vërtetoi në mënyrë eksperimentale se telepatia është e ndarë nga hipnoza, por në gjendje hipnotike ajo është më e theksuar dhe veprimi i saj është më i suksesshëm.

Bashkëkohësi i tij, O. Zhana, gjatë eksperimenteve mjaft interesante arriti që të provokojë hipnozë në largësi, nëpërmjet sinjaleve telepatike. Për fat të keq, Zhane nuk tentoi që t'i komentojë këto eksperimente, sepse frikësohej se do të rrezikonte autoritetin e shkencëtarit serioz. Eksperimente të ngjashme bëri edhe Henri Didwick. I hipnotizuari i vizualizonte numrat e zgjedhur dyshifrorë dhe në mënyrë telepatike ia dërgonte subjektit tjetër. Deklarata e tij për këtë eksperiment hyri në histori të parapsikologjisë si deklaratë e parë shkencore e këtij lloji.





Upton Sinkler me të shoqen Meri dhe libri i tij „Radioja mentale"

Eksperimente intensive, në fillim të viteve '30, zhvilloi edhe shkrimtari Upton Sinkler me të shoqen Meri K. Sinkler.

Uptoni vizatonte figura të ndryshme, ndërsa e shoqja mundohej që t'i pranonte në mënyrë telepatike dhe t'i reprodukonte. Në serinë prej 290 provave, arriti në 23% të rasteve rezultate të sakta; 53% rezultate të pjesshme dhe 24% të gabuara. Eksperimentet e Sinklerit bëheshin nën kontroll të plotë. Në disa raste përputhja e vizatimeve ishte plotësisht e saktë, ashtu që edhe gjeniu Albert Ajnshtajn, që ishte prezent në disa eksperimente, u magjeps aq shumë saqë ia shkroi edhe parathënien e librit të Sinklerit, „Radioja Mentale", në të cilën janë paraqitur të gjitha rezultatet e eksperimenteve.

Uejtili Kerington, mik i afërt i Frojdit, përdori një metodë tjetër të eksperimentimit. Ai merrej vesh me disa pranues të valëve, të shpërndarë nëpër vende të ndryshme të Britanisë së Madhe, që në kohë të caktuar t'i pranojnë në mënyrë telepatike mesazhet e tij. Në kohën e caktuar e hapte fjalorin dhe e zgjedhte një fjalë, e cila mund të paraqitej edhe në mënyrë figurative. E vizatonte në një letër dhe pastaj, me orvatje shpirtërore, mundohej t'ua emetonte pranuesve. Rezultatet i vlerësonte duke i shikuar të gjitha përgjigjet dhe secilës ia jepte vlerën e vet. Në çoftë se objekti i vizatuar ishte „molla" atëherë „dardha", si përgjigje, kishte vlerë më të madhe se sa „rrushi", ndërsa „rrushi" kishte vlerën më të madhe se sa ndonjë objekt statik etj.

Mungesë e eksperimentit të tij ishte se personi i njëjtë, d.m.th. vetë Keringtoni ishte eksperimentuesi dhe vlerësuesi i përgjigjeve, sepse subjektet shpesh nuk kontaktonin në kohën e njëjtë dhe ai nuk mund t'i kontrollonte.

Këtë mungesë, si dhe shumë të tjera, i plotësoi Rajni. Ai i mbante nën kontroll të gjitha ndryshimet e rëndësishëm. Rajni i pari i përdori me të madhe të ashtuquajturat „letrat e Zenerit". Ky është një komplet i përbërë nga 25 letra, të cilat ndahen në 5 pjesë, dhe secila nga këto pjesë përmban nga një simbol grafik. Në qoftë se gjatë eksperimentimit subjekti i qëllon letrat, në bazë të rastësisë eventuale pa pjesëmarrje të telepatisë, atëherë

probabiliteti do të jetë 1:5 ose 20%. Secila e qëlluar tjetër, mbi këtë mesatare, është e rëndësishme.

Letrat e J. Lozanovit

Letrat e S. Manczarskit

Letrat e Zenerit

Duke komentuar punën dhe rezultatet e prof. Rajnit dhe të bashkëpunëtorëve të tij, si dhe të Tajerit, të Kringtonit e shumë të tjerëve, dr. Taules arriti në përfundim se këto eksperimente „kanë larguar çdo dyshim mbi ekzistencën e telepatisë dhe kanë mundësuar që ajo të paraqitet me metoda eksperimentale”...

RASTI MESING

Një ndër telepatët më në zë ishte Wolf Gregorevich Messing (1899 - 1974). Aftësitë e tij telepatike i zbuloi rastësisht, në moshën 11 vjeçare, kur pa dashje largohet nga prindërit dhe hipën në trenin që udhëtonte në relacionin Varshavë - Berlin. Pasi nuk kishte biletë udhëtimi futet nën karrige, por kontrollori e kap dhe i kërkon biletën. Mesingu i vogël e sheh në dysheme një copë letër të thjeshtë, e kap atë dhe ia jep kontrollorit, duke u koncentruar në atë letër me bindje të thellë se ajo është biletë. Kontrollori e merr letrën, e shikon dhe i thotë: „Pse rri nën karrige pasi e ke biletën?”

Në Berlin, Mesingu bie në kontakt me prof. Abelin, psikiatër i njohur, i cili i vëren aftësitë e tij dhe së bashku me kolegun e tij, prof. Schmitin, e marrin nën mbikëqyrje. Më vonë Mesingu nis punën në një cirk të quajtur „BUSH” dhe kështu fillon turnetë e tij nëpër Evropë. Gjatë një manifestimi në Vjenë për Mesingun u interesua edhe Ajshtajni, i cili Mesingun e dërgoi tek Frojdi. Te dy këta shkencëtarë punuan mjaft me të. Me Frojdin mesingu qëndroi disa vite në shoqëri, i cili ia mësoi

metodat e koncentrimit dhe autohipnozën. Ja një eksperiment interesant që e bënë Frojdi dhe Ajnshtajni me Mesingun: Frojdi e urdhëroi në mënyrë telepatike: „Shko në banjë, merre pincetën dhe shkulja tri qime nga mustaqet Ajnshtajnit!”. Mesingu u mendua pak, pastaj shkoi në banjë, mori pincetën dhe iu afrua Ajnshtajnit duke i thënë: „Më falni, por duhet ta zbatoj urdhrin”, ndërsa të dy shkencëtarët ia plasën të qeshurit, duke admiruar aftësitë e tij. Pastaj pason urdhri tjetër i Frojdit (me mendime): „Merre violinën dhe jepja Ajnshtajnit që t’i bie”. Edhe këtë urdhër Mesingu e zbatoi me përpikëri. Kur po largohej nga Berlini Ajnshtajni i thotë: „Në qoftë se gjendesh në situata të palakmueshme, mu lajmëro lirisht.”

Më 1923, Mesingu takohet me M. Gandin. Edhe Gandi mbetet i kënaqur me detyrën që ia parashtroi: që ta merrte fyellin dhe t’ia jepte indianit që gjendej aty afër. Mesingu ia jep fyellin,pastaj indiani fillon t’i bie, ndërsa nga një gyp aty afër fillon të dalë një gjarpër, i cili lëvizte sipas melodisë.

Një nga eksperimentet mjaft interesante është ai i vozitjes së automobilit me sy mbyllur. Afër tij qëndronte një vozitës profesional, i cili e kishte për detyrë që t’ia tregonte rrugën me anë të mendimeve. E gjithë kjo u bë nën kontroll të caktuar. Mesingu kishte vozitur pa problem, edhe pse vozitjen e njihte shumë pak.

Pas agresionit gjerman mbi Poloninë, Mesingu kaloi në Rusi. Atje qëndroi deri në fund të jetës. Një ditë, me rastin e një manifestimi, Mesingun e marrin dy vetë dhe e dërgojnë tek Stalini. Disa herë takohet me Stalinin. Stalini eksperimentoi me aftësitë e tij, nën kontroll të policisë. Njëra ndër detyrat ishte edhe plaçkitja e bankës (100.000 rubla) përmes një letre të

thjeshtë. Mesingu e merr një copë letre nga një fletore e thjeshtë dhe i afrohet arkëtarit duke u koncentruar. Me anë të mendimit i sugjeron se kjo letër është çek më vlerë prej 100.000 rublash dhe ai duhet t'ia jepte. Kur u krye gjithë ceremonia, në prani të dëshmitarëve, Mesingu kthehet tek arkëtari me të hollat dhe ia shpjegon se çfarë kishte ndodhur. Arkëtari e shikon me dyshim, por kur i kontrollon çeqet, shef se në mes tyre gjendej me të vërtet një copë letër e thjesht dhe kur sheh të hollat e palosura në çantën e Mesingut, i bie të fikët.



Një libër për Mesingun i shkruar nga T. Kupers

Testi tjetër ishte edhe më i rëndë. Ai duhej që pa leje të hynte në vilën e një personaliteti të lartë sovjetik, e cila ishte e ruajtur nga rojet. Mesingu afrohet tek vila, koncentrohet duke iu sugjeruar rojeve: „Unë jam Berija, unë jam Berija, më lëshoni të hyjë!"(Berija ishte udhëheqës në zë i NKVD-së). Dhe vërtet, rojtarët e lejojnë, pa fjalë, që të hynte brenda në vilë.

Këto eksperimente në Moskë Mesingut i sjellin famë të posaçme dhe qeveria i jep leje për manifestime të lira nëpër gjithë territorin e Bashkimit Sovjetik.

Ky ishte vetëm një ndër rastet e shumta të kësaj dukurie.

DISA SHPJEGIME SHTESË MBI TELEPATINË

Problemi teorik themelor është se si telepatia mund të funksionojë, ndonëse ka barriera hapësinore e materiale, të cilat pengojnë format tjera të komunikimit. Shumica e kërkimeve sjellin si përfundim se për telepatinë nuk ka pengesa! Kontaktet telepatike mund të vendosen me subjekt edhe në nëndetëse, në thellësi deri në 3000 metra, si dhe në largësi nga dërguesi disa mijëra kilometra.

Numri më i madh i shkencëtarëve paraqesin teorinë se esenca e telepatisë është në bartjen e energjisë nga njëri sistem nervor në tjetrin, siç bëhet bartja në mes dy radiostacioneve. Duke pasur parasysh se kërkimet elektroencofalografike kanë treguar se masa e trurit emeton valë me frekuenca të ndryshme, supozohet se mendimet e caktuara kanë valë të caktuara me karakteristika ende të pazbuluara dhe që mesazhet barten me anë të këtyre valëve, dhe në trurin pranues deshifrohen.

Një variant i kësaj teorie është hipoteza e Kozinskit, sipas së cilës themelore në telepati është elektroinduksioni, në të cilin valët elektromagnetike induktojnë gjendjen e dëshiruar në trurin pranues.

Këtë teori e demanton plotësisht me eksperimentet e tij Leonid Vasiljev më 1963. Vasiljev i hipnotizonte subjektet dhe i fuste në kafazin e Faradeit, i cili eliminon plotësisht bartjen e valëve elektromagnetike. Kjo situatë nuk ndikonte fare në sugjestionet telepatike, kështu që, sot, teoria elektromagnetike mbi telepatinë konsiderohet si e pavlerë.

Roli, më 1966, në veprën e tij „Perceptimet jashtëshqisore dhe të mbajturit mend” jep teorinë e fushës psikike. Sipas asaj teorie, secili objekt dhe secila qenie e gjallë e ka fushën psikike, ngjashëm me gravitacionin (fusha gravituese ndikon pa marrë parasysh pengesat dhe izolimet). Ajo çfarë ndodh në një fushë

psikike, dyfishohet në fushën tjetër. Dobësia e vetme e kësaj teorie qëndron në atë se njëra dukuri - telepatia, shpjegohet me dukurinë tjetër - gravitacionin, i cili edhe sot e kësaj dite nuk është i sqaruar plotësisht.

Zbulimi i një numri të madh të grimcave elementare në fizikën atomike kishte rëndësi edhe për psikotronikën. Kështu, Artur Kestler në veprën „Rrënjët e koincidencës", solli mendimin e disa fizikanëve se ekziston grimca elementare e posaçme e quajtur PSITRON, e cila është bartëse e informatave në territorin e perceptimeve jashtëshqisore. Me gjithë arritjet e fizikës moderne atomike, kjo hipotezë nuk na afron drejt sqarimit derisa të mos zbulohet ajo grimcë.

Gardner Marfi, në sqarimin e telepatisë, thekson rëndësinë e marrëdhënieve personale mes dërguesit dhe pranuesit të valëve telepatike. Gjendja e ndryshuar psikike zvogëlon vetëdijen dhe i afron qeniet njerëzore njërën pranë tjetrës më shumë se që është e mundur gjatë gjendjes sonë „normale". Marfi posaçërisht thekson se dërguesi dhe pranuesi, respektivisht vetë mundësia e manifestimit të telepatisë, paraqet një fazë më të thellë të organizmit të përgjithshëm të vetëdijeve tona si dhe nivelin e ndikimit intim në shtresat më të thella, në të cilat fenomenet paranormale ndodhin. Duke u thelluar në shtresat e thella, të vetat, individi largohet nga e vetëdijshmja, me ç'rast shfaqen horizonte e përmasa të reja, të mjaftueshme për arritjen e kontaktit me dukuri reale, të cilat e tejkalojnë kohën dhe hapësirën.



Sipas Teorisë së Sinkronicitetit, të cilën e formuloi K. G. Jungu, përveç arsyes së lidhjeve kauzale në mes të paraqitjeve në natyrë, ekzistojnë edhe lidhje sinkronike akauzale, të cilat i lidhin dy dukuri me përmbajtje të njëjtë të kuptimit. Sipas Jungut, i cili në formulimin e kësaj teorie u frymëzua nga sistemi i vjetër kinez „JI-Xhing", gjithçka që ndodh në një

moment të caktuar, përmban karakteristikat e pandara të atij momenti. Fenomene sinkronike paraqiten në gjendje të ulët të vetëdijes dhe janë të ngarkuara me emocione, siç janë: ëndrrat, gjendjet meditative, sëmundjet shpirtërore e të ngjashme. Në ato raste përmbajtja e vetëdijes së emetuesit dha pranuesit në telepati janë të njëjta për nga kuptimi, sepse përmbajtja e njëjtë ose e ngjashme paraqitet në momentin e njëjtë tek te dy. Teoria e sinkronicitetit sqaron edhe shumë dukuri tjera nga jeta, p.sh.: lindja e ideve njëkohësisht te dy persona ose dukuria e njohur kur dikush „na merr fjalën nga goja," etj. Edhe pse kjo teori, në këtë periudhë, është njëra nga më të pranuarat në kuadrin e teorive tjera, prapëseprapë është larg sqarimit të plotë të fenomenit të quajtur Telepati.



Si përfundim mund të thuhet se shumica e eksperimenteve të psikotronikës, tregojnë se perceptimet jashtëshqisore janë procese të komunikimit të materieve të gjalla e jo vetëm të qenieve njerëzore. Kjo na bie deri te supozimi se telepatia është proces themelor i interaksionit tonë me rrethin, eventualisht më i vjetër se sa komunikimi verbal, përmes të cilit komunikojmë ne sot. Kjo dukuri gradualisht u zhduk me zhvillimin e funksioneve, të cilat e zëvendësuan dhe e lanë të shtyrë në prapavijë, sepse organet shqisore dhe funksioni i të folurit janë më të përshtatshëm për komunikim dhe veprim në rreth. Megjithëkëtë, perceptimet jashtëshqisore nuk u zhdukën, por vetëm u mënjanuan dhe, në gjendje kur humbet kontrolli i qendrave të larat të vetëdijes, siç janë rastet e rreziqeve për jetë, tronditjet e thella shpirtërore etj., këto funksione dhe mekanizma jashtëshqisorë, të lënë anash, aktivizohen.



ALKIMIA

„ARTI I TRANSFORMIMIT!”

Që nga zanafilla e krijimit të tij, njeriu ka qenë gjithnjë në kërkim të gjetjes së formave të mundshme transformuese, si për shpirtëroren ashtu dhe për materialen, në kërkim të një mrekullie e cila do t'i mundësonte atij jetë parajsore, jetë të amshueshme! Sado që duket paradoksale, megjithatë, këto përpjekje nuk kanë reshtur deri më ditët e sotme dhe do të vazhdojnë, ndoshta me intensitet edhe më të shtur, derisa të frymojë kjo specie e quajtur njeri.

Gjërat që dikur lidheshin me misticizmin, sot janë bërë avangardë e shkencës së sofistikuar, e një ndër to është edhe Alkimia.

Sa herë që lakohet ky nocion zakonisht ndërlidhet me ritualet e lashta okultike në të cilat alkimisti, metalet e zakonta, arrinte t'i transformonte në metale të çmuara, gjegjësisht në ar, si dhe me sekretin e eliksirit - pijes magjike, barit të mrekullueshëm, substancës që dhuronte jetën e amshuar!...

Por ç'është në fakt alkimia?

Alkimia është një veprimtari mjaft komplekse që zanafillën e ka shumë shekuj para erës sonë. Veprimtari që merrej me vëzhgimet, me fenomenet e natyrës dhe filozofisë, e cila ndërthurte në vete elemente të disa fushave, si: kimisë, fizikës, astrologjisë, artit, metalurgjisë, mjekësisë, misticizmit, fesë etj., dhe nga e cila, në shekujt 17 dhe 18, u krijua kimia dhe farmakologjia moderne. Pra, është shkëndija, brumi, burimi fillestar i këtyre dy degëve shumë të rëndësishme të shkencës së sotme.

Fjala alkimi rrjedh nga arabishtja - „al-ḫīmiyā” (الخيمياء) ose „al-kīmiyā” (الكيمياء). Arabët, pas pushtimit të Egjiptit, i morën

këto njohuri duke i zhvilluar edhe më tej, dhe i dhanë emërtimin e mësipërm. Supozohet se ky nocion „kīmiyā” është bartur nga fjala greke „chymeia” (χυμεία), që do të thotë, kimia. Megjithatë, interpretimi ose zbërthimi i domethënies së kësaj fjale, në fakt, është aq i shumanshëm sa edhe vetë alkimia. „Al” është një artikulim arab, ndërsa „Kemet” është një shprehje egjiptiane për „të zezën”, që ka kuptimin - „tokë e zezë”, e që lidhet me tokën e pëlleshme brigjeve të Nilit. „Toka e zezë” simbolizon edhe bazamentin e veprimtarive të para të praktikuara në fushën e alkimisë por, po ashtu, „Toka e zezë” është edhe emërtimi i hershëm i Egjiptit të sotëm. Për këtë alkimia edhe njihet si „Arti i egjiptianëve”. Ndërsa nocioni grek „chymeia” ka kuptimin e „shkrirjes, tretjes” dhe në këtë kontekst alkimia mund të quhet si „Doktrina e shkrirjes”.

Si baba i alkimisë konsiderohet Hermesi. Hermesi është emër i greqizuar i perëndisë egjiptiane - Thoti, i cili konsiderohet pionier i shumë shkencave e shkathtësive të tjera, e në veçanti i alkimisë. Edhe këtu kemi një shkrirje te dy zotave, atij grek - Hermesit, dhe atij egjiptas - Thotit.



Hermesi - Thoti

Tabula Smaragdina - Ilustrim

Teksti fillestar i alkimisë supozohet të jetë tabela „Tabula Smaragdina” që paraqet edhe bazamentin e hermetizmit, e quajtur ndryshe edhe si „Bibla e hermetizmit”, e përpiluar nga

Hermesi ose Thoti. Kjo tabelë përmban 15 fjali (radhitje), nga e cila më e njohura është fjalia e dytë në të cilën thuhet: „Ajo që është poshtë, është e njëjtë me atë që është lart. Dhe ajo që është lart, është e njëjtë me atë që është poshtë, për t'i përmbushur veprat e mrekullueshme të një gjëje të vetme.”

Një burim shumë i rëndësishëm, ndoshta ndër më të rëndësishmit për alkimistët deri më sot, është filozofia e natyrës antike greke dhe mësimet për katër elementët themelorë: ajrit, zjarrit, ujit dhe tokës (dheut). Mësimet për këta katër elementë, ose teoritë rreth këtyre katër elementeve themelore, në fakt, së pari u përmendën nga filozofët: Thales von Milet, Anaxsimenes dhe Herakliti, të cilët i përshkruan si elemente të veçuara. Më vonë u përpunuan nga Empedoklesi si dhe filozofët e famshëm Platoni dhe Arsitoteli, ku iu shtua edhe elementi i pestë, ai eterik (akasha). Besohej se të gjitha gjërat përmbajnë në vete këta katër përbërës të përzier në përpjesëtime të ndryshme dhe, varësisht prej ndryshimit të përpjesëtimit të tyre, mund të transformohen të gjitha gjërat dhe të marrin formë dhe përmbajtje tjetër.

Në alkimi, mësimet për këto elemente kanë kuptim të dyfishtë, edhe pse pothuajse gjithnjë kur flitet për „Alkimi” mendohet në elemente materiale. Në fakt, në planin fizik, këta elementë përbëhen nga molekulat, kripërat, mineralet, gazrat, avulli, tymi, humusi, rëra, gurët etj., dhe në këtë gjendje agregate përdorej përzierja e tyre në përpjesëtime të caktuara për arritjen e substancës së veçantë, lëndës së dëshiruar ose „lëndës së parë”, që ndryshe quhej edhe „Guri i dijes” ose „Guri i Filozofit”. Ky „gur” kishte fuqi që metalet e zakonta t'i shndërrojë në metale me vlerë, që zakonisht synim ishte ari, pasi ari konsiderohej si produkti më me vlerë në njërën anë dhe në anën tjetër ari, me gjithë shkëlqimin dhe pastërtinë e tij, pasqyronte përsosmërinë e Perëndisë. Po ashtu, me anë të këtij „guri”, nga këta katër elementë themelorë: ajri, zjarri, uji dhe toka, nga përzierja e tyre, mund të prodhohej edhe „bari i përjetësisë” ose „eliksiri i jetës”, i cili do t'i mundësonte

përdoruesit që të rinohet, ta „shtyjë” vdekjen ose, sipas disa burimeve, të arrijë edhe pavdekësinë. Megjithatë, në esencë, mjeshtëria kulminante e alkimisë, për të cilën shumë pak flitet e shkruhet, ishte transformimi shpirtëror.



Në këtë plan, pra në planin shpirtëror, këto elemente reale të tokës, që mbajnë të njëjtin emër, e humbin kuptimi fizik. Këto elemente nuk janë më në gjendja agregate, ato kalojnë nga gjendja inferiore në një gjendje më superiore; ato tashmë shfaqen si energji e përgjithshme kozmike. Me energji kozmike nënkuptojmë mënyrën, në të cilën shfaqet kjo energji hyjnore në universin dhe njeriun. Këto katër elemente kozmike nuk janë forca kozmike, por mënyra të shfaqjes në universin e pafund nga mijëra anë dhe përthyerja e tyre në dijen e njeriut, nga ana tjetër. Ato janë dukuri me të cilat forcat kozmike paraqiten dhe ndryshojnë, duke kaluar nga një gjendje në tjetrën.

ALKIMIA NË PLANIN FIZIK

Alkimistët konsiderohen hulumtuesit (shkencëtarët) e parë në histori, të cilët eksploruan natyrën sistematikisht. Ndryshe nga kimistët e sotëm, të cilët janë të përqendruar vetëm në këtë profesion, alkimistët ishin edhe filozofë, edhe astrologë, edhe metalurgë, edhe fizikanë, edhe mjekë, edhe artistë por edhe magjistarë dhe, falë njohurive të tyre, shumë nga ta, njihen si pionier të shkencave të sotme moderne.

„Përfytyrimi ynë i gabuara për alkimistët si kokëkrisur është një skandal. Këta shkencëtarë sot do të përbënin një

skuadër bartësish të „Çmimit Nobel”” - thotë historiani Bill Newman. Newmani, gjatë kërkimeve të veta në këtë fushë zbulon se, jo vetëm hulumtues të panjohur, por edhe shkencëtarë me famë janë marr intensivisht me „artin e transformimit” e një ndër ta është edhe fizikani i njohur ose, siç quhet „babai i fizikës”, Isak Njuton (Isaac Newton), i njohur për zbulimin e teleskopit të parë me pasqyra - teleskopin reflektues, i cili edhe sot është në përdorim; zbulimin e llogaritjeve integrale (matematikë)... por, ndër sukseset më të njohura të tij konsiderohet formulimi i ligjeve të lëvizjes së trupave fizikë dhe ai i gravitacionin kozmik. Njutoni, deri në fund të jetës së tij, ishte një hulumtues i pasionuar i fushës së alkimisë, por zbulimet e tij në këtë drejtim i mbajti sekret! Jo nga frika se do të akuzohej, as që do të përqeshej, por nga frika e keqpërdorimit të njohurive të zbuluara prej tij. Në fakt, alkimia edhe konsiderohej dije sekrete!



Në vitin 1693, pas më se 24 vitesh punë të lodhshme laboratorike, Njutoni në shënimet e tij thekson se kishte arritur ta zbulonte „Gurin e dijës”! Ai shkruan se kishte zbuluar një lloj „zhive të gjallë”, e cila mundëson krijimin e arit. Megjithatë, mbetet enigmë, pse Njutoni nuk eksperimentoi më kurrë në këtë drejtim dhe as që la ndonjë shënim tjetër, deri në fund të jetës së tij!

Athua përmbajnë ato fjalë të njutonit, bazuar në eksperimentet praktike, një sekret që është duke e kërkuar edhe

sot njerëzimi?! „Tërë përpjekjet e shkencës nuk janë asgjë tjetër përpos kërkime për jetën e amshuar, e gjithashtu edhe tërë përpjekjet e religjioneve nuk janë asgjë tjetër përveçse kërkim për jetën e amshuar” - thoshte edhe filozofi i madh indian, Osho.

Në vitin 1968, hulumtuesja e fizikës bërthamore Judith Temperley, i bombardoi atomet e zhivës me energji të fuqishme neutronesh, derisa njëri prej atomeve e humbi një proton. Dhe, atëherë, pasoi ajo që ishte ëndërr e alkimistëve shekuj me radhë: Një atom zhive u shndërrua në atom ari! Ekzistuaka vërtet një shteg për prodhimin e arit?...

Kuptohet se alkimistët nuk kishin në dispozicion mjete të sofistikuara, të cilat i disponon shkenca moderne, andaj edhe veprimtaria e tyre në fushën praktike ishte e kushtëzuar, megjithatë, dija dhe pasioni i tyre ishte tepër i madh. Secili alkimist i m„irëfilltë njihte edhe gjuhën „enigmatike” të formulave të shkruara. Formulat e shkruara të alkimistëve, jo vetëm që mbaheshin sekret, por edhe po të bëhej publik një shkrim i tillë, ishte pothuajse e pamundur të deshifrohej e të kuptohej përmbajtja e tij! Ja si e përshkruan formulën e gjetjes së arit dhe pastrimit të tij, alkimisti Basilius Valentinus: „Merreni një ujk koprrac, ngjyrë gri. I gjetur ndër lugina dhe male. Me një uri përpirësi. Hidhe atë para trupit të një Mbreti. Pasi ta gëlltit Mbretin, ndiz një zjarr të madh dhe hidhe ujkun mbi të. Të digjet i tëri. Kështu, Mbreti do të lirohet sërish. Kur kjo të ndodh tri herë, luani ka mposhtur ujkun. Dhe nuk do të mbetet aty më gjë për konsumim. Atëherë është trupi ynë i përsosur tek fillimi i punës sonë.”

Çfarë fshehët prapa kësaj formule? Studiuesit e kësaj fushe tërheqin këtë paralele: nga shtimi i antimonsulfatit tek aliazhi (përzierje) ar - argjend, përfitohet një legurë, ari-antimon. Gjatë

nxehjes në temperatura të larta, digjet antimoni dhe mbetet ari i pastër. Ky proces përdoret edh sot e kësaj dite për pastrimin e arit. Ta cekim se vetë ari i pastër, prej 18 karatësh, ka një përbërje prej vetëm 50% të atomeve të arit, ndërsa ari më i përhapur në botë, ai me siglën „333”, vetëm 18%.

I pasionuar pas alkimisë ishte edhe gjeniu Leonardo da Vinçi. Në kërkim të „eliksirit të jetës”, ai kishte çarë me dhjetëra trupa njerëzish të pajetë. Ditën pikturonte „Darkën e fundit”, ndërsa natën eksperimentonte fshehurazi në kufoma njerëzish, pasi në atë kohë, për një veprim të tillë dënoheshe me vdekje. Edhe pse Leonrado nuk arrita ta gjejë „eliksirin e jetës”, as në gjakun e as në zemrën e kufomave, megjithatë ai arriti të zbulojë i pari sistemin e qarkullimit të gjakut dhe të dëshmojë se arterioskleroza në enët e gjakut është shkaktar i sulmeve në zemër.

Kur jemi tek Leonrado dhe veprat e tija, pothuajse përherë enigmatike, që edhe lënë shumë mundësi interpretimi, po e cekim portretin e „Marias”, të cilën ai e kishte paraqitur në disa piktura të tij. Duke e pas parasysh qëndrimin e tij ndaj ateist supozohet se Maria e paraqitur në veprat e tij, e veçanërisht figura e saj tek piktura shumë e njohur murale në kishën Santa Maria delle Grazie të Milaons, „Darka e fundit”, nuk paraqet Shën Marien - Zonjën e Bekuar, por një Maria tjetër - Maria Prophetissa. Maria Prophetissa ishte një hebreje që kishte jetuar në Egjiptin antik dhe e cila nga alkimistët ishte shpallur „Shenjtore”. Ajo ishte formuluese e principit, sipas të cilit, secila substancë në Tokë ka një trup dhe një shpirt, pasuese e

parimit të njohur dhe të pranuar shumë më vonë edhe shkencërisht, ku thuhet se secili element ka veti specifike.

Ndoshta nuk do të ishte e tepër të shkruhet në këtë artikull edhe për shkrimtarin dhe filozofin e shquar, Gëte (Johann Wolfgang von Goethe), gjegjësisht për motivimin e tij për njërën nga veprat më të famshme botërore - „Faustit". Në dhjetor të vitit 1768, kur Gëte ishte vetëm 19 vjeçar, goditet nga një sëmundje e rëndë. Mjekësia e atëhershme u tregua e pasuksesshme. Dr. Metz, një alkimist i njohur, megjithatë i mban shpresat e ndezura! Ai e përgatit një pije të cilën ia jep Gëtes për ta pirë. Dhe si me magji, pas disa orësh, Gëte filloi ta rimarrë veten dhe u shërua plotësisht. Që nga ajo ditë, e deri në fund të jetës, ai iu përkushtua alkimisë. Aty gjente inspirimin për veprat e veta, edhe për „Faustin" e famshëm, vepër të cilën ia përkushtoi tërësisht mjekut, shpëtimtarit të tij, Dr. Metz-it.



Dhe ta përfundojmë këtë pjesë me një zbulim mjaft interesant. Dy gjeologë nga Zelanda e Re, Stuard Simmons dhe Kevin Brown, pasi i rishikuan edhe disa herë shënimet, paraqitën para mediave të dhënat e tyre sensacionale: Ata kishin zbuluar, në shtetin e vogël të kontinentit australian Papua-Neuguinea, një minierë ari me kapacitet enorm! Në kushte normale, nevojiten miliona vjet derisa të krijohet një rremb ari në një masë gurore. Në minierën Ladolam, në Papua-Neuguinea, për një proces nevojiten vetëm 55 000 vjet!

Ari deponohet në shtresat gurore, nëse ai më parë është larë me ujë që buron nga shtresat e thella të tokës me temperaturë mbi 200 gradë celsius dhe i cili ka përmbajte të squfurit. Simmons dhe Brown me zbulimin e tyre dëshmuan bindjet e alkimistëve! Ata thonë: „Nëse shkohet me këtë sistem, vetëm

brenda disa dekadave, mund të rimbushen sërish me shtresa ari shkëmbinjtë e një miniere”.

Për atë që alkimistët ishin të bindur që moti se ari „rritet” (krijohet) nga dheu, e vërtetojnë edhe zbulimet më të reja shkencore të shkencëtarit australian, Frank Reith. Ai hulumtoi gjatë nëpër galeritë nëntokësore të minierave të arit dhe aty zbuloi një lloj baktere e cila nga përmbajta e dheut thith një sasi tejet të vockël ari dhe e deponon në trupin e vet. Pse e bën këtë? Mikrobiologu Derek Lovley, nga Universiteti i Masachusetts në Amherst, thotë: „Ato baktere e shfrytëzojnë arin, sikurse ne oksigjenin!”. Me këto baktere Lovley eksperimenton edhe në laborator. Brenda disa ditësh thërrmija tejet të imëta ari dukeshin në thjerrëzën e mikroskopit. Këto baktere energjinë e tyre e tërheqin nga metalet e liruara në ujë. E për ta zhvilluar një proces të ngjashëm, Lovley gjatë eksperimentimit, futi në ujë elektrone të cilat provokonin lirimin e mineraleve, pra edhe të arit, të cilin e absorbonin pastaj këto baktere. Athua kishin arritur edhe alkimistët ta vrojtonin një gjë të tillë?! Sidoqoftë, ata ishin të bindur për lidhshmërinë mes materieve të gjalla dhe atyre, të ashtuquajtura „të vdekura”. Ata i njihnin ligjet e hermetizmit, sipas të cilave jeta është një dhe e pandarë, por format në të cilat ajo paraqitet janë pambarimisht të shumëllojshme dhe të ndryshme. Për ta, ndarja e botës në „materie të gjallë” dhe „të vdekur” është koncept i rrejshëm. Edhe ato gjëra që nga forma e jashtme duken të „vdekura”, siç është edhe ari, në fakt, në to ç’thuren energji enorme të atomit, por lëvizja harmonike e elektroneve rreth bërthamës së atomit, dhe shpejtësia e tyre tejet e madhe, reflektojnë tek receptorët tanë (që mjerisht janë të kufizuar,) ngurtësinë e metalit, gjegjësisht të ari.



ALKIMIA NË PLANIN SHPIRTËROR (PSIKIK)

Energjia, materia dhe jeta janë tri shikime të manifestimit ekzistencial - harmoni universale e hyjnores dhe tokësores, krijuesit dhe njeriut - mu ashtu siç thotë edhe Ligji i Hermesit: „Si poshtë, është lart, si lart është poshtë". „Si është makrokozmosi, ashtu është edhe mikrokozmosi" - një ndërlidhuri ndërmjet pjesëve më të imëta të materies dhe atyre më gjigante që lëvizin në gjithësi. Çdo lëvizje provokohet padyshim nga një lloj energjie, sakaq, energjia është vetia themelore e materies, burimi i një aksioni, i një veprimtarie.

Gjithçka që ekziston, si në univers ashtu edhe tek qenia njeri, ekziston në njërën nga gjendjet e katër elementeve themelore ose ambientale, që ne po i quajmë elemente kozmike. Gjithçka që është krijuar, që krijohet, kalon nëpër këto katër elemente kozmike, nëpër këtë nyjë të procesit evolutiv, nga trajta më e ulët, drejt më të lartës, duke pësuar edhe ndryshime, duke u transformuar nga një gjendje në tjetrën.

Elementi i tokës - Elementi bazë i veprimtarive në fushën e alkimisë, por edhe zanafilla e krijimit të njeriut (sipas religjioneve) nga Krijuesi. Shkenca (që njeh deri më sot 92 elemente natyrore) ka vërtetuar se pothuajse të gjitha elementet që ekzistojnë në natyrë, ekzistojnë edhe tek qenia njeri. Edhe alkimistët eksperimentet e tyre i kanë zhvilluar duke përdor këta elementë natyrorë, por edhe Zoti, m'u nga këta elementë përbërës ka modeluar krijesës më të përsosur - njeriun. Toka paraqet stabilitetin, peshën, masën. Edhe në planin material (fizik) edhe në atë shpirtëror (psikik), elementi i tokës përfaqëson bazën elementare të ekzistencës.

Elementi i ujit - Uji është element pastrues, ndërtues, ushqyes dhe burim i domosdoshëm për jetën. Dheu pa ujë do të thahet për pak kohë - do të bëhet shkretëtirë, nuk do të ketë më vlerë, pasi nuk mund të japë asnjë lloj fryti. Secili nga ne e dimë

se, për të krijuar brumin fillestar të diçkaje, është i domosdoshëm elementi i ujit. Me këtë brumë kanë eksperimentuar edhe alkimistët, po me këtë brumë (baltë), Krijuesi i ka dhënë formë krijesës së tij. Gjendja e ujit në rrethana normale, pa ndikim të ndonjë lloj energjie, është e qetë - jo aktive. Natyra e tij në këtë gjendje është e butë, por edhe e ftohtë.

Elementi i zjarrit - Veti bazë e elementit të zjarrit është nxehtësia. Ngritja e temperaturës vë në lëvizje grimcat e trupave dhe me këtë aktivizon energjinë e cila është burimi i vitalitetit, entuziazmit, aktiviteteve, pra fuqi e gjithëmbarshme, që kuptohet - ndërton ose rrënon. Derisa natyra e tokës dhe ujit është e qetë, natyra e zjarrit është gjithnjë aktive, shpërthyese, ekspansioniste. Elementi i zjarrit i vë në lëvizje edhe elementin e tokës edhe të ujit. Brumi i krijuar nga dy elementët e parë, me ndihmën e elementit të zjarrit, finalizohet.



Elementi i ajrit - Ajri është element i përsosmërisë, element që drejtpeshon, që plotëson çdo gjë, element që i jep jetë formës së finalizuar nga tre elementët tjerë, mu ashtu siç i dha jetë përmes frymës, krijesës së modeluar nga balta, vetë Krijuesi. Këta katër element janë edhe baza e ligjit të amshueshmërisë, ligjit të përhershëm të ndryshimeve: lindjes, zhvillimit, transformimit, shpërbërjes.

Këtu qëndron edhe magjia, sekreti i alkimisë së brendshme, asaj në planin më të lartë të niveleve të mundshme shpirtërore: lëvizja drejt formave më të larta të përsosmërisë ekzistenciale, transformimi nga përbërja më e ulët, ajo materiale, që herdokur

shpërbëhet dhe i kthehet elementit të tokës, drejt trajtës më të lartë, elementi eterik, bashkimit, njësimit, me unin e vërtet, me vetë shpirtin, me frymën e Krijuesit. Sinteza e të qenit një me Krijuesin, në fakt, ishte dhe mbetet synimi parësor i alkimistëve.

Ndërsa në nivelet më të ulëta të transformimit shpirtëror, thënë më thjesht, në jetën e përditshme, sekreti i alkimisë së brendshme qëndron në jetësimin e synimeve përmes formave të ndryshme psikologjike. Këtu bëhet fjalë për transformimin e vetive negative, gjegjësisht shprehive dhe emocioneve të padëshiruara, në veti pozitive: urrejtjen në dashuri, dëshpërimin në gëzim, vuajtjen në lumturi, mjerimin në mirëqenie, frikën në guxim, dështimin në sukses etj: me një fjalë, transformimin e mendimeve.

Trupi i njeriut edhe në nivelin më të ultë të transformimit, në planin shpirtëror, paraqet elementin e tokës - bazën elementare të ekzistencës, strukturat e përgjithshme të molekulave organike.

Të gjithë e dimë se trupi ynë përbëhet nga një përqindje e madhe e ujit: kockat e njeriut përmbajnë 22% të lëngut të ujit, shtresimet dhjamore 25%, indet muskulore përmbajnë rreth 75%, ndërsa plazma e gjakut përmban mbi 90% të këtij elementi jetësor. Megjithatë uji ndryshon gjendjen varësisht prej temperaturës - nën minus 0 gradë, molekulat tërhiqen fort dhe nuk lëvizin, dhe kështu uji kalon në gjendje të ngurtë. Kjo gjendje është e pavlerë - nuk ka aktivitet. Në nyjën e procesit transformues shpirtëror (psikologjik), njeriu në këtë gjendje është pasiv, pa vullnet, i dëshpëruar, i demoralizuar, i mjerë, depresiv. Mund të thuhet se kjo është gjendje e pajetë e njeriut.

Me rritjen e temperaturës, molekulat fitojnë energji dhe „rrëshqasin” mes tyre, duke ndryshuar gjendjen në të lëngët. Në këtë gjendje, gjithnjë në nyjën e procesit transformues shpirtëror, fillojnë të mbushen hapësirat dhe të nivelizohen ato. Edhe këtu aktivitetet janë të kufizuara ose, sipas ligjit të zakonshëm të ujit, ato „rrëshqasin” të pakontrolluara, varësisht

prej rastësive, kuptohet tatëpjetë! Dëshpërimi apo gëzimi, vuajtja apo lumturia, mjerimi apo mirëqenia, suksesi apo dështimi janë produkte të rastësisë. Ky proces i takon elementit të ujit.

Për ta vënë në lëvizje këtë përbërës kryesor të trupit të njeriut, për t'i kontrolluar mendimet, për të synuar caqet e dëshiruara, jetësimin e tyre, nevojitet energji. Është nxehtësia - elementi i zjarrit që ngrit temperaturën, aktivizon energjinë e cila, siç e kemi cekur edhe më lart, është burim i vitalitetit, burimi i motivimit, burimi i frymëzimit, burim i imagjinatës, burim i entuziazmit, burim i të gjitha aktiviteteve mendore për realizimin e qëllimeve të përcaktuara. Kjo energji shpërthyese aktivizon neuronet tona, i vë në lëvizje miliarda qeliza, molekulat e të cilave fitojnë aq shumë energji, sa përhapen në të gjitha drejtimet duke kaluar kështu në gjendje të gaztë, në avull.

Avulli - elementi i ajrit, ngjitet përpjetë, lëviz me lehtësi drejtë lartësive, atje ku është gjithçka e kristaltë, e përsosur dhe hyjnore. Edhe pse në dukje të lë përshtypjen e një energjie të qetë ose thënë më saktë, të plogësht, megjithatë fuqia e tij është enorme! Është aq e madhe kjo fuqi saqë, siç e dimë të gjithë, është në gjendja ta vë në lëvizje një kompozicion të madh

vagonësh treni, qindra tonelatash të rëndë. Ky është sekreti i alkimisë së brendshme, asaj transcendentale: i njëjti komponent, e njëjta përbërje - H2O, por në procesin transformues, me fuqi tërësisht të ndryshme.

SUKSESET NË FUSHËN SHKENCORE

Lirisht mund të thuhet se alkimistët ishin më shumë se „prodhues ari" dhe magjistarë! Ata i dhuruan botës, e në veçanti Evropës, artin e shkencës - ishin pionierë në shërbim të saj. Megjithëse ata veprimtaritë e tyre i bazonin në katër elementet themelore ambientale (dhe të pestin, elementin eterik - akashën, që konsiderohet elementi fillestar krijues ose elementi i (para) origjinës), një numër i konsiderueshëm i elementeve kimike që sot shkenca i njeh (gjithsej 114 - natyralë dhe artificialë), janë produkt i punës së alkimistëve. Gjithashtu edhe shumë pajisje, që edhe sot e kësaj dite përdoren në laboratorë të ndryshëm, sikurse janë epruvetat nga qelqi, janë zbulimi i alkimistëve, si dhe shumë zbulime të tjera të suksesshme pa të cilat shkenca e sotme do të ishte tejet e varfër.

Ishte Paracelsusi (Philippus Aureols), mjeku dhe alkimisti antik, i cili analizoi trupin e njeriut dhe e konsideroi atë si një sistem të proceseve kimike dhe erdhi në përfundim se lëndë kimike të përfituara nga bimët ndikojnë në trupin e njeriut dhe mund ta shërojnë atë. Ishte ky sinjali i parë prej të cilit lindi kimia farmaceutike dhe mjekësia shëruese alternative (fitoterpia).



Në librin e tij, të vitit 1536 „Medikamenti i mrekullive të

mëdha", Paracelsusi përshkruan bazamentin e hulumtimit të qelizave, një çelës i teknologjisë së shekullit 21: „Zemra shëron zemrën, mushkëria shëron mushkërinë, shpretka shëron shpretkën; e njëjta shëron veten." Asgjë tjetër nuk bën as terapia qelizore: qelizat e marra nga pacienti përgatiten në laborator dhe sërish injektohen në organin e dëmtuar. I njëjti princip vlen edhe në sferën e transformimit shpirtëror - është mendja ajo që shëron, forca jonë e brendshme, janë mendimet pozitive baza shëruese e të gjitha deformimeve psikike, pra ne jemi shërues të vetvetes, siç jemi edhe kreatorë të ardhmërisë - të lumtur ose plot vuajtje, varësisht prej kahut të mendimeve. Dhe sërish po rikthehemi tek zanafilla, tek ligji i Hermesit: „Si poshtë ashtu edhe lart..." Dukja e botës suaj të jashtme është pasqyrim i botës suaj të brendshme, i botës së mendimeve. Mendimet janë zanafilla e çdo gjëje, e të gjitha proceseve psiko-fizike. Të menduarit është burim i një aksioni, energji, prej së cilës edhe çdo gjë fillon, një mekanizëm që vë në lëvizje gjitha proceset pasuese, pozitive apo negative, të brendshme apo të jashtme.

Alkimisti dhe mjeku francez, Jean-Baptiste Denys pohonte se kishte zbuluar një bar që shëron sëmundjet shpirtërore. Ishte i pari që injektoi gjakun e kafshëve tek njeriu - një të sëmuri psikik, një djaloshi të ri, ia injektoi gjakun e deles. Edhe pse djaloshi nuk u shërua, megjithatë, me përpjekjet e tij, Denys u bë njeriu i parë në historinë e njerëzimit që praktikoi transfuzionin e gjakut, mënyrë kjo e domosdoshme në mjekësinë e sotme.

Mjaft shumë është në praktikim e sipër, në fushën e hulumtimeve të shkencës së mjekësisë, edhe elementi më i dashur i alkimistëve, elementi më me vlerë, pasqyrimi i shkëlqimit dhe pastërtisë, përsosmërisë së Perëndisë - ARI. Në kohët e lashta ari konsiderohej si simbol i zemrës së njeriut dhe fuqisë së Zotit. Rëndësia dhe domethënia e veçantë e arit për njeriun nuk është zbehur aspak as në ditët sotme. Ari sot është barometër matës i zhvillimit ekonomik të një shoqëria. Rezervat

e depozituara të arit, janë siguria më e mirë e një shteti. Në raste krizash ekonomike, atëherë kur kartëmonedhat kthehen në letra pa vlerë dhe nuk luajnë më asnjë lloj roli, të gjithë kërkojnë që të gjejnë strehë te shkëlqimi „verbues" i arit.

Ari, po ashtu është ndër stolitë më të preferuara të njeriut, në veçanti i adhuruar tejet shumë nga gjinia e bukur. Zbukuruesi më i preferuar i qafës, dorës, gishtit. Cila dasmë mund të paramendohet pa prezencën e këtij metali të çmuar? Edhe në manifestime të ndryshme, e në veçanti në sport, garuesi më i mirë përherë nderohet me medalje të artë. Edhe personalitetet më të famshëm botërore dekorohen me medalje të artë. Pra, në planin material, ari merr formën e simboleve të ndryshme, por edhe në planin shpirtëror ari e ka po atë vlerë! Sa e sa herë kemi dëgjuar të vlerësohet mendimi i dikujt si i artë! Vepra e tij e artë... punë e artë... por edhe nderimi i një njeriu të dashur e të çmuar, të cilin, nga respekti që kultivojmë ndaj tij, i japim epitetin më të lartë, duke e konsideruar si - mikun/eshën e ARTË!

Edhe në figurat e pikturuara të shenjtorëve, gjegjësisht rreth kokës së tyre, gjithnjë shihet një aureolë e shkëlqyer, një kurorë e ndritshme ngjyrë ari, simbolikë e amshueshmërisë.

Por të kalojmë tek praktikimi i këtij metali me kaq shumë vlera, në fushën shëndetësisë. Sot shkenca ka arritur që arin ta kthejë edhe në tableta për trajtimin e sëmundjeve të artritit reumatik, si terapi për luftimin e qelizave kancerogjene, sëmundjes së AIDS-it etj. Hulumtimet dhe eksperimentimet e shumta kanë dëshmuar se strukturat e këtij elementi në mënyrë ideale i transportojnë nëpër trupin e njeriut lëndët (materiet) shëruese. Bile, ari vlerësohet të jetë edhe si mjet shumë i përshtatshëm për transportimin e gjeneve deri në qelizat e njeriut. Athua është ky metal lënda e parë për „Gurin e dijes", i

cili na udhëzon drejt „eliksirit të përjetësisë”? Alkimistët nuk patën sukses në zbulimin e tij, megjithatë rezultatet e sukseset e tyre në shumë fusha po i përjetojmë ne sot!

Me 21 korrik të vitit 1969, raketa „Saturn V” që po dërgonte për herë të parë njerëz drejt hënës, startoi falë zbulimit të alkimistit arab, Abu Musa Dshabir ibn Hayyan. Ky alkimist, që në shekullin e VIII të erës sonë, arriti të prodhojë për herë të parë acidin nitrik, acid i cili pati një sukses të jashtëzakonshëm dhe deri para pak vitesh ishte pjesë përbërëse e karburantit të raketave.

Shumë herët, para se rryma dhe poçet elektrike në dhomat tona ta transformonin natën në ditë, alkimisti Hennig Brand, në vitin 1669 duke kërkuar „Gurin e dijes”, nga eksperimentet e bëra me urinë zbuloi një lloj drite tjetër, dritën artificiale - fosforin, elementin e parë kimik të kohës së re. Më vonë u pa se kjo lëndë është më shumë se sa një burim drite për llamba nate. Me fosfor zhvillohen shumë më mirë dhe më shpejt edhe bimët. Sot fosfori shërben si lëndë bazë për përfitimin e fosfateve, një përbërës elementar i plehut kimik.

Në kërkim të një lënde absolutisht të pastër, e perfeksionuan alkimistët këtë lloj arti të distilimit, dhe arritën të përfitojnë alkoolin e pastër. Ata zbuluan për herë të parë një substancë me të cilën, përveç dezinfektimit, mund të tretej, pastrohej rrëshira, vaji dhe përbërës tjerë të kësaj natyre - asokohe shihej si mrekulli, ndërsa sot, gjë e rëndomtë por dhe e domosdoshme në përditshmëri.

Automobil pa bateri startuese (akumulator) - për kohën e sotme e pamundur! Por edhe bateria pa acid sulfurik është pothuajse e parealizueshme! Sot në botë prodhohen rreth 130

milion tonelata të këtij acidi. Me emrin Vitriol (lat. Vitrum - qelq), njihet që moti, dhe përmendet edhe ne shkrimet e alkimistit të njohur arab, Abu Musa Dshabir ibn Hayyan që kishte zbuluar edhe acidin nitrik. Mënyra e prodhimit përmendet edhe në shkrimet e alkimistëve, Albertus Magnus (1200–1280) dhe Basilius Valentinus (1600). Mirëpo, kërkimet e para shkencore për këtë acid dhe përdorimi i tij për nevoja praktike u realizua nga farmacisti, kimisti dhe alkimisti i njohur gjerman, Johann Rudolph Glauber (1604 -1670). Glauber ishte edhe themeluesi i fabrikës së parë kimike në botë, dhe njeriu i parë që kiminë e bëri profesion jetësor.

As fishekzjarrët me ngjyra të llojllojshme, që zbukurojnë qiellin në festa e manifestime të ndryshme, nuk do t'i kishim sot pa ndihmën e alkimistëve! Ky pluhur i zi (barut) u zbulua nga alkimistët kinez që në vitin 1044, por u perfeksionua përbërja e tij nga nitrat kaliumi, qymyrdruri dhe acidi sulfurik, nga alkimisti me pseudonimin Marcus Graecus. Meqë Kisha ndalonte veprimtaritë alkimiste shumë alkimistë, në atë kohë, veprat e tyre i shënonin me pseudonim.



Edhe libri, „Liber ignum ad comburendos hostes" - Libri mbi zjarrin për t'i djegur armiqtë, u shkrua me pseudonimin e Marcus Graecusit. Me recetat e tij, Marcus Graecus u bë edhe babai i këtij lloji eksplozivi. Tek më vonë, kur u zbulua dinamiti (në vitin 1886 nga kimisti suedez, Alfret Nobel, i njohur ne të gjithë globin për fondacionin e „Çmimit Nobel") dhe TNT-ja (ie zbuluar në vitin 1863 nga kimisti gjerman, Joseph Wilbrand), ky pluhur i zi mbeti nën hijen e tyre.

Që në antikë, alkimistët arritën të zbulojnë procesin e galvanizimit (veshjen e një sendi me një shtresë të hollë metali që nuk ndryshket). Sot, me këtë proces, shumë mjete të

ndryshme dekorohen (shtresohen) në dukje të jashtme, që nga rubinët e deri tek bizhuteritë e llojllojshme. Procesi i galvanizimit në esencë, megjithatë, ka mbetur i njëjtë që nga antika.

Me gjithë sukseset e alkimistëve (në mesin e të cilëve kishte koka gjenish) që, siç e kemi cekur edhe më lart, konsiderohen hulumtuesit e parë në histori, e të cilët bënë shumë zbulime të rëndësishme të pranuara edhe nga shkenca bashkëkohore e që sot gjejnë zbatim praktik pothuajse në secilën fushë të jetës, duke filluar nga dekoret personale, kuzhinat, automjetet e deri tek industria e rëndë, prapë se prapë, puna e tyre, veprat e tyre janë margjinalizuar dhe pakkush merr guximin të diskutojë për to, veçanërisht në rrethe intelektualësh - thjesht, sepse do të bëhesh objekt përqeshjesh. Mirëpo këta njerëz, me bindje të njëanshme, që mendojnë se epoka e kompjuterëve do t'i zgjidhë të gjitha dilemat tona, mashtrohen shumë keq! Shkenca nuk është shkop magjik! Shkenca është vazhdimësi pikërisht e këtyre traditave të vjetra hermetike. Ishin njohuritë e kohërave të vjetra, arti i popujve antikë, që gërshetonin në vete: misticizmin, filozofinë, religjionin etj., shkëndijat e para... flaka që mbajti pishtarin e ndezur, burimi i sukseseve të shumta me të cilat sot krenohet shkenca. Andaj, unë mendoj, se çdo hap i hedhur i shkencës drejt njohurive të reja në botën e madhërishme dhe plot sekrete të natyrës (që njeriut i janë të shpalosura vetëm pjesërisht), çdo zbulim që arrin ta bëjë ajo, në mos asgjë tjetër, së paku ta kthejë kokën prapa dhe ta falënderojë burimin. Po e përfundoj këtë shkrim me një thënie të mrekullueshme popullore: „KUR PI UJË, KUJTO BURIMIN!"

PËRFUNDIM

Duke e ndjerë mungesën e informimit mbi fenomenet e parapsikologjisë në mesin e shoqërisë sonë, vendosa që ta shkruaj këtë libër. Shpresoj se me botimin e këtij libri do të zbus sadopak mungesën e informimit në këtë fushë shumë interesante, duke sjellë njohuri të reja mbi këto dukuri, që janë fare pak të njohura tek ne.

Interesimi për t'u marrë me parapsikologji më ka lindur rastësisht. Pas leximit të një libri mbi hipnozën m'u zgjua kureshtja që ta zbatoj edhe vetë në praktikë. Kështu, edhe pse isha kundërshtar i këtyre dukurive, pas eksperimenteve të bëra, mbeta i mahnitur dhe m'u shtua kureshtja, edhe më, për vazhdimin e mëtejmë të këtij drejtimi. Eksperimentet e shumta, sidomos ato me hipnozë, m'i kanë ndryshuar mendimet e mia dhe kanë krijuar tek unë një bindje krejtësisht të re mbi natyrën, shoqërinë dhe njeriun.

Është shumë gabim të mendohet se fshehtësi nuk ka dhe se gjithë natyra është e studiuar dhe e sqaruar. Njeriu dhe shkenca posa kanë filluar studimin e shumë dukurive të panjohura dhe janë duke shkuar drejt zhvillimit inercial, por që premton shumë në të ardhmen. „Çudirat nuk ndodhin në kundërshtim me natyrën -thotë Shën Augustini, por vetëm me atë që ne e njohim si natyrë". Pra, natyra nuk i thyen ligjet e veta, jemi ne ata që nuk arrijmë t'i kuptojmë ato.

Para një përpjekjeje këmbëngulëse për sqarimin e mistereve në mënyrë sa më objektive, thjesht në mënyrë „fotografike", duhet të përgjigjemi në disa pyetje: Vallë, a është njeriu qenie mjaft e përsosur, që të mund të bëjë „fotografimin" e dukurive misterioze? Pastaj: a posedon shkenca ekzakte mjaft instrumente për regjistrimin e këtyre dukurive dhe interpretimin e tyre? Të gjitha këto janë çështje që duhet studiuar seriozisht, që të mund

të formulonim mendimin tonë për to.

Shumë njerëz, paraqitjet e pashpjeguara (jashtëshqisore) përpiqen t'i shpjegojnë si veti të pasioneve të tepruara ose si simptome të çmendurisë. Faktikisht, paranormalja merret si sinonim për abnormalen. Në shoqërinë tonë, normale konsiderohen sjelljet e shumicës, sepse ato ligjësi „normale" i ka krijuar vetë kjo shoqëri dhe ato janë regjistruar në psiken tonë që nga periudha e hershme e fëmijërisë, pastaj në shkollë e kudo gjetiu si ligje normale, ashtu që edhe ne i pranojmë si të tilla. Ndërsa çdo veprim jashtë këtyre ligjeve, konsiderohet jonormal! Mund të numërojmë shembuj të ndryshëm që flasin për norma e ligje të caktuara, që në një shoqëri konsiderohen plotësisht normale dhe të përditshme, sakaq në shoqërinë tjetër, zbatuesit e tyre do të mund t'i çonin në burg, spital apo në vdekje.

Gjatë kontakteve të mia me njerëz të profileve të ndryshme, ithtarë të okultizmit, të cilët kanë tentuar që të japin informacione mbi dukuritë parapsikologjisë, kam parë se janë ndeshur në pengesa aq të forta saqë shumicës prej tyre edhe i ka humbur dëshira dhe vullneti për t'u marre më tej me këto dukuri. Por, fatmirësisht, ndodhitë e shumta që ndodhin në popull, nuk lejojnë që të harrohen dhe të zhduken ato, kësisoj ato vetvetiu ruajnë vetveten. Sot, pikërisht, këto dukuri zgjojnë gjithnjë e më shumë interesim, jo vetëm të parapsikologëve dhe ithtarëve të tyre, por edhe të materialistëve e të personave të tjerë eminentë.

Shpresoj se shumë lexues të nderuar, pas leximit të këtij libri, do të shfaqin interesim më të madh për parapsikologjinë dhe do të bashkëpunojnë në ndriçimin e mëtejmë të këtyre dukurive enigmatike në mënyrë sa më objektive, duke mos ua lënë këto dukuri në duar vetëm predikuesve religjiozë apo skeptikëve materialistë, të cilët me interpretimet e tyre, qëllimisht spekulative apo komikisht naive, t'ua humbin vlerën e tyre të vërtetë.

Natyrisht, që në këtë libër nuk përjashtohen as lëshimet e

ndryshme që kanë mundur të ndodhin si rrjedhojë e shumë faktorëve, duke filluar nga literatura e pakët (për të mos thënë e aspakët) në gjuhën shqipe për këto dukuri e deri te mungesa e erudicionit profesional. Por, shpresoj se lexuesi objektiv do të ketë mirëkuptim për të gjitha lëshimet e mundshme, duke pasur në konsideratë qëllimin tim transparent dhe plotësisht të sinqertë për ndriçimin e këtyre dukurive në suazat e logjikës reale, pa varësi, bindje e kamuflime, por në mënyrë të lirë e të pavarur.

Autori

LITERATURA

1. Kurt Tepperwein, Die hohe Schule der Hypnose, Genf/München, 1993
2. Grup autorësh, Unerklärliche Phänomene.
3. Vojislav Stojanović, Hipnoza i autohipnoza, Beograd, 1968
4. Tony Buzan, Make the of your mind, Londër, 1977
5. Astrit Kasimati, Njeriu dhe bota e madhe e sportit, Tiranë, 1971
6. Velimir Filipović, Parapsihologija u praksi, Beograd, 1984
7. Raif Kasi, Čovek i magija, Prizren, 1992
8. E. A. Wallis Buge, Egyptian magic, 1920
9. Arnoldo Zanatta, Ji primo Manuele - Dizionario di pranoterapia profesionale K/Z, Milano, 1988
10. Paul Clement Jagot, Metode Pratique d'autosuggestion.
11. Alexandre Eidhoff, La parapsychologie, Paris, 1987
12. Idries Shal, Oriental magic, Londër, 1956
13. Velimir Filipović, Avanture psihe, Beograd, 1987
14. Jovo Marić, Astralna medicina, Beograd, 1988
15. Slobodan Paunović, Zlatna Zora, Beograd, 1987
16. Paul Chausherd, Hypnose et suggestion, Paris, 1950
17. Drago Plečko - Ana Babić, Zdravlje Bioenergija Joga, Zagreb, 1987
18. Miroslav Pinter - Đeli, Škola hipnotizma, Sarajevo
19. Momčilo Todorović, Hipnoza za svakog, Beograd
20. Jacques La Maya. La medicine de l'habitat, Londër, 1983
21. Peter S. Stanković, Božanstvena medicina, Beograd, 1939
22. Emil Kue, Ce que je dij, Paris, 1910
23. W. E. Butler, How to read the aura, Londër, 1982

24. Swami S. Saraswati, Yoga Nidra, Mongur Dihar, Indi, 1982
25. Živorad M. Slavinski, Psihički trening Jogija, Beograd, 1976
26. Živorad M. Slavinski, Simboli hermetizma, Beograd, 1977
27. Živorad M. Slavinski, Ključevi psihičke magije, Beograd, 1979
28. Živorad M. Slavinski, Psihoteronika, Beograd, 1987
29. Nikola Rot, Psikologjia e përgjithshme, Beograd, 1968
30. N. Rot - S. Radojnić, Psihologija, Beograd
31. M. Semorie, Super pamćenje, Beograd, 1976
32. Julia and Derak Parker, Dreaming, 1958
33. Barbara Ann Brenan, Hands of Light
34. Vasilije Kartelj, Najveće misterije sveta, Beograd, 1974
35. Besnik Spahiu, Psikologjia, Prizren, 1982
36. Petar B. Petrović, Kako ču naučiti da hipnotišem, Beograd
37. Stevan P. Petrović, Psihologija i mogučnosti zloupotrebe, G. Milanovac, 1984
38. Werner Keller, Was gestern noch als Wunder galt, Cyrih, 1974
39. Revistat, Tajne, 1988 - 1992, Beograd
40. Revistat, Treće oko, 1989 - 1993, Beograd
41. Revistat, Arka, 1988-1991, Sarajevë
42. Revistat, Galaksija, 1986-1993, 8eograd
43. Revistat, Vikend plus, 1988, Zagreb
44. Revistat, Faktor X, 1996 - 1997, Linda
45. Revistat , Wege Visionen, 1996 - 1997, Herrischried
46. Pajazit Nushi, Fjalor i psikologjisë, Prishtinë, 1986
47. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe. Tiranë, 1980
48. Mikel Ndreca, Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë, 1986

PËRMBAJTJA

PARATHËNIA 4
FJALA E RECENSENTIT 5
TEORITË EKZISTUESE MBI PREJARDHJEN E JETËS NË TOKË 8
TEORITË MBI PREJARDHJEN E NJERIUT NË TOKË..... 13
TRURI..... 25
FORCA E TRURIT 26
HISTORIA E ZHVILLIMIT TË TRURIT 30
PSIKOLOGJIA 37
PERIUDHA E ZHVILLIMIT TË PSIKOLOGJISË..... 40
KEQPËRDORIMI I PSIKOLOGJISË..... 43
Shpëlarja e trurit..... 44
Hipnoza 44
ESB 45
Narkotikët 45
PARAPSIKOLOGJIA 49
Ç'ËSHTË PARAPSIKOLOGJIA? 52
„GJENERATORI PSIKOTRONIK" 56
SUGJESTIONI DHE AUTOSUGJESTIONI 61
NATYRA E MENDJES 61
Ç'ËSHTË SUGJESTIONI DHE AUTOSUGJESTION? 62
FORCA E SUGJESTIONIT DHE AUTOSUGJESTIONIT 65
HIPNOZA 72

HISTORIA E HIPNOZËS 72
Ç¨ËSHTË HIPNOZA 80
NDIKIMI I HIPNOZËS 82
SI ARRIHET HIPNOZA 85
AUTOHIPNOZA 89
HIPNOZA NË MJEKËSI 92
Rasti i parë 97
Rastit i dytë 98
KEQPËRDORIMI I HIPNOZËS 98
Rasti i parë 102
Rasti i dytë 104
Rasti i tretë 111
FENOMENET E HIPNOZËS 119
MËSIMI ME NDIHMËN E HIPNOZËS 130
GJUMI DHE ËNDRRAT 134
Ç'JANË ËNDRRAT? 134
Ç'ËSHTË GJUMI? 136
VALËT CIKLIKE TË GJUMIT 137
PERIUDHA REM DHE FENOMENET TJERA TË GJUMIT 140
PSE ËNDËRROJMË? 143
ÇFARË NDIKON NË GJUMIN TUAJ? 145
Ç'ËNDËRROJNË FËMIJËT? 147
MAGJIA 149
ESENCA E MAGJISË 149

HAJMALITË DHE TALISMANËT 152
MAGJIA E BARDHË DHE E ZEZË 156
SIMBOLET..... 162
HERMETIZMI DHE NJERIU BASHKËKOHORË..... 163
LIGJI I HERMESIT..... 165
MAGJIA SEKSUALE 168
MAGJIA NË VEPRIM 169
Shërbimet me porosi! 170
Në „kthetrat” e sekteve 173
Rast i Grahama Nashes 181
Rast i Jeams Deanit..... 184
Rasti i vajzës nga Reçani 187
Rasti i 15 vjeçares L. 190
BIOENERGJIA..... 193
SHIKIMI NË SHPIRTIN E NJERIUT 197
Fotografia e Kirlianit..... 197
Aura..... 200
TELEKINEZA OSE PSIKOKINEZA 204
NDIKIMI I SHPIRTIT MBI MATERIEN 204
FORCA E MENDIMIT 212
TELEPATIA 224
RASTI MESING..... 228
DISA SHPJEGIME SHTESË MBI TELEPATINË 230
ALKIMIA 235
„ARTI I TRANSFORMIMIT!” 235

ALKIMIA NË PLANIN FIZIK 238
ALKIMIA NË PLANIN SHPIRTËROR (PSIKIK) 244
SUKSESET NË FUSHËN SHKENCORE..... 248
PËRFUNDIM 254
LITERATURA 257
PËRMBAJTJA 259

SABIR KRASNIQI

PARAPSIKOLOGJIA

Shkencë që troket në dyert e të sotmes

Përgatitja kompjuterike:
Sabir Krasniqi